

INSTITUTI I STUDIUMVE MARRKISTE-LENINISTE
PRIME KO TE PESH

ENVER HOXHA

DITAR

1955-1957

SHKURT I SHKURT
SHKURT I SHKURT
SHKURT I SHKURT

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

DITAR

1928-1929

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1987



ENVER HOXHA

PARATHËNIE

Ditari i shokut Enver Hoxha është pjesë përbërëse e veprës së tij teoriko-praktike. Ai është dëshmi autentike e angazhimit të përditshëm të udhëheqësit të dashur e të paharruar të Partisë e të popullit në veprimtarinë e gjithanshme politike, ideologjike, ekonomike e shoqërore për ndërtimin e mbrojtjen e socializmit në Shqipëri.

Në çdo faqe të kësaj vepre ndihen vendosmëria e shokut Enver për t'u shërbyer popullit, revolucionit e ndërtimit të socializmit në Shqipëri, lufta e guximshme dhe pa kompromis kundër gjithë armiqve imperialistë e revizionistë dhe agjenturave të tyre, që janë përpjekur ta devijojnë Shqipërinë nga rruga e socializmit. Përmes ndjekjes hap pas hapi të ngjarjeve, përmes evidencimit e analizave të fakteve e fenomeneve, në Ditar përvijohen me ngjyra të gjalla lufta e përpjekjet konkrete për të kapërcyer vështirësitë e brendshme e të jashtme dhe kontributi i udhëheqësit në ideimin e arritjen e objektivave të mëdhenj nga populli e Partia për industrializimin socialist, kolektivizimin e modernizimin e bujqësisë, për zhvillimin e arsimit, të kulturës, artit, shkencës, për fuqizimin e mbrojtjes së vendit.

Kudo ndihet gëzimi i shokut Enver Hoxha për sukseset, por edhe shqetësimi për vështirësitë, për të metat e dobësitë në fusha të ndryshme të jetës. Përkrah këtyre shqetësimeve janë kurdoherë të pranishëm mendimi, idetë e këshillat për kapërcimin e tyre.

Ditari është një dëshmi tërësore, por edhe një element i veçantë i rëndësishëm i metodës së punës të shokut Enver Hoxha. Shënime për biseda e veprime, për libra e ngjarje shoku Enver Hoxha ka mbajtur qysh në rininë dhe ky zakon i vjetër, siç është shprehur ai vetë, iu kthye gradualisht në natyrë e metodë pune. Në mënyrë të veçantë nga viti 1955 e këtej Ditari kthehet në një komponent të përhershëm të ditës së tij të punës. Në faqet e Ditarit ai hidhte mendime, fiksonte takime, ngjarje ose probleme të veçanta, meditonte për to e për ngjarje dhe dukuri të tjera që lidheshin me momentin e të ardhmen e Partisë e të popullit, me ndërtimin e mbrojtjen e socializmit në Shqipëri. Ditari u kthye kështu edhe në plan pune për udhëheqësin, edhe në bilanc për këtë punë; ai ishte parapërgatitje për analizat e thelluara të fakteve e të ngjarjeve.

Përmes shënimeve e refleksioneve të kësaj vepre duket procesi konkret i lindjes dhe i zhvillimit të ideve, i ndjekjes dhe i depërtimit në thelbin e ngjarjeve, preokupimi i përhershëm i udhëheqësit për formulimin, zhvillimin e zërthimin e orientimeve e të direktivave të Partisë, për kuptimin e zbatimin si duhet të tyre në jetë. Trajtimin teorik të problemeve shoku Enver e shikon në lidhje të ngushtë e në funksion të zgjidhjes së tyre në praktikë, ndaj shtjellimi i ideve e i detyrave gjithmonë shoqërohet me përcaktimin e masave për zba-

timin e tyre e, më tej, me ndihmën e kontrollin e partisëm për zgjidhjen me konsekuencë të detyrave të caktuara. Ky tipar themelor, shembull i ndritur për përsosjen e metodës së punës të çdo komunisti, kuadri e drejtuesi të organeve të Partisë, të shtetit e të ekonomisë, mbështetet e buron nga lidhja e ngushtë me popullin, nga përpjekja e vazhdueshme për të tërhequr e sintetizuar mendimin dhe përvojën e masave.

Vite më parë, në ndihmë të komunistëve, kuadrove e specialistëve të politikës së jashtme, u përgatit një botim serial arkivor për përdorim të brendshëm, ku u përfshinë thujtë gjithë shënime, refleksionet e analizat e Ditarit të shokut Enver që i takonin politikës së jashtme të PPSH e të shtetit shqiptar; marrëdhënieve me partitë komuniste e punëtore; luftës kundër imperializmit e reaksionit ndërkombëtar; kundër varianteve hrushovian, titist, eurokomunist e kinez të revizionizmit modern; gjendjes në vende e rajone të ndryshme të botës, veçanërisht në Ballkan, në Lindjen e Mesme, në Kinë etj.

Ndërkohë, një pjesë e këtyre shënimeve të Ditarit është botuar në shqip e në disa gjuhë të huaja edhe për publikun e gjerë në përmbledhje tematike si: «Shënime për Kinën», «Shënime për Lindjen e Mesme», «Dy popuj miq» e «Superfuqitë». Këto shënime që do të përfshihen në vëllimet e Ditarit, do të dallohen nga një yllth(*) i vendosur te data e tyre.

Botimi i tanishëm i Ditarit, që zë fill me këtë vëllim, përfshin periudhën 1955-1985 dhe destinohet për publikun e gjerë. Në këtë seri janë përfshirë shënime, analiza, meditime të përditshme për çështje të politikës

së brendshme e të jashtme. Janë lënë jashtë disa shënime të shkurtra pa komente e vlerësime për vizita ose takime protokollare, një numër i kufizuar shënimesh përmbajtja e të cilave ende nuk mund të publikohet, si dhe pjesa më e madhe e shënimeve të «Ditarit familjar».

Në vëllimin e parë të Ditarit përfshihen shënime, refleksione, mendime e analiza për momente e ngjarje të një periudhe 3-vjeçare (1955-1957). Është periudha kur populli dhe Partia i janë përveshur punës me vull për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit në Shqipëri. Në krye të Partisë, shoku Enver Hoxha orienton e udhëheq shndërrimet e mëdha në bazën ekonomike e në superstrukturë, reflekton, mediton, ideon, interesohet e ndikon drejtpërsëdrejti për ndërtimin e veprave industriale, për krijimin e fuqizimin e kooperativave bujqësore, për zhvillimin e arsimit, të kulturës, të artit e të shkencës, për mbrojtjen dhe forcimin e Partisë e të diktaturës së proletariatit.

Një vend të rëndësishëm në këtë vëllim të Ditarit zënë shënimet që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të PPSH e të shtetit shqiptar në vitet 1955-1957, me marrëdhëniet mes partive motra komuniste e punëtore e, në mënyrë të veçantë, shënime të pasqyrojnë procesin e njohjes nga PPSH të revizionizmit modern që po hidhte rrënjë e forconte pozitat në PK të BS e në shtetin sovjetik, pas ardhjes në fuqi të ekipit hrushovian. Është periudha kur hrushovianët konsolidojnë pozitat e veprojnë më hapur për vënien në jetë të planeve tradhtarë, afrohen me titistët, vënë në hije e dënojnë me

egërsi veprën e J.V. Stalinit, inkurajojnë gjallërimin e oportunitizmit në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ushtrajnë presion për rehabilitimin e armiqve të dënuar në vendet e tjera të kampit socialist. Shoku Enver Hoxha, që ndjek me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve, që analizon me gjakftohtësi e në mënyrë dialektike çdo deklaratë e veprim të udhëheqjes sovjetike, lufton për mbrojtjen e respektimin e parimeve e të normave marksiste-leniniste në marrëdhëniet mes partive komuniste, reagon me guxim ndaj pikëpamjeve e veprimeve anti-marksiste të hrushovianëve dhe vihet në ballë të luftës e kontribuon drejtpërsëdrejti për mbrojtjen e pastërtisë së vijës së PPSH dhe për shpartallimin e gjithë tentativave të armiqve të brendshëm, të cilët synonin degjenerimin revizionist të PPSH.

Në faqet e këtij vëllimi duket rruga konkrete nëpër të cilën ka ecur e është realizuar njohja e revizionizmit modern hrushovian. Në këtë periudhë ende nuk është krijuar bindja e plotë për tradhtinë e udhëheqjes sovjetike. Njohja vjen duke u thelluar me zhvillimin e ngjarjeve dhe analizave marksiste-leniniste të zigzageve të udhëheqjes revizioniste sovjetike, me Hrushovin në krye. Në çdo moment spikat vigjilenca, shpirti internacionalist e atdhetarizmi i zjarrtë i shokut Enver Hoxha.

Botimi i Ditarit do t'u shërbejë komunistëve e kuadrove për të njohur më mirë rrugën luftarake e konsekuencën në zbatimin e vijës së Partisë, kontributin e drejtpërdrejtë të shokut Enver Hoxha në përcaktimin e vënien në jetë të kësaj vije, figurën madhore të udhëheqësit e të komunistit të devotshëm, birit më të shtrenjtë e më të dashur të popullit, internacionalistit, mikut të

madh të komunistëve e të revolucionarëve të vërtetë të të gjithë botës dhe, mbi të gjitha, për të mësuar nga metoda dhe stili në punë i shokut Enver. Nga kjo vepër ata do të mësojnë, siç thotë shoku Ramiz Alia, «... si ta duan e të jetojnë me popullin, ... si ta duan e ta mbrojnë atdheun, si të luftojnë për lumturinë e përparimin e tij, si të ruajnë e të zhvillojnë kurdoherë frymën revolucionare e internacionaliste».

Ditari është i pajisur me tregues.

1955

1955

1 JANAR 1955

**E SHTUNË
1 JANAR 1955**

Gëzuar Vitin e Ri 1955! E njëmbëdhjeta herë që i themi gëzuar njëri-tjetrit në Shqipërinë e lirë e sovrane. I njëmbëdhjeti vit, që do të vazhdojë t'i sjellë popullit ditë më të mira, më shumë prodhime industriale e bujqësore, më shumë bukë, veshje, banesa e më shumë kulturë. Në rrugën e socializmit jeta e popullit tonë do të përmirësohet nga viti në vit. Ky është ligj për ne dhe asnjë vështirësi e presion i bërë nga kushdo qoftë nuk do t'i shmangin kursesi Partinë dhe Qeverinë tonë nga puna e lufta për realizimin e këtij objekti të madh.

E MËRKURE
9 SHKURT 1955

Kërkesa e Malenkovit për t'u liruar nga detyra e kryetarit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Sovjetik më shumë më shqetëson sesa më çudit. Do të dëshiroja që arsyeja të ishte ajo që thuhet në «Deklaratë»¹. E kam në sy Malenkovin në takimin e vjetshëm të qershorit². Ai u bë baltë në fytyrë dhe nuk reagoi fare kur Hrushovi³ foli, dhe për mendimin tim jo pa tendencë, për rolin e autoritetin e sekretarit të parë të partisë, duke ua kundërvënë këto atyre të kryeministrit. Qysh atëherë e kuptova që autoriteti i Malenkovit qe tronditur, por e kam vështirë të besoj që ai u bind kaq shpejt e pa «ndihmën» e të tjerëve për paaftësinë e vet. Kjo deklaratë me frymë të theksuar autokritike, ku

1. Më 8 shkurt 1955, në seancën e përbashkët të dy dhomave të Sovjetit Suprem të BS, Sovjetit të Bashkimit dhe Sovjetit të Kombësive, u lexua dhe u miratua deklarata e G. M. Malenkovit për ta liruar nga posti i kryeministrit.

2. Në qershor 1954, në krye të një delegacioni, shoku Enver Hoxha u takua dhe bisedoi me disa nga udhëheqësit kryesorë të PK të BS për realizimin e kërkesave tona ekonomike nga pala sovjetike.

3. Në atë kohë Sekretar i Parë i KQ të PK të BS.

duket qartë kujdesi për t'i mbyllur shtigjet lindjes së çdo pikëpyetjeje për këtë akt legal, sikur e shton më tepër dyshimin për forcën e unitetit në udhëheqjen sovjetike. Më duket sikur bëj faj që mendoj kështu për udhëheqjen e partisë së dashur të Leninit e të Stalinit, por... qofsha unë i gabuar.

Sot u hap Kongresi i 4-t i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, të cilin e përshëndeta në emër të Partisë sonë të Punës, të Komitetit të saj Qendror dhe të Qeverisë¹.

Klasa jonë punëtore ka sot dy gëzime, përveç kongresit feston edhe 10-vjetorin e themelimit të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.

Kongresi ishte plot gjallëri dhe entuziazëm. Në fytirat e qeshura të delegatëve, të ardhur nga të katër anët e vendit, dukej ndjenja e gëzimit për fitoret e arritura dhe besimi i patundur për të ardhmen e ndritur socialiste që i buzëqesh Shqipërisë.

Ne kemi një klasë punëtore të mrekullueshme që është e re, por e pjekur dhe revolucionare, ajo është e ndërgjegjshme për rolin e madh që i takon si klasa udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë.

M'u bë zemra mal nga entuziazmi dhe gjallëria e delegatëve në kongres. Në sytë e tyre shprehej qartë dashuria e pakufishme për Partinë tonë të lavdishme, që po e udhëheq popullin nga fitorja në fitore.

Punimet e kongresit vazhdojnë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 208.

Shokët sovjetikë na vunë zyrtarisht në dijeni për problemin e Malenkovit. Plenumi i fundit i KQ të PK të BS e ka shqyrtuar në mënyrë të veçantë veprimtarinë e këtij shoku dhe ka vendosur shkarkimin e tij nga posti i kryeministrit. Siç del nga vendimi i plenumit, që na erdhi së bashku me një letër shoqëruese të firmosur nga N. S. Hrushovi, një barrë fajesh i ngarkohen Malenkovit¹. Nuk kemi arsye t'i vëmë në dyshim ato që thuhet në adresë të tij, por nuk arrijmë ta kuptojmë pse vazhdon të mbetet ky shok anëtar i Presidiumit të KQ të PK të BS dhe është emëruar zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave e ministër i Stacioneve Elektrike të BRSS?! Me «gjynahet» që numërohen në vendim, Malenkovi nuk duhej kurrsesi të qëndronte në këto poste të larta të partisë e të pushtetit.

1. Në këtë vendim G. M. Malenkovi akuzohej për një sërë gabimesh politike, për lidhje tepër të ngushta me Berian e për veprime të dënueshme të kryera së bashku me të pas shpinës së udhëheqësve të tjerë të partisë e të qeverisë dhe për pretendim të hapët për të marrë në dorë edhe udhëheqjen e Presidiumit të KQ të PK të BS.

E DIEL
13 SHKURT 1955

Vazhdon seria e takimeve dhe e bisedave të gjata të udhëheqësve kryesorë sovjetikë me grupin e gazetareve amerikanë¹. Pas Molotovit², Hrushovit dhe Zhukovit³, ata i pritën dhe Bulganini⁴. Natyrisht, është e drejta e tyre të bisedojnë me kë të duan, por nuk arrijnë të kuptojnë cili është qëllimi dhe interesi i botimit të këtyre bisedave, me konsideratat dhe pyetjet «sipas stilit amerikan» dhe me përgjigjet, në ndonjë rast jo shumë serioze, në faqet e para të shtypit sovjetik. Thuhet se kjo bëhet «për të ndihmuar opinionin të njohë pozitën e të dyja palëve». Por a mund të justifikohet me këtë vënia e organeve të shtypit në dispozicion të propagandimit të pikëpamjeve të imperializmit më të egër e më agresiv?!

1. Gazetarët amerikanë V. R. Hërst, J. Kingsberi-Smith dhe F. Konife vizituan BS gjatë muajve janar-shkurt 1955.

2. V. M. Molotov, në atë kohë nënkryetar i parë i Këshillit të Ministrave dhe ministër i Punëve të Jashtme të BRSS.

3. G. K. Zhukov, në atë kohë ministër i Mbrojtjes i BRSS.

4. N. A. Bulganin, në atë kohë kryetar i Këshillit të Ministrave të BRSS.

Dhe gazetarët amerikanë, përfaqësues të denjë të rendit të tyre, nuk hezitojnë që në këto biseda «të argumentojnë» domosdoshmërinë e mbajtjes së trupave amerikane në Tajvan «për ruajtjen e paqes», t'i kundërvënë demokracisë socialiste demokracinë borgjeze, bile të atakojnë hapur edhe fjalimin e fundit të Molotovit¹. Kjo valë «e shkëmbimit të sinqertë të mendimeve» kurrsesi nuk u shërben interesave të BS e të kampit socialist dhe nuk i pengon amerikanët të vazhdojnë t'i vringëllijnë armët në Lindjen e Largët. Agresiviteti është në natyrën e imperializmit dhe nuk mund të frenohet me argumente tavolinash.

1. Raporti «Mbi gjendjen ndërkombëtare dhe politikën e jashtme të qeverisë së BRSS» u mbajt nga V. M. Molotovi në mbledhjen e Sovjetit Suprem të BRSS më 8 shkurt 1955.

E HËNË
14 SHKURT 1955

Bashkë me Hysniun, Gogon e shokë të tjerë morëm pjesë në pritjen e organizuar nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë në hotel «Dajti» për nder të delegatëve të Kongresit të 4-t të Bashkimeve Profesionale.

Kishin ardhur edhe anëtarët e delegacioneve të huaja, që morën pjesë në punimet e kongresit.

Kaluam shumë mirë.

E MARTË
15 SHKURT 1955

Sot, me kërkesën e tij, prita në takim zëvendëssekretarin e organizatës-bazë të Partisë dhe kryetar i komitetit profesional të ndërmarrjes bujqësore «Irakli Terova» Korçë¹. Ai kishte ardhur tek unë për t'u ankuar për disa të meta në punën e drejtorisë së ndërmarrjes ku punon, të tregtisë në rreth dhe sidomos për problemin që ishte krijuar për 20 hektarë tokë që ndërmarrja i shkëmbeu me kooperativën bujqësore të Vinçanit për ta mbjellë vreshtë dhe nuk e mbolli, se e kishte shumë larg. Kërkonte nga unë që të urdhëroja anulimin e këmbimit të kësaj toke.

Bisedova gjatë me të, i thashë se të metat që ka konstatuar qëndrojnë, por e këshillova se ato duhet t'i zhdukim me luftë e përpjekje të vazhdueshme komunistët dhe punëtorët e ndërmarrjes, të cilët t'ia thonë hapur cilitdo mendimin e tyre për mbarëvajtjen e punës.

I thashë bashkëbiseduesit se këto të meta e dobësi që vëren ai në punë e sipër t'ua thotë dhe shokëve të Partisë e të pushtetit në rreth, se ata me siguri do të

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 233.

marrin masa për t'i eliminuar. Në Korçë kemi sekretar të parë shokun Haki Toska, që është një shok mjaft i mirë dhe i dëgjon njerëzit e popullit. Udhëheqja nuk mund të bëjë asnjë minutë pa bazën. Baza dhe rrethi zgjidhin problemet e shumta që dalin. Komiteti Qendror i Partisë ka dhënë porosi, ka lëshuar direktiva dhe ka marrë vendime për mbarëvajtjen e punëve dhe kur këto nuk zbatohen mirë në një ndërmarrje ose në rreth, punëtorët kanë të drejtë të ngrenë zërin e tyre deri në udhëheqje, e cila mban shënim dhe u kërkon llogari të gjithë shokëve që nuk e dëgjojnë zërin e drejtë të punëtorëve.

Ai m'u ankua edhe për Maqo Çomon, për të cilin më tha se edhe kur i bie rruga nga ndërmarrja e tyre, takohet vetëm me drejtorin dhe me agronomin dhe nuk pyet as për organizatën-bazë të Partisë, as për komitetin profesional. E sqarova shokun zëvendëssekretar për këtë ankesë se pavarësisht që Maqo Çomoja është zëvendësministër i Bujqësisë, ju duhet t'ia thoni edhe atij mendimet që keni për të, me qëllim që ai të kuptojë se ndërmarrja nuk janë vetëm drejtori dhe agronomi, por të gjithë punëtorët dhe komunistët që derdhin djersën për të realizuar prodhimin.

E ENJTE
3 MARS 1955

Ndryshime në qeverinë sovjetike¹. Veprim tërësisht i natyrshëm në qoftë se nuk ka lidhje me largimin e Malenkovit nga posti i kryeministrit. Por afërsia në kohë, megjithëse në asnjë mënyrë s'mund të shërbejë si argument, dashur pa dashur të detyron t'i lidhësh me njëra-tjetrën këto dy ngjarje. Tani për tani s'dimë asgjë të saktë, por qofshin për mbarë.

1. Me propozimin e N. A. Bulganinit, Sovjeti Suprem i BRSS vendosi të shkarkojë nga detyra më 2 mars 1955 dy ministra për punën e tyre të pakënaqshme.

E PREMTE
4 MARS 1955

Sot mora pjesë në mbledhjen e organizuar me kuadrot kryesorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme për punimin e vendimit të Byrosë Politike mbështetur në analizën që Komiteti Qendror i ka bërë punës së kësaj ministrie kohët e fundit. Pas diskutimeve, fola edhe unë¹.

Pa hyrë në hollësi, theksova rëndësinë e madhe që ka ky vendim për punonjësit e këtij sektori. Theksova se Partia, Komiteti Qendror i saj, e kanë vlerësuar dhe e vlerësojnë punën e mirë të organeve të Punëve të Brendshme, por që të evitohen të metat e konstatuara dhe që puna të ecë më mirë është e domosdoshme:

Së pari, që punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të jenë nga njerëzit më të mirë, besnikë të Partisë, por edhe me kulturë e të përgatitur politikisht e ideologjikisht. Kështu edhe besnikëria e tyre forcohet, edhe ndërgjegjja patriotike rritet. Duke studiuar marksizëm-leninizmin, edhe lufta kundër mbeturinave mi-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 237.

kroborgjeze, mendjemadhësisë, familjaritetit etj., do të zhvillohet më me sukses;

Së dyti, që në organet e Punëve të Brendshme të ketë një disiplinë të hekurt, se ndryshe armiku e ka më të lehtë të veprojë;

Së treti, që të përmirësohen metoda dhe stili në punë si nga Ministria e Punëve të Brendshme, ashtu edhe nga organet e Punëve të Brendshme në bazë;

Së katërti, që punonjësit e Sigurimit të jenë mirë në dijeni të situatës së brendshme dhe të jashtme, prandaj leximi i vazhdueshëm i shtypit të Partisë, veçanërisht për ta, ka rëndësi të madhe. Mbi këto situata duhet të reflektojnë e të rritin gjithmonë vigjilencën ndaj veprimtarisë së armikut të brendshëm e të jashtëm;

Së pesti, që të punohet më mirë për forcimin e lidhjeve midis punonjësve të Sigurimit dhe të policisë me popullin nëpërmjet Frontit;

Së gjashti, që t'i kushtohet kujdes shëndetit si nga degët e Punëve të Brendshme, ashtu edhe nga vetë punonjësit e Sigurimit.

Shpreha besimin e Komitetit Qendror të Partisë se këto çështje të rëndësishme shokët e Ministrisë së Punëve të Brendshme do t'i kuptojnë drejt e do të vënë të gjitha forcat për t'i zbatuar ato në jetë.

Mbledhja i zhvilloi punimet në nivel të kënaqshëm.

E SHTUNË
5 MARS 1955

Interesim «dashamirës» i qeverisë amerikane për Shqipërinë. Pas kërcënimit të paracakohshëm të Dallesit¹, që deklaroi se qeveria amerikane do të bëjë çmos «për ta çliruar» Shqipërinë, presidenti amerikan tund degën e ullirit dhe «me zemërgjerësi» na ofron «ndihmë». Dje Ajzenhaueri² deklaroi se qeveria amerikane është e gatshme të na dërgojë ushqime dhe kërkoi nga Lidhja e Shoqërive të Kryqit të Kuq të merrte përsipër shpërndarjen e tyre midis popullsisë shqiptare. Nuk më çudit aspak alternimi i kërcënimeve të Dallesit me «dhembshurinë» e presidentit «për të lehtësuar vështirësitë e fundit ushqimore» të popullit shqiptar, por më çudit kokfortësia dhe besimi i verbër i amerikanëve në forcën e dollarit. Me të vërtetë mendojnë krerët e imperializmit amerikan se mund ta blejnë me dollarë lirinë e pavarësinë tonë, për të cilat kemi derdhur aq gjak?! Akoma s'kanë nxjerrë mësim nga dështimi i njëpasnjëshëm i orvatjeve të tyre për të nënshtruar e sklla-

1. Xhon Foster Dalles, në atë kohë sekretar i shtetit të SHBA-së.

2. Duajt D. Ajzenhauer, në atë kohë president i SHBA-së.

vëruar Shqipërinë? Tentativa e tanishme ngjan si dy pika uji me «ndihmën e detyruar» që SHBA kërkonin t'i jepnin Shqipërisë menjëherë pas Çlirimit nëpërmjet UNRRA-s e që ne e refuzuam me forcë në ato kushte kur vërtet na mungonte buka.

Një gjë është e padyshimtë, imperializmi amerikan s'ka hequr e s'ka për të hequr dorë nga përpjekjet për të përmbysur pushtetin popullor e për të skllavëruar Shqipërinë. Deklarata e Ajzenhauerit tregon se Uashingtoni ka vendosur ta shtojë «interesimin» për vendin tonë, prandaj të rritim vigjilencën dhe, si kurdoherë, t'u japim përgjigjen e merituar si kërcënimeve, edhe «buzëqeshjeve» të armikut.

Mora pjesë në konferencën e Partisë për qytetin e Durrësit, që i zhvilloi punimet dje dhe sot. Si në raport, edhe në diskutimet u vu theksi në çështjet organizative të Partisë e sidomos në rritjen e forcimin e mëtejshëm të rolit drejtues të organizatës-bazë të Partisë, për ta bërë atë me të vërtetë vetëvepruese e me iniciativë, natyrisht, brenda normave të Partisë.

Në mbledhjen e sotme të Presidiumit të Kuvendit Popullor na u paraqit për aprovim projektdekreti mbi Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil, i cili ka rëndësi të madhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike civile; por shokët e aparatit të Presidiumit nuk na kishin dhënë që më parë një material shkoqitës se cila është përmbajtja, vlera, qëllimi dhe rëndësia e projektit, si dhe gjendja aktuale në fushën e zbatimit të legjislacionit civil. Për këtë arsye kritikova shokun sekretar të Presidiumit.

Kritikova, gjithashtu, edhe ministrin e Drejtësisë, i cili gjer më sot nuk na ka bërë ndonjë raportim për këto probleme me rëndësi dhe i këshillova shokët që të kërkojnë më tepër llogari për zbatimin e ligjeve nga gjykatat dhe prokuroritë.

Shokët ishin dakord me vërejtjet e mia.

E MARTË
8 MARS 1955

Sot pasdite asistova në mitingun që u zhvillua me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Grave.

Salla e Teatrit Popullor ishte mbushur plot me punëtores e aktiviste të dalluara. Përshëndeti shoku Pilo në emër të Komitetit Qendror të Partisë, pastaj foli Nexhmija. Diskutuan mirë shoqe punëtores e intelektuale. Përshëndetja e pionierëve më pëlqeu.

E PREMTE
11 MARS 1955

Vendimi i plenumit të fundit të KQ të Partisë së Punonjësve të Hungarisë¹, pjesë të të cilit u transmetuan pardje nga agjencia MTI dhe janë botuar sot në «Zërin e popullit», godet me forcë shfaqjet e oportunitizmit të djathtë. Me sa duket Partia e Punonjësve të Hungarisë ka qenë shumë në rrezik, sepse deviacioni i djathtë është frymëzuar e udhëhequr nga kryetari i Këshillit të Ministrave, Imre Nagi. Pikëpamjet oportuniste kohët e fundit, siç thuhet në vendim, ishin përhapur në parti, në aparatet shtetëror dhe në sektorë të tjerë, prandaj izolimi e demaskimi ideologjik i tyre janë shpëtimtare për partinë dhe socializmin në Hungari.

Gjatë leximit të pjesëve të vendimit më lindi një shqetësim që s'po më ndahet. Mohimi dhe sabotimi nga oportunistët hungarezë i industrializimit socialist të vendit më kujtoi padashur shprehjen e preferuar të shokut Mikojan², «Ç'ju duhet industria!», që ai dhe sho-

1. Ky plenum i zhvilloi punimet nga 2-4 mars 1955 në Budapest.

2. A. J. Mikojan, në atë kohë zëvendëskryetar i parë i Këshillit të Ministrave të BRSS.

kët e tij na i përsëritën aq shpesh në takimin tonë të fundit. Mos vallë u kanë thënë kështu edhe shokëve hungarezë e Nagi ka marrë krahë? Nuk e di, por si zor të jetë i rastësishëm gjallërimi i vullshëm i oportunitizmit në Hungari «që prej vitit 1953», siç thuhet në vendim. Sidoqoftë, goditja e deviacionit të djathtë nga Partia e Punonjësve të Hungarisë është një fitore e madhe për të e për ndërtimin e socializmit në Hungari.

KORÇË, E SHTUNË

12 MARS 1955

U nisa në orën 9⁰⁰ të mëngjesit për në Korçë, ku mbërrita në orën 13⁴⁵. Koha ishte e bukur. Gjatë rrugës për në Elbasan, ku ishte ditë pazari, pashë mjaft fshatarë, sidomos çermenikas, që shkonin në qytet. Nuk shihet që ata të çonin në treg veçse nga një gomar me dru. Çermenika është akoma një krahinë mjaft e varfër. Duhet të marrim për ta masa edhe nga ana shëndetësore.

Jeta e çermenikasve do të ndryshojë në qoftë se ata do të shkojnë të punojnë edhe në fabrikat e në minierat e kësaj zone. Prandaj duhet të punojmë akoma me ta, që t'i sqarojmë e t'i bindim se hapja e minierave të hekurit do ta rritë mirëqenien e tyre e do t'u sigurojë një të ardhme të lumtur. Duhet të shpejtohem në këtë drejtim. Në Çermenikë Partia gjithnjë ka pasur dhe ka miq të mirë. Në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare kjo krahinë ka qenë një nga bazat e shëndosha të Partisë. Para Çlirimit çermenikasit kanë qenë shumë prapa në të gjitha drejtimet, por tash jeta e tyre ka ndryshuar. Atje janë hapur shkolla e qendra kulture, ku brezat e rinj pajisen me dije. Megjithatë, duhet punuar akoma që banorëve të kësaj zone t'u hapim më shumë perspektiva në punë.

Me hidhërim e dhimbshuri kujtova të varfrin plak, Ali Dishën, i cili vdiq para disa muajsh dhe është varrosur aty, afër rrugës, në të dalë të Elbasanit, në disa ullishte. Ishte mik besnik i Partisë, që na ka strehuar e na ka mbajtur në kohët më të rrezikshme të luftës. Ishte njeri i drejtë, i thjeshtë e i pjekur. Shpesh më vinte në shtëpi. Një muaj para se të vdiste, kërkoi të më takonte dhe e prita në Komitetin Qendror; m'u ankua se tokën që i dha Partia disa dallaveraxhinj kërkonin t'ia hiqnin, gjoja pse qe plak.

Do të interesohem për gruan e tij, veçanërisht për nipin e tij të vogël, Abazin, të cilin e donte shumë e që ma la amanet kur erdhi herën e fundit tek unë.

Me shokun Haki Toska, i cili kishte dalë e më priste në Qafën e Thanës, biseduam për gjendjen ekonomike të rrethit të Korçës. Kjo paraqitet e kënaqshme, populli e ka nxjerrë mirë dimrin. Mungesa në ushqime dhe në veshmbathje s'ka pasur. Edhe gjendja e blegtorisë, gjithashtu, paraqitet e mirë.

KORÇË, E DIJEL
13 MARS 1955

Një sqarim i pamjaftueshëm, për të mos thënë i errët: Duke folur në aktivin e Partisë së Punonjësve të Hungarisë të qytetit të Budapestit¹ për vendimet e plenumit të fundit, sekretari i parë i komitetit të partisë së këtij qyteti tha: «Ashtu sikurse këshillon Komiteti Qendror i Partisë, deviacionistët nuk duhet të trajtohen në asnjë mënyrë si armiq». Asgjë më tepër nuk thuhet për këtë çështje. Në këtë mënyrë nuk bëhet kurrfarë diferencimi midis bartësve të ndërgjegjshëm e nxitësve të oportunitetit dhe të tjerëve, që vetëm manifestojnë ndonjë pikëpamje oportuniste. Për mendimin tim, të parët janë e duhen luftuar si armiq të rrezikshëm të socializmit. Kuptimi i kësaj është i domosdoshëm për ta shkullur nga rrënjët oportunitizmin, ndryshe ai do të vazhdojë ta brejë partinë dhe socializmin. Besoj se udhëheqësit e partisë hungareze, që mund të kenë ndonjë arsye për të mos i vënë hapur pikat mbi i, e kanë të qartë këtë dhe do ta shpjen deri në fund luftën e filluar kundër deviacionit të djathtë.

1. Aktiv i u mbledh më 11 mars 1955 në Budapest.

U vura në dijeni mbi gjendjen e reparteve ushtarake në rrethin e Korçës, që ishin duke mbaruar një lojë në përgatitjen e shtabeve kundër goditjes nga bomba atomike. Rezultatet dukeshin të kënaqshme. Një lojë e tillë, sigurisht, duhet të zhvillohet në të gjitha repartet e ushtrisë.

Fryn erë e fortë dhe qielli është i vrenjtur. Majat e maleve janë të veshura me borë. Kjo i ka hije Korçës. Fushat me grurë gjelbërojnë dhe gruri duket shumë i mbarë. Fshatarësia është përgatitur mirë për mbjelljet e pranverës, tash pret me padurim të ngrohet pak toka dhe të fillojë nga puna. Ndërkohë në Ndërmarrjen Bujqësore të Maliqit ka filluar mbjellja e panxharit.

Fillova të lexoj librin «Henri Barbusse» të shkrimtarit Ani Vidal. Libër shumë interesant, i dokumentuar, i shkruar me zemër e me dhembshuri për shkrimtarin dhe luftëtarin e madh, Barbysin. Duhet të rilexoj patjetër «Clarté»¹ dhe «Enchaînements»².

1. «Qartësi», 2. «Halkat» — vepra të rëndësishme të A. Barbysit.

Në Korçë ekzistojnë mundësi të mëdha për rritjen dhe zhvillimin e rrushit, për arsye të tokës së përshtatshme për këtë kulturë dhe të zellit në punë që i karakterizon korçarët. Kodrat e shën Thanasit duhet të kthehen në vreshta¹. Dhe kjo punë ka filluar, një pjesë e tyre janë kthyer në të tilla nga ndërmarrja bujqësore «Irakli Terova». Por punonjësve të bujqësisë të këtij rrethi duhet t'u ndajmë më shumë fidanë. Ata janë të gatshëm të bëjnë qilizmën dhe të kujdesen për mbjelljen e rrushit.

Fabrika për Konservimin e Frutave në Korçë po ngrihet. Porosita shokun Haki që këtë verë të nxjerrin përafërsisht statistikat e prodhimit të frutave, që të mos ecim pa parashikime për këtë fabrikë. Sigurisht duhet të mendojmë edhe për ndonjë fabrikë verërash dhe likeresh në Korçë, ku kemi rrush, dhe fabrikë alkooli.

1. Më vonë këto vreshta u prishën se territori i tyre u përfshi në planin rregullues të qytetit të Korçës.

E frikshme duhet të ketë qenë për të dashurit kalamanë të vegjël tuberkulozë nata kur u mori zjarr ndërtesa ku kuroheshin. Shkova i pashë. Fëmijët nuk kishin pësuar gjë, kurse ndërtesa ishte dëmtuar, prandaj duhet të marrim masa për rindërtimin e saj, sepse muret janë të mira.

KORÇE, E MËRKURË
16 MARS 1955

Po lexoj librin e bukur «Esteiros» të portugezit Pereira Gomes. Gomes, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Portugalisë, në këtë libër përshkruan në mënyrë realiste dhe shumë prekëse jetën e mjeruar të fëmijëve në Portugali nën regjimin e urryer të fashistit klerikal, Salazarit. Kujdesi për fëmijët pasqyron me të vërtetë fytyrën e regjimit në një vend. Mishtë të ngjethet kur lexon librin «Esteiros». I tillë, pra, është regjimi shtypës në Portugali. Sa të mëdha janë detyrat e njerëzve të drejtë në botë, sa e shenjtë është lufta që bëhet për çlirimin e të mjeruarve, për t'i nxjerrë ata në rrugën e dritës! Është e pakuptueshme që njerëzve të ndershëm t'u mungojnë guximi dhe kuraja për t'u hedhur në luftë kundër shtypjes dhe shfrytëzimit.

Energji të mëdha fshihen te njerëzit përparimtarë të të gjithë botës, të cilët ne duhet t'i zgjojmë, t'i armatosim, t'i hedhim në luftë. Fitorja na takon neve, njerëzve të thjeshtë, të drejtë e të guximshëm. Çdo njeri duhet të mendojë se me miliona njerëz në botë po vuajnë e po kërkojnë ndihmë. Jeta e njeriut të ndershëm duhet të jetë vazhdimisht në një luftë të paprerë, të

paepur dhe çdo hap i tij në këtë drejtim sjell të re për njerëzit që vuajnë. Larg është nga ne Portugalia, por sa pranë nesh janë Magdalena dhe Ginetaja, fëmijët që përmenden në librin «Esteiros». Të luftojmë pa pushim për rritjen e mirëqenies së kalamanëve të vendit tonë, sepse kështu kemi ndihmuar në çlirimin e kalamanëve të mjeruar për të cilët shkruhet në këtë libër.

E ENJTE
31 MARS 1955

Sesioni i dytë i legjislaturës së 3-të të Kuvendit Popullor, që hapet sot në orën 17⁰⁰ do të diskutojë kryesisht rreth politikës së brendshme e të jashtme të Qeverisë dhe projektligjit mbi buxhetin e shtetit për vitin 1955. Në sesion do të marrë pjesë edhe delegacioni i Sovjetit Suprem të BS, që mbërriti dje në vendin tonë i ftuar për këtë qëllim nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

E MARTË
5 PRILL 1955

Filloi punimet aktivi ekonomik, ku marrin pjesë drejtues të organeve ekonomike, shtetërore dhe të Partisë. U referua rreth masave që duhen marrë për përmirësimin e drejtimit të ekonomisë nga ana e organeve ekonomike, shtetërore dhe të Partisë.

Në seancën e dytë, pasdite, filluan diskutimet, që do të vazhdojnë edhe nesër.

E PREMTE
15 PRILL 1955

Në planin e punës për tremujorin e 2-të të vitit 1955 duhet të shtohet për Drejtorinë e Agjitpropit:

1. Kontrolli në vend i zbatimit të programeve politike në shkollën e bashkuar «Enver Hoxha» e në shkollën e Sigurimit (Ministria e Punëve të Brendshme). Kjo punë të shërbejë për ndërtimin e programeve të reja të përshtatshme me gjendjen.

2. Kontroll dhe ndihmë Shkollës së Partisë për vitin në vazhdim (pse pika 9 s'është e mjaftueshme).

3. Gjendja e vërtetë mbi folklorin e vendit tonë (për vjershat, historitë, përrallat popullore etj.). Punën për grumbullimin e folklorit tashmë e kemi përqendruar në Institutin e Shkencave. Edhe më parë në regjimet e kaluara është bërë kjo punë nga njerëz patriotë. Ç'po bëhet me këtë pasuri? Ç'mendohet të bëhet në të ardhmen?

4. Gjendja e zbulimeve arkeologjike: kërkimet aktuale dhe të kaluarat. Në ç'drejtime punohet? Perspektivat e punës, nevojat, masat.

5. Gjendja e monumenteve historike të çdo lloji në vendin tonë. Fati i tyre, masat për ruajtjen etj.

6. Fati i dokumenteve historike (dokumente antike,

të shtypura e dorëshkrime, libra të edicioneve të vjetra që s'gjenden, gazeta të vjetra etj.), që ndodhen në dorën e popullit. Si punohet në këtë drejtim për t'i bërë këto dokumente pronë kolektive? Ç'rezultate janë arritur deri tash dhe ç'masa duhen marrë për përpunimin e tyre?

E HËNË
18 PRILL 1955

Mora pjesë në sesionin shkencor kushtuar 85-vjetorit të lindjes së V. I. Leninit, organizuar nga Instituti i Shkencave.

Për veprën dhe mësimet dritëdhënëse të Leninit të madh referuan një numër bashkëpunëtorësh të institutit dhe shokë të tjerë të ftuar. Është gëzim e kënaqësi që njerëzit tanë, shokë të rinj të edukuar nga Partia, flasin me kompetencë e aftësi për idetë, mësimet dhe për veprën kolosale të Leninit të madh. Është gëzim e krenari që në Shqipëri kudo flitet e zbatohen mësimet e Lenin-Stalinit. Por s'ka vend për vetëkënaqësi. Ta duash Leninin do të thotë ta njohësh me themel veprën e tij, ta zbatosh marksizëm-leninizmin pa lëkundje e ta mbrosh nga çdo sulm e shtrembërim që shfaqet e nga kushdo që shfaqet.

E MARTË
19 PRILL 1955

Masa konkrete në luftën kundër oportunizmit të djathtë në Hungari: Para disa ditësh Komiteti Qendror i Partisë së Punonjësve të Hungarisë e përjashtoi Imre Nagin nga Byroja Politike e nga Komiteti Qendror dhe e shkarkoi nga të gjitha postet në parti, kurse dje Asambleja Kombëtare e RP të Hungarisë e shkarkoi atë edhe nga detyra e kryetarit të Këshillit të Ministrave. Goditja e kreut të oportunizmit është një fitore për partinë hungareze që ndihmon për zhvillimin me sukses të luftës kundër pikëpamjeve antimarksiste e antileniniste dhe për zbatimin e programit të ndërtimit socialist.

E ENJTE
21 PRILL 1955

Sot u mbushën 85 vjet nga dita kur lindi V.I.Lenini, udhëheqësi i Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit. Idetë e pavdekshme të Leninit janë e do të mbeten në themel të të gjitha fitoreve tona. Ato u ndriçojnë rrugën proletariatit dhe masave punonjëse të botës.

Sot pasdite ishim në mbledhjen solemne që u organizua me këtë rast nga Komiteti Qendror dhe Komiteti i Partisë për Qytetin e Tiranës.

Gjithashtu sot, Shkollës së Lartë të Partisë iu dha emri i V.I.Leninit. Morëm pjesë në ceremoninë që u zhvillua atje.

Por kryesorja e kryesoreve është t'i qëndrojmë besnikë në çdo hap, në çdo qëndrim e veprim veprës së Leninit që është vazhdim i veprës së kolosëve Marks e Engels, e që, pas Leninit e mbrojti dhe e çoi më përpara i paharruari Josif Stalini. T'u qëndrojmë besnikë mësimëve të tyre, ideve të tyre të pavdekshme. Ta peshojmë çdo hap që bëjmë, në politikën e brendshme ose të jashtme me mësimet e tyre, t'u referohemi atyre dhe askujt tjetër në mendimet dhe në qëndrimet tona. Vetëm kështu revolucioni do të ecë kudo i papërlyer.

Sot paradite në selinë e Komitetit Qendror të Partisë prita një grup ushtarësh, që kryejnë shërbimin ushtarak në kufi. Ata më dorëzuan stafetën e rojave të kufirit drejtuar Komitetit Qendror të Partisë.

Bëra një bisedë të ngrohtë me ta. I dëgjova me kënaqësi tregimet e tyre për jetën në kufi dhe i përgëzova për rezultatet që kanë arritur në kryerjen e detyrave. Të tillë janë kufitarët tanë, të gjallë, të shkathët e optimistë, trima të edukuar nga Partia, që ruajnë me vigjilencë kufijtë e shenjtë të atdheut.

I ktheva përgjigje shokut Hrushov, duke e falënderuar për ftesën që më bëri për të kaluar pushimet familjarisht në BS. Gjatë muajve maj e qershor do të bëjmë dy plenumë të KQ të Partisë, bile në qershor mbledhet edhe Kongresi i Frontit Demokratik, kështu që e kam të pamundur t'ua plotësoj dëshirën shokëve sovjetikë para fillimit të korrikut.

Nuk besoj të më keqkuptojnë për shtyrjen e afatit që më propozojnë, ca më tepër kur të marrin vesh për punët dhe për problemet që kemi aktualisht nëpër duar.

E MËRKURË
27 PRILL 1955

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, që filloi pardje, u dha fund punimeve. Në Plenum u diskutua dhe u aprovua raporti i Byrosë Politike «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj».

Në fjalën që mbajta në mbyllje të Plenumit¹, theksova se armatosja si duhet me idetë e marksizëm-leninizmit do të na hapë perspektiva më të gjera në punë, do të na ndihmojë të mënjanojmë gabimet në kryerjen e detyrave, t'i zgjidhim drejt dhe shpejt problemet dhe të orientohemi në çdo situatë. Çështjet ideologjike, kulturore e arsimore, që u diskutuan, Byroja Politike duhej t'ia kishte shtruar më përpara Plenumit të Komitetit Qendror, sepse këtij i takon të zbërthejë dhe të zhvillojë më tej çdo problem të rëndësishëm dhe jetik për Partinë. Ky gabim, që reflektohet edhe në bazë, duhet t'u bëhet mësim udhëheqjes së Partisë dhe komiteteve të Partisë në rrethe.

Të poshtra dhe tradhtare ishin tezat e Tuk Jakovës kundër vijës së Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj. Të

parashtruara në Plenum në mënyrë diversioni, me arrogancë dhe me këmbëngulje, me përjashtim të Bedri Spahiut që heshti në mënyrë të dyshimtë, ato revoltuan dhe u hodhën poshtë me zemërim nga të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror. Për të zbuluar tërësisht karakterin armiqësor të tezave të Tuk Jakovës që është pak të thuash se bien erë titizëm, u ngarkua Byroja Politike, që do t'ia paraqitë konkluzionet e saj mbledhjes së ardhshme të Plenumit.

Medoemos duhet sqaruar përse Tuk Jakova gjeti pikërisht këto momente për të shfaqur pikëpamjet e qëndrimet e tij antiparti?! I ruante prej vitesh dhe tani i shfaqti nga mosdurimi, apo mos iu gjallëruan nga arsye e rrethana të tjera të jashtme ose të brendshme? Do të rojmë e do të mësojmë.

Vigjilencë! Armiku është aktivizuar dhe ka vënë në qendër të goditjes Partinë dhe udhëheqjen e saj. Por, si kurdoherë, kokën do të thyejë, se Partinë e kemi të fortë, syçelë e me gjykim të shëndoshë marksist-leninist.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 267.

Sot paradite vajta në Fier, ku assistova në inaugurimin e kanalit ujitës Vjosë-Levan-Fier, vepër e rëndësishme e pesëvjeçarit të parë. Kjo është një ndihmë tjetër e madhe që i jep Partia fshatarësisë kooperativiste, është shprehje e kujdesit të saj të madh për zhvillimin e bujqësisë.

1 Maj. Dita e Solidaritetit Ndërkombëtar të Punëtorëve. Si çdo vit edhe sot kjo ditë te ne u festua me madhësi. Koha ishte shumë e bukur, tamam për festë. Punëtorë, fshatarë, nxënës, studentë e populli i kryeqytetit sot parakaluan krenarë për sukseset e arritura në ndërtimin e socializmit nën udhëheqjen e Partisë.

Më 11 maj do të mbliidhet në Varshavë Konferenca e tetë shteteve evropiane¹ pjesëmarrëse në Deklaratën e Moskës së 2 dhjetorit të vitit të kaluar për garantimin e paqes e të sigurimit në Evropë. Përballë blloqeve agresive e përgatitjeve të imperializmit për shpërthimin e një lufte të re është plotësisht e drejtë dhe e nevojshme që vendet tona të marrin bashkërisht të gjitha masat për të mbrojtur lirinë e pavarësinë, fitoret e punës ndërtimtare. Forca e bashkuar e vendeve socialiste me siguri do t'i vërë fre agresivitetit imperialist.

1. Këto shtete ishin: RP e Shqipërisë, Bashkimi Sovjetik, RP e Polonisë, Republika Çekoslovakë, RD Gjermane, RP e Hungarisë, RP e Rumanisë dhe RP e Bullgarisë. Në Konferencën e Varshavës u ftua të dërgonte vëzhguesin e saj edhe qeveria e RP të Kinës.

PYETJE DHE SQARIME PËR BEDRIUN¹

1. Fjalët në parantezë të pikës së 2-të janë të Bedriut [Spahiut] apo të Tukurit [Jakovës] dhe çfarë kup-tohet me frazën «nuk m'u dukën të pangjara këto»?

2. A e ka menduar Bedriu kaq serioze çështjen e ndonjë gabimi të ndonjë propagandisti në lidhje me Miladinin si internacionalist?

3. E aprovoi Bedriu Tukurin kur i tha se «kështu është në kundërshtim me të gjithë materialin historik të Partisë, është antimarksist»?

4. Në rast se jo, si duhej të vepronte Bedriu pas këtij bisedimi, ku vihej në diskutim vija e Partisë nga një anëtar i Komitetit Qendror?

a) Duhej të vinte menjëherë në dijeni Partinë, që Tuku më tha kështu-kështu.

b) Të vizitonte muzeun, veçanërisht për të parë a kishte të drejtë Tuku apo jo dhe t'i bënte vërejtjet e veta Partisë.

c) Në fund të fundit, pasi të shihte muzeun, t'i tho-

1. Titujt në Ditar janë të vetë autorit.

shte Tukut, nëse kishte ose jo të drejtë. Kështu dhe vetë do të dilte në rrugën se për këto medoemos duhej të vinte në dijeni Partinë.

5. Bedriu e ka parë muzeun para se t'i thoshte Tuku pikëpamjet e tij, apo më pas?

6. Si e shpjegon Bedriu çështjen që Tukut i ka thënë: «... këto janë antimarksiste», kurse, nga ana tjetër, neve na thotë se «... nuk diktova ndonjë çështje që të kishte të bënte me revizionimin e vijës së Partisë...». Kur gjykohet se ka pikëpamje antimarksiste, atëherë dikush ka gabuar dhe dikush duhet ta korrigjojë.

7. Pse Bedriu i kuptoi fjalët e fundit të Tukut në Plenum¹ «unë nuk kisha qëllim... nuk e kam çështjen për vijën...»? (Në fillim të faqes 3 të autokritikës së Bedriut.)

8. Mos vallë dëshira e Bedriut ka qenë që Tuku t'u shkiste gjërave, që Bedriu më lart i ka gjykuar «antimarksiste» dhe të mbyllej kjo çështje pa i vënë emrin, «as mish as peshk»?

9. Si e kupton Bedriu këtë «vijë të re të Tukut» (faqe 3, paragrafi i 2-të i autokritikës së Bedriut) deri në konsekuencat e fundit? (Bedriu e dëgjoi deri në fund tezën e Tukut në Plenum.)

10. Meqenëse Bedriu e gjykon tash këtë çështje si revizionim të vijës, kjo duhet shpjeguar më thellë dhe më gjatë, se mundet që pikëpamjet e Tukut ai t'i gjykojë si çështje të shkëputura, të rastit, për periudha të caktuara.

1. Në Plenumin e 13-të të KQ të PPSH, që u mbajt më 25-27 prill 1955.

11. Si e kupton Bedriu rolin përcarës të Tukut dhe me ç'qëllim, mendon Bedriu, e bën Tuku këtë punë? A mendon Bedriu se bisedat që ka bërë Tuku me të dhe me disa shokë të tjerë¹ kanë pasur qëllime përcarëse?

12. Ç'do të thotë Bedriu me fjalët se Tuku ka devijuar «në kuptimin idealist» dhe «bajraktar të udhëheqjes»?

13. Pse Bedriu ishte i vendosur të mos diskutonte dhe pse s'e vuri në dijeni Byronë Politike? (Ato që thotë në faqen 5 të autokritikës s'janë të plota dhe as të vërteta.) Derisa i gjykoj pikëpamjet e Tukut, kur i foli rastësisht Manushit [Myftiu], si «tendencioze dhe të lidhura si pak trashë», derisa i kishte quajtur më parë «antimarksiste» dhe të sugjerojmë, se kishte vajtur edhe në muze, *de visu*, kishte konstatuar se Tuku gabohej, të gjitha këto pse nuk e shtynë Bedriun t'ia thoshte problemin Byrosë Politike, por ishte aq i vendosur të heshtë?!¹

14. Bedriu pohon në faqen 5 se «kur mendonte kështu, ishte koherent me veten e tij». Kur thotë se «s'ndiente ndonjë përgjegjësi, bile edhe kur mori vesh se Tuku s'ia kishte thënë pikëpamjet e veta as shokut Enver», këto s'janë të vërteta.

1. Pikëpamjet e veta antimarksiste Tuk Jakova, para se t'i shtronte në Plenum, ua kishte shfaqur edhe Abdyl Këllezit e Hito Çakos. Në dallim nga B. Spahi u që heshti në mbledhjen e Plenumit, këta armiq, që u demaskuan më vonë, kur anëtarët e tjerë të Komitetit Qendror të Partisë hodhën poshtë pikëpamjet revizioniste të T. Jakovës, u ngritën, denoncuan bisedën e Tukut dhe u fshehën pas autokritikës.

a) Bedriu e dëgjoi bisedën e Tukat me vëmendje në shtëpinë e Tukat.

b) Bedriu i quajti «antimarksiste» pikëpamjet e tij.

c) Pastaj vajti në muze, dhe atje pa se çështjet nuk ishin siç i tha Tuku, pra Tuku gabonte.

d) Ai dëgjoi Tukan në Plenum. Dëgjoi Hiton [Çako] dhe Dylin [Abdyl Këllezi]. Dëgjoi të gjithë shokët.

e) Kur i foli Manushit shprehu dyshime për mënyrën tendencioze të shtrimit të pikëpamjeve nga Tuku.

Të kalosh nga të gjitha këto faza dhe të pretendosh se s'ke kuptuar, të insistosh për të mos vënë në dijeni Byronë Politike, kjo s'hahet. Të gjitha këto çështje nuk mund ta linin Bedriun në gjumë, se pikëpamjet e Tukat s'ishin për gjëra banale e të praktikës, dhe Bedriu s'mund të ishte kaq «koherent» në pikëpamjet e tij. Si guxon të thotë se s'ndien asnjë përgjegjësi, bile edhe kur mori vesh se Tuku s'ia kishte thënë as Partisë?!

Pra s'është vetëm arsyeja që thotë në paragrafin e 2-të të faqes së 5-të të autokritikës. Faktet që përmendëm nuk ishin të mjaftueshme që t'i zgjonin Bedriut kujtesën edhe sepse kishte të bënte me Tukan.

15. Cilat, pra, janë arsyet e vërteta që Bedriun e detyruan të mos flasë dhe të mos jetë «shumë koherent» në autokritikën e tij?

16. Cilat janë arsyet, sipas Bedriut, që Tuku hesht plotësisht në të gjitha autokritikat e tij për bisedën që ka bërë me të? Ai përmend bisedat me Hiton e me Dylin, kurse për bisedimin me Bedriun thotë se s'mban mend fare.

17. Bedriu s'lajmëron Partinë, Tukat asgjë s'i kuj-

tohet nga bisedimi me Bedriun. Ç'konkluzione nxjerr Bedriu nga kjo çështje?

18. A kanë ekzistuar te Bedriu pakënaqësi karshi shokëve, karshi udhëheqjes ose karshi vijës?

19. Disa çështje në punën dhe në qëndrimet e Bedriut:

a) Pse shumë zyrtar me instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë? Çdo gjë e sjell me letër dhe çdo përgjigje e kërkon me shkrim.

b) I ftohtë dhe shumë zyrtar me shokët.

c) Aktiv në ministri (sido që mjaft nervoz dhe shumë herë i mbron çështjet me pasion), i tërhequr nga aktivitetet e tjera shoqërore dhe të Partisë.

d) Metoda tërheqjeje në shfaqjet e jashtme.

e) E tepruar çështja e ngritjes dhe e propagandimit të punës së patriotëve të vjetër. Në këtë drejtim Bedriu tregon një zell të madh dhe lë të kuptohet sikur po ndreq gjoja «harresën» e Partisë në këtë çështje.

E MARTË
10 MAJ 1955

Sot në orën 12⁰⁰ prita një grup delegatësh që morën pjesë në Konferencën e Nënave. Ato më dorëzuan mesazhin e përshëndetjes, që konferenca i drejtoi Komitetit Qendror të Partisë.

Bisedova¹ përzhemërsisht me përfaqësueset e nënave shqiptare, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen dhe në edukimin e brezit të ri, si dhe në zhvillimin e industrisë, bujqësisë, kulturës etj.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 318.

E MËRKURË
11 MAJ 1955

Hapet në Varshavë Konferenca e vendeve evropiane për garantimin e paqes dhe të sigurimit në Evropë. Vendimet e kësaj konference, të frymëzuara nga vullneti i popujve tanë për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së vendeve tona, do t'i shërbejnë forcimit të miqësisë, të bashkëpunimit e të unitetit mes shteteve të demokracisë popullore të Evropës. Ato do t'i shërbejnë sigurimit të paqes dhe do të bëhen një barrierë e pakapërcyeshme për planet agresive të imperializmit. Për herë të parë në histori populli ynë ka kaq miq dhe lidhet kaq ngushtë me popuj të tjerë. Udhëheqja e Partisë, marksizëm-leninizmi e socializmi i forcuan popullit tonë besimin në vete, i dhanë dinjitetin e merituar dhe e bënë pjesëtar të barabartë të familjes së madhe socialiste. Për forcimin kurdoherë në rrugë marksiste-leniniste të kësaj miqësie populli, Partia dhe Qeveria jonë do të vënë të gjitha forcat për të zbatuar me përpikëri çdo detyrim që do t'u takojë nga traktati që do të nënshkruhet në Varshavë.

E SHTUNË
14 MAJ 1955

U nënshkrua në Varshavë Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke dhe marrëveshja mbi krijimin e komandës së përbashkët të forcave të armatosura të tetë vendeve evropiane.

U shpall komunikata për takimin në nivelin më të lartë të përfaqësuesve të Bashkimit Sovjetik dhe të RPF të Jugosllavisë. Në fund të majit përfaqësuesit e të dy vendeve do të takohen e do të bisedojnë në Beograd. Po përse? Për përmirësimin gjithnjë më shumë të marrëdhënieve midis dy vendeve, thuhet në komunikatë, kurse jugosllavët edhe sot deklaruan se gjatë takimit do të diskutohen disa çështje që kanë mbetur të pazgjidhura midis dy qeverive. Hajde gjeje, megjithatë, kjo është punë për ta.

Neve na intereson e shqetësohemi për tjetër gjë. Iniciativën për organizimin e një takimi të tillë e kanë marrë udhëheqësit sovjetikë qysh para një viti, por atëherë propozimi i tyre u refuzua nga Titoja, që vuri si kusht «arritjen e sukseseve paraprake në drejtim të nor-

malizimit». Ky kusht, me sa duket u pranua nga sovjetikët dhe kjo duket nga zhvillimet e ndodhura gjatë kësaj kohe në marrëdhëniet mes dy vendeve. Po pse bëhen gjithë këto? Cili është shkaku i ndryshimit të qëndrimit të udhëheqjes sovjetike ndaj titistëve? Mua s'ma kanë mbushur mendjen arsyet që jepeshin në letrën e qershorit 1954 të firmosur nga Hrushovi. A mund të shpresohet se nga kjo Titoja do të ndërrojë rrugë? Ai që mendon kështu, kushdo qoftë¹, nuk e njeh Titon, ose mbivlerëson shumë veten. Vjet Hrushovi na tha se ndryshimi i qëndrimit ndaj titistëve synon të provojë «sa të gatshëm e të vendosur janë udhëheqësit jugosllavë për të ndjekur rrugën e socializmit». Po a ia vlen që për të «provuar» tradhtinë e njohur botërisht të socializmit nga Titoja t'i shkosh atij mysafir në shtëpi, në Beograd?!

Në përbërjen e delegacionit sovjetik, që shpallet në komunikatë, bie në sy mungesa e Molotovit. Duke menduar rreth këtij fakti, m'u kujtua atakimi i hapur që i bëri para ca kohësh Titoja² një fjalimi të mbajtur në Sovjetin Suprem të BS nga Molotovi për frymë gjoja antijugosllave. Është e qartë që Molotovi është i padëshirueshëm për Titon, por t'ia plotësosh këtij dëshirën deri në këtë masë s'është aspak dinjitoze. Mund të mos jetë kjo. Mundet që Molotovi të ketë ndonjë detyrë tjetër të rëndësishme, se me shëndet është mirë, përderisa sot shkoi në Vjenë, ose. . . të ketë qenë kundër organizimit të këtij takimi. Mund të jetë edhe kjo, por tani për tani ne s'dimë asgjë të saktë.

1. Është fjala për N. S. Hrushovin.

2. Në fjalimin e mbajtur në Skupshtinën Popullore të Jugosllavisë më 7 mars 1955.

Dje Titoja i siguroi botërisht padronët e vet të Perëndimit¹ se në bisedimet me udhëheqësit sovjetikë nuk do të bisedohet asgjë kundër tyre dhe se asgjë nuk do të ndryshojë në marrëdhëniet e Jugosllavisë me ta. Dhe shërbëtori i devotshëm nuk u mjaftua me kaq, ai gjeti rastin në po këtë fjalim për të falënderuar vendet perëndimore dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën që i kanë dhënë dhe vazhdojnë t'i japin Jugosllavisë.

Ky është Titoja, që disa kanë filluar ta quajnë «shok». Të shpresosh që ky armik i betuar i marksizëm-leninizmit e i socializmit do të shkëputet nga prehri i imperializmit, me të cilin është lidhur kokë e këmbë, është utopi. Çdo veprim i nxitur nga ky iluzion vetëm ia rrit ajarin të diskredituarit Tito në opinion dhe te padronët e vet.

1. Fjalim i mbajtur në Pula me rastin e 10-vjetorit të çlirimit të Istrias.

E prisnim letrën që na erdhi¹, por kurrë nuk mendoja që përmbajtja e saj të më revoltonte e të më trondiste kaq shumë. Dihet që kohët e fundit udhëheqësit sovjetikë kanë filluar ta thërresin tradhtarin Tito «shoku Tito», por kurrë nuk do ta besoja, po të mos e kisha parë me sy, siç e pashë sot, që ata kanë vendosur ta hedhin poshtë si të padrejtë vendimin e Informbyrosë të nëntorit 1949 e ta rehabilitojnë tërësisht këtë armik.

Neve asnjëherë s'na ka pëlqyer e s'kemi qenë dakord me qëndrimet, opinionet e demarshet e kohëve të fundit të udhëheqësve sovjetikë për ta afruar Titon, por, për këto, si dhe për vajtjen në Beograd ata vendosin vetë. Gjithsecili e di vetë ç'bën, por askush s'ka të drejtë, qoftë ky edhe Sekretari i Parë i KQ të PK të BS, të anulojë në mënyrë të njëanshme një vendim kolegjal. Udhëheqjen trockiste të Beogradit e kanë dënuar partitë komuniste e punëtore, anëtare të Informbyrosë dhe u takon këtyre të vendosin nëse duhet rishikuar vendimi i nëntorit 1949.

1. Më 23 maj 1955 udhëheqjes së PPSH i erdhi një letër nga N. S. Hrushovi,

Ky vendim i udhëheqjes sovjetike, që për mendimin tim është tërësisht i papërligjur, më shqetëson, se lidhet jo vetëm me qëndrimin që duhet mbajtur ndaj një armiku tepër të rrezikshëm siç është Titoja, por edhe me marrëdhëniet midis partive tona. T'i kërkojmë një partie, tri ditë para takimit me Titon në Beograd, të rishqyrtojë dhe të vendosë për hedhjen poshtë të vendimit të Informbyrosë, do të thotë ta pyesësh sa për të larë gojën.

Nuk e di, por udhëheqja e ndonjë partie tjetër mund të jetë dakord me këtë vendim të sovjetikëve. Si të duan, kurse ne, që e njohim mirë renegatin e Beogradit, nuk do ta japim kurrë pëlqimin për larjen e të pararit Tito.

Letrën ua dhashë edhe shokëve për ta studiuar. Do të mblidhemi e do të vendosim bashkërisht për përgjigjen, që duhet kthyer sa më shpejt.

E MËRKURË

25 MAJ 1955

Pas diskutimit në Byronë Politike u kthyem përgjigjen e letrës shokëve sovjetikë. Mendimin tonë të argumentuar ua thamë hapur, megjithëse kjo mund të mos u pëlqejë. Kërkuam me forcë që, për të vendosur lidhur me vendimin e Informbyrosë të nëntorit 1949, të organizohej një mbledhje e Byrosë Informative, ku, mundësisht, të marrë pjesë edhe Partia jonë për të thënë fjalën e vet. Të shohim si do të reagojnë, por kam pak shpresë që ata të heqin dorë nga vendimi për ta rehabilituar udhëheqjen jugosllave.

Presidiumi i Kuvendit Popullor vendosi që më 28 maj të mblidhet Kuvendi Popullor për të shqyrtuar çështjen e ratifikimit të Traktatit të Varshavës.

Shokët sovjetikë jo vetëm s'e kanë mirëpritur, por, me sa duket, edhe janë shqetësuar nga përgjigjja që u kthyer. Këtë e provuan kërkesa e sotme e Leviçkinit, ambasadorit sovjetik, për t'u takuar e tentativat e tij gjatë bisedës për të na bindur të tërhiqeshim nga kundërshtimi. Megjithatë, jo ne, por ishte ambasadori sovjetik ai, që, përballë argumenteve që i parashtrova, u detyrua të tërhiqej, duke më premtuar se do t'ia transmetonte udhëheqjes të gjitha ato që i thashë. Le të bëjë ç'të dojë, por asgjë të re s'ka për të transmetuar, se të gjitha janë thënë në letrën që i drejtuam Hrushovit.

U nis nga Moska dhe mbërriti në Beograd delegacioni qeveritar i Bashkimit Sovjetik i kryesuar nga Hrushovi. Veç deklaratës së N.S.Hrushovit në aeroportin «Zemun», delegacioni qeveritar sovjetik i bëri një vizitë Titos.

Kundërshtimi ynë i vendosur për anulimin e njëanshëm nga sovjetikët të vendimit të Informbyrosë për dënimin e udhëheqjes jugosllave ka rënë në vesh të shurdhër. Qysh dje, me të vënë këmbët në aeroportin e Beogradit, N.S.Hrushovi nxitoi të deklaronte dhe të hidhte poshtë publikisht e me vendosmëri Rezolucionin e nëntorit 1949. «Argumentet» u gjetën, ky rezolucion është mbështetur në dokumente të trilluara nga armiqtë; Beria, Abakumovi e «agjentë të tjerë të imperializmit në radhët e PK të BS» e mashtruan dhe e shtynë Byronë Informativë të dënonte udhëheqjen jugosllave. E bukur logjikë: «komunistit Tito e shokëve të tij u është rënë padrejtësisht në qafë». Ky përfundim, edhe sikur të jetë thënë thjesht e vetëm për koniunkturë, që përsëri është absolutisht e palejueshme, është tepër i rrezikshëm, se krijon iluzione. Armiku mbetet armik e po e dobësive vigjilencën ndaj tij, të ngul thikën.

Po më forcohet bindja se kemi qenë të vetmit në kundërshtim me këtë vendim të sovjetikëve. Po të kishin vepruar si ne edhe partitë anëtare të Byrosë Informativë, N.S.Hrushovi do ta kishte shumë të vështirë dhe

fare të pajustificueshme ta rehabilitonte në këtë mënyrë Titon. Kjo u bë, me siguri, edhe me pëlqimin e të tjerëve, prandaj tani nuk ia vlen të kërkohet mbledhja e Informbyrosë për këtë çështje. Këtë mendim do t'ua shtroj edhe shokëve të Byrosë Politike dhe, pasi ta diskutojmë e të biem dakord, mund t'ua komunikojmë edhe sovjetikëve, natyrisht, duke theksuar përsëri qëndrimin tonë të palëkundur ndaj titistëve.

Shokët e Byrosë Politike ishin dakord me mendimet e mia. Thirra Leviçkinin, i cili këto ditë mbeti duke na kërkuar takime, e vura në dijeni për çka vendosëm me shokët dhe i kërkova që për këto të informonte udhëheqjen sovjetike.

Problemi është ende në zhvillim e sipër dhe ne kemi besim se udhëheqja sovjetike do të dijë e do të vendosë drejt për gjithçka. Sidoqoftë duhet mprehur më tepër vigjilencia e duhen hapur më mirë sytë.

E SHTUNË
28 MAJ 1955

Mes një entuziazmi të papërshkrueshëm Kuvendi Popullor ratifikoi njëzëri sot mbasdite «Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke» midis tetë vendeve tona të kampit socialist. Populli shqiptar, që ndër shekuj e ka derdhur gjakun lumë për lirinë e pavarësinë e vet, do t'i qëndrojë besnik këtij traktati, që është shprehje *de jure* e miqësisë dhe e vëllazërimit me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore të çelikosur nga leninizmi. I ndërgegjshëm për detyrat dhe të drejtat që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë traktat, populli ynë do të luftojë për mbrojtjen e kampit socialist, për ruajtjen e paqes në Ballkan dhe në Evropë, për mbrojtjen dhe shtimin e fitoreve në ndërtimin e socializmit.

Në mbledhjen e Kuvendit fola dhe unë¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 325.

Pas bisedimeve «në një atmosferë mirëkuptimi reciprok», drekave e darkave në ishullin Brioni, udhëtimit me jahtin «Jadranka», vizitës në portin detar të Rjekës e në shpella të Postojnës, dje u nënshkrua në Beograd një deklaratë e qeverive të BRSS dhe RPFJ.

Sot delegacioni sovjetik do të shkojë nga Beogradi në Sofje për një vizitë zyrtare miqësore në RP të Bullgarisë.

Fjalimi i mbajtur dje nga N.S.Hrushovi në mitingun e madh të organizuar në Sofje me rastin e mbërritjes së delegacionit sovjetik në Bullgari, iu kushtua kryesisht marrëdhënieve «të reja» me Jugosllavinë. Ai deklaroi se «bisedimet sovjeto-jugosllave i dhanë fund periudhës gjatë së cilës ishin prishur marrëdhëniet e mira midis vendeve tona» dhe se «tani është hapur rruga për vendosjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve miqësore... të të gjitha vendeve të demokracisë popullore me RPF të Jugosllavisë». Me një fjalë «të mos druhemi» se Sekretari i Parë i KQ të PK të BS na jep «leje» të shkojmë tek Titoja. Kjo jo vetëm s'ka asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin për marrëdhëniet mes partive, por është pak ta quash edhe logjikë megalomani. Qëndrimi i PPSH ndaj revizionizmit e veçanërisht ndaj titizmit nuk është përcaktuar e kurrë nuk do të përcaktohet nga dëshirat apo «urdhrat» e njërit apo të tjetrit, kushdo qofshin këta.

E HËNË
6 QERSHOR 1955

Vizitat rrufe të delegacionit sovjetik në Bullgari e Rumani¹ me të lënë Beogradin, i vunë kapak çështjes së anulimit të njëanshëm nga sovjetikët të vendimit të Informbyrosë të nëntorit 1949. «Shkëmbimi i mendimeve» në Sofje e sidomos bisedimet e djeshme në Bukuresht edhe me udhëheqësit e Hungarisë e të Çekosllovakisë, që duket hapur se ishin thirrur për këtë qëllim, ligjësuat hedhjen poshtë të këtij vendimi. Njoftimet e TASS-it vënë në dukje unanimitetin e plotë të pikëpamjeve dhe «shpresën e besimin» e udhëheqësve bullgarë, rumunë, hungarezë e çekë për vendosjen e një bashkëpunimi miqësor të vendeve të tyre me Jugosllavinë.

Kjo ka dy shpjegime: ose udhëheqësit e këtyre vendeve janë konformuar, për një arsye ose një tjetër, me vendimin e shokëve sovjetikë, ose s'kanë qenë kurrë të bindur për tradhtinë e titistëve. Më shumë të ngjarë ka që arsyeja e vërtetë të jetë kjo e dyta, sepse komunisti

1. Nga 3-5 qershor delegacioni sovjetik i përbërë nga N. S. Hrushovi, N. A. Bulganini dhe A. I. Mikoijani vizitoi Sofjen dhe Bukureshtin.

i vërtetë nuk i ndryshon bindjet as në një ditë e as me urdhër. Partia e Punës e Shqipërisë ka mendimin e vet tërësisht të bazuar e të argumentuar për udhëheqësit jugosllavë. Për tradhtinë e titistëve na kanë bindur pikëpamjet, veprimet e qëndrimet e tyre shumëvjeçare në kundërshtim të hapët me marksizëm-leninizmin, interesat e kampit socialist, e sidomos armiqësia ndaj Partisë e RP të Shqipërisë, prandaj mendimit tonë për ta s'mund t'i lëvizim presjen me sugjerimin e njërit ose të tjetrit, qofshin këta edhe udhëheqësit sovjetikë.

E MARTË
14 QERSHOR 1955

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, që mbli-dhet sot, do të dëgjojë dhe do të diskutojë rreth raportit të Byrosë Politike për realizimin e vendimeve të Partisë e të Qeverisë për mbjelljet e vjeshtës e të pranverës dhe, sipas vendimit të mbledhjes së fundit të Plenumit të Komitetit Qendror¹, do të analizojë veprimtarinë anti-parti e armiqësore të Tuk Jakovës dhe të Bedri Spahiut.

1. Plenumi i 13-të i KQ të Partisë (25-27 prill 1955) ngarkoi Byronë Politike të analizonte deri në fund tezat armiqësore të Tuk Jakovës e qëndrimin antiparti të Bedri Spahiut dhe t'ia parashtronte përfundimet e kësaj analize mbledhjes së ardhshme të Plenumit.

E MËRKURË
15 QERSHOR 1955

Të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë e ndoqën me shumë vëmendje raportin «Mbi gabimet e Tuk Jakovës», që mbajta në emër të Byrosë Politike¹. Jo vetëm ne, udhëheqja e Partisë, por edhe çdo komunist i thjeshtë dhe njeri i ndershëm i popullit, që njihet me pikëpamjet e qëndrimet e Tuk Jakovës e të Bedri Spahiut, kupton qartë karakterin trockist, anti-marksist e armiqësor të tyre.

Në luftën kundër elementëve tradhtarë, deviatorë, fraksionistë e trockistë, që janë përpjekur me të gjitha mjetet të likudojnë Partinë dhe pushtetin popullor, Partia ka grumbulluar një përvojë të pasur dhe e ka mprehur jashtëzakonisht nuhatjen e saj revolucionare. Kurdoherë vigjilente dhe me radhë të shtrënguara Partia jonë do t'i shtypë kokën kujtdo që do të guxojë të ngrejë dorën kundër saj dhe pushtetit popullor.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 335.

E PREMTE
17 QERSHOR 1955

Analiza e thellë dhe e gjithanshme që i bëri Plenumi i Komitetit Qendror veprimtarisë armiqësore të Tuk Jakovës e të Bedri Spahiut dhe vendimi unanimit për dënimin e tyre, që u mor pas fjalës së mbajtur nga unë sot paradite në mbyllje të punimeve të Plenumit¹, provojnë edhe një herë pjekurinë marksiste-leniniste dhe unitetin e çeliktë në udhëheqjen e Partisë.

Në orën 16⁰⁰ filloi punimet Kongresi i 3-të i Frontit Demokratik të Shqipërisë. Kongresin e deklaroi të hapur shoku Hysni². Mes entuziazmit të papërshkruar të delegatëve dhe të të ftuarve, që kishin mbushur plot sallën e Kuvendit Popullor, mbajta raportin «Mbi aktivitetin e Këshillit të Përgjithshëm dhe detyrat e mëtejshme të Frontit Demokratik»³.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 378.

2. Në atë kohë edhe sekretar i përgjithshëm i Frontit Demokratik të Shqipërisë.

3. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 393.

E SHTUNË
18 QERSHOR 1955

Sot bashkë me shokun Rita Marko pritëm në aparatet e Komitetit Qendror Gjovalin Lukën¹, i cili po mban qëndrim armiqësor ndaj vijës së Partisë sonë.

E ftuam të thoshte hapur pikëpamjet e tij për të cilat ka bërë një «autokritikë» me shkrim. Gjatë shpjegimeve që dha u mundua ta paraqiste veten si njeri që ka gabuar për arsye të gjoja paqartësive të tij. Me qëndrimin hipokrit që mbajti gjatë bisedës, sido që u mundua t'i fshihte këmbët, dukej qartë që ai është kundër Partisë dhe udhëheqjes së saj, është karrierist i tërbuar.

E kritikova për pikëpamjet e tij dhe e ftova të thellohet në analizën e shkaqeve që e kanë çuar në këto pikëpamje, megjithëse është e zorshme që ai të korrigjohet. Sidoqoftë Partia bëri detyrën e saj edhe ndaj këtij elementi të degjeneruar politikisht.

Herët a vonë armiqët i nxjerrin «kthetrat».

1. Dënuar më vonë për krime kundër shtetit.

E MARTË
21 QERSHOR 1955

Në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor aprovuam propozimin e Qeverisë për shkarkimin e Tuk Jakovës nga detyra e zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe të Bedri Spahiut nga detyra e ministrit të Arsimit dhe të Kulturës për papërshtatshmëri në kryerjen e detyrave që u janë besuar.

Presidiumi aprovoi unanimisht shkarkimin e tyre për arsye se ata kanë zhvilluar veprimtari antiparti dhe armiqësore. Si njëri dhe tjetri, duke qenë antimarksistë, e vunë veten në opozicion të hapët me interesat e Partisë dhe të shtetit, gjë për të cilën Plenumi i 14-të i Komitetit Qendror i përjashtoi nga radhët e tij para disa ditësh.

SHTATOR 1955

PUSHIMET E SIVJETSHME

Pushime u thënçin. 22 ditë rrugë me vapor, me tren e me avion, biseda të gjata, shpesh të mërzitshme e, në raste të veçanta edhe presione (nuk gaboj që i quaj kë-shtu), për të na detyruar të ndryshonim mendim e qëndrim ndaj titistëve. Tash po reflektoj më mirë për qëllimin e ftesës së përsëritur e këmbëngulëse të shokëve sovjetikë, që unë të shkoja sa më shpejt, mundësisht në pranverë, për pushime në Bashkimin Sovjetik! Ende s'isha çlodhur pas udhëtimit të gjatë deri në Moskë e takimi i parë me Suslovin ma tregoi, thujse hapur, këtë qëllim.

E dija që letra jonë e 25 majit, ndoshta edhe për tonin e saj të prerë, nuk u kishte pëlqyer shokëve sovjetikë. Këtë e ndjemë menjëherë, ndaj dy ditë më pas, në takimin me Leviçkinin, e shtrova përsëri çështjen e qëndrimit tonë ndaj udhëheqësve jugosllavë. «Ne kemi qenë në një situatë të rëndë, i thashë atëherë ambasadorit sovjetik, dhe na vinte e na vjen keq që në këtë pikë nuk mund të jemi në një mendje me ju». Megjithëse biseda ime me Leviçkinin iu transmetua udhëheqjes

sovjetike, kjo vazhdoi të mbetej e pakënaqur. E them këtë i nisur nga dendësimi i vizitave të Leviçkinis e nga shpeshimi i bisedave të tij për marrëdhëniet tona me jugosllavët. Për këtë arsye, në fund të qershorit, në emër të Byrosë Politike i shkrova një letër tjetër udhëheqjes sovjetike¹ për ta sqaruar edhe një herë se përse u ndodhëm në kundërshtim me ta për anulimin e Rezolucionit të mbledhjes së tretë të Informbyrosë. Menduam se pas kësaj shokët sovjetikë do ta kuptonin drejt e do të pajtoheshin me pikëpamjen tonë të argumentuar, të mbështetur tërësisht në mësimet e marksizëm-leninizmit e në fakte të pakundërshtueshme.

Por u gabuam. Që në fillim të bisedës së parë, që iu kushtua e gjitha çështjes jugosllave («sqarimet» për këtë çështje nuk m'u ndanë në asnjë bisedë të zhvilluar me shokët sovjetikë gjatë pushimeve), Suslovi na tërhoqi vërejtjen të mos e shihnim «ngurtë» problemin jugosllav. E vërteta rreth titistëve, e mbrojtur prej nesh, binte në vesh të shurdhër. Bashkëbiseduesve të mi, me sa duket, s'u interesonte e vërteta, por hedhja poshtë e saj. Ata përpiqeshin t'i shmangeshin polemikës dhe insistonin që Partia jonë të ndryshojë mendimin e qëndrimin e saj ndaj titistëve. «Këshillat» e «porositë» e tyre për të «vepruar me zemër më të hapët» e për të qenë «më të gjerë» me udhëheqësit jugosllavë, nuk kishin të mbaruar. E ndër këto «këshilla» kishte edhe të tilla, si ajo e Suslovit, që në një rast pati guximin të më

1. Më 26.6.1955 në emër të Byrosë Politike të KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha i drejtoi letrën e dytë udhëheqjes sovjetike lidhur me çështjen jugosllave.

thoshte se Partia jonë duhej të rishikonte edhe çështjen e armiqve të dënuar «për lidhje me jugosllavët»! Nga armiku mund të presësh gjithçka, por ta dëgjosh këtë nga goja e një shoku është sa e pabesueshme, aq edhe tronditëse! Megjithatë, pas përgjigjes sime, zor se do të guxojë kush të na e përsëritë këtë «propozim».

Në vazhdën e këtyre erdhi edhe telefonata e Mikojanit pas mesnate. Kërkoj që të nesërmen të takohesha me S. V. Tempon! Tonin e tij urdhërues, sikur unë të isha vartës i tij, nuk do ta harroj gjithë jetën. Mbete pa gjumë gjithë natën, por në takimin që ai kishte organizuar me kohë, desha s'desha, shkova! Por, nëse këtë radhë Mikojani më vuri para një fakti të kryer e më detyroi të bëja diçka jashtë dëshirës e bindjeve të mia, këtë e bëra edhe për të ruajtur autoritetin e udhëheqjes sovjetike, edhe të vetë Mikojanit. Ne e respektojmë atë si kuadër drejtues të Partisë Bolshevike, megjithatë ky respekt nuk duhet e nuk mund të jetë i njëanshëm. Këtë e argumenton Lenini, këtë na mësonte dhe e zbatonte me të gjithë Stalini.

Këto ishin pushimet në Bashkimin Sovjetik. Filluan me Suslovin e mbaruan me Mikojanin. Përpjekjet e tyre nuk ndryshuan asgjë në marrëdhëniet tona me jugosllavët, por nuk kaluan pa lënë gjurmë tek unë. Pse vepronjë e sillen kështu shokët sovjetikë në marrëdhëniet me ne? Pse insistojnë ata që ne me çdo kusht të pajtohemi me udhëheqësit jugosllavë? Këto pikëpyetje, që janë rezultat i drejtpërdrejtë i bisedave të Suslovit e i veprimit të Mikojanit, duan një përgjigje, që kurrësesi s'duhet të jetë e nxituar!

**SHKODËR, E DIEL
11 SHTATOR 1955**

Mora pjesë në festën e Reçit dhe fola në mitingun e organizuar me këtë rast. Entuziazmi i mijëra njerëzve të ardhur nga qyteti dhe fshatrat përreth, që mbushnin Fushën e Gështenjave, ku festohet çdo vit lufta e Reçit, ishte i madh. Në ditë të tilla gëzimi shpërthen me forcë dashuria e popullit për Partinë dhe respekti i tij për të rënë.

Në emër të KQ të Partisë vendosa një kurorë në lapidarin kushtuar shokëve dëshmorë të luftës së Reçit.

EH

**VLORË, E DIEL
18 SHTATOR 1955**

Mijëra veta ishin sot në festën e Drashovicës. Kishin ardhur të rinj e të moshuar, pjesëmarrës të luftës së 1943-së dhe luftëtarë të 1920-s.

Mitingu i organizuar ishte madhështor, manifestim masiv i besimit të patundur te Partia dhe i vendosmërisë për të ecur në rrugën e treguar prej saj.

I përshëndeta pjesëmarrësit e mitingut dhe, pasi vendosa një kurorë në lapidarin kushtuar dëshmorëve të luftës së Drashovicës, u futa mes tyre. Takova e bisedova me të njohur e me grupe të ndryshme fshatarësh.

Më 20 nëntor të këtij viti do të bëhen zgjedhjet e këshillave popullorë të fshatrave. Kryesia e Frontit Demokratik të Shqipërisë, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe politike të këtyre zgjedhjeve, zhvilloi një mbledhje të posaçme të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik. Kjo mbledhje kishte për qëllim që të diskutonte dhe të përcaktonte detyrat e organizatave të Frontit gjatë fushatës së zgjedhjeve.

Partia i ka kushtuar vëmendje të veçantë forcimit të pushtetit tonë, që është pushtet i popullit, që mbron interesat e popullit dhe punon për të mirën e popullit. Kjo shprehet edhe në vlerësimin që u bën Partia zgjedhjeve të këshillave popullorë, që janë bazë e pushtetit tonë shtetëror. Prandaj edhe në fjalën time¹ në këtë mbledhje vura në dukje qëllimin e thellë politiko-organizativ të fushatës së zgjedhjeve, në të cilën duhet të aktivizohet i gjithë populli; të tërë të marrin pjesë gjallërisht në diskutime e propozime për kandidatët, duke zgjedhur ata që e meritojnë më shumë nga niveli

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 16.

i tyre ideopolitik, nga besnikëria ndaj çështjes së popullit, nga dashuria për popullin dhe nga respekti që ata gëzojnë në popull. Gjithmonë të mbahet parasysh se kandidati më i përshtatshëm është ai që do dhe që zgjedh populli. Ky është edhe kandidati më i mirë i Partisë dhe i Frontit Demokratik.

Kuptohet, pra, se sa rëndësi të madhe ka një fushatë e tillë me karakter të theksuar politik siç është kjo e zgjedhjeve për këshillat popullorë të fshatrave. Kam bindjen se si kurdoherë, Fronti Demokratik i Shqipërisë, i udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme, do t'i kryejë me sukses detyrat që ka përpara kësaj fushate.

**E SHTUNË
8 TETOR 1955**

Organizata e rinisë është mjaft luftarake. Anëtarët e saj janë entuziastë, e duan me shpirt Partinë, por duhet të punojnë më shumë për ngritjen e nivelit të tyre ideologjik e kulturor. Organizatat e rinisë nuk po i shfrytëzojnë si duhet mjetet dhe mundësitë e shumta që kanë krijuar Partia dhe shteti ynë për këtë qëllim, prandaj në fjalën që mbajta sot në Plenumin e KQ të BRPSH¹ e vura theksin tek organizimi më i mirë i punës për shfrytëzimin në maksimum nga rinia të të gjitha këtyre mjeteve dhe mundësive. Kjo do të bëjë të mundur të luftohen me sukses edhe shfaqjet e sektarizmit në punën e organizatës së rinisë me të rejtat dhe veçanërisht për shtimin e radhëve të saj. Duhet kuptuar mirë nga të gjithë se nuk janë të njëjlojta kërkesat, disiplina dhe organizimi i Partisë me ato të organizatës së rinisë. Megjithëse këto dihen, në praktikën

1. Plenumi i 10-të i KQ të BRPSH, që i zhvilloi punimet më 7 e 8 tetor 1955, diskutoi për disa çështje të edukimit komunist të rinisë dhe për detyrat e organizatës së rinisë e të pionierit në shkolla.

e punës së organizatës së rinisë ka shfaqje të sektarizmit që duhen luftuar me forcë dhe sa më shpejt.

Me sugjerim të Komitetit Qendror të Partisë, Plenumi liroi nga funksionet e Sekretarit të Parë të Rinisë, Ramizin. E kam ndjekur punën e këtij shoku të ri, të aftë e të talentuar që nga vitet e luftës dhe me kënaqësi kam vënë re se ai i ka kryer në mënyrë shembullore detyrat e ngarkuara si drejtuesi kryesor i rinisë për vite të tëra. Tani Partia ka nevojë për aftësitë dhe për cilësitë e tij të vyera në një tjetër sektor të rëndësishëm, në atë të arsimit e të kulturës, ku prej disa muajsh, me propozimin tim i është ngarkuar detyra e ministrit.

E ENJTE
13 TETOR 1955

Sot, në orën 16⁰⁰, në sallën e Kuvendit Popullor, filloi punimet Kongresi i 4-t i BGSH. Pas fjalës së shkurtër të Nexhmijes¹, që hapi kongresin në mes entuziazmit të papërshkruar të qindra delegateve të ardhura nga të katër anët e vendit, shoqja Vito Kapo² mbajti raportin «Mbi aktivitetin e Këshillit të Përgjithshëm dhe detyrat e mëtejshme të Bashkimit të Grave të Shqipërisë».

Përshëndeta kongresin³ në emër të KQ të Partisë. Gruaja shqiptare ka shpërthyer në të gjitha fushat e aktivitetit të jetës në vendin tonë. Motrat dhe vajzat tona ndjekin në masë shkollat, punojnë në mënyrë shembullore në fabrika e në ara, janë bërë mjekte, mësuese, inxhinierë, artiste, drejtojnë ndërmarrje e institucione dhe përfaqësojnë popullin e zonave të ndryshme në Kuvendin Popullor. Këto arritje janë një bazë e

1. Në atë kohë Presidente e Bashkimit të Grave të Shqipërisë.

2. Në atë kohë nënpresidente e Bashkimit të Grave të Shqipërisë.

3. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 54.

shëndoshë për të ecur më shpejt në rrugën e ndritur të përparimit. Garanci për këtë është pushteti ynë popullor, është Partia e Punës e Shqipërisë që ka mbrojtur e do të mbrojë me të gjitha forcat, në parim dhe në jetën praktike, çështjen e drejtë e të madhe të gruas.

**E SHTUNË
15 TETOR 1955**

Për dy ditë rresht, dje dhe sot, vazhduan diskutimet në Kongresin e 4-t të BGSH. Diskutime të pjekura, fjalë të zjarrta për Partinë dhe pushtetin tonë të dala nga zemra. Të gjitha diskutueset, gra punëtore, kooperativiste e intelektuale folën me krenari për arritjet, sidomos për pjesëmarrjen masive të grave dhe të vajzave në prodhim dhe shprehën vendosmërinë për të ecur si kurdoherë në rrugën e treguar nga Partia, në rrugën e përparimit.

Kongresi u dha fund punimeve. Shoqja Vito Kapo u zgjodh presidente e BGSH.

**E DIËL
16 TETOR 1955**

Prita në selinë e Komitetit Qendror një grup grash delegate në Kongresin e 4-t të BGSH, që erdhën për të më uruar ditëlindjen. Biseduam për karakteristikat dhe jetën e grave në krahina të ndryshme. Gratë flisnin lirisht dhe me kompetencë për problemet e gruas, për arritjet dhe vështirësitë që hasen në rrugën për emancipimin e mëtejshëm të saj. Jam i bindur që ato edhe në të ardhmen do të punojnë pa u lodhur që organizata e gruas të plotësojë misionin e lartë në dobi të atdheut dhe të popullit.

LETORI V
 BERR: NËNTORI 1955

**E DIEL
 6 NËNTOR 1955**

Në orën 19⁰⁰ kemi mbledhjen solemne me rastin e 38-vjetorit të fitores së Revolucionit Socialist të Tetorit. U mbushën 38 vjet, që klasa punëtore po i tregon botës se ç'është e zonja të bëjë, kur merr pushtetin në duart e veta.

Për këtë ngjarje të mädhe, që hapi një epokë të re për njerëzimin, në mbledhje do të flasë shoku Gogo [Nushi]¹.

1. Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH.

LETORI V
 BERR: NËNTORI 1955

**E ENJTE
 24 NËNTOR 1955**

Përgëzova dhe i urova suksese të mëtejshme në të ardhmen një grupi vajzash pjesëmarrëse në Konferencën e Parë Kombëtare të të Rejave, që zhvilloi punimet dje në Tiranë.

E HËNË
28 NËNTOR 1955

Nesër mbushen 11 vjet nga dita kur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë shporri një herë e përgjithmonë nga trualli i vet pushtuesit nazistë. Dita e Çlirimit, 29 Nëntori i vitit 1944, shënon fitoren më të madhe në historinë shumëshekullore të vendit tonë, që u pasua nga fitore të tjera të mëdha në rrugën e transformimeve socialiste. Krenarë për sukseset e arritura në këta 11 vjet të jetës së lirë e të pavarur, ne jemi të vendosur më shumë se kurrë për të mbrojtur me vigjilencë fitoret e arritura e për të ecur pa u ndalur në rrugën e marksizëm-leninizmit.

Me rastin e festës së Çlirimit sot mbasdite, në sallën e Teatrit Popullor, u organizua një mbledhje solemne.

E MARTË
29 NËNTOR 1955

Pritje në Pallatin e Brigadave me rastin e 11-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Përveç udhëheqjes së Partisë e të shtetit në pritje merrnin pjesë edhe punëtorë të pararojës, përfaqësues të organizatave të masave, punonjës të artit, të kulturës e të shkencës etj. Të gjithë bashkë kaluam një mbrëmje të gëzuar.

Rroftë në shekuj Shqipëria socialiste, e lirë dhe sovranë!

E HËNË
12 DHJETOR 1955

Mora pjesë në ceremoninë e inaugurimit dhe vizitova ekspozitën e prodhimeve bujqësore e blegtorale të qarkut të Tiranës. Ekspozimi i prodhimeve të punonjësve më të dalluar të bujqësisë e të blegtorisë është një formë e drejtë emulacioni, që qarku i Tiranës po e praktikon për herën e dytë.

Si kudo, ne po ecim përpara edhe në bujqësi e blegtori. Kjo duket qartë si në rritjen e numrit të punonjësve, që kishin ekspozuar prodhimet e tyre, ashtu edhe në cilësinë e këtyre prodhimeve.

E MËRKURË
14 DHJETOR 1955

SHËNIME PËR DISKUTIM NË BYRONË POLITIKE

Organizimi i komiteteve të rajoneve

Sekretarët:

1. Sipas rretheve të ketë minimumi dy dhe maksimumi katër sekretarë. Në përgjithësi sekretari i parë të jetë i lirë, sidomos atje ku janë katër sekretarë.
2. Sekretarët të ndahen në baza funksionale.

Instrukturët:

1. Në përgjithësi në çdo lokalitet duhet të ketë dy instruktorë, njëri për organizimin e agjitpropin dhe tjetri për bujqësinë.
2. Në ndonjë lokalitet me shumë organizata-bazë partie dhe me shumë fshatra mund të shtohet edhe një instruktor i tretë për bujqësinë. Në qytetet e në lokalitetet e mëdha mund të shtohet edhe një instruktor ose për organizimin e agjitpropin, ose për ekonominë.

Seksionet:

1. Të mos ketë katër seksione, por dy dhe atje ku ka industri tri seksione. Pra: seksioni i organizimit e i agjitpropit, seksioni i bujqësisë, seksioni i ekonomisë.

2. Të mos ketë shef seksioni, por të ketë përveç instruktorëve funksionalë të seksionit të organizimit, si taser, evidencë etj. dhe nga një instruktor në çdo seksion, që të koordinojë punën dhe vazhdimin.

Administrata:

Të qëndrojnë e pandryshueshme.

Lidhjet:

1. Sekretarët, gjithsecili për funksionin e vet, mbajnë vetë në lidhje instruktorët përkatës të lokaliteteve. Mesatarisht çdo sekretari i bëhen 6-7 lidhje.

2. Sekretari mban lidhjet me seksionin përkatës.

Ndryshimet në organizimin ekzistues

1. Bashkohet organizimi me agjitpropin.
2. Eliminohet hallka shef seksioni.
3. Instruktorët lidhen drejt me sekretarët përkatës.
4. Instruktorët kanë si ndarje zone lokalitetet, ndarjen administrative.

Arsyet e këtij organizimi të ndryshëm nga ekzistuesi

1. Me ndarjen funksionale vazhdon të ruhet përgjegjësia e çdo sekretari për sektorin e vet përpara

komitetit dhe byrosë, në vend që kjo përgjegjësi të shpërndahet në tre, katër, pesë dhe gjashtë sekretarë.

2. Jemi më mirë në gjendje të gjejmë tre sekretarë në funksione të caktuara, sesa gjashtë sekretarë specialistë për të gjitha punët e Partisë, ose sekretarë të parë në miniaturë.

3. Koordinimi dhe ndihma e sekretarit të parë është më e mirë dhe më e koncentruar.

4. Me shumë sekretarë në zona është rrezik të dobësohet drejtimi kolegjial dhe sekretari i parë, po ashtu edhe sekretarët e zonave të shtyhen dhe të piren nga një punë drejtuese individuale.

5. Praktika e punës na ka treguar se edhe tash që kemi një numër të paktë sekretarësh të ndarë mbi baza funksionale, njerëzit na janë gozhduar në vend. Në rastin me shumë sekretarë të ndarë në bazë zone, sido që në parim thuhet që secili të rrijë në zonën përkatëse, këta do të thirren shpesh së bashku dhe veç e veç në qendër, pse janë udhëheqës të komitetit të Partisë. Në rast se nuk thirren, përgatitja e punës së byrosë dhe të komitetit do të dobësohet, do të dobësohet dhe udhëheqja kolegjiale.

6. Puna e seksioneve është më e thjeshtë sesa kur detyrat ndahen me zona dhe me instruktorë, që merren me të gjitha çështjet e Partisë.

- a) Në të tëra variantet ruhen seksionet.
- b) Në variantin tim sekretarët dhe instruktorët qëndrojnë funksionalë, pra, puna koncentrohet.
- c) Në variantin me sekretarë dhe instruktorë në bazë zone, të gjithë sekretarët dhe të gjithë instruktorët veç e veç do të kenë lidhje të domosdoshme me të gjitha seksionet.

c) Sipas variantit të pikës c, sekretarit të parë do t'i duhet të mbajë lidhjet me të gjitha seksionet për të përgjithësuar punën e Partisë, ashtu sikundër koordinon edhe punën me sekretarët.

d) Me variantin tim eksperiencia e Partisë do të përgjithësohet më mirë, sesa kur janë shumë përgjegjës, për të gjitha seksionet dhe për të gjitha punët e Partisë.

dh) Me variantin tim mund të hiqet lehtë shefi i seksionit dhe puna të bëhet më mirë pa të, pse sekretari përkatës ka lidhje drejtpërsëdrejti me instruktorët e seksionin përkatës dhe përgjithëson eksperiencën e Partisë me anën e tyre dhe të seksionit. Kurse me variantet e tjera duhet medoemos shefi i seksionit dhe prapë puna do të komplikohet për arsyet që thashë më lart.

7. Ky variant ka avantazhe në situatën tonë sepse:

a) Krijon mundësitë që njerëzit të specializohen, të fitojnë eksperiencë dhe të japin tash gjithçka sa mund të japin. Kjo si për sekretarët, ashtu dhe për instruktorët.

b) Forcon udhëheqjen kolegjiale dhe s'e frenon iniciativën as të sekretarët, as tek instruktorët.

c) Instruktorët caktohen në bazë lokaliteti dhe jo zone me dy ose dhe me tri lokalitete. Instruktorët në lokalitet, hallkë e pushtetit, do të kenë më mirë nën kontroll punën e pushtetit, do të ndihmojnë dhe do të koordinojnë më mirë punët e Partisë dhe të pushtetit.

c) Do të jetë më i lehtë grumbullimi, informimi dhe edukimi i sekretarëve të organizatave-bazë në lokalitet, sesa kur këto bëhen në bazë zone. Komunistët dhe po-

pullin i çon vetë puna e tyre në lokalitet, kurse me ndarjen në bazë zone komunistët e një lokaliteti duhet të shkojnë në një lokalitet tjetër të zonës së tyre për të gjetur instruktorin ose sekretarin shëtitës.

d) Instruktorët mund dhe duhet ta bëjnë jetën e tyre të Partisë në organizatën-bazë të lokalitetit, kurse instruktorët e ndarë me zona janë të orientuar ta bëjnë këtë në qendrën e rrethit. Në këtë mënyrë instruktorët në lokalitet lidhen më ngushtë me jetën e Partisë në lokalitetin e tyre.

Varianti i parë është ai i SMT-ve, që ekziston tash në Bashkimin Sovjetik dhe është varianti më i përparuar. Në Bashkimin Sovjetik SMT-të janë qendra të rëndësishme dhe kuadrot të përgatitur (jo vetëm kuadrot drejtues të partisë, por edhe komunistët, edhe masat punonjëse). Një gjendje e tillë te ne nuk ekziston. SMT-të tona nuk mund të krahasohen me ato të Bashkimit Sovjetik. Niveli i kuadrove, i komunistëve dhe i masave tona gjithashtu nuk mund të krahasohet. Pra, më parë se të vendosim për një variant të tillë, duhet të kemi parasysh këto gjëra. Unë mendoj se duhet të përgatitemi për të shkuar në këtë variant.

Varianti i parë bëhet në bazë zone dhe s'merret parasysh ndarja administrative e republikës. Duam s'duam ne, fshatarësia dhe organizatat-bazë të Partisë janë të grumbulluara në lokalitete, domethënë drejtimi i njerëzve është për nga lokaliteti, kurse në Bashkimin Sovjetik ekziston selsovjeti dhe pastaj vjen rrethi. Çështjet që populli në Bashkimin Sovjetik i zgjidh në selsovjete, te ne do t'i zgjidhë në lokalitete. Pra, mund të kuptohet lehtë rëndësia e qendrës së SMT-së

në Bashkimin Sovjetik, ku fshatarët drejtohen për çështjet e bujqësisë dhe komunistët për drejtimin dhe edukimin e tyre. Në çdo selsovjet të Bashkimit Sovjetik bëhen drejtpërdrejt punët që kryen lokaliteti.

Prandaj, unë mendoj se duhet ta ruajmë bazën lokalitet, derisa ky të ekzistojë, të ruajmë dhe ndarjen funksionale në sekretarët dhe instruktorët. Mendoj se ne duhet veçanërisht të interesohemi për forcimin e Partisë, për ngritjen e nivelit teorik dhe kulturor të saj dhe të masës. Këta dy sektorë mund t'i mbulojë një instruktor dhe jo dy, si i kishim më parë dhe instruktori i dytë të merret me çështjet e bujqësisë. Mund të ngjasë që këta të bëjnë një punë të palidhur. Edhe kjo mund të ndodhë, por ka më shumë rrezik të na ngjasë e kundërta, që instruktori jo i zoti të tërhiqet nga një sektor, nga ekonomia dhe të na dobësohet Partia. Kështu do të mbetet prapa niveli i Partisë dhe i popullit, gjë që do të ketë efekte të dëmshme në çështjet ekonomike.

**E MËRKURË
28 DHJETOR 1955**

Dje dhe sot zhvilloi punimet Plenumi i KQ të Partisë¹. Plenumi analizoi rezultatet e arritura në zhvillimin e ekonomisë dhe caktoi disa detyra kryesore për të ardhmen. Shokët folën me frymë të lartë përgjegjësie dhe me mendimet e tyre të vlefshme e plotësuan raportin. Në fjalën time² theksova disa çështje që duhen mbajtur parasysh për mbarëvajtjen më të mirë të punës në të ardhmen.

Plenumi aprovoi propozimin e Byrosë Politike për thirrjen e Kongresit të 3-të të PPSH më 25 maj 1956.

1. Plenumi i 16-të i KQ të PPSH diskutoi rreth raportit «Mbi realizimin e detyrave të planit të shtetit për vitin 1955 dhe masat për sigurimin e realizimit të planit të shtetit të vitit 1956».

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 97.

EH

[Faint, mostly illegible text, possibly bleed-through from the reverse side of the page.]

DITAR

6

1956

E DIEL
1 JANAR 1956

Mbrëmë mora pjesë në pritjen që u dha në Pallatin e Brigadave për 200 pionierë të dalluar, të ardhur nga i gjithë vendi me rastin e Vitit të Ri.

Pritja kaloi shumë mirë. U kënaqën të gjithë. Bashkë me pionierët edhe unë kalova çaste shumë të gëzueshme e çlodhëse.

U urova fëmijëve Vitin e Ri, i cili do t'i sjellë vendit tonë, të udhëhequr nga Partia, suksese akoma më të mëdha. I porosita, gjithashtu, të mësojnë gjithnjë më shumë, të duan prindërit, të respektojnë mësuesit, të duan atdheun, Partinë dhe pushtetin popullor.

E HËNË
2 JANAR 1956

Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe i KQ të Partisë për heqjen e pjesshme të sistemit të triskëtimit, për unifikimin e çmimeve dhe për vendosjen e marrëdhënieve të reja të shkëmbimit midis fshatit dhe qytetit, që hyn nesër në fuqi, është një tregues i rëndësishëm i sukseseve të arritura në zhvillimin e ekonomisë sonë gjatë planit të parë pesëvjeçar. Heqja e pjesshme e sistemit të triskëtimit, si hap i parë për likuidimin tërësor të këtij sistemi, që u bë e mundur nga vetë zhvillimi i ekonomisë sonë socialiste, ishte e domosdoshme për shtimin e mëtejshëm të prodhimit industrial e bujqësor. Populli, si kurdoherë, do ta kuptojë drejt këtë masë dhe, nën udhëheqjen e Partisë, do të arrijë me siguri fitore të reja gjatë pesëvjeçarit të dytë që sapo filloi.

EH

E MARTË
3 JANAR 1956

Shoku Vilhelm Pik, figurë e njohur e lëvizjes punëtore e komuniste ndërkombëtare dhe e klasës punëtore gjermane, President i RD Gjermane, mbushi 80 vjeç.

Piku është mik i madh i popullit tonë. Kur punonte në organet drejtuese të Kominternit, aty nga mesi i viteve 30-të, ai ka ndihmuar personalisht për zhvillimin e drejtë të lëvizjes komuniste në Shqipëri.

I dërguam një përshëndetje në emër të popullit shqiptar dhe të Komitetit Qendror të Partisë duke i uruar jetë të gjatë për të mirën e popullit gjerman dhe të çështjes së socializmit.

Në mbrëmje do të marr pjesë në pritjen që do të japë ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i RD Gjermane me rastin e 80-vjetorit të lindjes së shokut Vilhelm Pik.

E MËRKURË
4 JANAR 1956

Sot njoftuam popullin nëpërmjet shtypit për vendimin e Këshillit të Ministrave dhe të Komitetit Qendror të Partisë për tharjen e kënetës së Tërbufit dhe bonifikimin e fushës së Myzeqesë. Ky është një lajm i gëzuar jo vetëm për myzeqarët punëtorë e trima, por për gjithë popullin tonë sepse zhdukje kënetash do të thotë zhdukje e folesë së malarjes, do të thotë zhvillim e shëndet, do të thotë përparim e begati. Vetëm Partia jonë e Punës ka forcën, guximin dhe aftësinë të marrë përsipër vepra të tilla të mëdha që transformojnë jo vetëm natyrën, por edhe jetën e popullit, e bëjnë atdheun të begatë, të lulëzuar e të përparuar. Tharja e Tërbufit dhe bonifikimi i Myzeqesë do të kërkojnë mund e sakrificë, por populli ynë punëtor e heroik do t'ia arrijë qëllimit.

EH

E ENJTE
5 JANAR 1956

Lufta kundër shfaqjeve të huaja të kuadrot e organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të tërheqë më shumë vëmendjen e organizatave-bazë të Partisë në këto organe, të komiteteve të Partisë në qarqe e në rrethe e sidomos të udhëheqjes së organeve të Punëve të Brendshme, që ka bërë lëshime të pajustificuara ndaj shfaqjeve të dëmshme e negative të konstatuara, gjë që ka ndikuar në përhapjen dhe në përsëritjen e tyre. Nga masat që u morën kohët e fundit ndaj disa kuadrove të këtyre organeve në qarqet e Gjirrokastresë e të Durrësit për familjaritet të sëmure, karrierizëm, pakënaqësi, ambicie, thashetheme, dekonspirim të sekreteve të shtetit etj., nuk janë nxjerrë mësimet e duhura.

Shfaqje të tilla, të papajtueshme me moralin tonë komunist, që dëmtojnë seriozisht punën dhe autoritetin e organeve të Punëve të Brendshme, ligjshmërinë socialiste dhe vijën e Partisë vazhdojnë të konstatohen, sepse ka raste që vendimet dhe porositë e Partisë e të Komitetit Qendror nuk zbatohen me përpikëri nga këto organe. Kjo është e palejueshme. Organizatat-bazë të

Partisë në organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të ndihmuara e të kontrolluara nga komitetet e Partisë, duhet të kërkojnë më tepër llogari për punën e çdo komunisti dhe të godasin me guxim e me ashpërsi të metat e kujtdo qofshin. Në letrën që u drejtova sot organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme¹ u tërhoqa vëmendjen drejtuesve të këtyre organeve në qendër, në qarqe e në rrethe që të ndihmojnë e të kontrollojnë më mirë vartësit dhe të forcojnë kërkesën e llogarisë për zbatimin e përpiktë të detyrave që u janë ngarkuar.

E ENJTE
12 JANAR 1956

Midis kaq e kaq mesazhesh e urimesh që më kanë ardhur e më vijnë nga brenda e jashtë atdheut për Vitin e Ri, mora edhe një letër nga një invalide 60-vjeçare letoneze. Në letrën e saj ajo shpreh dashurinë e madhe për popullin shqiptar, për të ardhmen e tij të lumtur dhe për Partinë e Punës. Kjo veterane, së cilës hitlerianët i prishën dritën e syve, më shkruan se megjithëkëtë sheh me sytë e shokëve, pra, edhe me sytë e komunistëve shqiptarë! U preka shumë nga fjalët e saj të ngrohta.

Ndjenjat e miqësisë drejtuar Partisë dhe popullit shqiptar flasin për rrugën tonë të drejtë dhe për qëndrimin internacionalist, të cilët ne, komunistët shqiptarë, do t'i ruajmë si sytë e ballit dhe do t'i zhvillojmë sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 120.

E PREMTE
20 JANAR 1956

Prita ambasadorin e ri të jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Bashkimit Sovjetik në Republikën Popullore të Shqipërisë. Pritja ishte e ngrohtë e miqësore. Por të shohim nëse është dërguar me predispozicion e vullnet të mirë.

E PREMTE
3 SHKURT 1956

Mbledhja e Sekretariatit të KQ shqyrtoi një raport të paraqitur nga ekipi i aparatit të KQ për gjendjen e SMT-ve dhe të NBSH-ve në ish-qarkun e Vlorës. Rezultoi se kjo gjendje atje është e dobët, rendimentet janë më të ulëta se ato të fshatarësisë. Nuk më pëlqeu autokritika që bënë sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve Vlorë e Fier, ajo nuk ishte konstruktive. Këtë ua thashë¹ shokëve në mbledhje.

Edhe ndihma e dhënë këtyre rretheve nga aparati i KQ nëpërmjet ekipeve nuk ka qenë e mjaftueshme, prandaj rekomandova të merren masa praktike për organizimin e punës dhe përmirësimin e gjendjes.

I dërguam telegram shokut Voroshilov² me rastin e 75-vjetorit të lindjes me urime të përzemërta në emër të popullit tonë dhe të Komitetit Qendror të Partisë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 146.

2. K. E. Voroshilov, në atë kohë President i Presidiumit të Sovjetit Suprem të BRSS.

E DIEI
5 SHKURT 1956

U sollën nga Italia në atdhe eshtrat e poetit tonë të njohur, Migjeni. Sot ato do të varrosen në Shkodër, në qytetin e tij të lindjes.

Migjeni i përket brezit të intelektualëve përparimtarë të viteve 30-të që me penën e tij të fuqishme, paraqiti realisht jetën e mjeruar të popullit nën regjimin anadollak zogollian. Ai nuk e idealizoi realitetin siç bënin këngëtarët e oborrit, por me vargjet e tij akuzoi dhe kërkoi një jetë të re. Pikërisht për karakterin e tyre përparimtar e revolucionar, regjimi anadollak i Zogut i censuroi «Vargjet e lira» të Migjenit. Poeti ynë i shquar i «Poemës së mjerimit», i «Këngës së rinisë», i «Të birtë e shekullit të ri» etj., etj. do të prehet, më në fund, në atdheun e tij të dashur për të cilin ëndërronte ditë më të mira dhe ruante në gji «Këngët e pakëndueme». Partia i dha Migjenit vendin që meriton, sot ai është një nga poetët më të dashur të popullit, e veçanërisht të brezit të ri, përkrah Naimit, Mjedës, Çajupit e të tjerëve.

E MARTË
7 SHKURT 1956

Askujt nuk i lejohet të shkelë udhëzimet e Partisë për punën me kuadrin. Organizatat dhe komitetet e Partisë, që kanë përgjegjësi të plotë për kuadrin, duhet të ndalen dhe të marrin masë ndaj çdo shkelësi të këtyre udhëzimeve, pa marrë parasysh postin që mban ai. Gabimet në këtë drejtim u kanë kushtuar rëndë Partisë, shtetit dhe popullit, ndaj, për këtë çështje, me anë të një letre¹ në emër të Komitetit Qendror, u tërhoqa vëmendjen gjithë organizatave-bazë dhe komiteteve të Partisë. Puna me kuadrin nuk e duron burokratizmin. Ajo kërkon principialitet komunist, guxim, iniciativë, vlerësim të drejtë të punës, forcim të ndihmës e të kontrollit për njerëzit.

Këto ditë mbi territorin e Republikës sonë Popullore janë konstatuar një numër balonash të fabrikimit amerikan të mbushura me gaz eksploziv. Sikurse ka njoftuar vetë radioja e ashtuquajtur «Evropa e lirë», ato janë lëshuar nga autoritetet ushtarake amerikane prej tokës së Gjermanisë Perëndimore.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 150.

Këto balona përmbanin trakte me shpifje provokuese kundër pushtetit popullor si dhe aparate vëzhgimi dhe fotografimi nga lart.

Nuk heqin dorë armiqtë e urryer të popujve e të socializmit nga planet e komplotet e tyre diversioniste! S'vunë mend nga disfata e turpshme që pësuan kur vjet ua zumë si miun në çark gjithë ata banditë e kriminelë që i hodhën në tokën tonë nga ajri dhe nga deti për të zhvilluar veprimtari diversioniste e kriminale në Shqipëri! Përsëri turpi e disfata mbi ta do të bjerë.

Do t'i dërgojmë një letër proteste Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për këtë shkelje flagrante dhe të palejueshme të hapësirës ajrore të atdheut tonë.

MOSKË, E HËNË
13 SHKURT 1956

Mbrëmë vonë arritëm në Moskë për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Kanë ardhur këtu edhe shumë delegacione të tjera të huaja që do të marrin pjesë në punimet e këtij kongresi. Në Moskë bën shumë ftohtë, megjithatë qyteti ka gjallëri.

Sot pasdite vizituam «Ekspozitën industriale të Bashkimit Sovjetik», që është hapur në prag të kongresit.

**MOSKË, E MARTË
14 SHKURT 1956**

Filloi punimet Kongresi i 20-të i PK të BS. N.S. Hrushovi mbajti raportin e Komitetit Qendror të PK të BS. Ishte një raport që ndryshonte shumë nga ato ç'kemi lexuar e dëgjuar në kongreset e tjera të partive tona. Të paktën kjo është përshtypja që krijova në sallë nga dëgjimi i përkthimit në frëngjisht. Por është tepër herët të hedh ndonjë mendim rreth përmbajtjes së tij.

**MOSKË, E MËRKURË
15 SHKURT 1956**

Vazhdojnë punimet e Kongresit të 20-të të PK të BS. Sot në seancën e mëngjesit u mbajt raportin e Komisionit Qendror të Revizionimit të PK të BS, pastaj kongresi kaloi në diskutimin rreth raporteve. Duartrokitje! Miratim!

Në emër të Partisë Komuniste të Kinës dhe të popullit kinez, përsëritet e firmosur nga shoku Mao Ce Dun, e lexoi Çu De. E prisja me interesim fjalën e shokëve kinezë sidomos në drejtim të qëndrimit ndaj problemeve që shtroheshin në raportin politik të N. Hrushovit. Duartrokitje!...

MOSKË, E ENJTE
16 SHKURT 1956

Boleslav Bjeruti përshëndeti Kongresin e 20-të. Ushqej simpati dhe respekt për këtë udhëheqës revolucionar e komunist të vendosur të Partisë Punëtore të Bashkuar Polake dhe të klasës punëtore polake. M'u duk tepër i lodhur, thujse i plakur sidomos kur mbaroi përshëndetjen e shkoi të ulej.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë përshëndeti Novotni. Çdo gjë ecën kreshendo, si dhe në ditën e djeshme të diskutimeve!

MOSKË, E SHTUNË
18 SHKURT 1956

Në seancën e mëngjesit, në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të gjithë popullit shqiptar përshëndeta Kongresin e 20-të të PK të BS.

Në fjalën time të përshëndetjes shpreha ndjenjat e dashurisë së komunistëve dhe të popullit tonë për vendin e parë socialist në botë, dashurinë dhe besnikërinë ndaj marksizëm-leninizmit, ndjenjat e internacionalizmit proletar dhe të besimit që popujt kanë në prestigjin dhe në emrin e mirë të PK të BS.

U lexua përshëndetja që Titoja i dërgon Kongresit të 20-të ku midis të tjerave i thuren ditirambe vizitës së Hrushovit, Bulganinit dhe Mikojanit vitin e kaluar në Jugosllavi si dhe «adoptimit të deklaratës» së Beogradit që, siç thekson Titoja, shënuan një periudhë të re në marrëdhëniet midis dy vendeve dhe në qëndrimin e vendeve të tjera ndaj politikës së Beogradit.

MOSKË, E SHTUNE
25 SHKURT 1956

Morën fund punimet e Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Delegacioni ynë, bashkë me delegatët e rajonit «Stalin» të kryeqytetit sovjetik u bëri një vizitë punëtorëve të uzinës së pajisjeve elektrike për traktorë dhe automobila. Punëtorët na pritën me ngrohtësi, ata brohoritnin për popullin shqiptar dhe për miqësinë midis dy popujve tanë.

Pas fjalës së përshëndetjes që mbajta para tyre, biseduam me drejtuesit e uzinës për prodhimin, për jetën e punonjësve dhe u ndamë të gëzuar nga ky kolektiv punëtorësh.

MOSKË, E DIEL
26 SHKURT 1956

Për tërë natën lexova një raport sekret të N. Hrushovit që na u dha edhe neve si gjithë delegacioneve të tjera të huaja. Raporti hedh poshtë figurën dhe veprën e madhe të Stalinit.

E ndjeva qëndrimin e Hrushovit me shokë ndaj Stalinit dhe veprës së tij të lavdishme që gjatë punimeve të kongresit ku emri i tij nuk u përmend asnjëherë për mirë, po se arrinin deri këtu nuk ma merrte mendja.

Rrëqethem kur mendoj se sa do të gëzohen borgjezia dhe reaksioni po ta shtijnë në dorë këtë raport, ç'fushatë shpifjesh do të fryjnë e sa do të zgjatin. Lëre pastaj Titoja ç'është kënaqur e krekosur kur, me siguri, e ka lexuar.

Ç'dëm i pallogaritshëm për Bashkimin Sovjetik dhe kampin e socializmit! Ç'përgjegjësi e turpshme përpara historisë!

Nuk mund të hedh në letër asgjë tjetër. Është pak të them: «jam i tronditur»!

E MARTË
28 SHKURT 1956

Sot u kthjem me avion nga Bashkimi Sovjetik në atdhe. Që kur iu afruam tokës së mëmëdheut, zemra filloi të më rrahë më me forcë. Sa të dashura më janë malet, fushat, rrugët e qytetit, njerëzit...

Në Aeroportin e Tiranës na pritën shokë të udhëheqjes së Partisë e të shtetit.

E MËRKURË
29 SHKURT 1956

Sot pasdite, në sheshin «Skënderbej» u mbajt mitingu i madh i popullit të Tiranës. Fola për përshtypjet e delegacionit tonë nga punimet e Kongresit të 20-të të PK të Bashkimit Sovjetik dhe nga vizita në këtë vend. Fola me këtë rast edhe për rrugën e drejtë marksiste-leniniste në të cilën Partia jonë e Punës udhëheq popullin shqiptar për ndërtimin e socializmit si dhe për unitetin Parti-popull që ajo farkëton.

E PREMTE
2 MARS 1956

Sot u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë ku foli për punimet e Kongresit të 20-të të PK të BS.

E ENJTE
8 MARS 1956

Vazhdon shkëmbimi i mesazheve midis Ajzenhauerit dhe Bulganinit, për problemet e çarmatimit. E dëgjuam në Moskë këtë vijë dhe duam vërtet që bota të shpëtojë nga armët e nga kasaphanat. Po a thua që imperialistët të ndërrojnë thelbin? Përvoja jonë tregon krejt të kundërtën. Ne nuk ushqejmë asnjë iluzion për qëndrimin armiqësor të imperializmit amerikan ndaj popujve, ndaj lirisë së tyre dhe veçanërisht ndaj vendeve socialiste

E DIEL
11 MARS 1956

Shkova në Ulzë. Pas fjalës në mitingun që organizoi komiteti i Partisë së hidrocentralit me këtë rast, vizitova punimet në digë, në hidromontim dhe në fabrikën e re të betonit. Punëtorët e teknikët që takova ishin entuziastë dhe të vendosur për t'ia dhënë sa më parë popullit këtë vepër të madhe të dritës.

E MARTË
13 MARS 1956

Mësova lajmin e hidhur se dje afër mesnatës vdiq në Moskë Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Punëtore të Bashkuar Polake, Boleslav Bjerut.

Nesër do të nisem për në Varshavë, në krye të delegacionit të PPSH që do të marrë pjesë në funeralin e shokut Bjerut.

**VARSHAVË, E PREMTE
16 MARS 1956**

Sot populli polak përcolli me nderim dhe dhimbje birin e tij të dashur, Bjerutin. Në kortezhin e gjatë të përmortshëm që përcolli trupin e tij të vendosur mbi shtratin e një topi, drejt qendrës së Varshavës, për në sheshin «Stalin», bënte pjesë edhe delegacioni ynë.

Ruaj përshtypjet e kujtimet më të mira për Boleslav Bjerutin, i cili punoi e luftoi si një komunist i vendosur revolucionar e internacionalist dhe, si i tillë, ai do të rrojë në zemrat e komunistëve e të popullit shqiptar.

EH

**E SHTUNË
17 MARS 1956**

Sot u kthyem në atdhe, pasi morëm pjesë në funeralin e shokut Boleslav Bjerut, në Varshavë.

E DIEL
18 MARS 1956

Lexova disa materiale të plenumit¹ të fundit të KQ të PK Italiane. Në këtë plenum Toliati ka folur për rëndësinë botërore të Kongresit të 20-të të PK të BS. Në fjalimin e tij Toliati, përveç të tjerave, një vëmendje të veçantë i kushton tezës së N. Hrushovit për kalimin në socializëm me rrugë të ndryshme. Lidhur me këtë, duke dashur të mos mbetet pas, ai thotë, më mirë të themi mburret, duke deklaruar se partia italiane paska ecur me guxim në këtë rrugë dhe se «komunistët italianë» paskan gjetur mënyrën e tyre, italiane, të ecjes drejt socializmit...!

Edhe ky «socializëm italian» i duhej botës, pas «socializmit specifik» të Titos!

1. Mbajtur më 16 mars 1956.

E HËNË
19 MARS 1956

TË TËRHIQET MË MIRË MENDIMI I MASAVE PËR HARTIMIN E PLANIT

Në mbledhjen e Byrosë Politike për tri ditë me radhë diskutuam¹ për përgatitjen e planit të dytë pesëvjeçar, duke u mbështetur në projektin e paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit.

Shokët anëtarë të Byrosë Politike bënë mjaft vërejtje rreth projektit dhe një sërë propozimesh me vlerë për përmirësimin e tij para se ai t'i paraqitet për rishikim Byrosë e më pas Plenumit të KQ.

Mbi të gjitha u bë vërejtja që projekti ta pasqyrojë më saktë realitetin dhe t'i parashikojë më mirë nevojat e vendit. Për këtë qëllim u dha porosia të tërhiqet më mirë mendimi i bazës, i punëtorëve, i kuadrove dhe i specialistëve.

U caktua një komision për rishqyrtimin e të gjitha vërejtjeve dhe propozimeve që u bënë në Byro si, bie

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 165.

fjala, për investimet që duhen ulur, përcaktimin e objekteve që do të ndërtohen, shtesat për zhvillimin e bujqësisë, për çështjet e arsimit, të shëndetësisë, të tregtisë së jashtme, të ndërtimeve të vogla me rendiment të shpejtë ekonomik, për energjetikën etj.

E PREMTE
23 MARS 1956

Lexova rastësisht një raport të Komitetit të Partisë të Beratit, i përgatitur për t'u mbajtur në konferencën e Partisë të rrethit, dhe nëpër faqet e tij bëra një varg vërejtjesh me shkrim, sidomos në pjesën që trajtonte problemet ekonomike¹.

Raporti i është dërguar Nexhmijes, e cila do të marrë pjesë në këtë konferencë si e deleguar e Komitetit Qendror të Partisë.

1. Ky raport ndodhet në AQP.

E PREMTE
30 MARS 1956

Zhurme e madhe rreth kultit të individit. Shtypi sovjetik, ai jugosllav, hungarez etj., po botojnë artikuj ku, nën frymën e raportit sekret të Hrushovit në Kongresin e 20-të të PK të BS, dënohet kulti i individit. Sipas njoftimeve nga Hungaria, në një fjalim të kohëve të fundit, Matias Rakoshi¹ ka njoftuar se me iniciativën e partisë hungareze, gjykata e lartë e këtij vendi ka rishqyrtuar procesin e Rajkut dhe, pasi ka arritur në përfundimin se e gjithë «çështja» ishte bazuar mbi një provokim, anuloi vendimin e mëparshëm dhe rehabilitoi Lazlo Rajkun.

Vallë për këtë bëhet zhurma rreth kultit të individit, për të rehabilituar elementë si Lazlo Rajku?

Kjo do të ishte njëlloj sikur te ne të bëhej gabimi i pafalshëm për rehabilitimin e Koçi Xoxes me shokë! Jo, kurrë!

¹Në atë kohë Sekretar i Parë i KQ të Partisë së Punonjësve të Hungarisë.

E MARTË
3 PRILL 1956

Shifrat e buxhetit të shtetit, që u aprovuan sot në ditën e dytë të punimeve të Kuvendit Popullor, i përgjigjen realizimit të detyrave të mëdha të planit ekonomik të vitit të parë të pesëvjeçarit të dytë. Buxheti i këtij viti është tregues i rritjes e i fuqizimit të ekonomisë sonë dhe një shprehje e qartë e kujdesit të vazhdueshëm të Partisë për ngritjen e nivelit material e kulturor të popullit.

Filloi shqyrtimi i projektligjit mbi Kodin e Punës të RP të Shqipërisë, që do të zëvendësojë Kodin e Punës të aprovuar në vitin 1947.

E MËRKURË

4 PRILL 1956

Sesioni i 3-të i Kuvendit Popullor u dha fund punimeve. Në fund Kuvendi Popullor aprovoi Rezolutën ku shprehet gëzimi që në sesionin e fundit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara Shqipëria u pranua anëtare e kësaj organizate¹. Kjo është një ngjarje e shënuar në jetën e popullit tonë, sepse i jep këtij vendin e tij të merituar në OKB. Shqipëria ka qenë dhe do të jetë gjithmonë një vend paqedashës dhe së bashku me shtetet e tjera që e duan paqen, anëtare të kësaj organizate, do të bëjë të gjitha përpjekjet për përparimin e njerëzimit.

Në mbrëmje mora pjesë në pritjen që dha ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i RP të Hungarisë, me rastin e 4 prillit, 11-vjetorit të çlirimit të Hungarisë.

Sot në shtypin tonë u botua lajmi i daljes në qarkullim të librit të Leninit «Materializmi dhe empirio-kriticizmi», në gjuhën shqipe, një nga veprat e tij më të rëndësishme, për njohjen më mirë të filozofisë marksiste-leniniste.

1. Shqipëria u pranua anëtare e OKB-së më 15 dhjetor 1955.

E DIJEL
8 PRILL 1956

Plenumi i 18-të i KQ të Partisë u mbledh tri ditë (5-7 prill) për të shqyrtuar dy çështje shumë të rëndësishme: planin e dytë pesëvjeçar (1956-1960) dhe projektstatutin e PPSH, që do t'i paraqiten për aprovim Kongresit të 3-të të Partisë.

Për çështjen e parë relacionin e paraqiti shoku Spiro Koleka. Në mbyllje të punimeve të Plenumit rekomandova¹ që me rastin e diskutimit të direktivave të planit të shikohen realisht mundësitë tona dhe të mos bëhen kërkesa të fryra që do të krijonin një situatë jo të mirë për Partinë dhe udhëheqjen. T'i bëhet thirrje popullit që të shtojë përpjekjet për të shtuar prodhimin. Gjatë kësaj kohe prej një muaji e gjysmë që na mbetet gjer në Kongres të përgatitemi intensivisht që të raportojmë për punën e bërë dhe për perspektivat që na hapen. Të synojmë për investimet prodhuese dhe për pakësimin e atyre që nuk janë prodhuese.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 133.

E HËNË
9 PRILL 1956

Me shokë të udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit, në orën 9⁰⁰ vizituam ekspozitën me punime artizanati të RP të Kinës. Gjatë vizitës u shoqëruam nga ambasadori kinez dhe shokë të tjerë. Pamë me interes objektet e ekspozuara të cilat ishin punuar me mjeshtëri nga artizanët kinezë. Para se të largoheshim lamë një shënim në librin e përshtypjeve, me fjalët më të mira për punëtorët duarartë kinezë, të cilët me durim, me shije artistike, me punë të hollë e të bukur kanë krijuar këto objekte.

Ne gëzohemi për arritjet e popullit kinez e i urojmë atij gjithnjë suksese në ndërtimin e socializmit.

EH

E PREMTE
13 PRILL 1956

Dorëzuar për botim në gazetën «Zëri i popullit» artikullin: «Marksizëm-leninizmi mëson se populli është krijues i historisë»¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 193.

E HËNË
16 PRILL 1956

Shokët më lajmëruan se në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës, disa elementë të sëmurë, oportunistë, karrieristë dhe me qëndrim të theksuar anti-parti, duke shpërdoruar besimin e organizatave-bazë ku janë zgjedhur delegatë, u ngritën kundër vijës së Partisë dhe udhëheqjes së saj. Ata, duke bërë të vetën propagandën armiqësore të Radio Londrës, të «Zërit të Amerikës» etj., atakuan me cinizëm vijën e drejtë të Partisë sonë në planin e brendshëm dhe të jashtëm, kërkuan revizionimin e kësaj vije për luftën e klasave, për marrëdhëniet me Jugosllavinë etj. duke arritur gjer atje sa, «në emër të demokracisë dhe të frymës së Kongresit të 20-të të PK të BS» të kërkojnë rehabilitimin e armiqve: Koçi Xoxe, Tuk Jakova, Bedri Spahiu e të tjerë! Kjo që po ngjiste në Konferencën e Tiranës nuk kishte ndodhur kurrë në Partinë tonë.

U shqetësova shumë për përpjekjet e këtyre elementëve të degjeneruar, që donin ta çoroditnin Konferencën e Partisë të kryeqytetit dhe ta vinin atë në opozicion me Partinë e me Komitetin e saj Qendror. Isha i bindur se qëllimet e tyre ogurzeza nuk do t'u shkonin,

sepse në atë konferencë shumica dërrmuese e delegatëve ishin komunistë të pjekur e të vendosur, që nuk do ta lejonin veten të bëheshin viktimë e armiqve të kurdisur për t'i vënë minat çështjes së socializmit në Shqipëri. Megjithëkëtë e gjykova me vend t'i ndërprisja pushimet¹ dhe të jepja ndihmën time si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror për sqarimin e situatës dhe për demaskimin e këtij grushti elementësh antiparti, që, duke i bërë llogaritë gabim, menduan se kishte ardhur koha të nxirrnin thikën nga guna për të goditur në zemër Partinë.

Pasi u informova mirë për sa po ndodhte, dje shkova në konferencë. E nisa fjalën time² me gjakftohtësi, duke theksuar disa çështje parimore, që komunisti ka të drejtë të bëjë pyetje, të kërkojë sqarime dhe të shprehë mendimet e tij për zgjidhjen konstruktive të problemeve. Fola për kuptimin e drejtë të demokracisë në parti, për respektimin e normave leniniste të ndërtimit të partisë, por theksova se demokracia nuk mund të përdoret si maskë për të shpifur e për të mashtruar në dëm të partisë, gjë që armiku do ta dëshironte shumë. Ndaj këtyre shfaqjeve Partia duhet të jetë shumë vigjilente dhe të mos lejojë që disa elementë t'u atribuojnë komunistëve, kuadrove e udhëheqësve të ndryshëm faje që atyre nuk u përkasin.

Fola për kultin e individit si një praktikë antimarksiste, për analizën e drejtë të këtij problemi në

1. Shoku Enver Hoxha ndodhej me pushime në Vlorë.
2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 202.

Partinë tonë dhe sqarova detyrat e vazhdueshme që i dalin Partisë në këtë drejtim.

Për sa i përket qëndrimit të Partisë sonë ndaj elementëve armiq e deviatorë, që kishin kryer krime kundër shtetit dhe popullit, sqarova se ne nuk kishim asnjë arsye të rishikonim masat e marra ndaj tyre, se ata ishin gjykuar dhe ndëshkuar, me gjakftohtësi e maturi, në bazë të normave leniniste e të provave të pakundërshtueshme. Mbi ta rëndonin krime të rënda në dëm të interesave të Partisë e të popullit.

Për marrëdhëniet tona me Jugosllavinë thashë se dihet botërisht që nuk u prishën për fajin tonë. Perspektiva e tyre nuk varet vetëm nga ne, por edhe nga jugosllavët, të cilët kanë pikëpamjet, planet dhe dëshirat e tyre. Ne duam të kemi marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me Jugosllavinë, po interesat e atdheut e të marksizëm-leninizmit do t'i vëmë mbi të gjitha.

Lidhur me problemet ekonomike vura në dukje politikën që ka ndjekur Partia dhe planet e saj për të ardhmen. Natyrisht në këtë fushë situata te ne nuk pretendojmë se është e shkëlqyer, por nuk është as «e mjerueshme» siç janë shprehur me qëllim të keq disa diskutantë në konferencë.

Ngrita problemin e kujdesit të Partisë për kuadrot, të cilët punojnë pa u kursyer për ndërtimin e socializmit. Interesimi i Partisë për t'u krijuar kuadrove mundësi dhe kushte për punë, nuk duhet interpretuar sikur te ne po krijohet një kastë apo një shtresë pasanikësh, të cilën Partia nuk e ka lejuar e nuk do ta lejojë kurrë, as sot, as mot. Kritikkat e armiqve në këtë drejtim synojnë të na nxitin të hidhemi në ekstrem e të heqim

dorë nga kujdesi për kuadrot e Partisë e të shtetit.»

Lufta e klasave, u thashë shokëve, nuk duhet konceptuar sikur po shuhet dhe armiqtë e përmbysur do të heqin dorë vullnetarisht nga lufta kundër nesh. Jeta ka provuar se armiqtë nuk i kanë hedhur armët, prandaj do të ishte e pafalshme për ne sikur të flinim mbi dafina.

U bë vonë, prandaj e ndërpreva diskutimin tim për ta vazhduar sot në mëngjes. Gjithë natën nuk më zuri gjumi. Mendoja për arsyet që i kanë shtyrë disa elementë antiparti dhe disa komunistë pas akshamit që të ngrihen kundër Partisë pikërisht në momente të tilla. Këta përsëri kishin ardhur në konferencë me shpatë në dorë. Vendosa t'i demaskoj rreptë Vehip Demin, Nesti Zoton, Iljaz Ahmetin e ndonjë tjetër, të cilët kishin bërë pyetje provokuese dhe tendencioze me qëllim që të tronditnin besimin e komunistëve ndaj udhëheqjes dhe t'i vinin minat çështjes së drejtë të Partisë dhe të socializmit në vendin tonë. U drejtova atyre pyetje dhe zbulova qëllimet që fshiheshin prapa përgjigjeve që jepnin.

Vehip Demi u vu me shpatulla për muri si një nga më aktivët kundër udhëheqjes dhe si njeriu antiparti që donte rehabilitimin e Tuk Jakovës, të Bedri Spahiut etj.; Iljaz Ahmeti me qëndrimin e tij tepër armiqësor u demaskua si element kundër vijës politike të Partisë dhe udhëheqjes së saj; Nesti Zoto u godit si një nga përkrahësit më të flaktë të ideve revizioniste dhe të elementëve antiparti; Vandush Vinçani qëndroi po në

këto ujëra, duke kërkuar rehabilitimin e Tuk Jakovës e të armiqve të tjerë.

Kritikova edhe Komitetin e Partisë të Qytetit të Tiranës, që nuk ishte treguar vigjilent, kishte rënë në gjumë të rëndë dhe nuk kishte parë qysh para konferencës se si po manovronin këta elementë në dëm të interesave të Partisë.

Në fund u bëra thirrje shokëve që të ruajmë si sytë e ballit unitetin e Partisë, të punojmë vazhdimisht për plotësimin e planit të shtetit dhe përmirësimin e jetës së popullit. Shpreha bindjen e Komitetit Qendror se organizata e Partisë e Tiranës ashtu si gjithë Partia do t'i kuptojë drejt situatat dhe do të luftojë kundër armiqve që çështja e madhe e Partisë dhe e popullit të shkojë përpara.

E SHTUNË
21 PRILL 1956

Sot u dërguam një letër¹ gjithë organizatave-bazë të Partisë për zbulimin e disa elementëve antiparti dhe mësimet që duhet të nxjerrim nga tentativa e tyre për të devijuar në frymë revizioniste e çoroditëse punimet e Konferencës së 3-të të Partisë të qytetit të Tiranës.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 242.

E DIEI
22 PRILL 1956

U mbushën 36 vjet nga dita e lindjes së mësuesit të madh të proletariatit, revolucionarit dhe mendimtarit gjenial, V. I. Leninit.

Lenini, si vazhdues besnik i mësimeve të Marksit dhe Engelsit e çoi më përpara teorinë dhe praktikën e revolucionit e të socializmit. Ai është themeluesi dhe udhëheqësi i partisë së tipit të ri, i partisë komuniste; me emrin e tij lidhet fitorja e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

Partia e Punës e Shqipërisë, në këta 15 vjet të jetës së saj ka ecur gjithmonë në rrugën që na mëson Lenini dhe në jetë të jetëve ajo do të mbetet një parti e tipit leninist. Konsekuente për të mbrojtur e për të zbatuar kurdoherë marksizëm-leninizmin, këto ditë në Byronë Politike morëm vendimin, i cili u botua sot edhe në shtyp, që të përkthehen e të botohen në gjuhën shqipe veprat e plota të Leninit. Kështu komunistët dhe mbarë populli shqiptar do t'i kenë ato vazhdimisht në duar e udhëheqje për veprim.

E ENJTE
26 PRILL 1956

Bëmë mbledhjen e organizatës-bazë të aparatit të KQ të Partisë për të punuar letrën e Komitetit Qendror drejtuar gjithë organizatave-bazë të Partisë mbi mësimet nga Konferenca e 3-të e Partisë e qytetit të Tiranës dhe rezolucionin e Komitetit të Partisë të Qytetit të Tiranës.

Në diskutimin tim¹ të solidarizimit me letrën e Komitetit Qendror, shpreha disa mendime për detyrat e punonjësve të aparatit të KQ, siç janë kuptimi i qartë i qëllimit të armikut për të goditur udhëheqjen e Partisë dhe për ta zëvendësuar atë me një udhëheqje revizioniste, sqarimi i bazës dhe i masës së Partisë poshtë për problemet ekonomike dhe politike, duke iu përgjigjur saktë dhe drejt pyetjeve që bëhen rreth punës armiqësore të një grupi elementësh të degjeneruar e të molepsur politikisht në Konferencën e 3-të të Partisë të Tiranës; forcimi i shtypit të Partisë, i cili paraqitet dobët, si dhe shfrytëzimi më i mirë i shtypit që të kuptohet thellë ajo çka shkruhet në gazetë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 248.

Përmenda në organizatë që të luftohet një fenomen negativ që vihet re në punën e Partisë, e cila duke iu kushtuar me të drejtë problemeve ekonomike, nuk merret sa duhet me anën politike të tyre dhe sidomos me sqarimin e situatës ndërkombëtare.

Çështjet ekonomike të kuptohen më thellë e jo përciptas, se në këtë drejtim, vura në dukje, kemi dobësi. Sektori i Agjitpropit këtu në aparat bën një propagandë të shkëputur nga ekonomia, sepse nuk e njeh ekonominë; po kështu mund të thuhet edhe për Drejtorinë e Organizimit, prandaj shokët që kanë studiuar për ekonomi dhe ata që kanë studiuar për filozofi dhe që punojnë këtu në aparatën e KQ të rrinë më afër njëri-tjetrit dhe t'i lidhin më mirë problemet.

E DIEL
29 PRILL 1956

Një sihariq i madh për popullin dhe një sukses i madh për Partinë e shtetin tonë: sot me anë të shtypit dhe radios njoftuam vendimin për uljen e çmimeve të disa artikujve industrialë dhe ushqimorë me një vleftë prej një miliard e 500 mijë lekësh. Ulja e çmimeve është jo vetëm dëshmi e forcimit të vazhdueshëm të ekonomisë sonë socialiste, të udhëhequr nga Partia, por edhe e kujdesit të madh që kjo tregon për jetën e popullit, për përmirësimin e mirëqenies së tij.

**E MARTË
1 MAJ 1956**

Deri Manifestimi tradicional i punonjësve të kryeqytetit ishte një shprehje e gjallë e optimizmit, dashurisë dhe vendosmërisë së tyre për të ecur në rrugën e treguar nga Partia. Klasa punëtore e Tiranës, si mbarë populli ynë, shikon te Partia udhëheqësen dhe organizatoren e gjithë fitoreve, mbrojtësen vigjilente të interesave më të shtrenjtë të saj.

**E PREMTE
11 MAJ 1956**

Plenumi i KQ të Partisë, që u mbledh dje dhe vazhdoi punimet edhe sot, aprovoi njëzëri raportet që do t'i paraqiten Kongresit të 3-të të PPSH.

RIKONSTRUKTIV
 21 MAJ 1956

E HËNË
21 MAJ 1956

Prita sot pasdite, në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, delegacionin e Partisë Komuniste të Kinës si dhe delegacionin e Partisë Komuniste të Turqisë që kanë ardhur për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 3-të të Partisë sonë. Pritja kaloi në atmosferë të ngrohtë e miqësore.

RIKONSTRUKTIV
 23 MAJ 1956

E MËRKURË
23 MAJ 1956

Sot pasdite prita në selinë e KQ delegacionet që kanë ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 3-të të PPSH: delegacionin e Partisë Punëtore të Bashkuar Polake, delegacionin e Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, delegacionin e Partisë Punëtore Rumune, delegacionin e Partisë së Punonjësve të Hungarisë, delegacionin e Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë, delegacionin e Partisë Komuniste të Spanjës dhe delegacionin e Partisë Komuniste të Sirisë dhe Libanit.

E ENJTE
24 MAJ 1956

Pritëm në aeroport delegacionin e PK të BS të kryesuar nga P. N. Pospjelov¹. Për të pritur delegacionin kishin dalë gjithashtu edhe shokë të tjerë të udhëheqjes së Partisë e të kryeqytetit. Populli i Tiranës i priti miqtë me entuziazëm duke manifestuar dashurinë dhe respektin që ka për Partinë e Leninit e të Stalinit.

Pasdite pritëm në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, delegacionin e PK të BS, delegacionin e PK Bullgare, delegacionin e Partisë Popullore Revolucionare të Mongolisë, delegacionin e Partisë së Punës të Koresë, delegacionin e PK Franceze dhe delegacionin e Partisë Komuniste të Austrisë.

1. Në atë kohë sekretar i KQ të PK të BS.

E PREMTE
25 MAJ 1956

Në mes të një entuziazmi të madh të delegatëve dhe të të ftuarve, që shpreh dashurinë e pakufishme të masës së komunistëve për Partinë dhe për Komitetin Qendror të saj, deklarova të hapur Kongresin e 3-të të Partisë¹, i ftova shokët të ngrihen në këmbë për të nderuar kujtimin e Josif Stalinit, Klement Gotvaldit, Kjuici Tokudas dhe Boleslav Bjerutit, këtyre udhëheqësve të shquar të lëvizjes komuniste ndërkombëtare që u ndanë nga ne. Në emër të Kongresit përshëndeta delegacionet e huaja, të cilave u urova mirëseardhjen në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Pas fjalës së hapjes mbajta raportin² mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë.

Kongresi vazhdon punimet.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 269.

2. Po aty, f. 271.

E SHTUNË
26 MAJ 1956

Filluan diskutimet rreth raportit mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë.

Në seancën e pasdites përshëndeti Kongresin kryetari i delegacionit të PK të BS, Pospjelovi. Midis të tjerash ai foli edhe për Kongresin e 20-të, të cilin e quajti «një kontribut të rëndësishëm në thesarin e marksizëm-leninizmit», sidomos për bashkëjetesën paqësore midis dy sistemeve, për mundësinë e ndalimit të luftërave në kohën e sotme dhe për format e ndryshme të kalimit në socializëm. Janë me të vërtetë probleme të mëdha teorike dhe praktike, por, për mënyrën si i trajtoi Kongresi i 20-të unë kam rezervat e mia.

Kongresi tregoi pjekuri të lartë politike, duartrokiti me masë.

E DIEL
27 MAJ 1956

Vazhdojnë diskutimet në Kongres. Të gjithë diskutantët aprovojnë politikën e drejtë marksiste-leniniste që ka ndjekur Partia jonë, nën udhëheqjen e Komitetit Qendror.

Delegatët flasin për përvojën pozitive të punës së organizatave të Partisë që përfaqësojnë, për forcimin e mëtejshëm të rolit të tyre udhëheqës, kritikojnë me guxim të metat dhe shprehin besimin e vendosmërinë e organizatave të Partisë dhe të masave punonjëse për realizimin me sukses të detyrave të planit të dytë pesë-vjeçar.

E HËNË
28 MAJ 1956

Në orën 13⁰⁰, në selinë e KQ të Partisë, prita bashkë me Gogon¹ të dërguarin e jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë të Republikës së Indisë, zotin Xhohn A. Thivy.

Sonte, pas mbylljes së seancës së shtatë të Kongresit, së bashku me shokët e tjerë të udhëheqjes së Partisë e të shtetit do të shikojmë premierën e një drame² të shkruar nga Kolë Jakova, vënë në skenë nga Teatri Popullor.

1. Gogo Nushi, në atë kohë sekretar i Komitetit Qendror të PPSH dhe kryetar i Kuvendit Popullor.

2. Është fjala për dramën «Detyra».

E MARTË
29 MAJ 1956

U mbyllën diskutimet rreth raportit «Mbi aktivitetin e KQ të PPSH». Projektvendimi për aprovimin e këtij raporti u prit me duartrokitje të fuqishme nga delegatët.

Pas seancës së nëntë të Kongresit, në mbrëmje, bashkë me shokë të tjerë të udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit do të shohim një operë¹ të Smetanës.

1. Është fjala për operën «Nusja e shitur», të kompozitorit çek Bedërzhih Smetana, vënë në skenë nga Filarmonia Shqiptare.

E ENJTE
31 MAJ 1956

Shfaqjet e drejtimit të ekonomisë në mënyrë të përgjithshme, burokratizmi dhe zvarritja për zgjidhjen e çështjeve, si dhe mungesa e kontrollit, që vihen re shpeshherë në organet ekonomike e të pushtetit nga qendra në bazë, pengojnë shfrytëzimin si duhet të mundësive të shumta që ekzistojnë për shtimin e prodhimit dhe uljen e kostos. Shumë nga diskutantët në Kongres argumentuan me shembuj konkretë domosdoshmërinë e luftës kundër këtyre shfaqjeve për realizimin me sukses të detyrave të mëdha ekonomike të planit të dytë pesëvjeçar.

EH

E SHTUNË
2 QERSHOR 1956

Raportin «Mbi ndryshimet në Statutin e PPSH», që iu paraqit sot Kongresit, e lexoi shoku Gogo, sepse Rita ishte i sëmurë.

Në rezolucionin e aprovuar njëzëri nga Kongresi për raportin «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë»¹ u theksua se vija e përgjithshme politike, ekonomike dhe organizative e Partisë sonë dhe masat e marra prej saj kundër të gjitha grupeve dhe elementëve antiparti e deviatorë, revizionistë, trockistë e oportunistë, kanë qenë plotësisht të drejta. Përpyekjet e elementëve antiparti në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës për të goditur unitetin e Partisë, vijën e përgjithshme dhe udhëheqjen e saj tregojnë se sa aktuale dhe të domosdoshme janë forcimi i vazhdueshëm i disiplinës e i vigjilencës së Partisë dhe lufta kundër ndjenjës së qetësisë false, të zbutjes së kritikës dhe të autokritikës bolshevike.

1. Shih: «PPSH Dokumente Kryesore», vëll. II, botimi i dytë, f. 593.

E DIEL
3 QERSHOR 1956

Kongresi i 3-të i PPSH i mbylli punimet e tij. Ai aprovoi unanimisht vijën e Partisë gjatë periudhës që u analizua dhe shërbeu si një shkollë e madhe, që na armatosi me dijeni dhe forca të reja për punë. Detyra të mëdha na presin dhe jemi të bindur se ato do të realizohen. Partia jonë është e mrekullueshme.

Në emër të Komitetit Qendror, që u zgjodh, falënderova¹ delegatët për besimin e madh që treguan duke na zgjedhur në udhëheqje të Partisë dhe u premtova se detyrat që na u ngarkuan do t'i kryejmë me nder, me ndjenjë të lartë përgjegjësie dhe me besnikëri të patundur ndaj interesave të Partisë, të popullit, të atdheut dhe të marksizëm-leninizmit.

Sot në Tiranë u organizua një miting madhështor me rastin e mbylljes së punimeve të Kongresit të 3-të të Partisë. Duke iu drejtuar qytetarëve të kryeqytetit tonë të bukur, fola² shkurtimisht për rëndësinë e Kongresit,

për unitetin e çeliktë dhe për besnikërinë e pafund që manifestoi ky Kongres ndaj popullit, për aprovimin e direktivave të planit të dytë pesëvjeçar dhe për detyrat e mëdha që kemi përpara. Falënderova në emër të punonjësve delegacionet e huaja që na nderuan me pjesëmarrjen e tyre në punimet e Kongresit tonë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 489.

2. Po aty, f. 495.

E HËNË
4 QERSHOR 1956

Pashë sot gazetën «Pravda» të datës 2 qershor. Në faqe të parë, ku Titos i urohet mbërritja në Moskë, ajo boton një fotografi të tij të madhe. Në faqen e katërt, në rubrikën «Kronikat», diku në qoshe të faqes, njoftohet heqja e Molotovit nga posti i ministrit të Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik «sipas kërkesës së tij»! Kështu thuhet në gazetë!

Çudi! Ec e thuaj po deshe se nuk është fjala për një kurban që Hrushovi i bën ujkut Tito në prag të vizitës së tij në Moskë!

E PREMTE
8 QERSHOR 1956

Për nder të admiralit Kasatanov¹ dhe personave që e shoqërojnë, të cilët para disa ditësh mbërritën për një vizitë shoqërore në Portin e Durrësit, dhamë një pritje në Pallatin e Brigadave. Nesër në mbrëmje jemi ftuar dhe do të marrim pjesë në pritjen që admirali sovjetik do të japë në selinë e ambasadës së Bashkimit Sovjetik në Tiranë.

1. Në atë kohë komandant i flotës ushtarake detare sovjetike në Detin e Zi.

KORÇË, E HËNË
11 QERSHOR 1956

Vizitova muzeun e qytetit të Korçës. Ngritja e këtij muzeu është një iniciativë për t'u lavdëruar, që duhet pasuruar në të gjitha drejtimet. Në këtë muze duhet të gjejë pasqyrim më të plotë Korça me traditat e saj të shquara patriotike e revolucionare, me traditat kulturore, artistike e muzikore. Për këtë drejtuesit e muzeut duhet të kenë mbështetjen e Partisë dhe për-krahjen e gjithanshme të popullit.

Në bisedën me personelin dhe në shënimin që lashë në librin e përshtypjeve të muzeut hodha idenë e krijimit të një muzeu të veçantë për traditat e pasura të Korçës në bujqësi, që do të shërbente si shkollë për të gjithë. Duhet të mësojmë nga Korça, që është rreth i përparuar bujqësor.

KORÇË, E ENJTE
14 QERSHOR 1956

Mora pjesë si i deleguar i Komitetit Qendror në aktivin e Partisë të rrethit të Korçës, që i zhvilloi punimet dhe sot. Në aktiv fola për vendimet historike të Kongresit të 3-të të PPSH, për trajtimin prej tij në mënyrë shkencore të çështjeve më të rëndësishme të ndërtimit socialist dhe për perspektivat e gjera që i hapi Kongresi popullit tonë për të ardhmen. I porosita pjesëmarrësit e aktivit të studiojnë me kujdes materialin e Kongresit të 3-të të Partisë, të udhëhiqen prej tyre dhe të qëndrojnë në krye të masave për zbatimin në jetë të detyrave që dalin nga këto materiale.

KORÇË. E PREMTE
15 QERSHOR 1956

Mbrëmë pamë koncertin e grupeve artistike të qytetit të Korçës. I përgëzova artistët amatorë pas shfaqjes dhe u urova suksese të mëtejshme.

Gjatë këtyre ditëve në Korçë kam bërë edhe një varg vizitash në qendra prodhimi e kooperativa bujqësore, në familje dëshmorësh e punëtorësh të dalluar etj.

Bëra vizitë në Fabrikën e Qelqit, ku i përgëzova punëtorët dhe drejtuesit për sukseset si dhe i porosita për kujdesin akoma më të madh që duhet të bëjnë për shtimin e prodhimit.

U takova me filologun e njohur, profesor Spiro Kondën, me të cilin bisedova rreth disa problemeve të rëndësishme, siç janë origjina e gjuhës shqipe dhe problemi pellazgjik, që po studion. Bëra vizitë, gjithashtu, në familjen e punëtorit të dalluar të ofiçinës së Parkut Automobilistik, Hekuran File, u takova me pjesëtarët e familjes së tij dhe pashë nga afër dashu-

rinë dhe besimin e madh që njerëzit e popullit kanë të Partia.

Shkova edhe në kooperativat e reja bujqësore: të Drenovës në rrethin e Korçës, të Qinamit në rrethin e Kolonjës si dhe në Ersekë, ku u takova e bisedova me popullin e me drejtues të Partisë e të pushtetit në rreth.

E HËNË
18 QERSHOR 1956

Prita pasdite, në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, delegacionin parlamentar të Republikës Demokratike Gjermane, të kryesuar nga Ernst Goldenbaum¹, që ka ardhur në vendin tonë me ftesë të Kuvendit Popullor. Në pritje ndodheshin edhe shokë të tjerë të udhëheqjes së Partisë.

1. Në atë kohë zëvendëskryetar i Dhomës Popullore.

MOSKË, E PREMTE
22 QERSHOR 1956

Sot filloi konsulta e vendeve të KNER-it.

U mbushën 15 vjet nga dita kur ushtria hitleriane sulmoi Bashkimin Sovjetik. Ky sulm shënoi fillimin e Luftës së Dytë Botërore, një nga luftërat më të përgjakshme të historisë së njerëzimit. Kjo luftë u kushtoi popujve vuajtje e sakrifica të mëdha, por këta nuk u mposhtën. Lufta e madhe patriotike e popujve sovjetikë, të udhëhequr nga Stalini dhe lufta e popujve që u ngritën pa as më të voglën rezervë kundër fashizmit, janë të pashembullta për nga madhështia dhe heroizmi.

Populli shqiptar me komunistët në ballë u ngrit edhe ai në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare, lau me gjak çdo pëllëmbë të tokës së tij dhe e shndërroi këtë në një zjarr vdekjeprurës për fashistët. Ishin lufta e tij e papërkulur e heroike dhe udhëheqja e Partisë Komuniste që çuan në fitoren e lirisë më 29 Nëntor 1944. Gjakun e 28 000 bijve të rënë në luftën e madhe për lirinë e atdheut nuk do ta harrojmë kurrë.

MOSKË, E SHTUNË
23 QERSHOR 1956

Në konsultën e vendeve të KNER-it Ohabi¹ informoi për mosrealizimet e planeve nga minierat e qymyreve në Poloni, për nivelin e ulët të jetesës së punëtorëve të këtyre minierave dhe për grevat që ata kanë shpërthyer!

U krijua një situatë e nderë, por ajo që më bëri më shumë përshtypje e më tronditi ishte mendimi i habitshëm i Hrushovit² kur në një rast tha se për disa prodhime të veçanta të industrisë (ishte fjala për prodhimin e armëve) duhet të vepohet ashtu sikurse bëri Hitleri!

E habitshme! Si mund të merret e, për më shumë, t'u sugjerohet edhe të tjerëve eksperiencia e Hitlerit?!

1. Eduard Ohabi, në atë kohë Sekretar i Parë i Partisë Punëtore të Bashkuar Polake.

2. Shih: Enver Hoxha, «Hrushovianët» — Kujtime, botim i dytë, Tiranë, 1982, f. 88.

E MARTË
26 QERSHOR 1956

Sot botuam në shtyp thirrjen e Komitetit Qendror të Partisë drejtuar qytetarëve të republikës, anëtarëve të Partisë, prindërve dhe familjeve të dëshmorëve, për të dorëzuar¹ dokumentet, materialet si dhe për të shkruar kujtimet që kanë për historinë e lëvizjes demokratike, revolucionare e punëtore në vendin tonë, për historinë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të Partisë së Punës. Mbledhja, studimi dhe përpunimi i këtyre materialeve ka rëndësi të madhe për hartimin e historisë së lëvizjes komuniste në vendin tonë dhe për historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë.

1. Dorëzimi i këtyre materialeve do të bëhet në komitetet e Partisë të rretheve ose të qyteteve ose drejtpërdrejt në Institutin e Historisë së Partisë (sot Instituti i Studimeve Marksisiste-Leniniste) pranë KQ të PPSH.

E PREMTE
29 QERSHOR 1956

Arriti në vendin tonë, me ftesë të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë delegacioni i RDP të Koresë, i kryesuar nga shoku Kim Ir Sen. Në Aeroportin e Tiranës miqtë i pritëm me ceremoni zyrtare. Isha edhe unë. Pas shkëmbimit të përshëndetjeve, u nisëm për në Pallatin e Brigadave. Rrugës nga një makinë e hapur, bashkë me shokun Kim Ir Sen përshëndetëm popullin e Tiranës që i priti miqtë me dashuri.

Pasdite, në selinë e Këshillit të Ministrave të RPSH, filluam bisedimet me shokun Kim Ir Sen dhe anëtarët e tjerë të delegacionit. Shkëmbyem mendime për marrëdhëniet midis dy vendeve tona dhe për gjendjen e sotme ndërkombëtare.

VLORË, E SHTUNË
30 QERSHOR 1956

Bashkë me miqtë koreanë erdhëm në Vlorë. Në mitingun që organizoi populli i Vlorës fola¹ për vizitën e delegacionit qeveritar të RDP të Koresë në vendin tonë. Foli edhe shoku Kim Ir Sen.

Këto ditë në Poznan, një nga qendrat industriale më të mëdha të Polonisë kanë ndodhur disa përleshje të rënda me forcat e rendit të këtij vendi.

Nga sa kam dëgjuar në radio është fjala për veprime të ndërmarra nga provokatorë e diversantë të paguar nga qarqe imperialiste. Këto forca reaksionare kanë sulmuar disa godina publike dhe kanë përdorur armë zjarri.

Me sa duket ky është një provokacion i hapët kundër popullit polak dhe kundër pushtetit popullor në Poloni.

Çudi!... Qeveria sovjetike hesht, as na njofton, as bën sqarime për këto situata në kampin socialist.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 1.

E DIEL
1 KORRIK 1956

Mora pjesë në pritjen që ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i RDP të Koresë dha në darkë, në hotel «Dajti», me rastin e qëndrimit në vendin tonë të delegacionit qeveritar të RDP të Koresë, të kryesuar nga shoku Kim Ir Sen.

E HËNË
2 KORRIK 1956

E HËNË
2 KORRIK 1956

Sot u largua nga vendi ynë delegacioni qeveritar i RDP të Koresë, i kryesuar nga shoku Kim Ir Sen. Për të përcjellë miqtë shkova edhe unë në Aeroportin e Tiranës së bashku me shokë të tjerë të udhëheqjes së Partisë e të shtetit. Para se të ndaheshim me miqtë koreanë, këmbuem përshëndetje.

Shokët sovjetikë hodhën një hap tjetër në drejtim të Stalinit. Në gazetën «Pravda» u botua vendimi i KQ të PK të BS «mbi kapërcimin e kultit të individit dhe të pasojave të tij». Në vendim, natyrisht, bëhen përpjekje për të «argumentuar» akuzat ndaj Stalinit dhe gabimeve të tij, duke përfshirë edhe ato «në fushën e ndërtimit të socializmit në BS». Por mua asgjë nuk më bindi nga ato që shkruheshin. Sukseset e arritura në ndërtimin e socializmit në BS, ashtu si në të gjitha fushat e tjera, nën udhëheqjen e Stalinit nuk mund të mohohen.

SHKRUAR
NËN DREKTORIN E

**E MARTË
3 KORRIK 1956**

Shtypi i huaj borgjez shkruan e komenton sipas oreksit vendimin e KQ të PK të BS mbi kultin e individit. Edhe pa këtë vendim zyrtar të udhëheqjes sovjetike, ç'nuk kanë vjellë e shkruar borgjezia e reaksioni për Stalinin, kundër emrit dhe veprës së tij të madhe. Kurse tani gjetën edhe «certifikatën e vërtetësisë»!

SHKRUAR
NËN DREKTORIN E

**E MËRKURË
4 KORRIK 1956**

Shoku Kim Ir Sen na dërgoi një telegram falënderimi për pritjen e ngrohtë që i bëmë gjatë vizitës së tij në Shqipëri. Pas këtij, në emër të qeverisë së RDP të Koresë më fton të bëj një vizitë në Kore.

E MARTE
17 KORRIK 1956

Këto ditë u njoftua thirrja e Sovjetit Suprem të Bashkimit Sovjetik drejtuar qeverive e parlamenteve të vendeve të botës mbi çështjen e çarmatimit. Në të flitet edhe për masat konkrete që ka marrë qeveria sovjetike në këtë drejtim, siç është pakësimi i forcave të tij të armatosura. Ku do ta shpien Bashkimi Sovjetik dhe sigurimin e tij këto «iniciativa» të udhëheqjes sovjetike?!

E MËRKURË
18 KORRIK 1956

Mbledhje e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik për zgjedhjet e reja të këshillave të frontit në fshatra, lagje dhe blloqe. U vendos që këto zgjedhje të bëhen nga 5 shtatori deri më 5 tetor të këtij viti.

Sot fillon në Havre Kongresi i 14-të i Partisë Komuniste Franceze. Një raport mbi pikën e parë të rendit të ditës do ta mbajë Torezi¹. Ne dërguam Ramizin të marrë pjesë e të përshëndetë komunistët, klasën punëtore dhe popullin francez në emër të komunistëve e të popullit shqiptar.

1. Moris Torez, në atë kohë Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Franceze.

E PREMTE
30 KORRIK 1956

Mora pjesë dhe fola në Plenumin e 3-të të Këshillit të Përgjithshëm të BGSH për detyrat që i dalin organizatës së gruas nga vendimet historike të Kongresit të 3-të të PPSH për realizimin dhe tëjkalimin e planit të vitit 1956.

U fola, gjithashtu, grave për rolin e organizatës së tyre në përparimin e vendit dhe në përmirësimin e jetesës së popullit. U tregova se sa rëndësi ka për ekonominë tonë dalja e sa më shumë grave në punë, si dhe arsimimi i vazhdueshëm i tyre. U fola për rolin e madh të nënës në edukimin e fëmijëve, për rëndësinë e higjienës, të jetës së kulturuar në familje etj.

E SHTUNË
21 KORRIK 1956

Problemi i grumbullimit të tepricave të drithërave të bukës nga fshatarësia gjen zgjidhje vetëm në qoftë se organizohet si duhet tregtimi i mallrave për fshatin dhe bindet fshatari për leverdinë e shitjes së tepricave shtetit. Një gjë e tillë, që lidhet me sigurimin e bukës, nuk po gjen zgjidhje, prandaj me anë të një letre¹ u tërhoqa vëmendjen për këtë çështje gjithë komiteteve të Partisë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 9.

E DIEL
22 KORRIK 1956

Mora pjesë në pritjen që dha mbrëmë ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i RP të Polonisë në RP të Shqipërisë me rastin e 22 korrikut, festës kombëtare të RP të Polonisë. Pritja ishte miqësore. Ambasadori dhe unë mbajtëm nga një fjalim.

E HËNË
23 KORRIK 1956

Mora pjesë në Konferencën Kombëtare të Novatorëve dhe Racionalizatorëve, që filloi punimet sot në orën 8⁰⁰ në sallën e kinemasë «Punëtori» në Tiranë. Kjo konferencë, e treta e këtij lloji që organizohet në vendin tonë, është shprehje e kujdesit të vazhdueshëm të Partisë për nxitjen e iniciativës krijuese të masave. Kushtet e krijuara në vendin tonë kanë bërë të mundur që nga gjiri i klasës punëtore dhe i masave punonjëse të dalin talente të mrekullueshme, që Partia i ka përkrahur dhe do t'i përkrahë kurdoherë me forcë.

GJIROKASTËR, E PREMTE
27 KORRIK 1956

Megjithëse ca i gjatë, udhëtimi i sotëm nga Tirana për në Gjirokastrë, nuk më lodhi. Sa herë vij në këtë qytet ndiej emocione dhe kam dëshirë të rri gjithë ditën mes njerëzve, që të çmallem me ta, me shtëpitë e me rrugët.

Pasdite, së bashku me shokët drejtues të qarkut e të rrethit, bëra vizita në disa familje dëshmorësh të Luftës Nacionalçlirimtare.

Shkova në shtëpinë e xha Iljazit, mësuesit tim të fëmijërisë. Mbahej mirë plaku dhe u gëzua shumë kur më pa. Kujtuam të kaluarën, baba Çenin dhe folëm për përpjekjet e arsimtarëve patriotë për hapjen dhe mëkëmbjen e shkollave të para shqipe në Gjirokastrë.

GJIROKASTËR, E SHTUNË
28 KORRIK 1956

Vizitë në Fabrikën e Cigareve. Punëtorët e kësaj fabrike, sidomos ato të reparitit të ambalazhit, me të cilat u takova e bisedova, punojnë mirë dhe shumë prej tyre e tejkalojnë normën në një përqindje të lartë. U interesova për kushtet e punës dhe i porosita punëtorët të rritin më tej aftësitë profesionale për të nxjerrë prodhime të një cilësie më të mirë e për të realizuar me sukses detyrat e planit.

Gjirokastra është ndër të parat në vendin tonë që krijoi kooperativën bujqësore në qytet. U bë më shumë se një vit që bujqit e lagjeve të qytetit, me të cilët u takova e bisedova përzemërsisht e shtruar nën hijen e një arre, me iniciativën e tyre ngritën kooperativën. Sot kjo ekonomi, me 146 familje, ka një sipërfaqe të gjerë toke dhe qysh sivjet kontraktoi për t'i shitur shtetit 2 000 kuintalë drithë teprica.

Gjatë vizitave në kooperativën e punim-drurit, fabrikën e lëkurëve, kooperativën e kombinuar të meta-

leve, shtypshkronjë dhe trikotazh bisedova me punëtorë e drejtues për problemet e lëndës së parë, të kostos e të cilësisë. Në mënyrë të veçantë u interesova për punën në shtypshkronjë, ku botohen gazeta «Llaiko vima», tekste shkollore dhe libra politikë e artistikë në gjuhën greke për minoritetin.

Pasdite do të shkoj në kooperativën bujqësore të Mashkullorës.

GJIROKASTËR, E DIJEL
20 KORRIK 1956

Në mitingun e organizuar sot në mëngjes me rastin e vajtjes sime në kooperativën bujqësore të Goranxisë në sheshin e shkollës në qendër të fshatit, përshëndeta të pranishmit dhe nëpërmjet tyre gjithë minoritetin grek të krahinës së Dropullit në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë. Dropullitët janë të zgjuar, punëtorë, e duan Partinë si i gjithë populli shqiptar dhe ecin me besim e me vendosmëri në rrugën e treguar prej saj. Provë për këtë është edhe ngritja e kooperativave bujqësore pothuajse në të gjitha fshatrat e luginës së Dropullit.

Nga Goranxia shkuam në vendlindjen e Avni Rustemit, në Libohovë, ku kishin dalë për të na pritur edhe kooperativistë nga Suha e Nepravishta. Pas mitingut të organizuar në sheshin kryesor, ku fola për perspektivat që i hap ekonomisë sonë e veçanërisht bujqësisë plani i dytë pesëvjeçar, u takova e bisedova për probleme të ndryshme me shumë njerëz. Në orën 13⁰⁰ u nisëm nga Libohova për në Gjirokastrë.

Nesër në mëngjes do të shkoj në Delvinë. Po mbushen tri ditë që ndodhem në Gjirokastrë dhe s'më bëhet të largohem prej saj.

SARANDË, E HËNË
30 KORRIK 1956

Pritje e ngrohtë e punonjësve të Delvinës. Miting dhe vizitë në kooperativën e punim drurit të qytetit.

Gjatë vizitës në sektorin e agrumeve të kooperativës bujqësore të Vllahatit u interesova për bimët që mbjell e për kafshët që rrit kooperativa dhe i porosita kooperativistët që takova të shtojnë më tepër agrumet, sidomos limonat dhe të fuqizojnë bazën ushqimore për bagëtinë.

Me kooperativistët e Vrionit bisedova më tepër se dy orë. I pyeta për ndryshimet që janë bërë në fshat pas Çlirimit e veçanërisht, pas ngritjes së kooperativës bujqësore. Përparime të dukshme kishin bërë në fushën e arsimit e të kulturës, por edhe ekonomikisht qenë mirë. Sivjet kooperativa e Vrionit ka vendosur t'i shesë shtetit 1 200 kuintalë drithëra buke teprica.

Bisedë me shoferët e Parkut Automobilistik të Sarandës.

EH

E PREMTE
3 GUSHT 1956

Në orën 10⁰⁰ prita ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë të Republikës Popullore Çekosllovake në RP të Shqipërisë.

Një orë më vonë prita ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë të Republikës Popullore të Polonisë në vendin tonë.

SARANDE, E HËNË
30 KORRIK 1956

Pritje e ngrohtë e punonjësve të Delvinës. Miting dhe vizitë në kooperativën e punim drurit të qytetit.

Gjatë vizitës në sektorin e agrumeve të kooperativës bujqësore të Vllahatit u interesova për bimët që mbjell e për kafshët që rrit kooperativa dhe i porosita kooperativistët që takova të shtojnë më tepër agrumet, sidomos limonat dhe të fuqizojnë bazën ushqimore për bagëtinë.

Me kooperativistët e Vrionit bisedova më tepër se dy orë. I pyeta për ndryshimet që janë bërë në fshat pas Çlirimit e veçanërisht, pas ngritjes së kooperativës bujqësore. Përparime të dukshme kishin bërë në fushën e arsimit e të kulturës, por edhe ekonomikisht qenë mirë. Sivjet kooperativa e Vrionit ka vendosur t'i shesë shtetit 1 200 kuintalë drithëra buke teprica.

Bisedë me shoferët e Parkut Automobilistik të Sarandës.

EH

E PREMTE
3 GUSHT 1956

Në orën 10⁰⁰ prita ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë të Republikës Popullore Çekoslovakë në RP të Shqipërisë.

Një orë më vonë prita ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë të Republikës Popullore të Polonisë në vendin tonë.

E SHTUNË
4 GUSHT 1956

Sot bisedova me të dërguarin e jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiptotë të RPF të Jugosllavisë¹, i cili me porosi të KQ të LKJ shprehu mosaprovimin e udhëheqësve jugosllavë për vlerësimin që u bën Partia jonë marrëdhënieve midis dy vendeve për vitet 1944-1948.

I theksova të dërguarit jugosllav këto probleme:

Partia jonë dëshiron marrëdhënie të mira e miqësore me Jugosllavinë. Kjo u tha edhe në Kongresin e 3-të të Partisë.

PPSH nuk ka pasur frikë t'i pranojë ndershmërisht e në mënyrë marksiste-leniniste gabimet e saj por s'është aspak marksiste-leniniste që ajo të heshtë për gabimet e jugosllavëve.

Është fakt që ne, komunistët shqiptarë, e kemi dashur sinqerisht popullin jugosllav dhe partinë e tij, por kjo nuk do të thotë që ne të mbulojmë gabimet e tyre.

Dhe i përmenda:

Ndërhyrjen e palejueshme të Velimir Stoiniçit në punët e Partisë sonë.

Ndërhyrjet e Savo Zilatiçit, krimet e Koçi Xoxes kundër Partisë dhe shtetit shqiptar menjëherë pas Plenumit të Beratit, ku përfaqësuesi jugosllav ndërhyri brutalisht në punët e Partisë sonë.

I fola për marrëdhëniet ekonomike, për zhurmën që bëjnë ata për 20 000 tonë drithë; i përmenda propozimin e tyre për parifikimin e monedhës, për heqjen e kufirit doganor dhe për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, si dhe për propagandën që bëjnë shtypi dhe radioja e Beogradit kundër Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 19.

E MËRKURË**15 GUSHT 1956**

Mora pjesë në pritjen që dha në hotel «Dajti» ambasadori korean me rastin e 11-vjetorit të çlirimit të Koresë. Gjatë pritjes mbajta një fjalim, po kështu edhe ambasadori korean.

E ENJTE**23 GUSHT 1956**

Mbledhja e Byrosë Politike, veç të tjerave, shqyrtoi sot punën e Partisë me fshatin në qarkun e Elbasanit në bazë të raporteve të byrosë së Komitetit të Partisë të këtij qarku dhe të ekipit të Komitetit Qendror të PPSH. Krahas sukseseve dhe punës së mirë që ka bërë Komiteti i Partisë në këtë qark, ka dhe dobësi që duhen eliminuar. Propaganda e Partisë atje nuk është e kënaqshme, shtypi nuk shfrytëzohet mirë, agjitacioni i vogël individual nuk praktikohet në masën e duhur, problemet ekonomike nuk kuptohen thellë, nuk aktivizohen mirë në këto drejtime mësuesit e fshatit.

Lidhur me këto dobësi që vërehen rekomandova¹ që udhëheqja e Partisë në qark duhet të organizojë dhe të kontrollojë më mirë punën për zbatimin e direktivave dhe udhëzimeve që jep Komiteti Qendror. Të bëhen më tepër përpjekje për të punuar më shumë që të përmirësohet jeta e fshatarëve e sidomos e atyre të zonavave malore siç është ajo e Çermenikës.

Shpreha bindjen se tani e tutje puna në këtë qark do të ecë më përpara, se komunistët dhe punonjësit do

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 32.

të luftojnë më tepër për të dalë nga prapambetja dhe për të realizuar me sukses detyrat.

Bashkë me shokë të udhëheqjes së Partisë e të shtetit morëm pjesë në pritjen që dha në hotel «Dajti» ambasadori rumun me rastin e 12-vjetorit të çlirimit të Rumanisë.

E HËNË
27 GUSHT 1956

Pas ftesave zyrtare nga Kina dhe Koreja, edhe qeveria e Republikës Popullore të Mongolisë na fton për një vizitë në Mongoli. Do të shkoj me plot dëshirë.

E MARTË
28 GUSHT 1956

Nesër, në krye të delegacionit të PPSH, do të nisemi për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës. Do të bëjmë, gjithashtu, vizitë në Republikën Demokratike Popullore të Koresë dhe në Republikën Popullore të Mongolisë, ku jemi të ftuar.

EH

ULAN-BATOR, E HËNË
3 SHTATOR 1956

Sot mbërritëm në Ulan-Bator. Për të na pritur në aeroport kishin dalë Cedenbali¹ dhe të tjerë. Pritja ishte e ngrohtë, populli brohoriste dhe na përshëndeste; kishte flamuj të RP të Shqipërisë dhe të RP të Mongolisë, parulla kushtuar miqësisë së popullit tonë dhe atij mongol, kishte bile edhe parulla të shkruara në shqip! Për të na përshëndetur Cedenbali mbajti një fjalim të shkurtër.

Shokë të udhëheqjes së partisë dhe të qeverisë mongole dhanë një pritje në kryesinë e Këshillit të Ministrave për nder të delegacionit tonë.

Gjatë rrugës për në Mongoli ndalëm pak në Budapest. Nga biseda që pata në aerodromin e Budapestit me udhëheqës hungarezë, situata në Hungari nuk m'u duk e sigurt.

Shqetësimin tim ia shpreha edhe Suslovit gjatë ndalesës në Moskë, por ky nuk ra dakord me mendimin

1. Në atë kohë kryetar i Këshillit të Ministrave të RP të Mongolisë.

tim. Ashtu qoftë, popujt të mos kenë trazira, se mendimet korrigjohen.

Sot hapet në Korçë Kongresi i 3-të i Kooperativave Bujqësore. I uroj suksese nga larg kongresit dhe gjithë fshatarësisë sonë patriote e punëtore të palodhur.

ULAN-BATOR, E MARTË
4 SHTATOR 1956

Bëra vizitë në Universitetin e Ulan-Batorit. U folat studentëve mongolë për luftën dhe punën e popullit shqiptar në ndërtimin e socializmit.

PHENIAN, E PREMTE
7 SHTATOR 1956

Nga 3 deri më 7 shtator vizituam Mongolinë. Pamë kooperativa bujqësore dhe ferma kryesisht të karakterit blegtoral. Kudo na pritën mirë, me fjalë e përshëndetje të ngrohta dhe na servirën me bujar produktet e tyre tradicionale blegtorale, pa harruar sidomos qumështin e pelës! Vend i madh, me hapësira pa fund, me një popull të thjeshtë e pa pretendime, kryesisht blegtorë. Krijova përshtypjen se, pavarësisht nga zhvillimi e shtrirja e madhe e blegtorisë, ekonomia në Mongoli është tepër e njëanshme. U ndamë me shokët mongolë dhe u nisëm për në Kore. Në aeroportin e Phenianit na pritën shoku Kim Ir Sen dhe të tjerë. Populli dhe shokët e udhëheqjes së Partisë e të shtetit na rezervuan një pritje mjaft të ngrohtë, entuziaste. Kim Ir Seni mbajti një fjalim të shkurtër përshëndetjeje.

PHENIAN, E SHTUNË
8 SHTATOR 1956

Bëmë vizita në kryeqytetin korean:
 Vizituam muzeun e luftës, ekspozitën bujqësore, kombinatin e tekstilit etj., etj., ku u takuam me punëtorët që na pritën me dashuri. U fola atyre për përpjekjet dhe vetëmohimin e popullit shqiptar në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Pasdite u organizua një miting i madh i punonjësve të Phenianit. Kim Ir Seni mbajti një fjalim të shkurtër në të cilin përshëndeti vizitën tonë në Kore, foli për sukseset e popullit shqiptar si dhe të popullit korean.

Në mbrëmje kabineti i ministrave i RDP të Koresë shtroi një darkë për nder të delegacionit tonë.

E DIEL
9 SHTATOR 1956

Filluam vizita në pjesët veriore të Republikës Demokratike Popullore të Koresë. Kudo që shkuam në qytete e qendra pune populli na priti me gëzim, me brohoritje, me lule, gonge e me ngrohtësi.

PHENIAN, E MËRKURË
12 SHTATOR 1956

Pas vizitave në pjesën veriore dhe perëndimore të Koresë, ku populli na priti me dashuri u kthyem në Phenian. Sot patëm bisedime me shokët koreanë në kabinetin e Këshillit të Ministrave. Ajo që më bëri më shumë përshtypje ishte tregimi i Kim Ir Senit për dy anëtarë të Byrosë së tyre Politike, që në plenumin e KQ të Partisë, të mbajtur pas Kongresit të 20-të, kishin atakuar vijën e udhëheqjes dhe unitetin e saj. Kur e pyeta Kim Ir Senin se ç'qëndrim mbajtën ndaj tyre ai m'u përgjigj se plenumi i kritikoi dhe se pas kësaj ata qenkeshin arratisur në Kinë, ku ndodhen edhe sot e kësaj dite me gjithë kërkesën që koreanët i dërguan udhëheqjes kineze për t'i kthyer të arratisurit në atdhe!..

Në darkë, për nder të delegacionit tonë u shfaq nga Opera e Phenianit, pjesa koreane «Tregim për vajzën Sim Con». Pas shfaqjes morëm pjesë në pritjen që u organizua në ambasadën tonë në Phenian. Gjatë pritjes unë dhe shoku Kim Ir Sen shkëmbyem fjalime të shkurttra.

PEKIN, E ENJTE
13 SHTATOR 1956

Pas qëndrimit prej disa ditësh në Kore sot mbërritëm në Pekin për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës.

Na pritën mirë, me popull, me muzikë, me lule. Njerëzit mbanin në duar shumë portrete të Mao Ce Dunit. Në aeroport kishin dalë Liu Shao Çi, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini e të tjerë.

PEKIN, E SHTUNË
15 SHTATOR 1956

Sot u hap në Pekin Kongresi i 8-të i Partisë Komuniste të Kinës. Shoku Mao Ce Dun mbajti fjalën e hapjes, ku midis të tjerave përshëndeti delegatët e partive komuniste e punëtores, delegatët e partive demokratike të Kinës dhe njerëzit e paorganizuar në parti. Pastaj filloi raporti i KQ të Partisë Komuniste të Kinës, mbajtur nga Liu Shao Çi.

PEKIN, E HËNË
17 SHTATOR 1956

Vazhdon punimet Kongresi i 8-të i PKK. Sot pasdite në seancë plenare filluan diskutimet rreth raporteve që u mbajtën nga Liu Shao Çi, Çu En Lai dhe Ten Hsiao Pin.

Platforma e këtij kongresi mbështetet në tezat e Kongresit të 20-të të PK të BS.

Mikojani, kryetar i delegacionit të PK të BS mbajti një fjalim në Kongresin e 8-të të PKK. Pastaj lexoi përsëndetjen e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe, natyrisht, u duartrokoi gjatë...

EH

PEKIN, E MARTË
18 SHTATOR 1956

Përpara Kongresit të 8-të të PKK mbajta përsëndetjen që Partia e Punës dhe populli shqiptar u dërgojnë komunistëve dhe popullit kinez. U urova kongresit, Partisë Komuniste dhe popullit kinez suksese në rrugën e ndërtimit të socializmit. Shpreha ndjenjat e sigërtës të miqësisë dhe të internacionalizmit proletar që populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës ushqejnë ndaj popullit të madh kinez. Theksova dëshirën e mirë të Qeverisë Shqiptare për pranimin e Kinës në OKB.

PEKIN, E MËRKURË

26 SHTATOR 1956

Këto ditët e fundit vizituam disa qytete të Kinës, si Tiencinin, Nankinin, Shangain. Pamë në këto qytete disa fabrika: një fabrikë letre, kauçuku, mëndafshi etj. Punëtorët kudo na pritën me dashuri e duartrokitje. Në Kinë ka fabrika që vetë kinezët i quajnë shtetërore-private. Në Shangai, për nder tonë, natën e parë u dha një koncert, natën e dytë u shtrua një darkë.

Sot pasdite shoku Mao Ce Dun priti delegacionin tonë. Takimi vazhdoi rreth një orë. Është hera e parë që e takoj dhe bisedoj me të. Ne kishim dëgjuar për Maon që udhëhoqi luftën dhe revolucionin në Kinë dhe ishim gëzuar sa s'ka për fitoren e revolucionit kinez më 1949, e kishim përshëndetur atë nxehtësisht.

Shoku Mao Ce Dun na priti shumë ngrohtë, megjithëse nga mënyra si qëndronte e si fliste m'u duk ca i ngurtë. Por, siç mësuam, kishte qenë i sëmurë. Ai kërkoi mendimin tonë për Titon dhe unë i fola për qëndrimin e vendosur të Partisë së Punës ndaj vijës antimarksisiste të udhëheqjes jugosllave. Në këtë pikë ai tha se

gabimet i ka Informbyroja. Kërkoi të dinte edhe mendimin tonë për Stalinin. I thashë se PPSH e vlerëson figurën e Stalinit si udhëheqës dhe nxënës i Leninit dhe Maoja më pyeti a e botuam ne raportin e fshehtë që Hrushovi mbajti në Kongresin e 20-të. I thashë se ne nuk e botuam dhe as e botojmë. Maoja shtoi se edhe ata nuk e kishin botuar. Pastaj ai foli në teori për gabimet në parti dhe tha, në thelb, se për partinë është e nevojshme të gabojë, se kështu kjo edukohet!

Nga lajmet mësoj se N. Hrushovi që prej 19 shtatorit ndodhet në Jugosllavi për një «pushim të shkurtër».

PEKIN, E DIEL
30 SHTATOR 1956

Dje dhe pardje vizituam qytetet Port-Artur, Dalnij dhe Anshan. Në kantieret dhe qendrat e punës ku shkuam pamë si punon pa u lodhur populli kinez. Ne si komunistë e kuptojmë sa e çmuar është lumturia e çdo populli dhe me gjithë zemër ua urojmë atë gjithë popujve paqedashës, bashkë me ta edhe popullit të shumëvuajtur kinez.

Hrushovi e mbaroi «pushimin e shkurtër» në Jugosllavi dhe u kthye në atdhe¹, por jo vetëm. Bashkë me të janë Titoja me të shoqen e të tjerë.

1. Më 27 shtator 1956.

PEKIN, E MARTË
2 TETOR 1956

Pas 20 ditësh që qëndruam në Republikën Popullore të Kinës, nesër do të nisemi për në atdhe.

E DIEL
7 TETOR 1956

Pas udhëtimit të gjatë e të lodhshëm, por plot përshlyetje e mbresa të pashlyeshme, sot mbërritëm në atdhe. Populli ynë i dashur na priti me brohoritje e entuziazëm të paparë. Fola përpara popullit të Tiranës për zhvillimin e punimeve të Kongresit të 8-të të PKK.

Në darkë shkova në pritjen që dha ambasadori gjerman në hotel «Dajti» me rastin e 7-vjetorit të shpalljes së Republikës Demokratike Gjermane.

E ENJTE
11 TETOR 1956

Prita ambasadorin rumun George Velçeskun.

Sot u krijua Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë¹. Kryetar u zgjodh Dhimitër Shuteriqi.

Detyra të mëdha i presin shkrimtarët dhe artistët tanë dhe Partia ka besim në punën e tyre. Partia u ka qëndruar kurdoherë pranë, i ka përkrahur e i ka nxitur për rritjen e krijimtarisë letraro-artistike në lloje, përmbajtje e në cilësi; është kujdesur dhe vazhdimisht do të kujdeset për sigurimin e kushteve më të mira për shkrimtarët e artistët, me qëllim që të krijojnë vepra të dashura e të denja për popullin.

1. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë u krijua mbi bazën e organizatave që ishin të veçanta: Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë, e themeluar më 1945 dhe Lidhja e Artistëve të Shqipërisë, e themeluar më 1949.

E SHTUNË
13 TETOR 1956

Byroja Politike analizoi në mbledhjen e sotme raportin e Komitetit të Partisë të Qytetit të Tiranës mbi punën ideologjike dhe masat për përmirësimin e saj. Raporti nuk qe në nivelin e duhur, fliste nga pak për të tëra, në vend që të trajtonte si punohet për edukimin e njerëzve, çfarë problemesh nuk janë të qarta, çfarë pikëpamjesh ka, çfarë diskutohet dhe ç'duhet bërë në të ardhmen.

Ideologjia reaksionare vepron me të gjitha mënyrat për të infektuar njerëzit tanë, komunistë ose pa Parti. Bartës të saj janë armiqtë e brendshëm e të jashtëm që lidhen, veprojnë, përkrahin e ndihmojnë njëri-tjetrin, sikurse vepruan në Konferencën e Partisë të Tiranës. Kësaj ideologjie ne duhet t'i kundërvëmë ideologjinë tonë revolucionare.

Të punohet me ngulm që njerëzit të afrohen gjithnjë e më shumë me Partinë dhe të mos kursehen në plotësimin e në tejkalimin e detyrave.

Në afrimin e njerëzve të luftohet burokratizmi dhe shabllonizmi, që duken edhe në metodat e vjetra të punës.

Në punën politike, organizative, format dhe metodat që praktikohen do të ndryshojnë në vartësi me kushtet e reja.

Në qytetin e Tiranës paraqet rëndësi të veçantë puna për edukimin e intelektualëve, që ata të mos jetojnë të mbyllur në vetvete, por të bëjnë një jetë politike aktive, revolucionare. Të bëhet kujdes që të shmanget politika sektare me intelektualët dhe të luftohen shfaqjet e arrogancës e të prepotencës në marrëdhëniet me disa prej tyre.

Këto ishin disa mendime që shpreha¹ në mbledhjen e Byrosë Politike.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 52.

EH

E ENJTE
18 TETOR 1956

Bashkë me shokë të udhëheqjes së Partisë e të shtetit mora pjesë në inaugurimin e ekspozitës së arteve figurative të Bashkimit Sovjetik ku janë ekspozuar vepra në pikturë dhe skulpturë të autorëve sovjetikë.

E SHTUNË
20 TETOR 1956

Pamë koncertin e organizuar nga Filarmonia Shqiptare në sallën e Teatrit Popullor. Solistët e rinj të baletit, që sapo kanë mbaruar studimet, i ekzekutuan bukur pjesët nga baletet klasike dhe vallet tona popullore. Nën kujdesin e Partisë, radhët e artistëve tanë po shtohen përditë.

Sekretari i Parë i KQ të Partisë së Punonjësve të Hungarisë, Erno Gero ndodhet prej disa ditësh në Beograd. Në stacion e priti Rankoviçi¹. Në një nga takimet me Titon, ky midis të tjerave tha se bisedimet midis tyre «po zhvillohen në frymën më të mirë, më shoqërore» etj.

1. Aleksandër Rankoviçi, në atë kohë anëtar i komitetit ekzekutiv dhe i sekretariatit të Komitetit Qendror të LKJ.

E HËNË
22 TETOR 1956

I raportova Plenumit të Komitetit Qendror për veprimtarinë e delegacionit të Partisë sonë në Kongresin e 8-të të PK të Kinës, për zhvillimin e punimeve të këtij kongresi dhe për vizitat e delegacionit tonë qeveritar në RP të Mongolisë dhe në RDP të Koresë.

Pasdite prita delegacionin kinez për bashkëpunimin tekniko-shkencor që ndodhet në vendin tonë.

Me ftesë të Titos, Dezhi¹ shkoi në Jugosllavi. Ecejake të dendura në Beograd, i cili është bërë për shumë nga shokët e partive motra si Meka.

1. Georgiu Dezh, në atë kohë anëtar i Presidiumit të Asamblesë së Madhe Popullore të Rumanisë dhe Sekretar i Parë i Partisë Punëtore Rumune.

E MARTË
23 TETOR 1956

Lajme shumë shqetësuese po dëgjoj për gjendjen e rëndë e të turbullt në Hungari. Radiot e huaja po bëjnë një zhurmë të madhe rreth disa veprimeve që ata i quajnë «lëvizje e popullit të Budapestit kundër regjimit socialist» por që, për mendimin tim, janë thjesht veprime kundërrevolucionare për rrëzimin e pushtetit popullor në Hungari.

Po pres me interesim të madh të dhënat që do të na dërgojnë shokët e ambasadës sonë në Budapest. Po të vërtetohet ajo që mendoj unë, dhe kështu kam menduar që prej disa kohësh për gjendjen në Hungari, kemi të bëjmë me një çështje që do të dëmtojë rëndë jo vetëm Hungarinë, por të gjitha vendet e tjera të kampit tonë, vetë idenë dhe praktikën e socializmit.

E MËRKURË
24 TETOR 1956

Sot pata një takim me studentë dhe pedagogë të Shkollës së Lartë të Partisë «V.I.Lenin», të cilëve u fola për punimet e Kongresit të 8-të të PKK si dhe për vizitën e delegacionit tonë në Kinë, në Kore dhe në Mongoli. Fola, gjithashtu, për gjendjen në Poloni, për qëndrimin armiqësor të udhëheqjes jugosllave etj.

Ngjarjet në Hungari po marrin përmasa gjithnjë e më shqetësuese. Organizata reaksionare klandestine kanë shpërthyer një kryengritje kundërrevolucionare kundër pushtetit popullor, janë sulmuar institucione shtetërore e shoqërore, po grabiten magazina, po shkatërrohen instalimet dhe pajisje të ndërmarrjeve të ndryshme etj., etj. Kundërrevolucionarët kanë filluar të vrasin e të presin pa dallim komunistët.

Tash po bindem plotësisht se në Hungari «djajtë» kanë dalë jashtë kontrollit dhe se veprimtaria e tyre kundërrevolucionare nuk do të marrë fund shumë shpejt.

Porosita shokët që të ndjekin me vëmendje të madhe zhvillimin e ngjarjeve, të nxjerrim mësimet e

detyra dhe të rritim kudo vigjilencën sepse armiku do të ngrejë veshët edhe te ne, pavarësisht se ne jemi gati t'ia presim jo vetëm veshët por edhe kokën kujtdo që do të përpiqet të ngrejë dorën kundër Partisë, pushtetit popullor dhe fitoreve që i kemi arritur me gjak e me sakrificë e mundime të mëdha.

Sapo lexova një lajm të agjencisë TASS që njofton se qeveria e RP të Hungarisë ka kërkuar ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe se ky i fundit u ka dhënë urdhër reparteve të ushtrisë sovjetike që ndodhen në Hungari të ndihmojnë forcat e rendit, në këtë vend, që të riven-dosin rregullin dhe qetësinë.

Pak më vonë po kjo agjenci njofton se veprimet kundërrevolucionare në Hungari u eliminuan, domethënë u shtypën. Të shohim sa do të jetë e vërtetë kjo!

E ENJTE
25 TETOR 1956

Megjithëse mbrëmë u njoftua se kundërrevolucioni në Hungari ishte likuiduar, sot burimet zyrtare hungareze, nëpërmjet agjencisë TASS, thonë se në disa vende veprojnë akoma grupe të vogla të armatosura kundërrevolucionare. Kjo më nxit të mendoj se atje gjendja akoma nuk është marrë plotësisht në dorë dhe mund të ketë zhvillime të tjera.

E PREMTE
26 TETOR 1956

Sot u mblodh aktivi i organizatës së Partisë të Tiranës ku u fola komunistëve për përshtypjet e delegacionit tonë nga Kina, Koreja dhe Mongolia. Fola, gjithashtu, për gjendjen aktuale ndërkombëtare dhe për detyrat e Partisë.

TETOR 1956

Shoku Gaston Monmuso, militant i vjetër komunist francez, është për pushime në Shqipëri. Populli e Partia e pritën me dashuri. Unë u takova e bisedova me të hapur e përzemërsisht. Ai më foli për vizitën që bëri në Korçë, për pjesëmarrjen bashkë me kooperativistët në vjeljen e rrushit. Unë e pyeta se si i dukej vera jonë (Monmusoi është nga Shampanja, vendi i verërave të famshme) dhe ai m'u përgjigj, *pince-sans-rire*¹: «Si uthull».

Qesha me të madhe, i dhashë të drejtë dhe e pyeta se ç'duhej të bënim. Monmusoi më foli gjatë për verën, e dëgjova me vëmendje. Ai më foli me simpati për Shqipërinë dhe për të ardhmen e saj nën udhëheqjen e Partisë së Punës.

Ai do të largohet dhe unë i dhashë një letër², në frëngjisht, për shokun Marsel Kashen, në të cilën i shpreha këtij konsideratat e mia për artikujt e tij në gazetën «Ymanite» si dhe respektin e simpatinë që ushqej për të si një militant i shquar komunist.

1. Frëngjisht — këtu: qetë-qetë.

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 59.

E ftova dhe i shpreha, gjithashtu, gëzimin që do të ndiejmë ne komunistët shqiptarë në qoftë se shoku Kashen do të vijë të pushojë në Shqipëri ku do të takohemi e do të bisedojmë nga afër.

E SHTUNË
27 TETOR 1956

Po nisem për në Elbasan për të marrë pjesë në aktivin e Partisë të qarkut, që mbledhet sot pasdite.

Shqetësimi e dyshimet e mia për gjendjen që ziente në Hungari po vërtetohen shumë më tepër se parashikimet. Ua thashë shokëve hungarezë e Suslovit hapur mendimin tim, por ata qëndruan në të tyren. E ja, këto ditë në Hungari kanë shpërthyer kaosi, rrëmuja, përleshjet me armë, gjakderdhja, pse jo, kundërrevolucion! Dje pasdite Janosh Kadari, Sekretar i Parë i KQ të Partisë së Punonjësve të Hungarisë dhe Imre Nagi kryetar i Këshillit të Ministrave (doli dhe ky nga burgu për t'u vënë në krye), i kanë drejtuar thirrje popullit për rivendosjen e ligjit dhe të rendit!

ELBASAN, E DIEL
28 TETOR 1956

Vizitë në Uzinën e Fermentimit të Duhanit. Në këtë uzinë, ku aktualisht kanë filluar punën rreth 250 shoqe, do të punojnë 600 gra e të reja.

I porosita drejtuesit e Kombinatit të Drurit ta organizojnë më mirë punën dhe të mbështeten më tepër te punëtorët për shfrytëzimin me nikoqirllëk të lëndës së drurit.

Bisedë me punëtorët në klubin e kombinatit.

Vizita në disa familje dëshmorësh në qytetin e Elbasanit.

Vizita në Uzinën e Përpunimit të Naftës në Cërrik vazhdoi nga ora 14³⁰ deri në 15³⁰. Pashë sallat e termocentralit elektrik, impiantin e bitumit dhe bisedova me punëtorë e specialistë.

**E MARTË
30 TETOR 1956**

Delegacioni qeveritar dhe partiak i Rumanisë i kryesuar nga Dezhi përfundoi vizitën në Jugosllavi. Për bisedimet që janë zhvilluar me këtë rast, u botuan dy komunikata të përbashkëta. Një për bisedimet qeveritare dhe një për «marrëdhëniet midis Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë dhe Partisë Punëtoare Rumune». Kështu njofton TASS-i që reflekton me sa duket, kënaqësinë e sovjetikëve për përfundimet e kësaj vizite e të këtyre bisedimeve!

**E ENJTE
1 NËNTOR 1956**

Radiot e huaja dhe azhanset e ATSH-së informojnë për një provokacion shumë të rrezikshëm e për një gjendje shumë të rëndë në Lindjen e Mesme, për agresionin ushtarak të Izraelit kundër Egjiptit.

Që pardje, forcat ushtarake izraelite kanë kaluar vijën e demarkacionit të armëpushimit Egjipt-Izrael dhe kanë shpërthyer një operacion në shkallë të gjerë në gadishullin e Sinait. Siç njoftohet, po zhvillohen luftime të ashpra. Ushtria egjiptiane po i reziston invadimit izraelit.

Sikur të mos mjaftonte agresioni i Izraelit, qeveritë britanike dhe franceze, nën pretekstin e sigurimit të kalimit nëpër kanal in e Suezit, i kanë dërguar një ultimatum qeverisë egjiptiane, sa për sy e faqe edhe asaj izraelite, me kërkesën që të ndalen «të gjitha veprimet luftarake në tokë, det e ajër dhe të tërhiqen forcat ushtarake ndërluftuese në një distancë prej 16 kilometrash nga kanali i Suezit». Në qoftë se nuk do të veprohet kështu brenda 12 orëve, kërcënojnë anglo-francezët, njësitë ushtarake të Britanisë dhe të Francës «do të ndërhyjnë me çfarëdo force që të jetë e nevoj-

shme» për të siguruar zbatimin e asaj që kërkohet në ultimatium.

Ultimatumi, që nuk bën asnjë dallim midis agresorit dhe viktimës së tij është një provë e hapët e faktit që agresioni i tanishëm ushtarak izraelit kundër Egjiptit është një agresion i përbashkët britaniko-francez e izraelit. Unë kështu e gjykoj këtë punë.

Ne do të mbrojmë e do të mbështetim luftën e popullit egjiptian dhe të popujve të tjerë arabë kundër agresorit izraelit dhe padronëve të tij cilëtdo që të jenë ata. Në të njëjtën kohë do të marrim masat e nevojshme, që kërkon situata, për të mbrojtur vendin tonë nga pasojat që mund të sjellë zhvillimi i ngjarjeve në pellgun e Mesdheut.

Agresioni i Izraelit kundër Egjiptit po merr porcione të gjera. Sapo presidenti Naser thirri ambasadorin britanik në Kajro dhe i njoftoi se qeveria egjiptiane e hidhte poshtë ultimatumin britaniko-francez si një akt armiqësor e që prek të drejtën, nderin dhe sovranitetin e vendit të tij, radiot dhe agjencitë e lajmeve njoftuan se një numër i madh aeroplanësh bombardues anglezë e francezë filluan bombardimin e Kajros, Aleksandrisë, Port-Saidit dhe të Ismailias.

Turp i madh për imperialistët dhe shërbëtorët e tyre! Por ata nuk kanë as turp, as cipë.

E PREMTE
2 NËNTOR 1956

Takova me mall e bisedova me nënat tiranase, që i bënë shtëpitë çerdhe të revolucionit, që i bënë dhomat e tyre të thjeshta sallat e para të mbledhjeve të Partisë, për të cilën falën çka patën më të shtrenjtë, deri jetën e bijve të tyre.

U gëzova që i gjeta mirë, të plakura por me zemër të rinuar, të lumtura mes fëmijëve, nipërve e mbesave, nga goja u buronin veç fjalë dashurie për Partinë.

Shkova pa lajmëruar, pa trokitur si dikur kur isha ilegal.

Kur hyra në oborrin e Ije Farkës ajo ishte me nallane e diç po punonte, më doli përpara e m'u hodh në qafë. Ringjallëm kujtimet e luftës, kujtuam Vojon, Xhoxhin e Sadikun, të cilët ishin strehuar në këtë shtëpi para se të binin heroikisht në luftën e Kodrës së Kuqe. E porosita nënën t'u flasë për këtë akt heroik dhe për luftën tonë brezave të rinj, t'u flasë thjesht, me zemër nënë, t'u tregojë ato që ka parë e dëgjuar gjatë luftës.

Shkova ta takoj e bisedova me nënë Shyrin¹, nënë

1. Hajrie Shyri.

e dëshmorit Halil Shyri, në shtëpinë e së cilës strehohej në kohën e luftës.

Në familjen e Mehmet Begës u takova e bisedova me Tiren, të shoqen e tij, kurse Meti («karrocieri», siç e thërritnim në kohën e luftës) ishte në punë: vazhdonte zanatin e vjetër, karrocier, po tani në Shtëpinë e Fëmijëve, pranë jetimëve. Ata fëmijë vërtet kanë mbetur pa prindër, i thashë Tires, po nuk janë pa të ardhme, për ta mendon e kujdeset Partia.

Shkova edhe në shtëpinë e dëshmorit Hamid Shijaku, ku u takova me nënën e tij, Metijen.

U takova, u çmalla e bisedova edhe me nënë Hava Tufën, e cila më tregoi me përmallim dhomën ku qëndronim gjatë kohës së luftës. Në këtë shtëpi, një nga bazat tona të luftës, ku janë shtypur edhe numra të «Zërit të popullit» dhe që fashistët e quanin «Çerdhe komuniste», gjeta sot me të vërtetë një çerdhe të lumtur. Nënë Havaja me fëmijët, me nipër e mbesa (8 ishin akoma të vegjël, që sapo erdhën nga kopshtet e çerdhet), jetonin të gëzuar. Sa qumësht kanë pirë ata tani, tha nënë Havaja, unë kam pirë më parë gjithë jetën time.

Te Mine Keta, më pritën me dashuri e përmallim. Sikur më solle Dullën, tha nënë Minja kur u përqaftuam. Ta bëmë shtëpinë me baltë, i thashë nënë Mines, dhe ajo m'u përgjigj: Shtëpia sot shkëlqen se më erdhe ti, o bir. Kujtuam Dullën, që ra në kohën e luftës në krye të detyrës, kujtuam Miston e Mihalin, kujtuam se si Mihali kur mori vesh lajmin e rënies së Mistos, shkroi vjershën për të në oborrin e kësaj shtëpie, kujtuam Vojon me të cilin u takova për herë të parë pikërisht në këtë shtëpi, kujtuam si punonim për të shtypur trakte

me ato germa që Mihali e Mistoja ia patën rrëmbyer armikut.

Nënat trimëresha tiranase nuk kursyen asgjë për lirinë e atdheut, bijtë i përcollën në luftë dhe shtëpitë i vunë në shërbim të Partisë. Këto shtëpi të ulëta me mure prej balte u bënë kështjella të rezistencës popullore, qendra të agjitacionit antifashist, çerdhe të luftës kundër fashizmit, prandaj t'i ruajmë e t'i mirëmbajmë që brezat e rinj të mësojnë edhe prej tyre historinë e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare.

Bisedova shtruar me njerëzit e thjeshtë e të dashur të popullit. U folta edhe për gjendjen ndërkombëtare si dhe për qëndrimet armiqësore të disa personave në Konferencën e Tiranës¹.

Më dëgjonin me vëmendje dhe aprovonin ato që thosha. Të gjithë shpreheshin në një mendje se duhet të jemi vigjilentë e ta ruajmë Partinë. Me intuitën e tij të thellë populli e ndien se Partia është gjëja më e çmuar që ka, është garancia e lirisë dhe e përparimit.

Sot u botua Deklarata e Qeverisë sonë me anë të së cilës denoncojmë me vendosmëri aktin kriminal të agresionit ushtarak anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit. Në emër të popullit tonë, deklarojmë, gjithashtu, se mbështetim plotësisht luftën e drejtë të qeverisë dhe të popullit egjiptian për të mbrojtur vendin e tyre.

Dhamë porosi që të organizohen manifestime e demonstrata popullore në të gjithë vendin për të dënuar agresionin ushtarak imperialist e veprimet e bombardi-

1. Shih në këtë vëllim f. 144.

mit mbi qytetet egjiptiane dhe për të treguar solidaritetin e popullit tonë me popullin egjiptian.

Më vjen shumë keq për popullin e varfër por punëtor egjiptian që ka rënë viktimë e një agresioni barbar nga fuqitë imperialiste dhe shërbëtori i tyre, Izraeli.

Mësova sot nga agjencitë e lajmeve se anglezët e francezët vazhdojnë të hedhin bomba djegëse e eksplozive mbi qytetet egjiptiane, duke vrarë e duke plagosur me dhjetëra njerëz midis popullsisë së pambrojtur. Po këto agjenci njoftojnë se qeveria egjiptiane preu dje marrëdhëniet diplomatike me Britaninë dhe me Francën dhe e shpalli veten e saj në gjendje lufte me të dy këto vende agresore imperialiste.

Ky është një veprim shumë i drejtë, i vendosur dhe dinjitoz i qeverisë egjiptiane. Ne e përshëndetim atë.

E SHTUNË
3 NËNTOR 1956

Në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH trajtuam këto probleme:

Disa çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis vendeve të kampit socialist.

Ngjarjet në Hungari dhe në Poloni.

Bashkimi Sovjetik si në rrugë partie edhe në rrugë shtetërore nuk na ka thënë asgjë rreth këtyre ngjarjeve.

Detyrat e Partisë për të përballuar çdo situatë, sido e rrezikshme qoftë.

E HËNË
5 NËNTOR 1956

Në vazhdim të shënimeve që kam bërë disa ditë më përpara për ngjarjet në Hungari.

Pikërisht në ditët kur kundërrevolucioni ishte në zhvillim të plotë, Rakoshi u hoq nga udhëheqja e partisë hungareze gjoja për arsye shëndetësore dhe u «dërgua» në Bashkimin Sovjetik për pushime! Unë dyshoj shumë për këtë. Rakoshi kishte të metat e përgjegjësitë e tij, por ishte më i miri nga gjithë të tjerët që mbetën në udhëheqje. Pastaj, përse të çohet për «pushime» në Bashkimin Sovjetik. Nga sa gjykoj unë, vendimi për të rrëzuar Rakoshin nuk është marrë në Budapest.

Më ka bërë përshtypje të madhe fakti se pikërisht pas rrëzimit të Rakoshit, sidomos në ditët famëkeqe të tetorit, iu hapën dyert e rikthimit në Hungari hortistëve, baronëve e kontëve, ish-zotër dhe shtypës të dikurshëm të popullit hungarez.

Qeveria e tradhtarit dhe e kulakut, Imre Nagi, i pati ditët e numëruara. Kundërrevolucioni u shtyp, por një ndër krerët e tij, pikërisht Imre Nagi dëgjojmë se është strehuar e ruhet në ambasadën e Titos dhe i shpëtoi zemërimit të popullit! Me këtë vërtetohet se Nagi

ishte agjent i Titos e i reaksionit ndërkombëtar, vërtetohet se në tragjedinë e kohëve të fundit në Hungari udhëheqja jugosllave ishte e përzier kokë e këmbë.

Një kriminel tjetër i rrezikshëm e kundërrevolucionar tipik, kardinali Minxenti i ka shpëtuar zemërimit të popullit hungarez duke u strehuar në ambasadën amerikane ku po bëhet i paprekshëm nga ligjet hungareze dhe i pakapshëm nga forcat e rendit e të diktaturës së proletariatit.

E MARTË
6 NËNTOR 1956

Për festën e 39-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, u dërguam udhëheqësve sovjetikë një telegram urimi për popujt vëllezër sovjetikë.

Mbrëmje në ambasadën sovjetike në Tiranë me rastin e 39-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

Përshëndeti ambasadori Krilov. Fola edhe unë.

Agresioni ushtarak anglo-franko-izraelit, bombardimet e egra nga ajri dhe vrasja e njerëzve të pambrojtur në qytetet egjiptiane nga aviacioni ushtarak anglo-francez, kanë shkaktuar një kundërveprim të madh e të njëzëshëm në opinionin publik përparimtar botëror e sidomos midis masave punonjëse. Nga sa dëgjojmë nga radiot e huaja dhe nga sa lexojmë në azhanset e ATSH-së, në shumicën dërrmuese të vendeve të botës në Evropë, në Afrikë, në Azi e në Amerikë po zhvillohen demonstrata masive popullore për të dënuar agresorët, për

të kërkuar tërheqjen e tyre nga Egjipti dhe për të shprehur solidaritet me luftën e drejtë të popullit egjiptian. Pra kudo po thuhet: «Larg duart nga Egjipti». Kjo është një shenjë e mirë!

Agresioni ushtarak imperialist kundër Egjiptit po diskutohet këto ditë gjerësisht dhe po dënohet ashpër edhe në punimet e sesionit të jashtëzakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Por në këtë «kuvend të popujve», siç duan ta quajnë disa, në të njëjtën kohë po bëhen përpjekje për të shfajësuar agresorët imperialistë dhe Izraelin, për t'i shpëtuar ato nga dënimi e nga përgjegjësia dhe për ta detyruar Egjiptin të pranojë rezoluta e kompromise, midis tyre edhe një «rekomandim» armëpushimi. Kjo është një shenjë e keqe.

**E MËRKURË
7 NËNTOR 1956**

Sot është 39-vjetori i Revolucionit të Madh të Tetorit, i kësaj ngjarjeje që hapi një epokë të re për një-rëzimin.

Kurse nesër do të festojmë 15-vjetorin e Partisë sonë të dashur.

Populli i kryeqytetit zhvilloi sot një manifestim të madh kushtuar këtyre dy datave e dy ngjarjeve të rëndësishme për jetën e tij.

Po sot u inaugurua Òzina e Përpunimit të Naftës në Cërrik, një nga veprat e mëdha të planit të dytë pë-sëvjeçar, si dhe termocentrali i uzinës.

**E ENJTE
8 NËNTOR 1956**

Partia jonë e dashur mbushi pesëmbëdhjetë vjet që nga dita e themelimit të saj në Tiranë. Kjo datë është një ngjarje e shënuar jo vetëm për Partinë, po edhe për shtetin e popullin tonë. E re është PPSH për nga vitet, por, për nga vepra që ka kryer dhe nga pjekuria që ka treguar në udhëheqjen e fateve të vendit, ajo është e thinjur.

Me këtë rast paradite bëra vizitë në Shtëpinë-muze të Partisë. Sa kujtime më ngjall kjo shtëpi e thjeshtë, zyra e parë e mbledhjes së parë të themelimit të Partisë sonë të shtrenjtë.

Pastaj shkova në Varrezat e Dëshmorëve për të nderuar kujtimin e shokëve tanë që derdhën gjakun për lirinë e atdheut.

Mbasdite, me rastin e këtij përvjetori, si dhe të 39-vjetorit të Revolucionit Socialist të Tetorit përshëndeta¹, në emër të KQ të PPSH, pjesëmarrësit e mbledhjes solemne të organizuar nga Komiteti Qendror dhe Komiteti i Partisë për qytetin e Tiranës. Fola gjatë për rrugën e lavdishme që kanë përshkuar Partia dhe shteti ynë në ndërtimin socialist të vendit, për politikën e brendshme dhe atë të jashtme etj.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 83.

E PREMTE
9 NËNTOR 1956

Përfaqësuesi ynë në OKB foli dje në sesionin e jashtëzakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme. Dënoi dhe demaskoi fort aventurën e përgjakshme kundërrevolucionare të elementëve fashistë dhe të padronëve të tyre imperialistë kundër popullit hungarez.

Mora pjesë në shfaqjen që dha sonte në sallën e Teatrit Popullor grupi i artistëve të studios shtetërore të baletit «Çoi Sin Hi» të RDP të Koresë, i cili, prej disa ditësh, ndodhet në vendin tonë.

Programi përmbante pjesë të ndryshme që u ekzekutuan me mjeshtëri. Më pëlqeu.

E SHTUNË
10 NËNTOR 1956

Pas pranimit të rekomandimit të OKB-së për vendosjen e një armëpushimi me agresorët izraelitë, qeveria egjiptiane bëri dje një tërheqje tjetër. Ajo pranoi një propozim, a rekomandim, të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Hamarskjold për krijimin dhe vendosjen e forcave policore ndërkombëtare në tokat që ndajnë forcat ushtarake agresive izraelite dhe forcat ushtarake egjiptiane për «të ruajtur e mbajtur qetësinë»!

Ky veprim duket haptazi që është në favor të agresorëve izraelitë, të cilët refuzojnë të tërhiqen nga tokat e pushtuara egjiptiane dhe në dëm të sovranitetit të Egjiptit.

Të shohim tani ç'do të bëhet e ç'do të kurdiset më tej për të shpëtuar nga dënimi agresorët izraelitë e padronët e tyre imperialistë.

Prita sot udhëheqësit e ansambllit artistik të studios shtetërore të baletit të RDP të Koresë. I urova miqtë koreanë për sukseset e shfaqjeve të tyre në vendin tonë.

**E MARTË
13 NËNTOR 1956**

Në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike të KQ të PPSH së pari lexuam dy letra të kohëve të fundit, që janë këmbyer midis Titos dhe shokut Hrushov¹.

Pastaj i raportova mbledhjes për bisedën që pata sot me ambasadorin sovjetik Krilov: Për pyetjet që i bëra lidhur me letrat në fjalë, për qëndrimin e Titos ndaj nesh, për vënien e Janosh Kadarit në krye të KQ të Partisë së Punonjësve të Hungarisë, për heqjen e Geros si sekretar i parë, për qëndrimin ndaj Imre Nagit dhe për pyetjen që më bëri në fund Krilovi: «Po gjyqin e Dali Ndreut, do ta zhvillojë?».

I analizova këto probleme dhe shpreha mendimin e qartë e të vendosur të Partisë sonë.

Pastaj diskutuan shokët e Byrosë Politike.

Byroja Politike u shpreh në mënyrë unanime për qëndrimin e vendosur marksist-leninist të Partisë sonë për këto probleme.

1. Është fjala për letrën që Titoja i drejtoi Hrushovit më 8 nëntor 1956 si dhe përgjigjen e Hrushovit dërguar Titos më 9 nëntor 1956, në vazhdim të letrave të tyre të mëparshme, duke filluar nga data 4 nëntor, që bëjnë fjalë për çështjen hungareze, për mbrojtjen e tradhtarit Imre Nagi me shokë.

**E MËRKURË
14 NËNTOR 1956**

Sot paradite, në sallën e re të Kuvendit Popullor, u hap sesioni i 4-t i zakonshëm i Kuvendit Popullor. Pas aprovimit të rendit të ditës, shoku Gogo, që është ngarkuar me detyrën e zëvendëskryetarit të parë të Këshillit të Ministrave, kërkoi të lirohej nga detyra e kryetarit të Kuvendit Popullor. Kuvendi e pranoi këtë kërkesë dhe zgjodhi kryetar shokun Rita.

E ENJTE
15 NËNTOR 1956

Gjatë gjithë këtyre ditëve, radiot dhe shtypi i huaj kanë botuar materiale e fotografi që flasin e tregojnë për veprimet mizore, të egra e çnjerëzore që forcat kundërrevolucionare-fashiste hungareze kanë bërë kundër anëtarëve të Partisë së Punonjësve të Hungarisë, punëtorëve, nëpunësve, punonjësve të sigurimit të shtetit e të organeve të tjera të diktaturës së proletariatit si dhe njerëzve të tjerë të pafajshëm e patriotë të ndershëm.

Vigjilencë, vigjilencë, dhe një herë vigjilencë! Egërsia e mizoria e kundërrevolucionarëve është e pakufi. Prandaj ata duhet të shtypen pa mëshirë e pa hezitim.

E SHTUNË
17 NËNTOR 1956

TASS-i njofton se në Bashkimin Sovjetik u bë me sukses një provë me armë bërthamore.

Le t'i vënë gishtin kokës imperialistët luftënxitës!

E ENJTE
22 NËNTOR 1956

Në Moskë u shpall zyrtarisht se Molotovi u shkar-kua nga detyra e zëvendësit të parë të kryetarit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Sovjetik dhe u «grada» ministër i Kontrollit të Shtetit!

Nesër në gazetën «Zëri i popullit» do të botohet artikulli ynë që demaskon rëndë një fjalim të Titos, mbajtur disa ditë më përpara¹ mbi gjendjen ndërkombëtare e, në radhë të parë, mbi ngjarjet në Hungari e në Egjipt. Në artikull i japim Titos atë që meriton.

Këto ditë kam lexuar edhe një artikull — koment të gazetës «Pravda» për këtë fjalim. Flitej me dorashka, me merak se mos acarohet «shoku Tito», siç e cilësonin në artikull!

1. Mbajtur më 11 nëntor 1956 në qytetin e Pulas dhe botuar në gazetën «Borba» më 16 nëntor 1956.

E PREMTE
23 NËNTOR 1956

Sot, në 15-vjetorin e krijimit të organizatës së Rinisë Komuniste të Shqipërisë, mes brohoritjeve entuziaste të qindra delegatëve, filloi punimet në Tiranë Kongresi i 3-të i BRPSH. Kudo ndihet forca, gëzimi dhe vendosmëria e brezit të ri të edukuar e të kalitur nga Partia për të ecur në rrugën e socializmit.

Rinia e sotme po rritet e kulturuar, e ditur, e pastër ideologjikisht dhe e fortë fizikisht. Ajo është vepër e mrekullueshme e Partisë. 15 vjetët e jetës së organizatës së saj janë dëshmi e gjallë e cilësive të larta të rinisë sonë. E udhëhequr si kurdoherë nga Partia, ajo edhe në të ardhmen do t'i vërë të gjitha forcat dhe energjitë e saj në shërbim të popullit dhe të atdheut.

Në emër të KQ të Partisë, Kongresin e përshëndeti shoku Hysni.

SHKËMBI 2
26 NËNTOR 1956

E HËNE
26 NËNTOR 1956

Sot nëpërmjet shtypit populli ynë u njoh me vendimin e Këshillit të Ministrave të RP të Shqipërisë dhe të KQ të PPSH për uljen e re të çmimeve, për rritjen e pagave të ulëta dhe të pensioneve të ulëta, prej të cilave ai do të ketë një fitim prej 1 miliard e 100 milionë lekësh.

SHKËMBI 2
28 NËNTOR 1956

E MËRKURË
28 NËNTOR 1956

Mbledhje solemne me rastin e 12-vjetorit të Çlirimit organizuar nga KQ i Partisë, Këshilli i Ministrave dhe Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Demokratik. Pas fjalës së rastit do të jepet një program artistik.

E ENJTE
29 NËNTOR 1956

Pritje në Pallatin e Brigadave me rastin e festës së Çlirimit.

E PREMTE
7 DHJETOR 1956

Njoftohemi për rezultatet e zgjedhjeve të 2 dhjetorit. Rezultatet janë të larta. Zgjedhësit votuan pothuaj unanimisht për kandidatët e Frontit, gjë që flet për lidhjet e ngushta të popullit me Partinë dhe për forcën e pushtetit popullor të ne.

Provokacion i turpshëm. Dje, në postën kufitare të Kakavijës, roja greke qëlloi dhe vrau ushtarin tonë të kufirit Llesh Pal Çupin. Ky është vazhdim i provokacioneve të rojave greke të kryera në kufirin tonë gjatë këtij muaji. Qeveria jonë ka ruajtur gjakftohtësinë dhe ka protestuar pranë OKB-së për këto incidente. Kujt i shërbejnë këto qëndrime?! Ne kemi qenë dhe jemi për marrëdhënie normale me fqinjët.

DHJETOR 1956

Pas disa ditësh bashkë me shokun Hysni Kapo do të nisemi për në Moskë për bisedime me udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, siç kishim vendosur më parë edhe në mbledhjen e Byrosë Politike¹. Do të bisedojmë çështje të situatave aktuale ndërkom-bëtare, për ngjarjet në Hungari e në Poloni, si dhe për marrëdhëniet me Jugosllavinë.

1. Është fjala për mbledhjen e datës 13 nëntor 1956; shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 146.

E HËNË
31 DHJETOR 1956

Shkuam në mbrëmjen e organizuar në Pallatin e Brigadave nga KQ i Partisë dhe Këshilli i Ministrave për pionierët më të dalluar të vendit me rastin e Vitit të Ri.

Faint, illegible text at the top of the left page, possibly a header or introductory paragraph.

Faint text at the bottom of the left page, possibly a footer or reference.

Main body of faint, illegible text on the right page, containing the majority of the document's content.

1957

Faint text at the bottom of the right page, possibly a footer or reference.

Në mbledhjen e Byrosë Politike raportova¹ për bisedimet që zhvilloi në Moskë delegacioni i Partisë sonë me udhëheqësit e PK të BS. Për të tria çështjet kryesore që u biseduan, për çështjen jugosllave, poloneze e hungareze, delegacioni ynë, ashtu siç kishim vendosur në nëntor në Byronë Politike² parashtrroi pikëpamjet e qëndrimin e Partisë sonë, duke bërë edhe propozime përkatëse. Shokët e udhëheqjes së PK të BS i cilësuan qëndrimet e PPSH të drejta dhe ishin dakord me to. Kjo, natyrisht, është një kënaqësi për Partinë tonë, që në këto situata shumë të vështira, ka ditur të orientohet e të thellohet në problemet që dikton koha, duke qëndruar kurdoherë fort në pozita marksiste-leniniste. Vazhdimi dhe thellimi më tej i luftës kundër armiqve të klasës, kundër titistëve dhe armiqve të tjerë të marksizëm-leninizmit kërkon ta ruajmë të fortë unitetin e radhëve të Partisë dhe të popullit rreth saj, të jemi vigjilentë dhe të ngremë më lart nivelin ideologjik e politik të Partisë sonë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 172.

2. Kjo çështje u shqyrtua në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH më 13 nëntor 1956.

E SHTUNË
5 JANAR 1957

Sot në gazetën «Zëri i popullit» botuam artikullin e «Pravdës»: «Dështimi i planeve agresive të reaksionit ndërkombëtar», të shkruar nga Ponomarjov. Aty u bëhet një analizë ngjarjeve në Hungari, bëhen përpjekje për të hedhur dritë rreth shkaqeve që çuan në kundërrevolucion, nxitësve të tij dhe mësimet që duhen nxjerrë nga ato ngjarje.

Me siguri, pas tërë atyre që ndodhën, jo vetëm shokëve hungarezë, por edhe shokëve sovjetikë, edhe udhëheqjeve të partive të tjera motra u duhet të bëjnë analizat e duhura, t'i thellojnë e t'i argumentojnë ato për të zbuluar mirë rrënjët e shkaqet e atyre ngjarjeve e për të mos lejuar më të ndodhin tragjedi të tilla. Artikulli i Ponomarjovit është, si fillim, një përpjekje jo e keqe drejt analizave më të thella e më të gjera. Por një gjë më mbeti e pakuptueshme: asnjë fjalë në artikull për jugosllavët, megjithëse dihet mirë roli famëkeq i Titos me shokë në ato ngjarje! Përse? Kanë frikë se mos i mbetet qejfi Titos: Këtij vetë as i erdhi e as i vjen frikë të strehojë e të ruajë në ambasadën jugosllave në Budapest kreun e kundërrevolucionit Imre Nagin.

E DIEL
6 JANAR 1957

Dje presidenti Ajzenhauer në një mbledhje të posaçme të përbashkët të Dhomës dhe të Senatit lexoi mesazhin e tij mbi politikën e Shteteve të Bashkuara në Lindjen e Mesme. Në mes të tjerash thuhej se politika amerikane do të forcojë «pavarësinë kombëtare» të Lindjes së Mesme. Pallavra. Doktrina e presidentit amerikan, që ka për qëllim nënshtrimin e vendeve të Lindjes së Afërt e të Mesme, përmban në vetvete farën e një lufte të re. Imperialistët kujtojnë se gjithçka varet nga ata. Por jo. Lëvizja çlirimtare e popujve, që ka marrë vrull të madh në kolonitë, do të triumfojë e s'mund ta ndalin dot imperialistët as me dollarë, as me topa.

Lexova një deklaratë zyrtare të qeverisë hungareze, transmetuar nga agjencia sovjetike TASS. Midis të tjerash shokët hungarezë theksojnë se «ne nuk lejojmë më kurrë që në udhëheqjen e punëve shoqërore të rilindin metodat antileniniste të Rakoshi-Geros, kultit të individit» etj., etj. Kjo deklaratë, e thënë në kuadrin e analizave për ngjarjet kundërrevolucionare të tetor-nëntorit në Hungari, merr një tingëllim tepër të hidhur! Pra, paskëshin qenë «metodat antileniniste» të udhëheqjes, «kulti i individit», që çuan në shpërthimin e ngjarjeve të përgjakshme e tragjike në Hungari! Pra, ato që ndodhën atje s'ishin kurdisur nga reaksioni e imperializmi ndërkombëtar e nga gjallërimi i pafalshëm dy-tre vjetët e fundit i reaksionit të brendshëm, por na qenkëshin pasojë e metodave «antileniniste» të Rakoshit me shokë etj., etj.!

Për bindjen time shkaqet e rrënjët e ngjarjeve kundërrevolucionare në Hungari janë shumë më të thella e më komplekse, jo më nga aq sa thonë shokët hungarezë, por bile edhe nga ato që thonë shokët sovjetikë. Përse u gjallërua e u organizua reaksioni i brendshëm,

hortistët e Minxenti pikërisht vitet e fundit e jo më parë?! Kush ua hapi shtigjet e u dha mundësitë imperializmit e reaksionit ndërkombëtar të depërtonin lirshëm në Hungari, të gjallëronin lidhjet e vjetra, të krijonin një rrjet të tërë kundërrevolucionar, ta organizonin e ta hidhnin në veprim? Këto kalohen në heshtje, ose s'zihen në gojë fare. Për mendimin tim, nëse ka bërë gabime shoku Rakosh, gabimi i tij më i madh është se nën presionin e parullave e thirrjeve për «demokratizim», për «çrrënjosjen e metodave antileniniste», u dorëzua, lëshoi frenat e Partisë nga dora, dobësoi forcën dhe kombativitetin e diktaturës së proletarietit. Këtë kërkonte imperializmi e reaksioni e u hodhën në aksion.

E MËRKURE
23 JANAR 1957

Sot bashkë me shokët e tjerë shkua në Durrës për të pritur delegacionin qeveritar bullgar, që erdhi për vizitë te ne me ftesën e Qeverisë sonë. Delegacioni kryesohet nga kryetari i Këshillit të Ministrave të Bullgarisë, Anton Jugov. Me Jugovin jam takuar edhe herë të tjera, sidomos kur kam udhëtuar me të nëpër Bullgari, ku më ka shoqëruar në shumë vizita që kam bërë dhe kam përshtypje të mira. Jugovi është kuadër i vjetër i Partisë Komuniste Bullgare, shok dhe bashkëpunëtor i udhëheqësit të lavdishëm të popullit bullgar, Gjergj Dimitrovit; njeri i vendosur dhe organizator i mirë.

Pas mbërritjes në Tiranë, shokët bullgarë i prita në selinë e Komitetit Qendror të Partisë.

Po sot filluan bisedimet midis delegacionit bullgar dhe delegacionit tonë, për zhvillimin e marrëdhënieve midis dy vendeve tona dhe për probleme të ndryshme të gjendjes së sotme ndërkombëtare.

E ENJTE
24 JANAR 1957

Në mëngjes u nisëm me shokët bullgarë për të vizituar Shkodrën. Binte shumë shi.

Asistua në banketin e shtruar në një nga sallat e Komitetit Ekzekutiv, pastaj në mitingun e madh të popullit të Shkodrës, ku folëm unë¹ dhe Jugovi.

Vizitua Uzinën e Fermentimit të Duhanit. Jugovi i përshëndeti punëtorët në emër të delegacionit bullgar.

Pas vizitës që bëmë në kooperativën bujqësore të Dobraçit, shkua për drekë në hotel «Turizmi».

Pasdite u kthyem në Tiranë.

Shoqërimi me Jugovin është vërtet i këndshëm. Është njeri i dashur e i hapët.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 198.

E DIEL
27 JANAR 1957

Asistova në pritjen që u dha në Pallatin e Brigadave për nder të delegacionit bullgar.

E MARTË
29 JANAR 1957

Sot në drekë shkuam në Pallatin e Brigadave, ku u nënshkrua deklarata mbi qëndrimin e delegacionit bullgar në vendin tonë.

Pasdreke asistua në mitingun e madh të popullit të Tiranës, që u organizua me rastin e vizitës së delegacionit qeveritar bullgar.

Në mbrëmje mora pjesë në pritjen që dha ambasadori bullgar në hotel «Dajti». Folëm unë¹ dhe Jugovi.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 205.

STAN/10 3
TOSI JANAR 57

E MËRKURË
30 JANAR 1957

Sot shokët bullgarë u larguan nga vendi ynë. Shkuam në Aeroportin e Rinasit për t'i përcjellë. Para nisjes Jugovi mbajti një fjalim përshëndetje.

STAN/10 3

E ENJTE
31 JANAR 1957

Botuam në shtyp deklaratën mbi qëndrimin e delegacionit qeveritar bullgar në vendin tonë.

Vizitën e shokëve bullgarë Partia jonë e vlerëson lart. Shkëmbimi i mendimeve u bë në unitet pikëpamjesh nga të dyja palët, qoftë për çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet në mes dy vendeve tona, qoftë për problemet që dalin nga gjendja në Ballkan, të cilat i shqyrtuam në detaje, apo për probleme të tjera të gjendjes ndërkombëtare dhe për bashkëpunimin në mes dy vendeve tona.

TEZA PËR RAPORTIN NË PLENUMIN E ARDHSHËM TË KQ TË PARTISË

Situata politike ndërkombëtare

Forcat e paqes dhe të demokracisë kalojnë një periudhë lufte kundër forcave agresive.

Përpara këtyre evenimenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e lirisë dhe të paqes Partia dhe populli dënuan me vendosmëri agresionin anglo-franko-izraelit ndaj Egjiptit, kundërrevolucionin në Hungari, mbajtën një qëndrim kompakt dhe të drejtë në çështjen poloneze.

Imperialistët dhe armiqtë e tjerë të vendit tonë s'munguan të na sulmonin rreptë për qëndrimet tona të vendosura. Kjo tregon se qëndrimet tona janë të drejta, se ato godasin dhe demaskojnë planet e tyre dhe se kontributi ynë në politikën paqësore dhe monolite të kampit të socializmit është një kontribut i çmueshëm.

Punimet e Plenumit të KQ kanë për qëllim t'i japin një ndihmë akoma më të madhe Partisë dhe popullit

për t'u armatosur, për të qenë akoma më vigjilentë dhe për të luftuar me sukses intrigat dhe orvatjet e armiqve.

Karakterizimi i situatës së jashtme.

Ulja e tensionit dhe ngritja e tij përsëri.

Planet e imperialistëve.

Politika e BS dhe e vendeve të demokracisë popullore.

Lufta e ftohtë, përgatitja e luftës.

Sulmi kundër Egjiptit.

Rilindja e popujve arabë.

Politika e Bashkimit Sovjetik, politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Interesat e imperialistëve në kanalin e Suezit.

Plani i ri i Ajzenhauerit.

Roli i vendit tonë.

Kundërrevolucionin në Hungari.

Imperializmi.

Gabimet.

Intrigat.

Ndërhyrja e Bashkimit Sovjetik.

Çështjet në Poloni.

Sulmi kundër partisë franceze e italiane.

Qëndrimi i partisë italiane.

Mësimet që duhen nxjerrë nga ngjarjet hungareze.

Do të jetë gabim të mendohet se reaksioni ndërkombëtar ka hedhur armët në vendet e demokracisë popullore.

«Kapitalizmi, — ka thënë Lenini, — do të bëjë, deri në zhdukjen e tij të plotë, një luftë të ftohtë dhe të hapët, paqësore dhe ushtarake, të përgjakshme dhe jo të përgjakshme».

Termet që u përdorën në Hungari:

1. **Nacionalizmi shovinist.** Kryelartësia mazhare kundër BS, oficerët hortistë të mundur nga ushtria sovjetike.

2. **Demagogjia punëtore.** Të shpronësuarit, fabrikantë e të tjerë sabotonin moralin e punëtorëve, i eksitonin duke u mbështetur në vështirësitë e përkohshme dhe në disa gabime të vërtetuara dhe këto s'ia hidhnin socializmit (sepse demaskoheshin) por udhëheqjes së partisë. Këta elementë u lehtësuan në punën e tyre, sepse u qenë hapur portat e partisë dhe gënjyen punëtorë dhe komunistë të rinj. Në fshat ata patën më pak sukses, pse fshatarësia kishte marrë tokën etj.

3. **Kundër padrejtësive dhe për «lirinë».** Intelektualët e rrethit «Petëf» që me përkrahjen e Nagit përgatitën ofensivën ideologjike, spekuluan mbi të drejtën e kritikës për të goditur ndërtimin e socializmit si dhe mbi gabimet që janë të paevitueshme, por të ndreqshme në regjimin socialist.

Filloi të lulëzojë fjala «liri» në kuptimin e vërtetë socialdemokratik, dhe gjoja nën parullën e lirisë së mendimit morën të drejtën të shkallmonin shtetin socialist nën pretekstin se s'duhej penguar liria individuale.

Këtë fushatë e ushqyen me kohë radiot perëndimore, dhe sidomos «Evropa e lirë» e ngritur apostafat. Individualizmi, anarkizmi ekzaltoheshin prej intelektualëve të rrethit «Petëf» si shpirtalla e lirisë. Shumë intelektualë të ndershëm punëtorë ranë brenda.

Kundërrevolucioni hungarez na mëson shumë gjëra që Lenini i ka parashikuar dhe që s'duhet kurrë të harrohen nga ne.

Nuk mjafton vetëm komanteri¹ i shfaqjeve të jashtme, të sipërfaqshme të ngjarjeve, por duhet thelluar, pse ka ligje të luftës politike, ligjet e revolucionit që nuk mund të kuptohen, në rast se nuk i referohesh bazës së klasës, të forcave politike që ndeshen.

Vetëm metoda e materializmit historik lejon të gjesh rrugën e drejtë në ngjarjet e koklavitura.

Armiqtë, veglat e tyre, titistët, oportunistët e çdo kallëpi e quajtën kundërrevolucionin hungarez një «revolucion popullor në regjimin socialist». Kjo s'ka asnjë përmbajtje shkencore, pse një revolucion është një ndryshim rrënjësor kualitativ i raporteve të prodhimit, në konformitet me karakterin e forcave prodhuese. Çdo zallahi ose demonstratë apo lëvizje s'mund të quhet revolucion popullor dhe ca më pak kundërrevolucioni hungarez. Kjo tregon vetëm dëshirën e armiqve të socializmit, injorancën e tyre nga marksizmi, si ajo e titistëve, dhe përdorimin e parullave pseudomarksiste për të fshehur qëllimet.

Marksizëm-leninizmi na mëson se nuk mund të katandiset analiza shoqërore vetëm në ekzistencën e dy klasave, proletariatit dhe borgjezisë. Ekzistojnë shtresa të ndryshme dhe të forta në numër të borgjezisë së vogël dhe atje është problemi politik kryesor pas vendosjes së diktaturës së proletariatit.

Lenini e sqaron këtë çështje në të gjitha detajet.

Disa aspekte të këtij problemi kanë shumë rëndësi dhe veçanërisht pse ilustronë ngjarjet në Hungari, ose

1. Nga frëngjishtja — komentim, shpjegim.

më drejt ngjarjet hungareze vërtetojnë edhe një herë tezat gjeniale të Leninit.

Lenini na mëson se diktatura e proletariatit duhet të zbatohet një violencë të pamëshirshme, të shpejtë dhe të vendosur kundër kapitalistëve, çifligarëve dhe kulishëve të tyre, dhe jo vetëm në fillim, por gjithë periudhën e ndërtimit të socializmit gjatë së cilës shpresat e restaurimit të kapitalizmit transformohen edhe në tentativa të restaurimit.

Por Lenini na tregon, gjithashtu, se në diktaturën e proletariatit kryesore nuk është vetëm violenca, esenca qëndron dhe në «shpirtin e organizimit dhe të disiplinës së detashmentit të përparuar të punonjësve, të avangardës së tyre, të udhëheqësit të tyre të vetëm, proletariatit».

Pse udhëheqësi i vetëm — proletariati dhe jo një klasë tjetër.

1. E vetmja klasë që është krejt e zhveshur nga kapitali, nga prona private dhe s'ka asnjë interes që ta mbrojë, në çdo formë qoftë, pronën private.

2. Përmirësimi i jetës për të është zhdukja e pronës private, ndërtimi i socializmit dhe të çojë kështu të gjithë shoqërinë në një nivel të lartë.

3. Lufta e klasave kundër kapitalizmit dhe borgjezisë e ka pajisur atë me një eksperiencë të madhe. Ai njih mirë djallëzitë, barbarizmat, gënjeshttrat, qëllimet grabitqare të borgjezisë. Ai njih mirë forcën e armikut që ka përpara dhe, pra, vetëm ai mund të drejtojë ndërtimin e socializmit, vetëm proletariati është në gjendje t'u rezistojë me heroizëm goditjeve, humbjeve, sakrificave që historia u imponon atyre që vendosin të shkë-

puten nga e kaluara. S'ka rrugëdalje tjetër për të, kapitalizmi ia ka mbyllur të gjitha portat. Proletariati i njih pa mundim fare kapitalistët, me çfarëdo veshje dhe maskë që ata të dalin, qofshin këta të maskuar në aparatet shtetërore të shtetit socialist, qofshin këta emigrantë politikë, që hedhin lot krokodili, për «lirinë, demokracinë», por që në realitet janë në shërbim të kapitalizmit dhe organizojnë komplete.

Borgjezia e vogël nuk i ka këto kualitete të borgjezisë së madhe dhe të kapitalistëve, por s'duhet harruar se edhe në ndërtimin e socializmit ajo ekziston dhe tenton të kërkojë drejtimin e punëve, thotë Lenini, tenton t'i imponojë pikëpamjet e veta proletariatit.

1. Ekziston prodhimi i vogël dhe s'mund të zëvendësohet menjëherë me prodhimin socialist.

2. Proletariati në kooperativizmin socialist duhet të veprojë në mënyrë progresive, pa u shpejtuar por edhe pa u vonuar shumë dhe këtë gjë duhet ta shoqërojë me shumë masa ekonomike, politike, edukative.

Prodhuesi i vogël nga natyra është i lëkundshëm, si punonjës i afrohet proletariatit, si shitës dhe blerës i afrohet kapitalizmit.

Kur shfaqen vështirësi, ai heziton, hidhet andej-këndej, dhe gjen instinktivisht paragjykime antikomuniste, antipunëtore. Prodhimi i vogël, pra, ekonomikisht është fusha e lëkundjeve politike që karakterizojnë borgjezinë e vogël, fusha e anarkizmit, i cili manifestohet edhe kundër planeve të mëdha të industrializimit socialist, edhe në planin politik kundër organizimit dhe disiplinës së ndërtimit socialist.

Domethënë revolucioni gjen përpara një forcë të

madhe të rutinës së vjetër, zakonet, injorancën, paragjykimet dhe fodullëkun e borgjezisë së vogël. Duhet me fitu mbi këto forca, prandaj Lenini na mëson se s'duhet harruar asnjëherë kjo luftë e përditshme.

Këtu e kanë forcën kapitalistët dhe çifligarët që revolucionin popullor i ka shpronësuar dhe goditur. Ata gjejnë forca pse e gjithë masa e punonjësve dhe veçanërisht elementët e borgjezisë së vogël nuk i zbatojnë ngahera si duhet ligjet e pushtetit socialist.

Kapitalistët dhe borgjezia e madhe e çifligarët si ish-drejtuës të ekonomisë, i dinë vështirësitë tona dhe ku na dhemb, prandaj përveç sabotimeve ata presin momentin, presin vështirësitë e regjimit të ri, ruajnë gabimet që bëhen dhe shfrytëzojnë në favor të tyre forcën e zakonit të mentalitetit mikroborgjez.

Kur kujtojnë se erdhi momenti ata hedhin parullat e kurdisura sipas situatës për gjendjen shpirtërore të masave që janë për revolucionin. Qëllimi me marrë pushtetin, me parulla të djathta ose mëngjarashe s'ka rëndësi për ta, rëndësi për ta ka të zbojnë udhëheqësit më të vendosur të proletariatit, komunistët. Këtë kuptim ka pasur parulla e Miljukovit, pas kundërrevolucionit në Kronshtad (me sovjetë, pa bolshevikë), këtë kuptim kanë pasur dhe këshillat revolucionarë të punëtorëve në Hungari, të përdorur nga titistët.

Është e kuptueshme pse borgjezia dhe kapitalizmi çajnë kokën për sovjetët ose «këshillat revolucionarë». Pasi të marrin pushtetin atëherë ia dredhin zverkun edhe borgjezisë së vogël që e përdorin si mashë.

Po të vihen frenat e shtetit popullor në duart e bor-

gjezisë së vogël, revolucionin, thotë Lenini, është në buzhën e disfatës.

Lenini tregon se me ndryshimin e konditave historike borgjezia e vogël është bërë e pazonja të çojë në fitore asnjëfarë revolucionin. 1789 — borgjezët e vegjël mund edhe të ishin revolucionarë të mëdhenj; më 1848 ata u bënë qesharakë; më 1917-1921 u bënë bashkëpunëtorë të ndyrë të reaksionit, valetë¹ e tyre për rolin që luajtën. Ç'mund të themi për ata të 1956-s, Minxentët, Nagët? Me një grusht u likuiduan në Hungari.

Rezulton, pra, se kapitalistët e shpronësuar kanë si pikëmbështetje kryesore në vendet e demokracisë popullore lëkundjet politike të borgjezisë së vogël. Pra, klasa punëtore duhet t'i zhdukë dhe t'i kapërcejë këto lëkundje, të cilat s'janë të njëllajta në të gjitha vendet e demokracisë popullore.

Ç'duhet bërë? Dy gjëra: nga një anë duke prerë nga rrënjët faktorin ekonomik të hezitimeve e duke u siguruar kondita ekonomike punonjësve dhe prodhimitarë së vogël, nga ana tjetër duke zhvilluar një luftë politike dhe ideologjike kundër koncepteve, pikëpamjeve dhe praktikës mikroborgjeze.

Për këtë një konditë absolute: forca e organizimit dhe e disiplinës së partisë. Socializmi nuk ndërtohet i izoluar nga këto influenca mikroborgjeze. «Kufoma e kapitalizmit kalbëzohet në sytë tanë» — Lenini. Domethënë se kapitalizmi i rrëzuar akoma nuk është varrosur. Me mikrobet dhe me erërat e tij qelbet shoqëria e re, prandaj pengesa kryesore për të janë uniteti dhe disiplina e partisë.

1. Nga frëngjishtja — shërbëtorë.

Reaksioni që ka humbur, thotë Lenini, ruan gabimet, nga të cilat sigurisht edhe do të bëhen, pse proletariati nuk e posedon plotësisht artin dhe shkencën e drejtimit të shtetit. Ai e mëson atë gjatë luftës së tij revolucionare. Intelektualët borgjezë utopistë thonë se proletariati nuk duhet ta marrë fuqinë pa dhënë provat se ai është i zoti të drejtojë pa gabime. Këta kanë për qëllim që revolucionin të mos bëhet kurrë.

Drejtësia e vijës së përgjithshme të ndërtimit të socializmit, e bazuar mbi shkencën marksiste-leniniste, është një politikë klase. Teoria nuk mund të parashikojë të gjitha aspektet e reja të praktikës në ndërtimin e socializmit dhe për këto aspekte s'ka skema, por ka principe

Proletariati mëson duke ushtruar diktaturën. Një vepër si ndërtimi i socializmit, parashikon, për njëqind gabime, të meta, 10 mijë aksione heroike që borgjezia këto përpiqet t'i fshehë dhe të vërë në dukje, të publikojë vetëm gabimet (shih shtypin dhe radiot). Gabimet sigurisht duhen korrigjuar.

Cilat janë garancitë kundër gabimeve.

Respektimi i parimeve të partisë, lidhjet me masat, centralizmi, drejtimi kolektiv, kritika dhe autokritika.

Fashizmi — rreziku aktual.

Evenimentet në Francë dhe në Hungari vunë në dukje kërcënimin fashist.

As nuk duhet me pasë iluzione se kapitali financiar do t'i lëshojë armët dhe pozitat.

Nga të gjitha format e luftës, më e egra quhet fashizmi. Fashizmin borgjezia e përdor kundër hovit revolucionar të masave. Dimitrovi ka thënë se «fashizmi

është diktatura terroriste e hapët e elementëve më reaksionarë dhe më shovinistë të kapitalit financiar».

Sa më tepër thellohet kriza në gjirin e kapitalizmit, sa më tepër kapitalistët humbasin tregjet dhe u pakësohen fitimet, sa më shumë forcohet kampi i socializmit, sa më shumë popujt hedhin poshtë zgjedhën e kapitalit dhe lëvizja revolucionare ngrihet, aq më tepër kapitalizmi e quan urgjente të forcojë ekzekutivin e tij, domethënë të zhdukë dhe ato forma gjoja demokratike, me një fjalë të zëvendësojë demokracinë formale me një diktaturë terroriste të hapët. Kjo po zhvillohet gradualisht përpara syve tanë në Shtetet e Bashkuara dhe në demokracitë e tjera perëndimore.

Përmbajtja, ideologjia dhe karakteristikat e fashizmit janë të njëjta në çdo vend. Përveç të tjerave për të gënjyer masat e lëkundura të borgjezisë së vogël, kapitalistët përdorin edhe socialdemokratët. Nuk heziton të krijojë grupe dhe banda terroriste, përdor demagogjinë më të shfrenuar, spekulon mbi vështirësitë dhe aspiratat e masave. Mos harroni ç'bënte Musolini që më 1919: «Do të shpronësojmë çifligarët, pasanikët, e minierave» etj. Por akoma në Itali këto probleme ndodhen të pazgjdhura, pse e gjithë kjo qe gënjeshtërt.

Hitleri bënte po këtë propagandë. Nxiste racizmin, vinte në plan të parë teorinë raciste të kontit Gobino të hierarkisë për racat njerëzore me racën gjermane në krye, nxiste antisemitizmin dhe ksenofobinë më të egër kundër popujve të tjerë.

Ideologë, teoricienë të çuditshëm e që i gjejmë edhe tash pas disfatës hitleriane, përpiqen të demonstrojnë se roli i gruas është të pjellë dhe ai i burrit të luftojë.

Dihet se ku na çuan këto dhe kush i pagoi me gjak.

Por fashizmi në restaurim tregon një shenjë dobësie të borgjezisë. Prandaj duhet me pasë parasysh se fashizmi nuk është një makinë e gatshme, por ajo përgatitet nën regjimin e borgjezisë nëpërmjet përpjekjeve të ashpra, nganjëherë të përgjakshme me proletariatin dhe me partinë e tij si edhe me partitë e tjera përparimtare.

Pra, duhet me luftu kundër fashizmit gjatë gjithë etapave që ai përgatitet.

Në Francë po ecet në përgatitjen e fashizmit, në forcimin e ekzekutivit, në stabilizimin e qeverive reacionare dhe të fuqisë presidenciale. Përpiqen, pra, me i heq pushtetin e kontrollit të të zgjedhurve të popullit, të deputetëve mbi pushtetin ekzekutiv. Prej shumë kohe borgjezia në fuqi po ua ha pak nga pak të drejtat formale demokratike, lirinë individuale, të drejtat sindikale, heqjen e subvencioneve organeve demokratike si CGT, po bëjnë arrestime. Të gjitha këto, për të krijuar një atmosferë mbytëse dhe të egër kundër komunistëve dhe elementëve progresistë. Këto veprime në planet zyrtare shoqërohen me akte terroriste dhe me krijimin e organizatave terroriste kundërrevolucionare.

Sulmojnë «Ymanitenë», e djegin, sulmojnë shitësit e gazetës; djegin godinën e KQ. Partia borgjeze hapur proklamon luftën kundër komunizmit, kërkon shpërndarjen e partisë komuniste.

Përgjegjësi e madhe e socialdemokracisë franceze dhe në radhë të parë e partisë socialiste.

Prandaj duhet forcuar lufta kundër fashizmit, kundër përgatitjes së fashizmit.

I. Roli ndërkombëtar i Bashkimit Sovjetik.

Përpjekjet e imperialistëve dhe të revizionistëve për të mohuar rolin e madh të Bashkimit Sovjetik.

Këtë rol e përcaktojnë konditat historike:

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit, goditja e sistemit kapitalist dhe çlirimi i një të gjashtës së botës. Diktatura e proletariatit. Tronditja dhe shkatërrimi i kolonializmit. Revolucioni ideologjik. Demaskimi i imperializmit. Demaskimi i Internacionales së Dytë dhe i të gjitha rrymave antimarksiste.

Zbatimi në jetë i marksizëm-leninizmit.

Ndërtimi i shtetit socialist. Ndërtimi i ekonomisë socialiste. Fitorja mbi intervencionin. Fitorja mbi fashizmin. Rindërtimi i shpejtë i BS. Çlirimi i popujve të demokracisë popullore. Ndërtimi i socializmit në këto vende. Ndhima e BS. Eksperienca universale e BS. Njohja e këtij realiteti dhe mbrojtja e BS përcakton degrenë e internacionalizmit të çdo individi, partie ose shteti.

Qëndrimi i imperialistëve karshi BS. Qëndrimi i shteteve të quajtura asnjëse, si India etj., qëndrimi i titistëve dhe i revizionistëve të çdo lloji.

II. Mbi marrëdhëniet midis vendeve socialiste, midis partive marksiste-leniniste dhe mbi internacionalizmin proletar.

Imperialistët kërkojnë të na përçajnë. Këtë punë po bëjnë dhe titistët.

Ç'thotë propaganda e tyre për marrëdhëniet tona me BS dhe si janë në fakt këto marrëdhënie.

Ç'thonë titistët për këto marrëdhënie.

(Hungari, Poloni, Shqipëri.)

Ç'thonë titistët për marrëdhëniet e tyre me BS. Si i cilësojnë dhe ç'janë në realitet këto marrëdhënie. (Nga ana ekonomike, ideologjike, shtyp-propagandë etj.)

Ç'thonë titistët për aleancat, për blloqet, për kampin tonë. Çfarë aleancash kanë krijuar ata dhe ç'karakter kanë këto. Ku synojnë titistët.

Detyrat e Partisë sonë për forcimin e marrëdhënieve të aleancës dhe demaskimi i propagandës imperialiste dhe titiste.

III. Lufta ideologjike për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga revizionistët, trockistët e të tjerë.

Nevojë e domosdoshme — edukimi marksist-leninist i anëtarëve të Partisë. Ku e kanë qëllimin antimarksistët, si veprojnë, si maskohen, lufta kundër diktaturës së proletariatit etj.

«Vija jugosllave» dhe mbrojtësit e saj imperialistë.

Si e maskojnë vijën e tyre titistët.

«Luftë kundër dogmatizmit», në realitet kundër bazave të marksizmit. Lufta e klasave, diktatura e proletariatit, roli udhëheqës i partisë etj.

Marksizmi duhet të zbatohet në mënyrë krijuese në kondita të veçanta etj.

Bashkësi e tipareve të ligjeve të përgjithshme kryesore, format, metodat, ritmet.

Komunizmi nacional specifik. Çështje të përbashkëta, diktatura nën udhëheqjen e partisë, lufta e klasave, aleanca, likuidimi i pronës kapitaliste dhe vendosja

etj. sja e pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit, organizimi socialist i bujqësisë, zhvillimi i planifikuar i ekonomisë, mbrojtja e socializmit nga goditjet e imperialistëve etj.

Qëllimi i komunizmit nacional.

Lufta kundër stalinizmit.

Qëllimi i armiqve: Me zhvillu në këtë çështje të gjitha tezat e titistëve, shpifjet, qëllimet.

Internacionalizmi dhe nacionalizmi.

«Historia e të gjithë shoqërisë nuk ka qenë veçse historia e luftërave të klasave» (Marks).

Kontradikta kryesore e shoqërisë kapitaliste është kontradikta në mes karakterit shoqëror të prodhimit dhe karakterit privat të përvetësimit, në mes regjimit të prodhimit dhe regjimit të pronësisë dhe kjo kontradiktë mund të zgjidhet duke përmbysur rendin shoqëror kapitalist. Kjo kontradiktë do të thotë luftë e klasave në mes kapitalistëve dhe proletarëve.

Pra lufta e klasave është një realitet internacional, që kërkon solidaritet ndërkombëtar të klasës revolucionare. Pra internacionalizmi proletar s'është një dogmë, por një princip veprimi shkencor, si konditë e domosdoshme për fitoren e proletariatit.

Internacionalizmi proletar — nevojën e tij e ka vërtetuar eksperiencia. Lufta e Parë Botërore. Internacionalja e Dytë, Internacionalja e Tretë e Leninit e Partisë Bolshevike.

Kundërshtimi i luftës dhe transformimi i luftës imperialiste në luftë civile kundër borgjezisë.

Ekzistenca e një shteti socialist dhe tani i një sistemi botëror socialist s'ka ndryshuar asgjë. Internaciona-

lizmi proletar është një princip bazë i diktaturës së proletariatit revolucionar.

Ky princip i madh në rast se dobësohet atëherë forcat imperialiste me hekur dhe me zjarr do të shkatërronë socializmin dhe të gjitha shtetet e tjera që luftojnë për paqe, për demokraci etj.

Armiku lufton. Internacionalizmi proletar, lufta e klasave, centralizmi demokratik, diktatura e proletariatit etj. Ai di se nga përçarja e klasës punëtore në planin nacional dhe internacional, dobësimi i ndërgjegjes së klasës dhe dobësimi i pozitave avangarde varet fitorja e tij.

Ai ekzalton nacionalizmin borgjez — shovinizmin, kozmopolitizmin.

Kozmopolitizmi — justifikim i ideologjisë së shkëmbimeve të lira. Teoria me zhduk ndjenjën e sovranitetit kombëtar në popujt e tjerë në mënyrë që të eksportojë mallrat e saj (Anglia), zhdukja e kufijve (të zhduken luftërat dhe pra, të shuajë luftën e proletariatit kundër borgjezisë).

Internacionalizmi proletar kurrë nuk mohon sovranitetin kombëtar, kurrë s'ka qenë në shërbim të kapitalit kozmopolit, por kundër imperializmit.

Ç'tregojnë të gjitha ngjarjet në Perëndim?

Qëllimi i amerikanëve të ekzaltojnë shovinizmin në vendet e demokracisë popullore. Dallesi ka deklaruar se është i kënaqur nga «një ndarje paqësore me Moskën», sikurse një gazetar me emër amerikan, Sulberger, ka shkruar: «Në Jugosllavi ne bashkëpunojmë ngushtë me titizmin, sepse kjo u shërben interesave tanë». Dhe kur në NATO flet ministri i Jashtëm gjer-

man, do të thotë se kjo s'është vetëm ideja e një gazetari.

Nacionalizmi i shteteve të mëdha e të vogla.

Si u thosh Lenini proletariatit të shteteve të vogla që të keni kujdes nga ndarjet shoviniste.

Taktikat që përdori armiku (tregtinë) etj.

Internacionalizmi s'është në kundërshtim me sovranitetin kombëtar.

Mbi rolin e partisë së klasës punëtore në revolucionin socialist dhe në ndërtimin e socializmit.

Ç'është partia, roli i saj. Ç'ngjau në vendet socialiste nën udhëheqjen e partisë. Ç'ngjau në Hungari, në Poloni, në Jugosllavi.

Ç'mendojnë titistët për partinë dhe rolin e saj. Roli i masave zhduket, diktatura e udhëheqësve, «demokratizimi» etj. T'i heqin klasës punëtore partinë.

Mbi rolin e diktaturës së proletariatit.

Çështja e pushtetit.

Diktaturën e proletariatit Kardeli e mohon dhe e quan të panevojshme.

Diktatura e proletariatit — e domosdoshme për të shtypur përpjekjet e klasave shfrytëzuese dhe të imperialistëve, ajo është diktaturë e shumicës.

Liberalizimi i diktaturës.

Diktatura — e domosdoshme për ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Drejtimi i centralizuar i ekonomisë, nevojë objektive që e lind zhvillimi i prodhimit të madh, aq më tepër ai i ekonomisë socialiste ku vepron ligji objektiv i zhvillimit proporcional e të planifikuar të ekonomisë.

Decentralizimi që predikojnë jugosllavët mohon rolin udhëheqës të partisë dhe të diktaturës, minon planifikimin e ekonomisë, thellon diferencat e klasave dhe krijon anarkinë.

«Këshillat punëtorë të vetadministrimit». Shteti grabit punëtorët. Anarki, konkurrencë, shpronësim fondesh.

Lufta e klasave.

Pikëpamjet jugosllave.

Marrëdhëniet tona me Jugosllavinë.

Qëndrimi i Partisë sonë në gjithë këtë situatë.

Detyrat.

E HËNË
11 SHKURT 1957

Ndodh shpesh që drejtues të Partisë e të pushtetit marrin zotime dhe i lënë ato në harresë. Këto zotime për bujë janë shumë të dëmshme, prandaj, në një letër që u nisa komiteteve të Partisë në qarqe e rrethe¹ kritikova me emër disa shokë, që nuk i kanë realizuar zotimet e marra para Kongresit të 3-të të PPSH. Këtë gjendje Komiteti Qendror i Partisë nuk mund ta lejojë. Kudo, dhe veçanërisht para organit më të lartë të Partisë, përpara Kongresit, marrja e zotimeve bëhet me përgjegjësi. Komitetet e Partisë duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë plotësimit të këtyre zotimeve, ta analizojnë menjëherë në byro çështjen dhe të njoftojnë Komitetin Qendror për shkaqet e mosrealizimit të tyre.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 210.

**E MËRKURË
13 SHKURT 1957**

Ngjarjeve në Hungari e Poloni Partia jonë, megjithëse për to nuk e informoi askush, u bëri një analizë marksiste-leniniste dhe tregoi se ajo është shumë e ngritur politikisht dhe e kupton fare mirë zhvillimin e ngjarjeve në botë.

Megjithatë, në kushtet e krijuara tani pas Kongresit të 20-të të PK të BS, ishte e nevojshme t'u bëhej një analizë më e thellë me sy më kritik këtyre ngjarjeve.

Byroja Politike e vlerësoi të domosdoshme ta njohë Partinë me gjykimin e saj për probleme të situatës ndërkombëtare që bien ndesh me disa teza të Kongresit të 20-të të PK të BS. Për këtë qëllim u mblodh Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të Partisë, ku mbajta raportin «Mbi gjendjen ndërkombëtare dhe detyrat e Partisë». Në raport u bëhej një analizë e thellë ngjarjeve të hidhura në Hungari e në Poloni, si dhe situatës së acaruar ndërkombëtare që është krijuar si rezultat i manovrave të imperializmit me atë amerikan në krye dhe i qëndrimeve e veprimeve të revizionistëve

modernë, flamurtarë të të cilëve janë revizionistët jugosllavë.

Byroja Politike ka vendosur që pas Plenumit, raportin e mbajtur në këtë mbledhje ta publikojmë me anë të shtypit dhe të radios. Me siguri do të ketë reagime.

Shokëve sovjetikë dhe të tjerëve mund të mos u vijë mirë, po Partia jonë kështu e ka gjykuar. Sidoqoftë ne si kurdoherë do të mbrojmë me konsekuencë marksizëm-leninizmin.

E SHTUNË
16 SHKURT 1957

Plenumi vazhdon punimet. Sot diskutuam rreth raportit të paraqitur nga shoku Hysni «Mbi disa çështje të bujqësisë: zhvillimi i pambukut, përmirësimi i deles dhe zgjerimi i kulturës së agrumeve». Diskutimet e shokëve ishin shumë të mira, me përmbajtje e nivel të lartë. Preokupimi i të gjithëve, që doli edhe nga diskutimet, është preokupimi i vazhdueshëm i Partisë: përmirësimi i jetës së popullit.

Trajtimi i disa çështjeve bujqësore dhe vendimet përkatëse që mori Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të Partisë duhet të shërbejnë për një kthesë rrënjësore në drejtim të rritjes së prodhimeve. Kjo kthesë do të realizohet në qoftë se për ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave që vuri Plenumi, do të interesohen të gjithë funksionarët e Partisë e të shtetit dhe jo vetëm Ministria e Bujqësisë.

Në diskutimin tim¹ rreth raportit që mbajti shoku Hysni për këtë çështje e vura theksin te propaganda e prodhimit. Për problemet e bujqësisë e të blegtorisë

Ministria e Bujqësisë duhet të përgatitë materiale të thjeshta e të kuptueshme nga punonjësit e këtyre sektorëve, ajo duhet të kërkojë që specialistët e kuadrot të lidhen më mirë me bazën dhe të përfitohet më shumë nga përvoja e përparuar.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 294.

E HËNË

18 SHKURT 1957

Sot në orën 10⁰⁰ kishim mbledhjen e Kuvendit Popullor për shqyrtimin e projektligjit mbi buxhetin e shtetit për vitin 1957 dhe zbatimin e buxhetit për vitin 1956. Mbledhjen e hapi shoku Rita Marko.

E MËRKURË

20 SHKURT 1957

Në aparatën e Komitetit Qendror të Partisë sot prita ambasadorin e Mongolisë.

E SHTUNË
23 SHKURT 1957

Për tri ditë rresht zhvilloi punimet aktivi për bujqësinë i organizuar nga Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave. Në të morën pjesë sekretarë të komiteteve të Partisë të qarqeve e të rretheve, kryetarë të komiteteve ekzekutive, drejtorë të NBSH-ve e të SMT-ve, kryetarë kooperativash, specialistë të bujqësisë e të tjerë. Raportet që u mbajtën në aktiv dhe diskutimet që u bënë me siguri do t'i shërbejnë analizës së drejtë të problemeve të bujqësisë dhe marrjes së masave për realizimin e detyrave të mëdha që qëndrojnë para punonjësve të këtij sektori.

Vajta në pritjen që dha Novikovi¹ në ambasadën sovjetike me rastin e përvjetorit të ushtrisë sovjetike.

1. Në atë kohë atashë ushtarak pranë ambasadës sovjetike në vendin tonë.

E PREMTE
1 MARS 1957

Mora pjesë në mbledhjen e aktivit të Partisë të qytetit të Tiranës me rastin e punimit të materialeve të Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të Partisë dhe fola gjatë për të dy problemet që shqyrtoi Plenumi¹.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 311.

Përfundova artikullin që po shkruaj për «Zërin e popullit», pasi i bëra disa shtesa e redaktime¹.

Për këtë artikull mora shkas nga fjala që ka mbajtur Koça Popoviçi² në Skupshtinën Popullore të Jugosllavisë, ku në mes të tjerash na akuzon «për ndërhyrje të hapët në punët e brendshme të Jugosllavisë» dhe për «nxitje të hapët kundër sovranitetit dhe integritetit tokësor». Dhe pse na bëhen këto akuza? Pse e kritikojmë udhëheqjen jugosllave për tezat e saj antimarksiste e revizioniste ose pse e dënojmë me të drejtë qëndrimin e saj shovinist e çnjerëzor ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Pavarësisht nga ç'thotë Koça Popoviçi, ne kemi plotësisht të drejtë ta dënojmë një politikë të tillë. Qeveria jugosllave paska të drejtë të kujdeset edhe për

1. Është fjala për artikullin «Ne dënojmë qëndrimin shovinist kundër shqiptarëve të Kosovës e Maqedonisë dhe propagandën shpifëse jugosllave kundër vendit tonë». (Gazeta «Zëri i popullit», nr. 72 (2659), 24 mars 1957.)

2. Në atë kohë sekretar i shtetit jugosllav për Punët e Jashtme.

të marrët dhe për të vdekurit e për varrezat e tyre që janë te ne, kurse ne nuk paskemi të drejtë të kujdesemi për të gjallët e të ngremë zërin kundër veprimeve çnjerëzore që po bëhen kundër një milion shqiptarëve të Kosovës e të Maqedonisë! Janë të shumta faktet e hidhura që flasin për këtë politikë çnjerëzore, e që Koça Popoviçi nuk i mbulon dot me akuza e zhurma. Janë pikërisht këto fakte (që i kam numëruar një për një në artikull) që na japin neve të drejtë të kërkojmë të marrë fund kjo gjendje shqetësuese për ne, vëllezërit e shqiptarëve të Kosovës e të Maqedonisë.

Pse nuk flet Koça Popoviçi për masat që po merr udhëheqja jugosllave për ta kthyer Kosovën në një bazë kundër vendit tonë?! Disa, që e konsiderojnë Jugosllavinë si vend socialist, mund të çuditen e të thonë: «Si ka mundësi të ushqejë ajo qëllime të tilla». Çuditen vetëm disa naivë që nuk e dallojnë akoma mirë demagogjinë e udhëheqjes jugosllave. Kurse ne e njohim mirë atë.

Ne e quajmë detyrë, të drejtë të ligjshme dhe nevojë për sigurimin e pavarësisë sonë demaskimin e këtij qëndrimi të udhëheqjes jugosllave dhe të planeve të saj të errëta kundër pavarësisë e integritetit tonë.

E PREMTE**29 MARS 1957**

Sot pasdite bashkë me shokun Hysni pritëm ambasadorin sovjetik Ivanov.

E MARTË**2 PRILL 1957**

Kolektivizimi i bujqësisë është një detyrë e madhe partie dhe shtetërore, për realizimin e së cilës duhet të punojë çdo anëtar partie, çdo njeri që punon e lufton për ndërtimin e socializmit. Kjo është një detyrë që u takon të gjithëve, prandaj në letrën që u dërgova sot¹ komiteteve të Partisë në qarqe e në rrethe dhe gjithë organizatave-bazë të Partisë u bëra thirrje komunistëve, punëtorëve dhe nëpunësve, ushtarakëve, të rinjve dhe të rejave të vënë të gjitha forcat për realizimin me sukses të objektivave që caktoi Kongresi i 3-të i Partisë për kolektivizimin e bujqësisë dhe transformimin socialist të fshatit.

U tërhoqa vëmendjen komiteteve të Partisë në qarqe e në rrethe për përdorimin e shpeshtë të masave administrative në ndërmarrjet ekonomike dhe në dikastere². Nga shqyrtimi i ankesave të punonjësve ka dalë se në shumë raste janë shkelur të drejtat e tyre të

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 338.

2. Po aty, f. 345.

caktuara me ligj. Një gjë e tillë nuk duhet lejuar nga organizatat e Partisë dhe nga bashkimet profesionale. Këto duhet të ndërhyjnë dhe të marrin masa të menjëhershme për ndreqjen e gabimeve. Përdorimi pa vend i masave administrative i sjell dëm të madh punës së Partisë.

ОБРАЗЛОЖЕНИЕ
И РЕШЕНИЕ

**Ë MËRKURË
3 PRILL 1957**

Shokët sovjetikë na kanë kërkuar të dërgojmë në Moskë një delegacion të nivelit të lartë në kuadrin e miqësisë. Vërtet ky të jetë motivi? Apo është reagim, duan të merren vesh me ne për çka deklaruaam e publikuaam në Plenumin e 3-të të Partisë? Të shohim.

Sido që të jetë, nesër delegacioni ynë nisët për në Moskë. Do të nisemi nga Porti i Durrësit, me vapor.

ODESË, E MARTE

9 PRILL 1957

Delegacioni ynë, pas «odisesë» disaditore nëpër dete, sot mbërriti në Odesë. Porsa hymë në ujërat territoriale të Bashkimit Sovjetik, vaporin «Krimea» me të cilin udhëtoi delegacioni ynë, e priti një skuadër prej 5 apo 6 anijesh luftarake të flotës detare sovjetike, që na futi në mes e na shoqëroi deri në port. Pak e habitshme! Na pritën zëvendëskryeministri i Ukrainës, zëvendësministri i parë i Punëve të Jashtme të BS, Patoliçev, drejtues të partisë e të pushtetit të Odesës e shumë autoritete të tjera, si dhe një numër i madh njerëzish me lule e flamurë nëpër duar.

Dita do të jetë e ngjeshur me aktivitetet: drekë, vendosje kurorash në varret e dëshmorëve e ndonjë shfaqje, sepse në darkë do të nisemi për në Moskë.

MOSKË, E ENJTE

11 PRILL 1957

Dje pasdite mbërritëm në Kiev, ku na pritën Kiriçenkoja¹, Kalçenkoja² e të tjerë. Zhvilluam një bisedë të shkurtër e të përzemërt me ta dhe natën vonë u nisëm për në Moskë.

Një atmosferë miqësore akoma më e ngrohtë se në Odesë e në Kiev na priste sot në Moskë. Mijëra banorë të Moskës kishin dalë për të përshëndetur delegacionin tonë. Është një dashuri e sinqertë kjo, që shpreh populli sovjetik për popullin shqiptar, për Partinë dhe udhëheqjen e tij, dashuri e kalitur prej kohësh nga udhëheqësi i tij i paharruar e i lavdishëm, Josif Visarionoviç Stalini.

Në stacionin «Kievski» kishin dalë për të na pritur Hrushovi, Bulganini, Malenkovi, Mikoiani e shumë të tjerë, anëtarë të Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë dhe anëtarë të qeverisë së BS. Një pritje shumë e përzemërt, ndryshe nga herët e fundit kur kemi qenë në Bashkimin Sovjetik; konsideratat që u shprehën për Partinë tonë ishin shumë të larta.

Delegacionin tonë sot e pritën në Kremlin Hrushovi, Bulganini e Voroshilovi.

1. Në atë kohë sekretar i parë i Ukrainës.
2. Në atë kohë kryeministër i Ukrainës.

Në *prim*-in që dha Hrushovi për nder të delegacionit tonë, pra qysh në takimin e parë, pasi vlerësoi dhe ngriti lart vijën e Partisë sonë, ai na tërhoqi vëmendjen për taktikën që duhet të ndjekim ndaj Jugosllavisë, e kur ne e kundërshtuam, na cilësoi gjaknxeh-të (si popull i viseve të Jugut, që jeni, u shpreh ai) dhe tha se «shokët rumunë kanë të drejtë në përcaktimin që ju kanë bërë në «Skënteja» si grindavecë». E kundërshtova rreptë për këtë epitet të rëndë dhe për trajtimin e këtij problemi nga ana e rumunëve.

Në fund të takimit, Hrushovi përsëri theksoi se në marrëdhëniet me Jugosllavinë duhet të jemi më të përmbajtur, të kemi më shumë takt, të mos i përmendim me emër revizionistët jugosllavë, por të flasim për revizionizmin në tërësi si fenomen. Si ta quajmë këtë qëndrim? Paralajmërim?! Sido që të jetë, qëndrimi ynë ndaj revizionistëve jugosllavë është i prerë e i vendosur. Ne do t'i demaskojmë ata kudo e kurdoherë. Të tjerët le të tregohen «të arsyeshëm».

Sot pasdite bëmë takimin e parë qeveritar. Nga ana e sovjetikëve ishin Hrushovi, Bulganini, Mikoiani, Saburovi, Gromiko dhe ambasadori Ivanov. Të parët e morëm ne fjalën. Pasi parashtruam problemet, u krijuan komisionet që do të vazhdojnë punën.

Vizituam dhe vendosëm kurora në Mauzoleun e Leninit e të Stalinit. Mirënjohje e nderim të veçantë ndjeva për këta udhëheqës të lavdishëm të proletariatit, por njëkohësisht edhe emocione të forta.

Në mbrëmje asistua në një shfaqje të bukur në Teatrin Balshoi.

LENINGRAD, E SHTUNË

13 PRILL 1957

Delegacioni ynë është ndarë në dy grupe. Grupi ynë sot në mëngjes mbërriti në Leningrad. Me mua ishin shokët Ramiz e Gogo dhe ambasadori ynë, Mihal Prifti. Grupi tjetër shkoi në Tashkent. Në Leningrad na pritën nxehtësisht Kozlovi, Spiridonovi e të tjerë.

Të shoqëruar nga Pospjelovi, sekretar i KQ të PK të BS, vizituam uzinën e ndërtimit të makinave «Lenin», një uzinë e madhe, 100-vjeçare me rëndësi historike, ku Lenini organizoi rrethet e para të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Na u bë një pritje shumë e bukur, shumë e ngrohtë nga punëtorët e uzinës. Të cilët manifestonin një dashuri të veçantë për popullin tonë. U organizua një miting spontan, ku u grumbulluan rreth 5 000 punëtorë. Në fjalën që mbajta para tyre fola për dashurinë e pastër e të sinqertë që ushqen populli shqiptar për popujt e Bashkimit Sovjetik, për përpjekjet e tij në punën vetëmohuese për ndërtimin e socializmit, për vështirësitë që na nxjerrin armiqtë imperialistë e revizionistë në rrugën tonë. Veçanërisht fola këtu për veprimtarinë armiqësore shoviniste të udhëheqësve jugosllavë kundër vendit e po-

pullit tonë. Hrushovi më dha orientime për këtë çështje, por unë s'mund të mos flisja. Punëtorët më dëgjonin me vëmendje dhe ishin shumë entuziastë.

Pas meje foli edhe Pospjelovi.

LENINGRAD, E DIEL

14 PRILL 1957

Mbrëmë asistua në shfaqjen e baletit «Taras Bulba», në Teatrin e Operës e të Baletit të Leningradit. Para shfaqjes pata një bisedë ose më mirë debat me Pospjelovin, lidhur me fjalimin që mbajta para punëtorëve të uzinës «Lenin» e pikërisht për përcaktimin e veprimtarisë së udhëheqjes së Beogradit. Nguli këmbë që fjala «**armiqësore**» të zëvendësohej, pra, të zbutej ajo pjesë, meqë fjalimi im do t'i jepej shtypit; gjithë e keqja është se «jugosllavët do të zemërohen me ne e do të na akuzojnë se ju nxitim të flisni hapur kundër tyre», kështu më tha Pospjelovi. Më bëri përshtypje të madhe fakti se Pospjelovi u tregua i gatshëm të shtynte orën e fillimit të shfaqjes, kur i thashë që do të ishte mirë ta diskutonim çështjen më vonë.

Porosita shokun Ramiz të ishte vetë prezent kur të bëhej korrigjimi i fjalës «**armiqësore**» me «**antimark-siste**». Ramizi më tha qysh mbrëmë, kur u kthye, se shokët sovjetikë padrejtësisht i kishin hequr të tëra ç'kisha thënë në fjalimin tim për jugosllavët, por më konkretisht këtë e pashë sot në gazetën «Pravda» ku është botuar fjalimi im e ku ajo pjesë ka dalë krejt ndryshe.

Në takimin e afërt që do të kemi me shokët kryesorë të udhëheqjes sovjetike, sikurse kemi vendosur, do t'ua themi hapur përse nuk jemi dakord me ta për problemin jugosllav.

Sot paradite vizituam muzeun «Lenin». Autoblinda prej nga 40 vjet më parë Lenini u foli punëtorëve të Leningradit, ishte vendosur në hyrje të muzeut.

Vizituam gjithashtu muzeun rus me sallat e mëdha të artit të vjetër rus e të artit të shekullit të 18-të.

Vajtëm në pallatin e Smolnit, atje ku jetoi e punoi Lenini i madh në epokën e revolucionit e ku drejtoi shtabin e revolucionit. Dëgjuam të incizuar zërin e tij.

Në librin e përshtypjeve, në mes të tjerash shkrova se populli dhe Partia jonë do t'u qëndrojnë kurdoherë besnikë ideve të pavdekshme të Leninit.

MOSKË, E HËNË

15 PRILL 1957

Sot u zhvilluan bisedimet midis dy delegacioneve, të Partisë sonë dhe të PK të BS.

Me projektdeklaratat e bisedimeve u njohëm para mbledhjes. Për deklaratën e bisedimeve qeveritare nuk kishim ndonjë vërejtje të rëndësishme. Sa për deklaratën tjetër, të delegacioneve të partive, bisedova me shokët dhe vendosëm të insistonim që çështja jugosllave të figuronte patjetër. Shprehja hapur mendimin e Partisë sonë për qëndrimet dhe veprimet e udhëheqjes jugosllave kundër nesh, për çështjen e Kosovës, për përpjekjet e udhëheqjes jugosllave për organizimin e puçit kundër vendit tonë (mbështetja dhe nxitja e Tuk Jakovës kundër PPSH deri te Konferenca e Tiranës). Hrushovi u shpreh për ne se i shikojmë marrëdhëniet me Jugosllavinë me nervozizëm (!), pa perspektivë e se për këtë çështje partitë tona kanë pikëpamje të kundërta. Natyrisht nuk mund të heshtja. Ndërhyrjet e mia e revoltuan Hrushovin aq sa na tha: «Nuk bisedohet me ju, t'i presim bisedimet». U krijua një situatë e rëndë, por ne mbajtëm gjakftohtësinë. I thashë se ndërhyrjet që bëja kishin për qëllim të sqaronin problemin, naty-

risht pa bërë lëshime në çështjet parimore. E ndjeva fort shqetësimin që më vlonte përbrenda, por s'e bëra veten. Nuk më duket aspak e drejtë një sjellje e tillë ndaj Partisë sonë, pse ajo mban qëndrim revolucionar kundër revizionistëve jugosllavë. Lëshimet e shokëve sovjetikë dhe qëndrimet e buta që vazhdojnë të mbajnë ndaj klikës së Titos neve s'na pëlqejnë.

Për rezultatet e bisedimeve, kur të kthehemi në atdhe, do të informojmë me hollësi Byronë Politike dhe Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë¹.

Në fund të bisedimeve, Hrushovi theksoi se kreditë që BS i kishte dhënë vendit tonë për zhvillimin ekonomik e kulturor gjer në fund të vitit 1955, na i kanë falur dhe shtoi se «Shqipërinë do ta bëjmë një kopsht të lulëzuar». Ndihmë internacionaliste që i jepet një vendi të vogël vëlla apo ndihmë prapa së cilës fshihet ndonjë motiv? Ne duam dhe besojmë se kjo është një ndihmë vëllazërore, internacionaliste që na japin neve popujt sovjetikë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 351.

MOSKË, E MËRTË
16 PRILL 1957

MOSKË, E MËRTË
16 PRILL 1957

Në mbrëmje asistua në shfaqjen e operës «Dama Pik» të Çajkovskit, në Teatrin Balshoi.

MOSKË, E MËRKURË**17 PRILL 1957**

Pritja e fundit në pallatin e madh të Kremlinit. Pas ceremonive të rastit, Hrushovi ftoi të vinte pranë nësh ambasadorin jugosllav, Miçunoviç dhe më sugjeroi të bisedoja me të. Me këtë rast i shpreha mendimet tona. Edhe ai më kundërshtonte me «argumentet e tij». Me fjalë të tjera u zumë.

INHO W. KRASHALICH
 17 APRIL 1957

ODESË, E SHTUNË**20 PRILL 1957**

Sot u nisëm nga porti i Odesës për në atdhe. Bashkë me ne erdhi edhe ambasadori Ivanov.

SHËNIMET E LINDUR
21 PRILL 1957

BULLGARI, E DIEË
21 PRILL 1957

Mbërritëm në portin e Varnas. Kishin dalë për të na pritur Zhivkovi e udhëheqës të tjerë të PK Bullgare.

SHËNIMET E LINDUR
22 PRILL 1957

BULLGARI, E HËNË
22 PRILL 1957

Anton Jugovi shtroi sot një drekë për nder të delegacionit tonë.

BULEVARDI E HËNË
29 PRILL 1957

E PREMTE
26 PRILL 1957

Sot u kthyer në atdhe. Në Portin e Durrësit kishte dalë për të na pritur popull i madh.

E ndienim veten si të çliruar nga një ankth. Na kishte marrë një mall i madh për popullin, për njerëzit tanë, për vendin tonë.

Në orën 12⁰⁰ mbërritëm në Tiranë. Bulevardi buçiste nga thirrjet entuziaste të popullit të grumbulluar në të dyja anët e rrugës. Miting i madh i popullit të kryeqytetit, para të cilit fola për vizitën e delegacionit tonë në BS.

BULEVARDI E HËNË
29 PRILL 1957

E HËNË
29 PRILL 1957

Prita sot në mesditë ambasadorin e RP të Kinës me rastin e largimit të tij.

Asistova në mbrëmjen tradicionale të miqësisë shqiptaro-sovjetike që u organizua në Teatrin Popullor në kuadrin e 40-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

E MARTË
30 PRILL 1957

Në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror mbajta raportin që paraqita para tri ditësh edhe në mbledhjen e Byrosë Politike¹ «Mbi vizitën e delegacionit të Partisë dhe të Qeverisë në Bashkimin Sovjetik»². Shokët e Byrosë Politike dhe të Plenumit të KQ u informuan me hollësi rreth bisedimeve që zhvilluam me udhëheqjen e PK të BS.

1. Mbledhja e Byrosë Politike u zhvillua më 27 prill 1957.

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 350.

E MËRKURË
1 MAJ 1957

Manifestimi tradicional i punonjësve të kryeqytetit në bulevardin «Dëshmorët e kombit» vazhdoi rreth një orë e gjysmë. Entuziazmi i papërshkruar i dhjetëra mijë njerëzve që parakaluan para tribunës është një shprehje tjetër e unitetit dhe e dashurisë së madhe të popullit tonë për Partinë e vet të sprovuar, që ndjek dhe do të ndjekë kurdoherë rrugën marksiste-leniniste.

SHKËRIM I
1957

**E SHTUNË
4 MAJ 1957**

Kuvendi Popullor aprovoi rezultatet e bisedimeve midis delegacioneve qeveritare të RP të Shqipërisë e të Bashkimit Sovjetik, që u zhvilluan në Moskë nga 11 deri më 17 prill. Diskutova menjëherë pas mbajtjes së raportit.

**E MËRKURË
8 MAJ 1957**

Sot Nexhmija u nis për në Kinë me delegacionin tonë të Kuvendit Popullor që kryesohet nga shoku Rita Marko.

SHKËRIMET
TË 17 MAJ 1957

E ENJTE
9 MAJ 1957

Asistova në pritjen e dhënë në hotel «Dajti» nga ambasadori i Republikës Çekoslllovae me rastin e festës kombëtare të Çekoslllovakisë. Folëm unë dhe ambasadori çek.

SHKËRIMET
TË 17 MAJ 1957

E SHTUNË
11 MAJ 1957

Shkova në mbledhjen e ushtarakëve shembullorë të Ushtrisë Popullore. Mes entuziazmit të tyre të papërshkruar u fol¹ për sukseset e arritura në fuqizimin e mbrojtjes dhe të ushtrisë sonë dhe për detyrat që u dalin në situatat aktuale. Partia është kujdesur e do të kujdeset vazhdimisht që ushtria të mbetet kurdoherë një armë e dashur e popullit dhe e Partisë, e fortë dhe vigjilente në mbrojtje të lirisë e të pavarësisë së atdheut.

Sot, me anën e një letre², në emër të Komitetit Qendror përgëzova për rezultatet e arritura në kolektivizimin e bujqësisë organizatat e Partisë të rrethit të Vlorës dhe të Bilishtit, që i ngritën kooperativat bujqësore në të gjitha fshatrat. Kjo arritje duhet të bëhet shembull për të gjitha rrethet e tjera të vendit, ndaj kërkova që letra të botohet në «Zërin e popullit»³.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 380.

2. Po aty, f. 371.

3. «Zëri i popullit», nr. 115 (2702), 12 maj 1957.

SHprehje
Të Parë

E DIEL
12 MAJ 1957

Dje pasdite, në sallën e kinoklubit të kombinatit të tekstileve «Stalin» u fola tekstilistëve¹ për detyrat e mëdha që u dalin atyre dhe gjithë punonjësve të vendit tonë për realizimin dhe për tejkalimin e detyrave të planit të shtetit. Megjithëse e re, klasa jonë punëtore ka bërë hapa të mëdhenj përpara, është rritur në numër, është kualifikuar e arsimuar. Ajo punon me entuziazëm dhe e do me shpirt Partinë.

Punëtorët dhe punëtorët e kombinatit i porosita të punojnë më shumë për kualifikimin e tyre, të mirëmbajnë dhe të shfrytëzojnë si duhet makineritë dhe të kursejnë lëndën e parë. Ata u zotuan se do të shtojnë përpjekjet për arritjen e treguesve tekniko-ekonomikë, do të përmirësojnë cilësinë dhe asortimentin e prodhimeve.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 392.

SHprehje
Të Parë

E MARTË
14 MAJ 1957

Bashkë me shokët Spiro Koleka e Haki Toska sot paradite prita zëvendësministrin e Bujqësisë të Bashkimit Sovjetik. Ai shoqërohej nga ambasadori Ivanov.
Në mbrëmje — darkë në Pallatin e Brigadave.

Nesër hapet Kongresi i Parë i Shkrimtarëve dhe i Artistëve të Shqipërisë. Me këtë rast, bashkë me shokët Ramiz Alia, Spiro Koleka, Haki Toska e disa shokë të tjerë, u takuam e zhvilluam një bisedë të ngrohtë me një grup shkrimtarësh e artistësh¹.

Në këtë takim dhashë disa mendime për zhvillimin e arteve e të kulturës te ne. Zhvillimi i tyre duhet të ecë krahas të gjitha realizimeve në vendin tonë, sepse ato janë një nga armët e rëndësishme të Partisë për mobilizimin e masave për ndërtimin e socializmit. Në këtë drejtim duhet menduar më thellë për të sotmen dhe për perspektivën e arteve e të kulturës. Sa është kujdesur Partia për zhvillimin e tyre dhe cilat janë rezultatet?

Është e vërtetë se artet e kultura në vendin tonë kanë ecur përpara, shkrimtarët dhe artistët tanë, nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, kanë bërë përpjekje të shumta dhe i kanë dhënë vepra të mira popullit. Janë bërë hapa përpara jo vetëm në fushën e letërsisë, të

poezisë e të muzikës, ku ne kemi edhe një traditë të mirë, por edhe në pikturë, ku s'kemi pasur ndonjë traditë. Megjithatë, edhe pse e dimë rëndësinë e letërsisë e të arteve, duhet ta kuptojmë edhe më thellë atë e të përpiqemi t'i ndihmojmë më shumë ata që merren me këtë detyrë të rëndësishme.

Shkrimtarët dhe artistët tanë do t'i japin popullit vepra dinjitoze vetëm në qoftë se do të venë në popull e atje të frymëzohen. Vetëm kështu dhe duke ruajtur frymën e pastër të ideologjisë sonë marksiste-leniniste veprat e tyre do të dalin realiste. Këto u theksova shokëve në këtë takim.

Perspektivat e zhvillimit tonë socialist u krijojnë mundësi të mëdha dhe u hapin një fushë të gjerë veprimi edhe shkrimtarëve e artistëve tanë për të vënë në shërbim të popullit aftësitë e tyre. Në këtë drejtim ata duhet të tregojnë kujdes të veçantë e të vazhdueshëm për brezat e rinj, që do të jenë krijuesit e ardhshëm.

Në fund të këtij takimi, në emër të të gjithë shokëve, i falënderova shkrimtarët e artistët tanë duke u uruar suksese dhe i sigurova për ndihmën e vazhdueshme që do t'u japë Partia në punën e tyre.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 424.

E ENJTE

16 MAJ 1957

Në mes gëzimit dhe duartrokitjeve të zjarra, sot në orën 9⁰⁰ u hap në sallën e Kuvendit Popullor, Kongresi i Parë i Shkrimtarëve dhe i Artistëve të Shqipërisë.

Të bëhet zemra mal kur dëgjon shkrimtarët dhe artistët tanë të flasin për rezultatet e punës së tyre. Thua jse të gjithë janë të rinj e të reja, që e zhvilluan talentin gjatë revolucionit popullor e ndërtimit të shoqërisë së re socialiste. Lidhjet e tyre të ngushta me popullin dhe me Partinë janë garanci e sigurt për zhvillimin e gjithanshëm të letërsisë e të artit, për krijimin e veprave me përmbajtje të shëndoshë e nivel të lartë artistik.

E PREMTE

17 MAJ 1957

Duhet të jemi vigjilentë dhe të mos e nënvleftësojmë armikun, që as ka hequr e as do të heqë dorë nga lufta kundër nesh. Shumë armiq kanë dalë nga radhët tona pas Çlirimit, por që të gjithë Partia i ka shpartalluar, sepse përballë vigjilencës dhe forcës së saj përjekjet e armikut janë të destinuara të dështojnë. Tradhtia e Panajot Plakut provon se ndërtimi i socializmit dhe mbrojtja e atdheut nuk mund të sigurohen në mënyrë të qetë, pa luftë. Arratisja ditët e fundit në Jugosllavi e Panajot Plakut, u thashë shokëve të Presidiumit të Kuvendit Popullor¹, që u mblodh sot në orën 14⁰⁰ dhe i hoqi funksionet, gradat, titujt e medaljet këtij tradhtari, ka edhe të mirën e vet, sepse i spastroi radhët tona nga një armik i rrezikshëm, gjë që e forcon më tepër Partinë dhe pushtetin popullor.

1. Procesverbali i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor ndodhet në AQP.

E ENJTE

16 MAJ 1957

Në mes gëzimit dhe duartrokitjeve të zjarra, sot në orën 9⁰⁰ u hap në sallën e Kuvendit Popullor, Kongresi i Parë i Shkrimtarëve dhe i Artistëve të Shqipërisë.

Të bëhet zemra mal kur dëgjon shkrimtarët dhe artistët tanë të flasin për rezultatet e punës së tyre. Thua jse të gjithë janë të rinj e të reja, që e zhvilluan talentin gjatë revolucionit popullor e ndërtimit të shoqërisë së re socialiste. Lidhjet e tyre të ngushta me popullin dhe me Partinë janë garanci e sigurt për zhvillimin e gjithanshëm të letërsisë e të artit, për krijimin e veprave me përmbajtje të shëndoshë e nivel të lartë artistik.

E PREMTE

17 MAJ 1957

Duhet të jemi vigjilentë dhe të mos e nënvleftësojmë armikun, që as ka hequr e as do të heqë dorë nga lufta kundër nesh. Shumë armiq kanë dalë nga radhët tona pas Çlirimit, por që të gjithë Partia i ka shpartalluar, sepse përballë vigjilencës dhe forcës së saj përpjekjet e armikut janë të destinuara të dështojnë. Tradhtia e Panajot Plakut provon se ndërtimi i socializmit dhe mbrojtja e atdheut nuk mund të sigurohen në mënyrë të qetë, pa luftë. Arratisja ditët e fundit në Jugosllavi e Panajot Plakut, u thashë shokëve të Presidiumit të Kuvendit Popullor¹, që u mblodh sot në orën 14⁰⁰ dhe i hoqi funksionet, gradat, titujt e medaljet këtij tradhtari, ka edhe të mirën e vet, sepse i spastroi radhët tona nga një armik i rrezikshëm, gjë që e forcon më tepër Partinë dhe pushtetin popullor.

1. Procesverbali i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor ndodhet në AQP.

SHKURTIM
TË KËMBËRËS

E SHTUNË
18 MAJ 1957

Njoftova me radiogram gjithë ambasadorët dhe ministrat tanë që ndodhen jashtë shtetit për arratisjen në Jugosllavi të tradhtarit Panajot Plaku, agjent i vjetër i jugosllavëve.

Theksova se ky rast duhet të vlejë për të forcuar akoma më shumë vigjilencën revolucionare kundër armiqve të Partisë, për të forcuar edhe më shumë konspiracionin. Porosita që përmbajtja e radiogramit t'u komunikohet organizatave-bazë të Partisë në mbledhjen e tyre të zakonshme.

SHKURTIM
TË KËMBËRËS

E HËNË
20 MAJ 1957

Sot në mbrëmje agjencia jugosllave TANJUG komunikoi arratisjen e Panajot Plakut (agjentit të tyre të vjetër) dhe pohoi se Jugosllavia i dha atij strehim politik.

Mendoj t'i bëjmë qeverisë jugosllave një notë të shkurtër me gjakftohtësi, duke ruajtur edhe të gjitha format diplomatike, ku t'i kërkojmë kthimin e këtij tradhtari. Për këtë do të bisedoj edhe me shokët. Notën duhet ta bëjmë, sepse s'kam asnjë dyshim që tradhtarin Panajot Plaku jugosllavët do ta përdorin për qëllimet e propagandës së tyre kundër vendit tonë¹.

1. Pasi u arratis, tradhtari Panajot Plaku vulli vrer kundër Partisë e vendit tonë nëpërmjet një të ashtuquajturë radio klandestine.

E PREMTE
24 MAJ 1957

Kam përshtypjen, dhe këtë e theksova edhe sot në diskutimin tim në mbledhjen e Sekretariatit¹, se organet shtetërore nuk interesohen sa duhet për forcimin e punës në kooperativat bujqësore. Me këtë dhe me çështjen e grumbullimit më tepër merren komitetet e Partisë, gjë që nuk është aspak e drejtë. Këto detyra u takojnë organeve të pushtetit dhe Partia duhet t'u kërkojë këtyre llogari për kryerjen e tyre. Komitetet e Partisë të luftojnë çdo shfaqje të burokratizmit dhe të punojnë për edukimin ideopolitik të punonjësve të organeve shtetërore, për forcimin e disiplinës dhe mobilizimin e tyre në punë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 450.

E HËNË
27 MAJ 1957

Më duket shumë e mirë iniciativa që është marrë në Presidiumin e Kuvendit Popullor për të analizuar herë pas here gjendjen e këshillave popullorë të rretheve të ndryshme të vendit. Këshillat popullorë janë organe lokale të pushtetit shtetëror, prandaj kjo analizë që i bëhet punës së tyre ndihmon për forcimin e mëtejshëm të pushtetit në bazë.

Sot kishim mbledhjen e Presidiumit. Në pikën e parë të rendit të ditës diskutuam mbi gjendjen e këshillave popullorë të qarkut të Elbasanit. Në diskutimin tim, duke marrë shkas nga kjo analizë, theksova disa nga shkaqet që çojnë në mosfunksionimin në rregull të këtyre këshillave.

Më duket se në metodën dhe stilin në punë të këshillave popullorë ka formalizëm dhe burokratizëm, gjë që pengon gjallërimin e pushtetit, prandaj në to duhet futur një frymë më luftarake, që pushteti të jetë në gjendje të përballojë detyrat e qeverisjes së vendit. Këta këshilla nuk ecin në rregull edhe për faktin se nënvlerësohen. Nga kush? Deri edhe vetë kryetari i komitetit ekzekutiv të qarkut ose të rrethit i nënvlerëson rolin

dhe funksionin e tyre, përderisa nuk e organizon punën në mënyrë të tillë që këshillat të ushtrojnë kompetencat ligjore për zgjidhjen e problemeve që u takojnë. Kjo bën që aktivizimi i këshillave të jetë formal. Mirëpo në pushtetin tonë popullor nuk mund të durohet formalizmi. Këtë e theksova me forcë në diskutimin tim.

Në fund shpreha edhe shqetësimin që kam lidhur me ligjshmërinë socialiste, se mos ndoshta, pa dashur, kemi rënë në një burokratizëm juridik, duke i rënduar ligjet aq sa të na krijohet një «pyll» i dendur me norma ligjore që edhe vetë juristët e kanë vështirë t'i kuptojnë. Unë mendoj se shumë norma ligjore duhen thjeshtuar.

Sot paradite prita doktorin e shkencave filologjike, prof. Jermilov si dhe një poet dhe një kompozitor sovjetik që morën pjesë në Kongresin e Parë të Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

Pasdite prita një grup shkrimtarësh nga Kina, Bullgaria, Çekoslovakia e Hungaria, një piktor rumun dhe shkrimtarin francez Andre Vurmser, redaktor i gazetës «Ymanité».

E MARTE
28 MAJ 1957

Nëpërmjet radios mësova se sot Hrushovi ka pritur në Kremlin një grup korrespondentësh dhe bashkëpunëtorësh të një shoqërie amerikane të radiotelevizionit të cilëve u dha një intervistë për politikën e jashtme e të brendshme të Bashkimit Sovjetik, për gjendjen ndërkombëtare dhe marrëdhëniet sovjeto-amerikane.

Hrushovi shprehet se BS e ka kaluar Amerikën në disa sektorë, e se do ta kalojë, sidomos, në bujqësi! Ashtu qoftë! Por një gjë më bën përshtypje jo të mirë: si shumë propagandë po bën shoku Hrushov për konkurrencën me Amerikën.

Prita ambasadorin e Republikës Popullore të Bullgarisë.

E DIEL
2 QERSHOR 1957

Në Konferencën kombëtare për zhvillimin dhe përmirësimin e blegtorisë dhe problemin e bonifikimit të tokave që u hap dje në Tiranë, sot vazhduan diskutimet. Diskutuan mirë shumë shokë brigadierë, kryetarë kooperativash blegtorale, specialistë, veterinerë, zooteknikë e të tjerë, të cilët folën për ndikimin e madh që ka ushtruar në ekonominë e vendit tonë vendimi që mori në shkurt të këtij viti Plenumi i 3-të i KQ të Partisë për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë. Ata folën, gjithashtu, për interesimin e madh që ka ngjallur ky Plenum në masat e gjera të popullit dhe veçanërisht në blegtorët.

Edhe unë isha përgatitur për të folur. Diskutova¹ gjatë dhe vura në dukje rëndësinë e blegtorisë, si dhe kujdesin që duhet treguar për të.

Për sa i përket bonifikimit të tokave ngrita nevojën e kuptimit nga ana e fshatarëve të rëndësisë së madhe të këtij problemi, si dhe për mobilizimin e krahëve të punës që të përmirësohen tokat.

Diskutimet me vlerë dhe eksperiencë që u këmbye në konferencë janë premtuese. Të luftojmë për zbatimin e detyrave.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 14, f. 461.

E MARTË
18 QERSHOR 1957

Është me të vërtetë i çuditshëm qëndrimi mendjelehtë i disa shokëve në dikastere që bëjnë raporte pa përgjegjësi dhe i dërgojnë në udhëheqje pa analizuar shkaqet e disa fenomeneve negative që duken në punë dhe pa u shqetësuar për masat që duhet të marrin për përmirësimin e gjendjes.

Konkretisht sot lexova një raport të një shoku të Ministrisë së Bujqësisë për ngordhjen e disa deshve krejt për arsye të trajtimit të keq të tyre. Në vend që ai të merrte masa për të parandaluar dëmin, na propozonte neve që ta bënim këtë punë, ndërsa deshtë vazhdojnë të ngordhin!

Ky qëndrim burokratik është i palejueshëm, prandaj e paralajmërova personin zyrtar, se po nuk u angazhua plotësisht në punën që i përket të bëjë, do të merren masa të rrepta. Secili të kryejë detyrën që i është ngarkuar.

Asistova në mbledhjen solemne kushtuar 75-vjetorit të lindjes së udhëheqësit të madh të popullit bullgar

dhe të lëvizjes punëtoare ndërkombëtare, Gjergj Dimitrovit. E kam njohur nga afër Dimitrovin dhe ruaj për të mirënjohjen dhe respektin më të thellë. Ai ka qenë një mik i singertë e besnik i popullit tonë dhe si një nga drejtuesit e Kominternit e ka ndihmuar singërisht zhvillimin e lëvizjes komuniste në vendin tonë.

17

Bashkë me shokun Ramiz Alia prita delegacionin e arsimtarëve sirianë që kanë ardhur për vizitë në vendin tonë. Bisedë e përzemërt.

E PREMTE
21 QERSHOR 1957

travët. E kam detyrë që të bëj një vizitë në
për të cilën kam marrë pjesë në të gjitha
qendrat e punës në të gjitha qendrat e punës
në të gjitha qendrat e punës në të gjitha
qendrat e punës në të gjitha qendrat e punës
në të gjitha qendrat e punës në të gjitha
qendrat e punës në të gjitha qendrat e punës

E HËNË

24 QERSHOR 1957

• Pasdite prita në Komitetin Qendror delegacionin e
Partisë Komuniste Franceze të kryesuar nga Zhanetë
Vermesh që erdhi për vizitë në vendin tonë.

E MARTË

25 QERSHOR 1957

Zhvilluam bisedimet me delegacionin e PK Fra-
nceze.

E ENJTE
4 KORRIK 1957

Agjencia TASS njoftoi sot se më 22-29 qershor është mbledhur Plenumi i Komitetit Qendror të PK të BS në lidhje me veprimtarinë «antiparti e fraksioniste të grupit Malenkov, Kaganoviç, Molotov». Plenumi ka vendosur përjashtimin e tyre nga Presidiumi dhe nga Komiteti Qendror i Partisë. Sipas TASS-it personat në fjalë «kanë synuar të ndryshojnë vijën politike të partisë; kanë qenë në kundërshtim me politikën e partisë të aprovuar në Kongresin e 20-të, kanë kundërshtuar politikën leniniste të bashkekzistencës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore, uljen e tensionit» etj., etj.

Nuk mund ta mendoja që këta ish-bashkëluftëtarë të Stalinit të përfundonin kështu(!).

Njoftohet se plenumi ka zgjedhur anëtar të Presidiumit edhe Leonid Brezhnëvin. Më kujtohet që jam takuar me të në Kongresin e 20-të dhe më ka lënë përshtypjen e një njeriu të ngrysur, të rëndë e mendjemadh. Shumë lart u ngrit ky njeri.

Këto që po ngjasin në radhët e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, duhet të na shërbejnë për të

kalitur gjithnjë e më shumë vigjilencën revolucionare, unitetin e mendimit e të veprimit të udhëheqjes sonë e të gjithë Partisë, unitet i bazuar në marksizëm-leninizmin. BS po futet në një rrugë të rrezikshme.

E DIEL
7 KORRIK 1957

Së bashku me shokët e tjerë të udhëheqjes së Partisë e të shtetit shkuam në stadiumin kombëtar «Qemal Stafa» për të parë ceremoninë e hapjes së spartakiadës së rinisë dhe të studentëve.

E PREMTE
12 KORRIK 1957

Në mbyllje të punimeve të Plenumit të 6-të të Komitetit Qendror të Partisë fola kryesisht për disa probleme të trajtimit e të përgatitjes së kuadrove¹.

Siç doli edhe në Plenum, me gjithë sukseset e arritura, në përgatitjen e kuadrit jemi akoma shumë prapa. Ne kemi një rrjet të gjerë për edukimin e kuadrove, por, kam përshtypjen, që komitetet e Partisë, në radhë të parë, si dhe komitetet ekzekutive nuk interesohen sa duhet, ose interesohen shumë pak për këtë çështje. Një gjë e tillë duhet korigjuar sa më parë, se pa interesimin e Partisë dhe të pushtetit në bazë nuk mund të ecet përpara në përgatitjen e kuadrit.

Me kuadrin duhet ndjekur një politikë e drejtë, e zgjuar, elastike. Kuadrove duhet t'u kërkojmë llogari për punën, t'i kritikojmë për të metat, por edhe t'i lavdërojmë për sukseset. Puna me ta është shumë e zorshme, ajo kërkon takt dhe duhet bërë e diferencuar, sepse njerëzit nuk janë të gjithë njëllorj. Kuadrot nuk punojnë, nuk ndiejnë, nuk binden dhe nuk i kuptojnë

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 1.

të tëra çështjet njëlloj. Në qoftë se kjo mbahet kurdoherë parasysh, atëherë nuk do të gabojmë, nuk do të biem as në oportunitizëm e as në sektarizëm dhe do t'i ndihmojmë kuadrot të japin më shumë.

17 KORRIK 1957

...

...

17 KORRIK 1957

MOSKË, 17 KORRIK 1957

**MOSKË, E MËRKURË
17 KORRIK 1957**

U bënë ditë që bashkë me Nexhmijen ndodhemi për pushime në Bashkimin Sovjetik. Kemi marrë vesh se këto ditë këtu kanë ardhur për pushime edhe Zhivkovi me të shoqen, por edhe... Rankoviçi e Kardeli me gratë!

...

MOSKË, E PREMTE

19 KORRIK 1957

Mbrëmë ishim në një *priom* të ftuar nga Hrushovi. Në këtë *priom* ishin ftuar edhe Zhivkovi, Rankoviçi e Kardeli me bashkëshortet e tyre. (Hrushovi më kishte thënë para nja dy ditëve se në këtë darkë ishin ftuar edhe këta.) As mua, as Nexhmijes nuk na erdhi mirë e s'kishim dëshirë të uleshim në tavolinë me jugosllavët, por s'kishim ç'bënim dhe vajtëm.

Gjatë darkës, ndërsa Hrushovi fliste me jugosllavët gjithë thirrje e gjeste, unë me titistët nuk shkëmbeva asnjë fjalë, përveç një rasti që i ktheva përgjigje Rankoviçit, kur ky na akuzoi ne, shqiptarët, se nuk i paskemi lënë rehat ata. Isha i acaruar dhe, meqë më doli në shteg, nuk e lashë pa ia numëruar të gjitha poshtërsitë që kanë kurdisur e organizuar kundër nesh. Tërë kohën, pas kësaj, edhe unë edhe Nexhmija, biseduam vetëm me Kiriçenkon që e kishim afër dhe që nuk la gjë pa thënë kundër jugosllavëve.

U larguam nga ky *priom* me përshtypje jo të këndshme. Për më shumë, ç'ishte ai leksion që na mbajti Hrushovi për miqësinë që duhet të ekzistojë në mes Bashkimit Sovjetik—Shqipërisë—Jugosllavisë e Bullgarisë?!

MOSKË, E HËNË

22 KORRIK 1957

Ditët e pushimeve po kalojnë, por unë akoma s'kam filluar të pushoj.

Pardje Andropovi erdhi më solli letrën që agjenti i UDB-së, Panajot Plaku, i ka dërguar Hrushovit. Më tha se ata (sovjetikët) nuk kanë diskutuar mbi letrën. Jo pa qëllim e pyeta se kur e kanë marrë këtë letër, se ajo është shkruar nga spiuni Panajot Plaku qysh më 15 qershor. «Para 10 ditësh e morëm», — m'u përgjigj Andropovi. I thashë me një ton të ashpër, bile e theksova dy herë, se letra duhet t'i kthehet dërguesit sa më parë. «Ky është mendimi im, — i thashë Andropovit, — po Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik le të veprojë si të dojë, ajo është punë e tij». M'u përgjigj se do t'ia raportonte Hrushovit pikëpamjen time.

Është e qartë se letra demaskon vetë jugosllavët dhe agjentin e tyre të fëlliqur Panajot Plakun, por mund të them se demaskon edhe ata të cilëve u drejtohet. Tash asgjë s'më habit.

Sidoqoftë, duhet me qenë vigjilentë dhe me mbajtur gjakftohtësinë. Nuk duhet me u nervozu. Të tilla posh-

tërsi kemi dëgjuar shumë dhe kemi eksperiencë boll për t'ua shtypur kokën armiqve të Partisë dhe të popullit.

Sot më vizituan mjekët dhe më gjetën mirë. Nesër do të filloj të ndryshoj ilaçet që përdorja deri tash.

MOSKË, E SHTUNË
3 GUSHT 1957

Hrushovi me Titon u takuan në Bukuresht, në krye të dy delegacioneve. Ata kanë rënë dakord për shumë probleme, si për çështjet kryesore të gjendjes së tanishme ndërkombëtare, për format konkrete të bashkëpunimit në mes dy partive, për mbajtje të lidhjeve të përhershme midis tyre etj. Ç'politikë është kjo e udhëheqësve sovjetikë?!

Për marrëdhënie më të mira me popujt e Jugosllavisë dhe me Jugosllavinë edhe ne kemi qenë e jemi, por revizionistëve nuk u bëjmë kurrë lëshime. Kurse udhëheqësit sovjetikë kanë tjetër mendim; ata e gjykojnë ndryshe çështjen. Sidoqoftë, kjo është punë e tyre, kurse ne nuk lëvizim nga jona.

MOSKË, E HËNË
5 GUSHT 1957

Sot pasdreke në Komitetin Qendror të PK të BS, Kusineni, Suslovi dhe Ponomarjovi më informuan për bisedimet e zhvilluara në mes delegacionit sovjetik dhe atij jugosllav në Bukuresht. Llaptievi bënte përkthyesin. Pastaj erdhi shoku Hrushov e më foli edhe ai rreth një orë.

Për bisedimet sovjeto-jugosllave:

Në mes problemeve të tjera, për të cilat kishin rënë dakord e që i ka publikuar edhe TASS-i, kishin diskutuar edhe çështjen e marrëdhënieve të Jugosllavisë me Partinë tonë, me atë çekosllovake dhe me bullgaren. Hrushovi më tha se Titoja ishte shprehur se «me këto tri parti nuk kemi marrëdhënie të mira, mbasi atje janë në udhëheqje stalinistë konservatorë». «Ne ju mbrojtëm, — tha Hrushovi, — por s'mund t'ju mbroja në çdo rast dhe pohova përpara jugosllavëve, — vazhdoi ai, — se shqiptarët janë treguar ca gjaknxehtë, bile ne i kemi këshilluar për këtë çështje!» Bukur na paskan mbrojtur(!).

Partia jonë, më thanë shokët sovjetikë, do të vazhdojë përpjekjet për forcimin e marrëdhënieve me ju-

gosllavët në të gjitha çështjet, edhe në çështje partie, dhe nuk do t'i vërë në plan të parë mosmarrëveshjet ideologjike. Këtë e këshillojmë edhe për partitë e tjera motra.

U përgjigja se edhe ne jemi për marrëdhënie shtetërore të mira me jugosllavët, pa bërë asnjë lëshim në çështjet parimore. Por theksova se ne ndaj tyre do të jemi kurdoherë vigjilentë për mbrojtjen e pavarësisë dhe sovranitetit dhe nuk do të lejojmë askënd të ndërhyjë në punët e brendshme të Partisë e të popullit tonë. Këtu fola për propagandën jugosllave kundër Partisë e vendit tonë, si dhe për punën e tyre agjenturore kundër nesh.

Jugosllavët thanë se nuk bëjnë punë spiunazhi, — tha Hrushovi, — dhe mund të besohet se do ta pakësojnë, por edhe do të bëjnë, prandaj mirë bëni që jeni vigjilentë!

Për ardhjen e Zhukovit në Shqipëri.

Hrushovi më tha se mareshali Zhukov, i cili do të vejë në Jugosllavi, do të vijë edhe në Shqipëri për vizitë. Më gëzoi lajmi për vizitën e Zhukovit, të cilin e vlerësojmë ashtu siç e ka vlerësuar Stalini i madh, si një strateg të luftës heroike të popullit sovjetik, si një kua-dër të vjetër të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por më bëri përshtypje reagimi që shkaktoi te Hrushovi gëzimi që shpreha në këtë rast. «Shikoni Enverin sa i gëzuar është që do të vejë Zhukovi», — u tha ai shokëve.

Në fund më foli për letrën që i ka drejtuar Panajot Plaku. I shpreha mendimin tim e të Partisë sonë se Panajot Plaku është një tradhtar i fëlliqur i çështjes së

Partisë e të popullit e se arratisja e tij nuk është e rastit, gjë që del fare qartë edhe nga kjo letër e tij. Të gjitha ato që ngre tradhtari në letrën drejtuar Hrushovit, s'janë gjë tjetër veçse teza të vjetruara të jugosllavëve, të Tuk Jakovës, të Bedri Spahiut e të atyre që janë kundër Bashkimit Sovjetik.

Kur i fola Hrushovit për qëndrimin tonë, për internacionalizmin tonë, për dashurinë që na ka ushqyer Partia jonë për popujt sovjetikë, Hrushovi më tha me të qeshur: «Mos na merr edhe ne për agentë të jugosllavëve»(!).

Për këto probleme kur të kthehem në Shqipëri do të bisedoj gjërë e gjatë me shokët.

Në spital më mbajtën 10 ditë. Prova doli me sukses e insulinë tash nuk bëj më, por do të marr hape nga goja. Nesër në mëngjes do të nisem me avion për në Kislovodsk, ku do të pushoj.

E HËNË

2 SHTATOR 1957

Molotovin e emëruan ambasador të Bashkimit Sovjetik në Mongoli. Parapension të jetë ky emërim, apo egzil në Ulan-Bator?!

E MËRKURË
11 SHTATOR 1957

Gomulka me Cirankieviçin, Rapackin e të tjerë dje arritën në Beograd për vizitë, të ftuar nga Titoja. Ky bashkë me Stamboliçin i priti në aeroportin e Zemunit.

E HËNË
16 SHTATOR 1957

Në mes entuziazmit të papërshkruar të studentëve dhe pedagogëve inauguroam Universitetin Shtetëror të Tiranës. Me ngritjen e universitetit Partia bëri realitet ëndrrën e rilindësve tanë të shquar, dëshirën e zjarrtë të popullit tonë për dije e kulturë. Kjo është një ngjarje e madhe për popullin, që na ka gëzuar të gjithë. Universiteti Shtetëror i Tiranës është qendra më e rëndësishme kulturore e shkencore, që do t'i hapë rinisë së vendit tonë perspektiva të shkëlqyera në fushën e diturisë e të shkencës.

Pas mbledhjes solemne që u organizua me këtë rast në sallën e Teatrit të Operës dhe të Baletit, shkuam në korpusin kryesor të universitetit. Preva shiritin e inaugurimit dhe të gjithë së bashku vizituam sallat dhe laboratorët e ndryshëm.

SHKRUAR NË
20 SHTATOR 1957

E PREMTE
20 SHTATOR 1957

Një delegacion parlamentar sirian ndodhet për vizitë në vendin tonë. E prita sot në Komitetin Qendror dhe pata me të një bisedë të ngrohtë.

SHKRUAR NË
26 SHTATOR 1957

E ENJTE
26 SHTATOR 1957

Prita pjesëtarët e Ansambllit të Këngëve e Valleve të Armenisë që ndodhet këtu prej disa ditësh. Zhvillova me ta një bisedë dhe i përgëzoza për koncertet e bukura që kanë dhënë.

SHKËMBI I
TERRI KOPATASHI M

E HËNË
30 SHTATOR 1957

Çështja që morëm sot në analizë në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi zbatimin e legjislacionit të punës është shumë e rëndësishme. Më shqetëson fakti përse ndodh që shkelet legjislacioni? A duhet lejuar që nga burokratizmi i punonjësve të administratës të shkelen të drejtat e punëtorëve? Jo, në asnjë mënyrë. Si është e mundur që na aksidentohen disa punëtorë për shkak se shkelen rregullat e sigurimit teknik dhe prokuroria nuk merr masa për të ndjekur penalisht personat fajtorë?! Po ç'bën organizata e bashkimeve profesionale në këto drejtime? Si i ka mbrojtur ajo të drejtat e punëtorëve e të nëpunësve që janë të garantuara me ligj? Më duket se kjo organizatë nuk punon në masën e duhur që Kodi i Punës të njihet nga të gjithë punëtorët e nëpunësit. Në këtë drejtim si Prokuroria e Përgjithshme ashtu edhe organizata e bashkimeve profesionale duhet t'i kryejnë më mirë detyrat që u takojnë. Këtë e theksova me forcë në diskutimin tim.

SHKËMBI I
TERRI KOPATASHI M

E MARTË
1 TETOR 1957

Prita paradite kryetarin e Komitetit Ekzekutiv të Odesës, Llavdishenko.

Drekë për nder të tij.

Asistova në pritjen që dha ambasadori kinez Lo Shi Gao në hotel «Dajti» me rastin e festës së republikës.

Prita sot, me kërkesën e tyre, pesë fshatarë nga katundi Ballaj i lokalitetit të Kryevidhit të rrethit të Durrësit. Kishin disa ankesa ndaj kryetarit të lokalitetit i cili, sipas pretendimeve që bënë ata, ka ushtruar presion për t'i futur në kooperativë jashtë vullnetit të tyre.

Pasi dëgjova me vëmendje secilin prej tyre, u thashë se Partia e inkurajon dhe e përkrah kolektivizimin e bujqësisë. E ardhmja e bujqësisë janë kooperativat bujqësore, që e ngrenë nivelin e jetesës së fshatarit dhe shpejtojnë ecjen e vendit në rrugën e socializmit, prandaj i këshillova të mendohen mirë dhe të mos ndahen nga bashkëfshatarët e tyre. Por, u thashë fshatarëve, se Partia e shtron çështjen e kolektivizimit vetëm mbi baza vullnetare, me metodën e bindjes dhe pa asnjë detyrim. Prandaj, në qoftë se ndaj tyre është përdorur kërcënim nga kryetari i lokalitetit, se po të mos futen në kooperativë do të cilësohen kulakë etj., është vepruar gabim dhe jo në bazë të vijës së Partisë.

Për ta sqaruar çështjen mora përsipër t'ua plotësoja kërkesën fshatarëve për të dërguar pa vonesë në vend një shok nga aparati i Komitetit Qendror.

Nuk isha dakord dhe e kundërshtova propozimin që u bë në mbledhjen e Byrosë Politike për uljen e çmimit të tepricave që fshatarësia i shet shtetit¹. Fshatarësia me siguri nuk do ta mirëpriste një vendim të tillë në këto kushte. Pastaj është fakt, që edhe me çmimet e tanishme të blerjes së tepricave nga shteti, plani i grumbullimit të tyre nuk është realizuar asnjëherë. Ngri-tja e çmimeve për detyrimet e fshatarësisë mendoj se do të ndihmojë edhe për grumbullimin e tepricave me çmimet aktuale.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 25.

Shokët më njoftuan se kishin ardhur 8 fshatarë nga fshati Zimur i rrethit të Peshkopisë, që kërkonin të takoheshin me mua. I pritja menjëherë.

Pasi u përshëndetëm filluam një bashkëbisedim të përzemërt. Ata më folën për familjet e tyre, për të ardhurat që realizojnë dhe për ndryshimet e fshatit dhe të rrethit të tyre në këto pak vjet të pasçlirimit. Më ngritën edhe problemin e ujit të Zimurit që mendohej t'i jepej Peshkopisë, por ata sugjeruan që uji për qytetin mund të merrej diku më larg, mbi fshatin e tyre.

Gjatë bisedës së ngrohtë që pata me ta u vura në dukje fshatarëve dibranë se përparimet që kishin bërë ishin të mira, por nuk duhet të kënaqeshin me ato që kanë arritur. Partia ka plane të mëdha për forcimin e ekonomisë, për ndërtimin e socializmit dhe për ngritjen e nivelit të jetesës së fshatarësisë e të mbarë popullit. U fola për mundësitë e shumta që kemi për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, për naftën tonë me perspektivë, për situatën e brendshme dhe të jashtme etj.

Për sa i përket ujit të Zimurit u mora përsipër

të bisedoj që nesër me drejtuesit e rrethit të Peshkopisë që fshati i tyre të mos mbetet pa ujë dhe qyteti i Peshkopisë gjithashtu t'i plotësojë nevojat e tij, duke gjetur një zgjidhje të arsyeshme.

Ata më dëgjuan me vëmendje dhe u larguan të kënaqur.

E ENJTE

17 TETOR 1957

Sot erdhi për vizitë në vendin tonë mareshali Zhukov, ministër i Mbrojtjes i Bashkimit Sovjetik, kuadër i vjetër i Partisë Bolshevike e Hero i Ushtrisë së Kuqe. Dolëm e pritëm në aeroport. Para se të vinte këtu, Zhukovi kishte qenë për vizitë në Jugosllavi.

Në mesditë e prita në Komitetin Qendror, ku zhvilluam një bisedë për probleme të ndryshme. Në mes të tjerave Zhukovi na tha se me ato që kishte parë në Jugosllavi, nuk e merrte vesh se ç'vend socialist është ajo. Thuaia shokut Hrushov, — i thashë me të qeshur, — se ai nuk mendon kështu për Jugosllavinë.

E MËRKURË
23 TETOR 1957

Zhukovi gjatë këtyre ditëve bëri disa vizita në vendin tonë, si në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Vlorë e Korçë.

Sot për nder të tij dhamë një pritje në Pallatin e Brigadave. Fola unë, foli dhe Zhukovi.

V MËRRKURË
24 TETOR 1957

E ENJTE
24 TETOR 1957

Paradite vizituum aeroplanin Tu-104, aeroplani i parë reaktiv për pasagjerë.

Është vërtet një ndër realizimet e mrekullueshme të shkencës dhe të teknikës sovjetike.

Asistova në pritjen që dha ambasadori Ivanov në hotel «Dajti» për nder të ministrit të Mbrojtjes së BS, mareshalit Zhukov.

Pas pritjes koncert.

E SHITHË
25 TETOR 1957

E PREMTE
25 TETOR 1957

Bashkë me shokët Hysni e Haki pritëm në Komitetin Qendror të Partisë delegacionin e veteranëve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ish-pjesëmarrës në Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit, ish-luftëtarët dhe bashkëpunëtorët e Leninit e të Stalinit. Gjatë takimit, i cili u zhvillua në një atmosferë shumë të ngrohtë e miqësore, ata na treguan gjëra interesante për bashkëpunimin e tyre me Leninin e madh.

E SHTUNË
26 TETOR 1957

Përcollëm në aeroport mareshalin Zhukov. Por, sitë thuash, ndërsa aeroplani, në të cilin ai kishte hipur vazhonte të fluturonte në drejtim të Moskës, TASS-i njoftonte se Presidiumi i Sovjetit Suprem të BS e kishte shkarkuar Zhukovin nga detyra e ministrit të Mbrojtjes të Bashkimit Sovjetik dhe se në vend të tij kishte emëruar mareshalin Malinovski¹!

Më habiti shumë fakti që një vendim kaq i rëndësishëm e për një person që ishte edhe anëtar i Presidiumit të KQ të PK të BS merret kur ai ndodhej për vizitë jashtë vendit. Pavarësisht cilat janë arsyet e motivet, mënyra e shkarkimit është krejtësisht antidemokratike; bie erë puçi.

Për Zhukovin dimë që ka qenë një nga gjeneralët e shquar sovjetikë, kuadër i vjetër i Partisë Bolshevike, Hero i Bashkimit Sovjetik. Ai ka drejtuar armatat e Ushtrisë së Kuqe, të cilat nën komandën e tij çliruan Berlinin. Si strateg ka qenë bashkëpunëtor i afërt i

1, Zhukovi mbërriti në Moskë më 26 tetor 1957, dhe po në këtë datë u shpall vendimi i Presidiumit të Sovjetit Suprem për shkarkimin nga posti i ministrit të Mbrojtjes të BS.

Stalinit. Por dimë edhe që për gabime Stalini ka mbajtur qëndrim ndaj tij.

Gjatë qëndrimit në vendin tonë, ai u tregua miqësor. Nuk tregoi asnjë shenjë se pozita e tij në BS ishte në rrezik.

TETOR 1957

28 Nëntori, Dita e Flamurit, po afron. Në këtë 28 Nëntor mbushen plot 45 vjet që nga Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ngritja e flamurit në Vlorë. Festimi me madhësi të kësaj date të shënuar është detyrë patriotike për të gjithë ne. Për këtë qëllim organizuam mbledhjen e një komisioni¹ që do të merret me përgatitjet e festimit të këtij përvjetori. Ishte emocionuese prania në këtë mbledhje e disa prej atyre patriotëve që kishin marrë pjesë në këtë ngjarje të shënuar për popullin tonë.

Propozuam një sërë aktivitete që do të zhvillohen në të gjithë vendin me këtë rast, caktuam datën e mbledhjes solemne që do të bëhet në Tiranë (27 nëntor), të mitingut të madh që do të organizohet në Vlorë, detyrat e shtypit etj.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 107.

E ENJTE
31 TETOR 1957

Sot prita një shqiptar¹ të kthyer nga Australia dhe zhvillova me të një bisedë të ngrohtë e të këndshme². Ishte i përmalluar për atdheun, ashtu siç janë tërë shqiptarët e ndershëm që ndodhen në mërgim. Varfëria i detyroi të linin atdheun e familjet, të merrnin rrugën e kurbetit e të punonin si robër në vende të huaja.

Ishte shumë i entuziazmuar nga përparimet që ka bërë atdheu ynë, të cilin ai nuk e kishte parë qysh prej 20 vjetësh. Të gjitha këto, i thashë i ka bërë forca e popullit dhe drejtësia e vijës së Partisë.

Shprehu dëshirën të qëndrojë këtu përgjithmonë bashkë me familjen.

1. Eqrem Gjata.

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 97.

**E SHTUNË
2 NËNTOR 1957**

Realizimi dhe tejkalimi i detyrës për përmirësimin racor të dhenve provon drejtësinë e vendimit të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë në shkurt të këtij viti për këtë problem. Ky rezultat, që tregon forcën bindëse dhe lidhjet e ngushta të Partisë me masat, u arrit në sajë të punës e të mobilizimit të organizatave-bazë, të organeve të Partisë e të pushtetit, të specialistëve dhe të të gjithë punonjësve të bujqësisë për të bërë realitet fjalën e Partisë. Të gjithë këta i përgëzova në emër të Komitetit Qendror me anë të një letre drejtuar komiteteve të Partisë të disa qarqeve e rretheve¹. Në këtë letër theksova edhe disa nga detyrat kryesore që shtrohen tani para organizatave të Partisë e organeve të pushtetit për shtimin dhe përmirësimin racor të bagëtisë.

Mbledhje solemne me rastin e 40-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit. Fjalimin e rastit e mbajta unë. Midis të tjerave theksova rëndësinë historike ndërkombëtare të kësaj ngjarjeje, që do të mbetet një datë e shënuar në historinë e njerëzimit.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 114.

**E HENË
4 NËNTOR 1957**

Nesër nisem për në Bashkimin Sovjetik, në krye të një delegacioni që do të marrë pjesë në festimet e 40-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

Asistova në pritjen që dha ambasadori Ivanov për nder të delegacionit tonë.

**MINSK, E MARTË
5 NËNTOR 1957**

U nisëm për në Bashkimin Sovjetik. Udhëtuan me Tu-104 dhe në drekë arritëm në Minsk. Nesër në mëngjes do të nisemi me tren për në Moskë.

**MOSKË, E MËRKURË
6 NËNTOR 1957**

Rreth orës 9⁰⁰ në mëngjes mbërritëm në Moskë. Në stacionin hekurudhor kishin dalë për të na pritur Kusi-neni, Pospjelovi, Kosigini e të tjerë.

Me të arritur — vizitë në Mauzoleun e Leninit e të Stalinit. Vumë kurora me lule për udhëheqësin e lavdi-shëm të Revolucionit të Madh të Tetorit e të proleta-riatit ndërkombëtar, V.I. Leninit dhe për nxënësin e vazhduesin e veprës së tij, marksist-leninistin e shquar J.V. Stalinin.

Në orën 10⁰⁰ u hap sesiioni jubilar i Sovjetit Su-prem të Bashkimit Sovjetik. Dëgjuam raportin për 40-vjetorin e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

MOSKË, E MËRKURË
8 NËNTOR 1957

MOSKË, E ENJTE
7 NËNTOR 1957

Në sesionin e Sovjetit Suprem sot mbajta përshëndetjen e popullit dhe të Partisë sonë me rastin e 40-vjetorit të Revolucionit të Tetorit drejtuar popujve të Bashkimit Sovjetik dhe PK të BS.

Pritje në Kremlin për nder të të gjitha delegacioneve që kanë ardhur në Moskë për 40-vjetorin e Revolucionit të Tetorit.

Përsëndeti Voroshilovi.

MOSKË, E DIEL
10 NËNTOR 1957

Udhëheqësit sovjetikë sot pritën në Kremlin delegacionin gjerman, polak, korean, çekoslovak, si dhe delegacionin jugosllav. Protokoll i çuditshëm!

MOSKË, E SHENJË
13 NËNTOR 1957

MOSKË, E MËRKURË
13 NËNTOR 1957

Delegacionin tonë e pritën në Kremlin Hrushovi, Voroshilovi e Bulganini.

Sot në mëngjes vdiq Antonin Zapotocki. Ai ka qenë udhëheqës i shquar i popullit çekoslovak, kuadër i vjetër i Partisë Komuniste të Çekoslovakisë.

MOSKË, E SHENJË
15 NËNTOR 1957

MOSKË, E PREMTE
15 NËNTOR 1957

Pasdreke shkuan në ambasadën çeke për të shprehur ngushëllimet për vdekjen e presidentit Zapotocki.

Përfundoi konsulta e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste që filloi para dy ditësh¹. Morën pjesë përfaqësues të 12 partive. «Përfaqësuesi i 13-të», Titoja, mungonte, me gjithë lutjet e shumta që i ishin bërë këto kohët e fundit nga udhëheqësit sovjetikë, gjë që ne nuk e kemi pranuar e s'kemi për ta pranuar kurrë. Por edhe pse s'ishte prezent, prania e tij u ndje, sepse kur dëgjoja si folën në mbledhje Gomulka e disa të tjerë, më dukej sikur dëgjoja Titon. Gomulka propozoi të mos përdoret më termi «kampi socialist me Bashkimin Sovjetik në krye» e të mos përcaktohet revizionizmi modern si rrezik kryesor për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Bile Ohabi avancoi më tej dhe e «argumentoi» këtë: «Kështu i kemi larguar shokët e mrekullueshëm jugosllavë, tani po na largoni edhe ne, polakët». U bë zhurmë e madhe në sallën ku u zhvillua mbledhja nga debatet që bënë nëpër ve-

1. Konsulta e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste i zhvilloi punimet nga 14-16 nëntor 1957.

ndet ku ishim ulur ne, përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore me njëri-tjetrin.

Për ne, komunistët shqiptarë është çështje parimore dhe detyrë internacionaliste mbrojtja e Bashkimit Sovjetik, është vijë demarkacioni lufta kundër revizionizmit modern, veçanërisht kundër atij jugosllav, që sot është rreziku kryesor për lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Në fjalën time shpreha mendimin e Partisë sonë për të gjitha çështjet që u ngritën në mbledhje, për luftën kundër revizionizmit modern, për luftën kundër imperializmit amerikan, si rrezik kryesor i popujve, për unitetin marksist-leninist të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, për rrugët e kalimit në socializëm dhe për mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik.

Gomulka mbeti në minoritet, sepse të gjithë u ngritën kundër tij.

«Interesant» ishte argumenti i Mao Ce Dunit për të mbrojtur Bashkimin Sovjetik. Ai iu kundërvu propozimit të Gomulkës me këto fjalë: «Kampi ynë duhet të ketë një kokë, sepse edhe gjarpri ka një kokë»(!)

Në fund të mbledhjes të gjithë përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste nënshkruan Deklaratën e Moskës, së cilës ne do t'i përmbahemi me besnikëri. Jugosllavët nuk e nënshkruan, megjithëse disa u munduan t'i qetësonin duke u thënë se në të asgjëkundi nuk përmendet emri i tyre e se do të flitet për revizionizmin pa bërë asnjë përcaktim. Por jugosllavëve prapë edhe kështu nuk iu kthye mendja.

MOSKË, E DIEL

17 NËNTOR 1957

Dreکہ në Kremlin për nder të delegacioneve që morën pjesë në festimin e 40-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

Folën Hrushovi, Mao Ce Duni dhe Zhak Dyklo.

Pas konsultës së 12 partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste, më 16-19 nëntor u zhvillua mbledhja e 64 përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore, e cila sot u dha fund punimeve. Në këtë mbledhje morën pjesë edhe të dërguarit e Titos. Këtu ishte Toliati ai që ia mori avazit të Gomulkës. U lodh së foluri edhe ky kundër përcaktimit të revizionizmit modern si rrezik kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Pastaj propozoi të çelim rrugë të reja e të nxjerrim parulla të reja për t'i kthyer partitë komuniste në parti të gjera të masave. Pse duhet të kemi një qendër të vetme udhëheqëse, — tha ai, — kur kjo s'do të ishte e dobishme për afrimin e masave të gjera rreth partisë? Pikëpamje krejtësisht oportuniste e revizioniste. Shumica e pjesëmarrësve në mbledhje u ngritën kundër tezave të Toliatit e të disa të tjerëve që folën si ai.

Në fund aprovuam Manifestin e Paqes drejtuar gjithë punonjësve të botës.

Mësojmë se me rekomandim të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Çekoslovakisë, sot Asambleja Kombëtare e Republikës Çeke zgjodhi Sekretarin e Parë të Partisë, Novotnin, President të Republikës.

MOSKË, E PREMTE**22 NËNTOR 1957**

Sot në mes delegacionit tonë dhe atij sovjetik u nënshkrua marrëveshja ekonomike dhe teknike. Këtë marrëveshje ne e konsiderojmë si shprehje të dashurisë që ushqen populli sovjetik për popullin tonë dhe i ndjenjave të tij të internacionalizmit proletar.

I dhashë një intervistë Manolis Glezos, heroit të Akropolit, për gazetën «Avji» të EDA-s¹. Trajtova problemin e normalizimit të marrëdhënieve në mes Greqisë dhe vendit tonë.

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 134.

TIRANË, E DIEL**24 NËNTOR 1957**

Në mëngjes u nisëm nga aeroporti i Vnukovos. Kishin dalë për të na përcjellë Kusinen, Pospjelov, Kosigin e të tjerë. Para nisjes mbajta një përshëndetje të shkurtër. Aeroplani Tu-104 pas tri orësh na solli në atdheun tonë të dashur.

E HËNË
25 NËNTOR 1957

Prita përfaqësuesin e kolonisë shqiptare të Parisit, Andon Zuni, që ka ardhur për të marrë pjesë në festimin e 45-vjetorit të Pavarësisë dhe 13-vjetorit të Çlirimit. Bëra një bisedë të ngrohtë me të.

E MËRKURË
27 NËNTOR 1957

Paradite, në Komitetin Qendror të Partisë prita dhe bisedova me përfaqësuesit e vëllezërve tanë të kolonisë shqiptare të Egjiptit dhe të Sirisë.

Isha në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor. Në një nga pikat e rendit të ditës, diskutova shkurtimisht. Shfaqja mendimin se për vjetërsi në shërbim dhe punë të pandërprerë duhet të dekorohen jo të gjithë, po disa kategori punonjësish të specialiteteve të ndryshme si, bie fjala, në mjekësi, në arsim etj.

Mbledhje solemne me rastin e 45-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 13-vjetorit të Çlirimit. Mbledhjen e hapi shoku Hysni, kurse shoku Haxhi Lleshi mbajti fjalën e rastit.

Pas përshëndetjeve në emër të klasës punëtore, të rinisë, të ushtrisë etj., u dha një program artistik.

Erdhëm në Vlorë për të festuar 45-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Rrugët e qytetit ishin mbushur plot me njerëz, që kishin dalë të na prisnin. Brohoritjet e tyre për Partinë nuk reshtnin.

Shkuam në vendin ku 45 vjet më parë patrioti i mençur Ismail Qemali ngriti flamurin. Ndjeva emociione shumë të forta, kur, në orën 10 e 30 minuta, së bashku me patriotin Xhafer Xhuvëli (nga Tragjasi) ngritëm flamurin. Pas kësaj ceremonie dhe vendosjes së kurorave te busti i Ismail Qemalit, filloi mitingu.

Shkuam dhe vendosëm lule në varrezat e shokëve tanë dëshmorë dhe në varrin e patriotit demokrat Avni Rustemi.

Pritje me rastin e 45-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 13-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë. Fola në pritje.

Raportova në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë për Mbledhjen e Përfaqësuesve të Partive Komuniste e Punëtore të Vendeve Socialiste dhe për mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që morën pjesë në festimin e 40-vjetorit të Revolucionit Socialist të Tetorit. Plenumi aprovoi Deklaratën e Mbledhjes së Përfaqësuesve të Partive Komuniste e Punëtore të Vendeve Socialiste, Manifestin e Paqes dhe gjithë veprimtarinë e delegacionit të Partisë e të Qeverisë sonë në Moskë.

E HËNË
4 DHJETOR 1957

E MËRKURË
4 DHJETOR 1957

Pritje nga Kryesia e Kuvendit Popullor në Pallatin e Brigadave për nder të delegacionit parlamentar çekoslllovak.

Shkruar dhe botuar nga Komiteti Qendror i Propagandës dhe Kulturës së Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Pritje me nder nga Kryesia e Kuvendit Popullor në Pallatin e Brigadave për nder të delegacionit parlamentar çekoslllovak.

E ENJTE
5 DHJETOR 1957

E ENJTE
5 DHJETOR 1957

Në selinë e Komitetit Qendror prita sekretarin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Çekoslllovakisë, Vratislav Krutina, që ka ardhur në vendin tonë në krye të delegacionit parlamentar çekoslllovak. Ishin edhe shokët Hysni e Haki. Zhvilluam një bisedë shumë të ngrohtë me shokun çek.

NUMRI 8
1781 DHJETOR 1957

**E PREMTE
6 DHJETOR 1957**

Mora pjesë në aktivin e Partisë për qytetin e Tiranës, që u mbledh sot në zbatim të vendimit të Plenumit të 7-të të KQ të PPSH për të punuar dokumentet e aprovuara nga Mbledhja e Përfaqësuesve të Partive Komuniste e Punëtore në Moskë. Fola për punimet e Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të PPSH dhe për rezultatet e Mbledhjes së Partive Komuniste e Punëtore.

NUMRI 9
1782 DHJETOR 1957

**E HËNË
9 DHJETOR 1957**

Paradite prita delegacionin sovjetik, që kryesohet nga Jeljutin, ministër i Arsimit të Lartë të Bashkimit Sovjetik.

Darkë në ambasadën sovjetike nga ambasadori Ivanov me rastin e vizitës së delegacionit sovjetik në vendin tonë.

Pas darkës pamë filmin «Koordinata të panjohura».

11 DHJETOR 1957

**E MËRKURË
11 DHJETOR 1957**

Isha dakord me propozimin që të deleguarit e Komitetit Qendror në Fier, Berat e Lushnjë, t'u dorëzojnë këtyre rretheve edhe urdhrat që Presidiumi i Kuvendit Popullor u ka akorduar për realizimin e planit të pambukut. Meqenëse do të shkoj në Berat dhashë porosi të m'i bëjnë gati për nesër në mëngjes urdhrat që u janë akorduar rrethit dhe kuadrove të tij.

**E ENJTE
12 DHJETOR 1957**

Prita ambasadorin e Republikës Popullore të Bullgarisë.

**BERAT, E SHTUNË
14 DHJETOR 1957**

Me rastin e dekorimit të rrethit të Beratit për realizimin e planit të pambukut për vitin 1957 me Urdhrin e Punës të Klasit I u organizua një mbledhje e zgjeruar e këshillit popullor të rrethit. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Qeverisë dhe të Presidiumit të Kuvendit Popullor, i përshëndeta të pranishmit në këtë mbledhje dhe i urova për suksesin e arritur. Mes entuziazmit dhe brohoritjeve për Partinë dorëzova dekoratat për Komitetin Ekzekutiv të Rrethit dhe për kryetarin e këtij komiteti.

Paradite bëra një vizitë në kooperativën bujqësore të Perondisë, kooperativa e parë që është formuar në rrethin e Beratit. Pashë shkollën dhe u njoha me rezultatet që janë arritur gjatë jetës 9-vjeçare të kësaj kooperative.

Në mbledhjen që u organizua i përgëzova kooperativistët për sukseset dhe u fola për detyrat e rëndësishme që u dalin në drejtim të forcimit ekonomik dhe organizativ të kooperativës, për forcimin e rolit të or-

ganizatës-bazë të Partisë dhe të asamblesë, për përmirësimin e kushteve të jetesës, për edukimin e mirë të fëmijëve etj. Pastaj vizitova bllokun e ri të ullinjve, stallën e lopëve dhe bisedova me një grup kooperativistësh.

Hëngra drekë në kooperativën e Perondisë.

Në takimin e organizuar në Qytetin Stalin me kuadrot drejtues të Kombinatit të Naftës, me inxhinierë, teknikë, heronj të punës socialiste dhe punëtorë të dalluar fola për arritjet dhe detyrat e punonjësve të naftës gjatë vitit 1958, për perspektivat që i hapen kësaj dege të industrisë në të ardhmen, për nevojën e kualifikimit të mëtjeshëm të kuadrove teknikë dhe për përgatitjen e kuadrove të rinj.

**BERAT, E DIEL
15 DHJETOR 1957**

Vizitova disa reparte të Kombinatit të Naftës në Qytetin Stalin dhe bisedova me punëtorë, teknikë dhe inxhinierë.

**E HËNË
16 DHJETOR 1957**

Darkë në ambasadën bullgare me rastin e 10-vjetorit të nënshkrimit të Traktatit të miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke në mes vendit tonë dhe Bullgarisë.

Shkëmbyem fjalime unë dhe ambasadori bullgar.

E MËRKURË
18 DHJETOR 1957

Gazeta greke «Avji» ka botuar intervistën që i dhashë në Moskë kryeredaktorit të saj, Manolis Glezos.

E PREMTE
20 DHJETOR 1957

Në mbledhjen e Byrosë Politike, që shqyrtoi çështjen e riorganizimit të organeve lokale të pushtetit hodha poshtë mendimin e Liri Belishovës për krijimin në vendin tonë të selsovjetëve¹. Këtë ajo e paraqiti si propozim të bazës, të Vlorës dhe të Shkodrës, por, me sa kuptova nga zbërthimi që i bëri përmbajtjes, ishte i veti. Sipas Lirisë selsovjetët «nuk kanë përgjegjësi për kooperativat bujqësore, sepse çështjet ekonomike i zgjidh rrethi». T'i heqësh pushtetit në bazë funksionin ekonomik, ta zhveshësh atë nga detyrat e mëdha që ka për zhvillimin dhe përparimin e bujqësisë është shumë e gabuar. Ne nuk duhet ta marrim shabllon përvojën sovjetike dhe të kërkojmë ngritjen e selsovjetëve, kur te ne mungojnë kushtet e nevojshme objektive dhe subjektive. Natyrisht, do të vijë dita që në vendin tonë të krijohen këshilla për disa fshatra, por kjo së pari do të ndodhë, siç thashë edhe në mbledhje², kur zhvillimi

1. Këshilla për disa fshatra, që do të lidheshin drejtpërsëdrejti me rrethin dhe që nuk do të merreshin me çështjet ekonomike të kooperativave bujqësore.

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 138.

ekonomik do të çojë në bashkime kooperativash bujqësore dhe së dyti, edhe atëherë asnjëherë e në asnjë mënyrë këshillat popullore nuk do të zhvishen nga detyrat në çështjet ekonomike.

NUMERI
23 DHJETOR 1957

E HËNË
23 DHJETOR 1957

Sot isha në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor. Shpreha nja dy mendime për rishikimin e ligjit mbi sigurimet shoqërore dhe shtetërore, si dhe mbi varësinë e inspektoriatit shtetëror të sigurimit në miniera dhe të pajisjeve nën presion

Thashë, ndër të tjera, se nuk ka arsye të mos u jepet pension patriotëve të vjetër nën pretekstin se ata nuk paskan zhvilluar aktivitet revolucionar në kohën e Zogut. Ky kufizim nuk është i justifikuar kur nga tërësia e veprimtarisë së patriotit del që ai ka sakrifikuar shumë për interesat e atdheut.

TREGUESI I LENDES

A

Ambasadat e RP të Shqipërisë në vende të ndryshme — 209, 225, 336.

Ambasadat e shteteve të ndryshme në RP të Shqipërisë — 109, 114, 140, 162, 169, 180, 188, 195, 196, 198, 200, 218, 219, 244, 250, 273, 299, 300, 304, 323, 328, 341, 348, 349, 369, 376, 383, 403, 405, 409.

Arkeologjia — 41.

Arkivat, materialet dokumentare — 41-42, 177.

Armiqtë; lufta kundër veprimtarisë armiqësore — 49, 67, 117-118, 220, 226-227, 268-269, 276, 290, 335.

B

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë — *Kongresi i 4-t i tyre (shkurt 1955). Roli dhe detyrat për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve në ba-*

zë të ligjeve — 14, 18, 305-306, 368.

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik — *përhapja dhe forcimi i pozitave të revizionizmit në BS. Metodrat dhe taktikat e tij* — 12-13, 15, 21, 60-61, 67, 168, 254, 350, 363, 378;

— *Partia Komuniste e BS; Kongresi i 20-të dhe ple-numet e KQ të saj* — 15, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 127, 128, 138, 158, 160, 350;

— *afrimi dhe forcimi i lidhjeve me ShBA* — 16, 129, 341;

— *rehabilitimi i revizionistëve jugosllavë dhe marrëdhëniet me ta* — 60-61, 66, 67-68, 70, 71, 168, 215, 216, 266, 310, 313-314, 315-316, 356, 359, 360;

— *politika e jashtme; marrëdhëniet me vendet e demokracisë popullore*

dhe përpjekjet për forcimin e hegemonisë ndaj tyre — 70, 71, 72, 212, 227, 387;
— qëndrimet demagogjike dhe presionet ndaj PPSH dhe RP të Shqipërisë — 63-64, 66, 79-81, 265, 307, 308, 309-310, 311-312, 313-314, 315-316, 318, 356, 357, 360-362, 388, 394.
Blegtoria — zhvillimi dhe përmirësimi racor; lufta kundër dëmtimeve — 296-297, 342, 343, 382.
Borgjezia, borgjezia e vogël (mikroborgjezia) — 280-283, 286.
Britania e Madhe; politika e jashtme — 235-236, 240.
Bujqësia në RPSH — zhvillimi i saj. Pemëtaria. Ujitja, veprat ujitëse dhe bonifikimet — 35, 50, 110, 296-297, 300, 342.
Bullgaria; marrëdhëniet me RP të Shqipërisë — 270, 275, 320.
Buxheti i shtetit — 139.
Byroja Informativ e Partive Komuniste e Punëtores — 63-64, 65, 67, 72, 80, 215.

Ç

Çarmatimi, armatimi dhe armët bërthamore; demagogjia imperialisto-revizioniste për

çarmatimin — 129, 176, 184, 253.
Çmimet e artikulujve industrialë e ushqimorë; ulja e tyre — 153, 256, 371.

D

Dekorimet — 397, 404, 406.
Dëshmorët — 82, 83, 175, 237-239, 247.
Diktatura e proletariatit — 280-281, 291.

E

Edukimi marksist-leninist i masave, i komunistëve dhe i kuadrove; lufta kundër shfaqjeve të huaja — 48, 220-221, 305-306, 370.
Egjipti; agresioni anglo-franko-izraelit kundër tij — 235-236, 239-240, 244-245, 249, 277.
Ekonomia dhe politika — 152.
Ekonomia popullore — përsosja e drejtimit të saj; drejtimi i centralizuar — 40, 164, 291-292.
Ekspozitat — 96, 142, 222.
Engels, Fridrih — 45, 150.
Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 31-32, 34, 47, 79-80, 81, 83, 125, 126, 172-173, 190, 191-192, 247, 343-344, 356, 357-358, 362.

F

Fashizmi; gjallërimi, rrezikshmëria dhe lufta kundër tij — 284-286.
Folklori; grumbullimi dhe sistemimi i materialeve folklorike — 41.
Franca; politika e jashtme — 235-236, 240, 286.
Fronti Demokratik i Shqipërisë; Kongresi i 3-të i tij (qershor 1955); zgjedhjet për këshillat e Frontit — 76, 84-85, 185.
Fshatarësia, fshati — politika e Partisë për zhvillimin e tyre — 199-200, 370, 372-373, 406-407.

G

Greqia; qëndrimi ndaj RP të Shqipërisë — 259.
Gruaja dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë — Kongresi i 4-të i BGSh (13-15 tetor 1955) — 88-90, 186;
— emancipimi i grave; edukimi dhe pjesëmarrja e tyre në ndërtimin socialist të vendit — 28, 58, 88-89, 90, 91, 93.
Grumbullimi i tepricave të prodhimeve bujqësore e blegtorale — 187, 371.

H

Historia e Shqipërisë — Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912) — 380, 397, 398.
Hungaria; gjallërimi i oportunitizmit dhe kundërrevolucionit i vitit 1956 në Hungari — 29-30, 33, 44, 138, 203-204, 223, 225, 226, 227, 228, 232, 241, 242-243, 252, 266, 268-269, 277-280, 283, 294-295.

I

Imperializmi — strategjia globale — 287, 290.
Industria e naftës, e tekstileve dhe ajo ushqimore — 35, 330, 407.
Inteligjencia përparimtare e viteve 30-të. Krijimi dhe edukimi i inteligjencies në vitet e pushtetit popullor — 116, 221, 332-333.
Internacionalizmi proletar dhe kozmopolitizmi — 289-290, 291.
Internacionalja e Tretë Komuniste (Komininterni) — 109, 344.
Izraeli; agresioni i tij kundër Egjiptit — 235-236, 239-240, 245, 249.

J

Jugosllavia; revizionizmi jugosllav; vetadministrimi jugosllav — 292;

- politika e jashtme kundërrevolucionare; afrimi, bashkëpunimi me revizionistët sovjetikë — 61, 62, 123, 234, 242-243, 266, 279, 287-288, 359, 360, 390-391;
- qëndrimi shovinist, persekutimet dhe terrori ndaj kosovarëve dhe popullsisë tjetër shqiptare në Jugosllavi — 302-303;
- marrëdhëniet me RP të Shqipërisë dhe qëndrimi armiqësor ndaj saj — 73, 196-197, 302-303, 337.

K

Kapitalizmi; kriza dhe kontradiktat në gjirin e tij — 277, 282, 283, 285-286, 289.

Këshillat popullorë; funksionimi dhe gjallërimi i tyre. Roli dhe detyrat në fushën e ekonomisë — 84-85, 339-340, 406, 411-412.

Kina — gjendja e brendshme. Marrëdhëniet me RP të Shqipërisë — 142, 201, 202, 210, 214-215, 216.

Klasa punëtore në RPSH — cilësitë, misioni historik dhe roli udhëheqës — 14, 130, 330.

Klasa punëtore (proletariati); roli udhëheqës — 280-281, 284. Klasat dhe lufta e klasave — 147, 280-286, 289, 292.

Kolektivizimi socialist i bujqësisë — politika e Partisë për shndërrimin socialist të fshatit — 305, 329, 370.

Koreja e Veriut (RDP e Koresë) — gjendja e brendshme; marrëdhëniet me RP të Shqipërisë — 178, 180, 181, 183, 201, 202, 206, 207, 208, 209. Kuadrot — politika e Partisë me kuadrin; përgatitja e kualifikimi; lidhjet e tyre me masat — 19-20, 117, 146-147, 353-354.

Kuvendi Popullor; Presidiumi dhe Kryesia e Kuvendit Popullor — 27, 39, 65, 69, 78, 140, 251, 298, 326, 335, 339, 397, 400, 413.

L

Lenin, Vladimir Iliç — 13, 43, 45, 81, 150, 215, 277, 278, 279-280, 281, 282-283, 284, 291, 311, 314, 377, 385.

Letërsia dhe artet — zhvillimi i tyre. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë; shkrimtarët, artistët — 219, 223, 332-333, 334.

Letrat, ankesat e punonjësve — 19-20, 305, 370.

Lëvizja komuniste punëtore ndërkombëtare

- partia marksiste-leniniste — tiparet revolucionare dhe roli i saj udhëheqës — 283-284, 291;
- Konsulta e partive komuniste e punëtore e vendeve socialiste (14—16 nëntor 1957) — 390-391;
- mbledhja e përfaqësuesve të 64 partive komuniste e punëtore (16—19 nëntor 1957) — 393, 402;
- Partia e Punonjësve të Hungarisë — 29-30, 33, 44, 157;
- Partia Komuniste Franceze — 185, 286;
- Partia Komuniste Italiane — 134, 393;
- Partia Komuniste e Kinës — 121, 156, 210, 211, 212, 213.

Lëvizjet dhe luftërat çlirimtare dhe përparimtare të popujve — 37-38, 244-245, 267.

Ligjet, legjislatoni; Kodi i Punës dhe Kodi Civil; përsosja dhe zbatimi i tyre — 27, 139, 340, 368, 413.

Lindja e Mesme, Lindja e Afërt — 235, 267.

Liria, demokracia — kritikë pikëpamjeve borgjezo-revizioniste për këto probleme — 278.

Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare e popullit shqiptar — Çlirimi i Shqipërisë (29 Nëntor 1944) — 94, 95, 175, 237-239, 257.

Lufta e Dytë Botërore (1939—1945) — 175.

M

Marksizëm-leninizmi — busull për udhëheqje e veprim; studimi, zbatimi dhe mbrojtja e tij — 43, 45, 48, 140, 150, 279-280, 284, 288.

Marks, Karl — 45, 150, 289. Metoda dialektike marksiste-leniniste — 279.

Mërgimi — shqiptarët e mërguar, kolonitë shqiptare të mërgimit — 381, 396, 397.

Ministritë

- Ministria e Punëve të Brendshme — 22-23;
- Ministria e Bujqësisë — 297, 343.

Minoriteti grek në Shqipëri — 192, 193.

Mirëqenia në shoqërinë tonë socialiste — 11.

Mongolia — 201, 202, 203, 206. Monumentet e kulturës. Muze të — 41, 170.

N

Novatorët, racionalizatorët, iniciativat krijuese të masave — 189.

NJ

Një Maji — Dita e Solidaritetit Ndërkombëtar të Punëtorëve — 51, 154, 325.

O

Organet e Punëve të Brendshme dhe punonjësit e kuadrave të tyre; organizatat-bazë të Partisë në këto organe — 22-23, 111-112;

— Forcat e Kufirit, kufitarët — 46.

Organizata e Kombeve të Bashkuara — pranimi i Shqipërisë në OKB dhe qëndrimi i RPSH ndaj saj — 118, 140, 213, 245, 248, 249.

P

Partia e Punës e Shqipërisë — lufta e klasave në Parti

— lufta kundër elementëve antiparti, deviatorë, fraksionistë e trockistë — 75, 146, 147-148, 165, 197;

— lufta kundër elementëve revizionistë T. Jakova, B. Spahiu etj. — 48-49, 53-57, 74, 75, 76, 77, 78;

— lufta kundër veprimtarisë armiqësore antiparti në Konferencën e 3-të të Partisë të qytetit të Ti-

ranës (15-16 prill 1956) — 144-148, 149, 151-152, 165;

— demaskimi i tradhtarit e agentit P. Plaku — 335, 336, 337, 357, 361-362;

— lufta kundër pikëpamjeve deviatore të L. Belishovës — 411.

Partia e Punës e Shqipërisë — marrëdhëniet dhe kontradiktat me PK të BS dhe me partitë komuniste e punëtorë — 156, 157, 202, 213, 214-215, 260, 265, 346, 347, 399, 401.

Partia e Punës e Shqipërisë — ndërtimi dhe jeta e brendshme

— themelimi i PKSH dhe rëndësia e saj historike — 150, 246, 247;

— Statuti i PPSH; demokracia e brendshme në Parti; kontrolli i Partisë — 41, 141, 145, 165;

— përvoja, vigjilenca dhe mësimet për t'i prerë rrugën revizionizmit në Shqipëri — 145, 226-227, 350-351, 357-358.

Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore dhe lokale

— Kongresi III i PPSH (25 maj — 3 qershor 1956) — 141, 155, 159, 160, 161, 163, 164, 165, 166-167, 171;

— Komiteti Qendror, Byroja Politike e KQ — 20, 22, 45, 48-49, 68, 135, 166, 241, 250, 294-295, 411;

— Plenumi i 13-të i KQ (25-27 prill 1955) — 48-49, 54, 55;

— Plenumi i 14-të i KQ (14-17 qershor 1955) — 74, 75, 76, 78;

— Plenumi i 16-të i KQ (27-28 dhjetor 1955) — 103;

— Plenumi i 18-të i KQ (5-7 prill 1956) — 141;

— Plenumi i 3-të i KQ (13-16 shkurt 1957) — 276-292, 294-295, 296-297, 342, 382;

— Plenumi i 6-të i KQ (10-12 korrik 1957) — 353-354;

— plume të tjera, mbajtur gjatë viteve 1956 dhe 1957 — 128, 155, 224, 324, 399, 402;

— aparati i KQ; organizata-bazë e tij — 41-42, 115, 151-152;

— Komitetet e Partisë në qarqe, rrethe, rajone e lokalitete dhe aparatet e tyre — 97-102, 111-112, 117, 305-306, 338, 382;

— organizatat dhe komitetet e Partisë të rretheve të Beratit, të Durrësit, të Elbasanit dhe të Kor-

çës — 19-20, 26, 137, 171, 199-200, 329;

— organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës — 45, 144-148, 220-221, 229, 301, 402;

— Komitetet e Partisë të rretheve të Vlorës e të Fierit — 115, 329.

Pensionet, pensionistët — 413.
Pionierët, fëmijët; kujdesi i Partisë për ta — 36, 37-38, 107, 261.

Planet — projektplani i dytë pesëvjeçar (1956-1960) — 135-136, 139, 141.

Politika e jashtme e RPSH

— lufta për demaskimin e imperializmit, revizionizmit e reaksionit dhe përkrahja internacionale e luftërave çlirimtare dhe e të drejtave të popujve — 59, 69, 129, 236, 239-240, 276, 294, 391;

— marrëdhëniet dhe qëndrimet parimore marksiste-leniniste ndaj BS — 47, 63-64, 65, 66, 67-68, 79-81, 123, 124, 158, 169, 244, 250, 265, 308, 309-310, 311-312, 313-314, 315-316, 324, 331, 374, 377, 383, 384, 385, 386;

— qëndrimi parimor ndaj Jugosllavisë dhe lufta e PPSH dhe e RPSH kundër revizionizmit jugo-

sllav — 63-64, 67-68, 71, 72, 146, 196-197, 214, 254, 294-295, 302-303, 313-314, 315-316, 318, 337, 356, 361;
— marrëdhëniet me vende të ndryshme (Bullgarinë, Poloninë, Çekoslovakinë, RD Gjermane, Kinën, RDP të Koresë etj.) — 109, 131, 132, 162, 174, 178, 179, 180, 181, 185, 202, 203, 205, 206, 207, 213, 214, 216, 217, 218, 224, 260, 270, 271, 273, 275, 340, 366, 389, 394, 401, 409;
— të huajt, miqtë për PPSH dhe RPSH — 113, 230-231, 345.

Polonia — gjendja e brendshme; politika e jashtme — 122, 132, 176, 179, 241, 294-295, 364, 390.

Populli shqiptar — traditat patriotike revolucionare — 69.
Prona private; prodhimi i vogël — 281-282.

Propaganda; propaganda e prodhimit. Shtypi — 275, 295, 296-297.

Pushteti popullor, organet shtetërore — 84-85, 259, 338.

R

Revizionizmi modern — përhapja, strategjia dhe taktikat e tij — 134, 279, 393.

Revolucioni dhe ligjet e tij. Kundërrevolucionit. Kritikë pikëpamjeve borgjezo-revizioniste për revolucionin socialist — 279-284.

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit — 92, 244, 246, 283, 287, 382, 392.

Rinia dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë — Kongresi i 3-të (nëntor 1956) dhe plenumet e KQ të BRPSH — 86-87, 255.

Rumania — politika e jashtme; qëndrimi ndaj RP të Shqipërisë — 224, 234, 310.

S

Socializmi — 283-284.

Stalin, Josif Visarionoviç — lufta e revizionistëve kundër Stalinit dhe veprës së tij. Mbrojtja e Stalinit nga PPSH — 13, 45, 81, 125, 150, 159, 175, 181, 182, 214-215, 289, 309, 310, 350, 361, 377, 379, 385.

SH

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e luftës dhe e agresionit. Qëndrimi demagogjik dhe presionet ndaj RP të Shqipërisë — 17, 24-25, 117-118, 267, 290.

Shtypi dhe propaganda borgjeze e revizioniste — 16-17, 182, 197, 225, 252, 278, 285-286, 341.

T

Teoritë e pikëpamjet borgjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre

— për partinë politike të klasës punëtore dhe diktaturën e proletariatit — 291-292;

— për rrugët e kalimit në socializëm dhe për bashkekzistencën paqësore — 134, 160;

— për luftën kundër «dogmatizmit», për «zbatimin krijues të marksizëm-leninizmit» dhe për kultin e individit — 138, 145-146, 268, 288-289.

Traktati i Varshavës — 59, 60, 65, 69.

T-iskëtimi; h-rqja e pjesshme e sistemit të triskëtitimit — 108.

TH

Thelbi dhe shfaqja — 279.

U

Uji i pijshëm; sigurimi i tij — 372-373.

Uniteti Parti—popull — 82, 83, 166-167, 239, 322, 325.

Universiteti i Tiranës — 365, 375.

Ushtria Popullore — forcimi, roli i saj për mbrojtjen e atdheut. Stërvitjet ushtarake — 34, 329.

V

Vendet e demokracisë popullore (socialiste) — 52, 59, 72, 278-284, 287-288.

Vigjilenca revolucionare — 49, 226-227, 239, 252, 335, 336.

Z

Zgjedhjet për organet e pushtetit popullor — 84-85, 259.
Zotimet dhe lufta për plotësimin e tyre — 293.

TREGUESI I EMRAVE

A

Alia, Ramiz — 87, 185, 311,
313, 332, 345.
Abakumov, Viktor — 67.
Ahmeti, Iljaz — 147.
Ajzenhauer, Duajt — 24, 25,
129, 267, 277.
Andropov, Juri — 537.

B

Barbys, Anri — 34.
Bega, Mehmet — 238.
Bega, Tire — 238.
Belishova, Liri — 411.
Beria, Lavrentiev — 15, 67.
Bjerut, Boleslav — 122, 131,
132, 133, 159.
Brezhnjev, Leonid — 350.
Bulganin, Nikolai — 16, 21, 72,
123, 129, 309, 310, 388.

C

Cedenbal, Jumzhagin — 203.
Cirankieviç, Jozef — 364.

Ç

Çajupi, Andon Zako — 116.
Çako, Hito — 55, 56.
Çomo, Maço — 20.
Çu De — 121.
Çu En Lai — 210, 212.
Çupi, Llesh Pal — 259.

D

Dalles, Xhon Foster — 24, 290.
Demi, Vehip — 147.
Dezh, George Georgiu — 224,
234.
Dimitrov, Gjergj — 270, 284-
285, 343-344.
Disha, Abaz — 32.
Disha, Ali — 32.
Duri, Mihal — 238, 239.
Dyklo, Zhak — 392.

F

Farka, Hatixhe (Ije) — 237.
File, Hekuran — 172.
Frashëri, Naim — 116.

G

Gero, Erno — 223, 250.
 Glezos, Manolis — 394, 410.
 Gobino, Zhozef — 285.
 Goldenbaum, Ernst — 174.
 Gomes, Pereira — 37.
 Gomulka, Vladislav — 364,
 390-391, 393.
 Gotvald, Klement — 159.
 Gromiko, Andrei — 310.

GJ

Gjata, Eqrem — 381.

H

Hoxha, Nexhmije — 28, 88,
 137, 327, 355, 356.
 Hamarskjold, Dag — 249.
 Hørst, V.R. — 16.
 Hitler, Adolf — 176, 285.
 Hoxha, Hysen (baba Çeni) —
 190.
 Hoxha, Iljaz — 190.
 Hrushov, Nikita — 12, 15, 16,
 47, 61, 66, 67-68, 71, 120,
 121, 123, 125, 134, 138, 168,
 176, 215, 216, 250, 309-310,
 312, 315, 316, 318, 341, 356,
 357, 359, 360-362, 374, 388,
 392.

I

Ivanov, V.I. — 304, 310, 319,
 331, 376, 383, 403.

J

Jakova, Kolë — 162.
 Jakova, Tuk — 48, 49, 53-57,
 74, 75, 76, 78, 144, 147, 148,
 315, 362.
 Jeljutin, Viaçeslav — 403.
 Jermilov, V. — 340.
 Jugov, Anton — 270, 271, 273,
 274, 321.

K

Kapo, Hysni — 18, 76, 255,
 260, 296, 304, 377, 397, 401.
 Koleka, Spiro — 141, 331, 332.
 Kadar, Janosh — 232, 250.
 Kaganoviç, Llazar — 350.
 Kalçenko, N. — 309.
 Kapo, Vito — 88, 90.
 Kardel, Eduard — 291, 355,
 356.
 Kasatanov, V. — 169.
 Kashen, Marsel — 230-231.
 Keta, Dullë — 238.
 Keta, Mine — 238.
 Këllezi, Abdyl — 55, 56.
 Kim Ir Sen — 178, 179, 180,
 181, 183, 206, 207, 209.
 Kingsberi-Smith, Xhon — 16.
 Kiriçenko, Aleksei — 309, 356.
 Konda, Spiro — 172.
 Konife, F. — 16.
 Kosigin, Aleksei — 385, 395.
 Kozlov, Frol — 311.
 Krilov, Ivan — 244, 250.
 Krutina, Vratislav — 401.

Kusinen, Oto — 360, 385, 395.
 Kushi, Vojo — 237, 238.

L

Laptiev — 360.
 Lavdishenko, G. — 369.
 Levïçkin, K.D. — 66, 68, 79-
 -80.
 Liu Shao Çi — 210, 211, 212.
 Lo Shu Gao — 348, 369.
 Luka, Gjovalin — 77.

LL

Lleshi, Haxhi — 397.

M

Marko, Rita — 77, 165, 251,
 298, 327.
 Myftiu, Manush — 55, 56.
 Malenkov, Georgi — 12-13, 15,
 21, 309, 350.
 Malinovski, Rodion — 378.
 Mame, Misto — 238, 239.
 Mao Ce Dun — 121, 210, 211,
 214-215, 391, 392.
 Martini, Xhoxhi — 237.
 Miçunoviç, Velko — 318.
 Migjeni (Millosh Gjergj Ni-
 kolla) — 116.
 Mikojan, Anastas — 29-30,
 72, 81, 123, 212, 309, 310.
 Miljukov, P.N. — 282.

Minxenti, Jozef — 243, 269.
 Mjeda, Ndre — 116.
 Molotov, Viaçeslav — 16, 17,
 61, 168, 254, 350, 363.
 Monmuso, Gaston — 230.
 Musolini, Benito — 285.

N

Nushi, Gogo — 18, 92, 162,
 165, 251, 311.
 Nagi, Imre — 29, 30, 44, 232,
 242-243, 250, 266, 278.
 Naser, Gamal Abdel — 236.
 Ndreu, Dali — 250.
 Novikov, Kuzmin — 300.
 Novotni, Antonin — 122, 393.

O

Ohab, Eduard — 176, 390.

P

Peristeri, Pilo — 28.
 Patoliçev, Nikolai — 308.
 Pik, Vilhelm — 109.
 Plaku, Panajot — 335, 336,
 337, 357, 361-362.
 Ponomarjov, Boris — 266, 360.
 Popoviç, Koça — 302-303.
 Popoviç, Miladin — 53.
 Pospjelov, Pjetër — 158, 160,
 311, 312, 313, 385, 395.
 Prifti, Mihal — 311.

Q
Qemali, Ismail — 398.

R
Rajk, Lazlo — 138.
Rakoshi, Matias — 138, 242,
268-269.
Rankoviç, Aleksandër — 223,
355, 356.
Rapacki, Adam — 364.
Rustemi, Avni — 398.

S
Saburov, Maksim — 310.
Salazar, Antonio — 37.
Smetana, Bedërzhih — 163.
Spahiu, Bedri — 49, 53-57, 74,
75, 76, 78, 144, 147, 362.
Spiridonov, Ivan — 311.
Stamboliç, Petar — 364.
Stavaleci, Sadik — 237.
Stoiniç, Velimir — 196.
Sulberger, C.L. — 290.
Suslov, Mihail — 79, 80-81,
203-204, 232, 360.
Svetozar, Vukmanoviç (Tempo) — 81.

SH
Shijaku, Hamid — 238.
Shijaku, Metije — 238.

Shuteriqi, Dhimitër — 219.
Shyri, Hajrie — 237-238.
Shyri, Halil — 238.

T
Toska, Haki — 20, 32, 35, 331,
332, 377, 401.
Ten Hsiao Pin — 210, 212.
Tito, Josip Broz — 60-61, 62,
63, 64, 66, 67, 68, 71, 123,
134, 168, 214, 216, 223, 224,
242-243, 250, 254, 266, 316,
359, 360, 364, 390, 393.
Tokuda, Kjuici — 159.
Toliati, Palmiro — 134, 393.
Torez, Moris — 185.
Tufa, Hava — 238.

TH
Thivy, Xhohn — 162.

V
Velçesku, George — 219.
Vermesh, Zhanetë — 346.
Vidal, Ani — 34.
Vinçani, Vandush — 147.
Voroshilov, Klement — 115,
309, 386, 388.
Vurmser, Andre — 340.

X
Xoxe, Koçi — 138, 144, 197.

XH
Xhuveli, Xhafer — 398.

Z
Zapotocki, Antonin — 388,
389.
Zillatiç, Savo — 197.

Zogu, Ahmet — 116.
Zoto, Nesti — 147.
Zuni, Andon — 396.

ZH
Zhivkov, Todor — 320, 355,
356.
Zhukov, Georgi — 16, 361, 374,
375, 376, 378-379.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Aeroporti i Tiranës — 126, 178, 181, 274.
 Aeroporti i Zemunit (Beograd) — 66, 67, 364.
 Afrikë — 244-245.
 Aktiv i ekonomik (5—6 prill 1955) — 40.
 Aktiv i Partisë për Tiranën (6 dhjetor 1957) — 402.
 Aktiv për bujqësinë (23 shkurt 1957) — 300.
 Aleksandri (Egjipt) — 236.
 Ambasada e Jugosllavisë në Hungari — 242-243.
 Ambasada e ShBA në Hungari — 243.
 Ansambli artistik i studios shtetërore të baletit «Çoi Sin Hi» i RDP të Koresë — 248, 249.
 Ansambli i Këngëve dhe i Valleve i Armenisë — 367.
 Anshan (Kinë) — 216.
 ATSh (agjencia e lajmeve ~) — 235, 244-245.

«Avji» (gazeta ~) — 394, 410.

Azi — 244-245.

B

- Ballaj (Durrës) — 370.
 Ballkan — 275.
 Bashkimi Sovjetik (1917-1953) — 181, 287.
 Beograd — 60, 66, 70, 223, 224, 364.
 Berat — 404, 406.
 Berlin — 378.
 Bilisht (Korçë) — 329.
 Brioni (ishulli ~, Jugosllavi) — 70.
 Budapest — 33, 203, 225.
 Bukuresht — 72, 359.

C

- CGT (Konfederata e Përgjithshme e Punës) — 286.
 «Clarté» [«Qartësi»] (libri ~, A. Barbys) — 34.

C

Çekosllovakia — 388, 393.
Çermenikë (Elbasan — Librazhd) — 31, 199.

D

Dalnij [Dairen] (Kinë) — 216.
«Dama Pik» (opera ~, P. Çajkovski) — 317.
Deklarata e G.M. Malenkovit për t'u liruar nga posti i kryeministrit — 12.
Deklarata e qeverive të BRSS dhe RFPJ, Beograd (2 qershor 1955) — 70, 123.
Deklarata e 12 partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste, Moskë (16 nëntor 1957) — 391.
Delvinë — 194.
«Detyra» (drama ~, K. Jakova) — 162.
Drashovicë (Vlorë) — 83.
Dropull (Gjirokastër) — 193.
Durrës, Porti i Durrësit — 111, 169, 270, 307, 322.

E

Ekspozita e arteve figurative e Bashkimit Sovjetik (tetor 1956) — 222.
Ekspozita e prodhimeve bujqësore e blegtorale e qarkut

të Tiranës (dhjetor 1955) — 96.

Ekspozita industriale e Bashkimit Sovjetik (shkurt 1956) — 119.

Ekspozita me punime artizanati e RP të Kinës (prill 1956) — 142.

Elbasan — 31, 232, 233.

«Enchainements» [«Hallkat»] (libri ~, A. Barbys) — 34.

Ersekë — 173.

«Esteiros» (libri ~, P. Gomes) — 37, 38.

Evropë — 52, 244-245.

F

Fabrika e Cigareve, Gjirokastër — 191.

Fabrika e Konservimit të Frutave, Korçë — 35.

Fabrika e Lëkurëve, Gjirokastër — 191-192.

Fabrika e Qelqit, Korçë — 172.

Fier — 404.

Filarmonia Shqiptare — 223.

Fjalimi i J.B. Titos, mbajtur në Pula (17 maj 1955) — 62.

Fjalimi i J.B. Titos, mbajtur në Pula (11 nëntor 1956) — 254.

GJ

Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 117.

Gjirokastër — 111, 190, 191-192.

H

Havër (Francë) — 185.

«Henri Barbusse» (libri ~, A. Vidal) — 34.

Hidrocentrali i Ulzës [Hidrocentrali «Karl Marks»] — 130.

I

Indi — 287.

Instituti i Shkencave i RPSH — 41, 43.

Ismailia (Egjpt) — 236.

Itali — 285.

K

Kajro — 236.

Kakavijë (Gjirokastër) — 259.

Kanali ujitës Vjosë—Levan—Fier — 50.

Kiev — 309.

Kislovodsk (BS) — 362.

KNER (Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke) — 175, 176.

Kodrat e Shën Thanasit (Korçë) — 35.

Kombinati i Drurit, Elbasan — 233.

Kombinati i Naftës, Qyteti Stalin — 407, 408.

Kombinati i tekstileve «J.V. Stalin», Tiranë — 330.

Konferenca e Parë Kombëtare e të Rejavë (23 nëntor 1955), Tiranë — 93.

Konferenca e tetë shteteve socialiste evropiane për garantimin e paqes e të sigurimit në Evropë (maj 1955), Varshavë — 52, 59.

Konferenca Kombëtare e Nënave (9 maj 1955), Tiranë — 58.

Konferenca Kombëtare e Novatorëve dhe e Racionalizatorëve (23 korrik 1956), Tiranë — 189.

Konferenca Kombëtare për zhvillimin dhe përmirësimin e blegtorisë dhe problemin e bonifikimit të tokave (1—2 qershor 1957), Tiranë — 342.

Kongresi i 14-të i Partisë Komuniste Franceze, Havër — 185.

Kongresi i Parë i Shkrimtarëve dhe i Artistëve të Shqipërisë (maj 1957), Tiranë — 332, 334, 340.

Kongresi i 3-të i Kooperativave Bujqësore (shtator 1956), Korçë — 204.

Kooperativa Bujqësore e Dobracit, Shkodër — 271.

Kooperativa Bujqësore e Drenovës, Korçë — 173.

Kooperativa Bujqësore e Goranxisë, Gjirokastër — 193.

Kooperativa Bujqësore e Mashkullorës, Gjirokastër — 192.

Kooperativa Bujqësore e Pe-
rondisë, Berat — 406-407.

Kooperativa Bujqësore e Qina-
mit, Kolonjë — 173.

Kooperativa Bujqësore e qy-
tetit të Gjirokastrës — 191.

Kooperativa Bujqësore e Vin-
çanit, Korçë — 19.

Kooperativa Bujqësore e Vlla-
hatit, Sarandë — 194.

Kooperativa Bujqësore e Vrlon-
nit, Sarandë — 194.

Kooperativa e Kombinuar e
Metaleve, Gjirokastrë — 191-
-192.

Kooperativa e Punim-drurit,
Gjirokastrë — 191-192.

«Koordinata të panjohura»
(filmi ~) — 403.

Korçë — 19-20, 31, 32, 34, 35,
170, 172, 204, 375.

L

Leningrad (BS) — 311, 314.

Libohovë (Gjirokastrë) — 193.

Lindja e Largët — 17.

Lufta e Drashovicës (1943) —
83.

Lufta e Kodrës së Kuqe (7
tetor 1942) (Tiranë) — 237.

Lufta e Reçit (gusht 1943)
(Shkodër) — 82.

Lushnjë — 404.

LL

«Llaiko Vima» (gazeta ~)
— 192.

M

«Materializmi dhe empiriokri-
tizizmi» — (vepra ~, V.I. Len-
nin) — 140.

Mauzoleu i Leninit dhe i Sta-
linit, Moskë — 310, 385.

Minsk (BS) — 384.

Moskë — 66, 79, 129, 203, 307,
309, 326, 384, 385, 386, 399,
410.

MTI (agjencia e lajmeve ~)
— 29.

Muzeu i Korçës — 170.

Muzeu rus, Leningrad — 314.

Muzeu «V.I. Lenin», Lenin-
grad — 314.

Myzeqe — 110.

N

Nankin (Kinë) — 214.

NATO (Pakti i Atlantikut Ver-
rior) — 290.

Ndërmarrja Bujqësore e Ma-
liqit, Korçë — 34.

Ndërmarrja bujqësore «Irakli
Terova» — Korçë — 19, 35.

Nepravishtë (Gjirokastrë) —
193.

«Nusja e shitur» (opera ~,
B. Smetana) — 163.

O

Odesë (BS) — 308, 309, 319.
Opera e Phenianit — 209.

P

Parku Automobilistik i Sara-
ndës — 194.

Peshkopi — 372-373.

Phenian — 206, 207.

Port-Artur [Liushun] (Kinë)
— 216.

Port-Said (Egjipt) — 236.

Portugali — 38.

Poznan (Poloni) — 179.

«Pravda» (gazeta ~) — 168,
181, 254, 266, 313.

Prokuroria e Përgjithshme e
RPSH — 368.

Q

Qafa e Thanës — 32.

Qyteti Stalin — 407.

R

Radio Beogradi — 197.

Radio «Evropa e lirë» — 117,
278.

Radio Londra — 144.

Radio «Zëri i Amerikës» —
144.

Reç (Shkodër) — 82.

Revolucionet e vitit 1848 —
283.

Rjekë (porti ~, Jugosllavi)
— 70.

S

Sinai (gadishulli ~, Egjipt)
— 235.

Siri — 397.
Spartakiada e rinisë dhe e
studentëve (7 korrik 1957), Ti-
ranë — 352.
Socialdemokracia — 285, 286.
Sofje — 71, 72.
Suez (kanali ~, Egjipt) —
235, 277.
Suhë (Gjirokastrë) — 193.

SH

Shampanjë (Francë) — 230.
Shanghai (Kinë) — 214.
Shkodër — 271, 411.
Shkolla e bashkuar e ofice-
rëve «Enver Hoxha» — 41.
Shkolla e Lartë e Partisë
«V.I. Lenin» — 41, 45, 226.
Shkolla e Sigurimit [Shkolla
e Ministrisë së Punëve të
Brendshme] — 41.
Shpellat e Postojnës (Jugo-
sllavi) — 70.
Shtypshkronja e Gjirokastrës
— 192.

T

Tajvan — 17.
TANJUG (agjencia e lajme-
ve ~) — 337.
«Taras Bulba» (baleti ~) —
313.
TASS (agjencia e lajmeve ~)
— 72, 227, 228, 234, 253, 268,
350, 360, 378.

Tashkent — 311.
Teatri Balshoi i Moskës — 310.
Teatri i Operës dhe i Baletit i Leningradit — 313.
Teatri i Operës dhe i Baletit i RPSH — 365.
Termocentrali i Uzinës së Përpunimit të Naftës, Cërrik — 246.
Tërbuf (kënetë ~, Lushnjë) — 110.
Tiencin (Kinë) — 214.
Tiranë — 127, 154, 158, 166, 178, 221, 237-239, 246, 270, 271, 273, 322, 380.

«Tregim për vajzën Sim Con» (opera ~) — 209.
Trikotazhi, Gjirokastër — 192.

TH

Thirrja e KQ të PPSH drejtuar qytetarëve të Republikës, anëtarëve të Partisë, prindërve dhe familjeve të dëshmorëve (qershor 1956) — 177.

U

UDB (Drejtorja e Sigurimit Shtetëror) — 357.
Ulan-Bator — 203, 363.
Ulzë (Mat) — 130.
Universiteti i Ulan-Batorit — 205.

UNRRA (Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë e Rimëkëmbje) — 25.
Uzina e Fermentimit të Duhanit, Elbasan — 233.
Uzina e Fermentimit të Duhanit, Shkodër — 271.
Uzina e ndërtimit të makinave «V.I. Lenin», Leningrad — 311, 313.
Uzina e pajisjeve elektrike për traktorë dhe automobila, Moskë — 124.
Uzina e Përpunimit të Naftës, Cërrik — 233, 246.

V

Vapori «Krimea» — 308.
«Vargjet e lira» (libri ~, Migjeni) — 116.
Varnë (porti ~, Bullgari) — 320.
Varshavë — 52, 59, 60, 131, 132.
Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe i KQ të PPSH për heqjen e pjesshme të sistemit të triskëtimit, për unifikimin e çmimeve si dhe për heqjen e kufizimit të tregtisë (25 dhjetor 1955) — 108.
Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe i KQ të PPSH për tharjen e kënetës së Tërbufit dhe bonifikimin e fushës së Myzeqesë (janar 1956) — 110.

Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe i KQ të PPSH për uljen e re të çmimeve, për rritjen e pagave të ulëta dhe të pensioneve të ulëta (nëntor 1956) — 256.

Vendimi i KQ të PK të BS «mbi kapërcimin e kultit të individit dhe të pasojave të tij» (korrik 1956) — 181.
Vjenë — 61.
Vlorë — 179, 329, 375, 380, 411.

Y

«Ymanité» (gazeta ~) — 230, 286, 340.

Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 29, 143, 238, 254, 266, 302, 329.
Zimur (Dibër) — 372-373.

QËNDRORE E PARTISANIT DËGJIMOR I PARTISANIT
KËNDREJ QËNDRORE

ENVER HOXHA

DITAR

PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE

(1958-1960)

1

TIRANË, 1981

SHËNIM

Me këtë vëllim nis botimi — për përdorim të brendshëm — i «Ditarit për çështje ndërkombëtare» të shokut Enver Hoxha.

Materialet që do të përfshihen në serinë e këtyre vëllimeve, do të nxirren nga «Ditari politik» i autorit. Në to flitet për veprimtarinë e tij të gjithanshme politike: takime, pritje delegacionesh e personalitetesh të huaja, vizita pune jashtë shtetit, analiza të problemeve e të ngjarjeve konkrete ndërkombëtare e të lëvizjes komuniste e punëtore marksiste-leniniste, direktiva e orientime për politikën e jashtme të vendit tonë, për marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet fqinje e me vendet e tjera, teza e shënime për artikuj themelorë teorikë, ideologjikë e politikë e për çështje të tjera të rëndësishme.

Në vëllimet e ardhshme të «Ditarit për çështje ndërkombëtare», do të përfshihen, në datat e vitet përkatëse, edhe materialet e botuara në librat «Shënime për Kinën».
Krahas vëllimeve «Ditar për çështje ndërkombëtare», do të botohet — gjithashtu për përdorim të brendshëm — edhe seria e vëllimeve «Ditar për çështje të brendshme», (vëllimi i parë i të cilave u botua kohët e fundit). Edhe materialet e vëllimeve «Ditar për çështje të brendshme» do të nxirren nga «Ditari politik» i shokut Enver Hoxha dhe kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij të përditshme, me shënime për mbledhjet e forumeve të Partisë, me vizita

pune në rrethe të ndryshme të vendit, me takime e biseda me popullin, me punëtorë e kooperativistë, me komunistë e kuadro të sektorëve të ndryshëm në qendër e në bazë. Në to janë shprehur mendime dhe janë dhënë përshtypje e konkluzione për probleme të rëndësishme në fusha e sektorë të ndryshëm politikë, ekonomikë, ushtarakë, kulturorë e shkencorë dhe për çështje shoqërore.

Si në ditarin për çështje ndërkombëtare, ashtu edhe në atë për çështje të brendshme, janë lënë jashtë fakte e shënime me karakter politik e organizativ sekret, që ruhen në arkivin e Komitetit Qendror të Partisë ose shënime nga jeta personale, që ruhen në arkivin familjar.

Vëllimi i parë i «Ditarit për çështje ndërkombëtare», përfshin vitet 1958-1960, kurse vëllimi i parë i «Ditarit për çështje të brendshme» përfshin vitet 1955-1961, nga koha që janë filluar të mbahen këto shënime dhe ashtu siç janë mbajtur qoftë dhe shumë shkurt. Në vitet e ardhshme kalohet nga shënimet e shkurtra në refleksione e analiza, të cilat u japin këtyre vëllimeve një vlerë e rëndësi të veçantë e që dalin nga kuadri i një ditari të zakonshëm.

Botimi i këtyre vëllimeve përkrah Veprave në seri të shokut Enver Hoxha, si edhe i veprave të tjera të tij, do të ndihmojë komunistët e lexuesit e tjerë të kuptojnë më thellë probleme të vijës e të veprimtarisë së Partisë sonë për ngjarje të brendshme e ndërkombëtare.

Shënimet plotësuese, referencat e ndryshme për persona, ngjarje, data, si dhe treguesit në fund të vëllimeve janë të redaksisë. Edhe një pjesë e titujve, të nxjerra nga teksti i shënimeve, janë gjithashtu të redaksisë.

Prill 1981

1958



[Faint, mostly illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the page.]

1958



1958
1 JANAR 1958

**E MËRKURË
1 JANAR 1958**

**INTERVISTË E GAZETËS «SOVJETSKAJA
ROSIJA»**

Gazeta «Sovjetskaja Rosija» boton sot përgjigjet e mia dhënë pyetjeve të redaksisë së kësaj gazete.

I. V. I.

TAKIM ME AMBASADORIN SOVJETIK

Prita ambasadorin sovjetik Ivanov¹, i cili më informoi mbi politikën e NATO-s për vendosjen e raketave në Itali dhe më propozoi që të koordinojmë fushatën tonë propagandistike kundër këtij veprimi.

¹ V. I. Ivanov.

BISEDE ME AMBASADORIN KOREAN

Takova ambasadorin korean¹, i cili u kthye nga Koreja. Më informoi për mbledhjen e plenumit të muajit dhjetor të vitit të kaluar të KQ të Partisë së tyre.

Në këtë plenum u miratuan dokumentet e Mbledhjes së Moskës të vitit 1957, u analizua realizimi i planit ekonomik i vitit 1957 dhe u ripohua vendimi i drejtë i marrë kundër bandës së Kim Du Bonit.

¹ Lim Çun Çu.

HIDROCENTRALIT TË ULZËS T'I JEPET EMRI «KARL MARKS»

Byrosë Politike të KQ të Partisë i dërgova sot një letër¹ me anën e së cilës u lutem shokëve që Hidrocentralit të Ulzës, mbi lumin e Matit, i cili do të inaugurohet më 11 janar të këtij viti, t'i ndryshohet emri që i është vënë dhe të marrë emrin e themeluesit dhe mësuesit të lavdishëm të komunizmit ndërkombëtar, Karl Marks.

¹ Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 151.

NGUSHËLLIME PËR VDEKJEN E P. GROZËS

Shkuam në ambasadën rumune dhe ngushëlluam ambasadorin për vdekjen e Petru Grozës¹.

¹ Petru Groza (1884-1958), personalitet politik rumun; në vitet e fundit të jetës ishte president i Presidiumit të Asamblesë së Madhe Kombëtare të RP të Rumanisë.

SOVJETIKËT NA DËRGOJNË PROJEKTPROPOZIMET E TYRE PËR ULJEN E TENSIONIT

NDËRKOMBËTAR

Ambasadori sovjetik Ivanov, në takim të përbashkët me të, më dorëzoi projektpropozimet sovjetike për organizimin e një mbledhjeje të nivelit të lartë. Sovjetikët propozojnë që në këtë mbledhje të marrin pjesë shtetet anëtare të Paktit të Atlantikut të Veriut (NATO), të Traktatit të Varshavës, si dhe disa vende që nuk bëjnë pjesë në grupet e përmendura, e të gjithë së bashku të bisedojnë për «uljen e tensionit ndërkombëtar». Por në realitet po shohim të kundërtën: sa më shumë u bëhet thirrje imperialistëve për «mirëkuptim», aq më tepër ngrihet tensioni e acarohet gjendja ndërkombëtare.

TAKIM ME AMBASADORIN SOVJETIK

U takova me ambasadorin sovjetik, i cili shkon këto ditë në Moskë për të marrë pjesë në zgjedhjet e Sovjetit Suprem. Është deputet i federatës ruse.

**AMBASADORI SOVJETIK NUK THOTË ASGJË
MË SHUMË NGA Ç'THOTË SHTYPI**

Ambasadori sovjetik Ivanov u kthye nga Moska dhe sot u takova me të.

Nuk më tha ndonjë gjë të re, përveç atyre që i kam lexuar në gazetat e në buletinet e lajmeve.

**U HAP EKSPOZITA SOVJETIKE MBI
ENERGJINË ATOMIKE**

Morëm pjesë në inaugurimin e ekspozitës sovjetike kushtuar përdorimit të energjisë atomike për qëllime paqësore dhe në mbrëmje shkuam për darkë në ambasadën sovjetike me rastin e çeljes së kësaj ekspozite.

**BISEDE ME KRYETARIN E KOMITETIT EKZEKUTIV
TË KP TË TIRANËS PAS KTHIMIT
NGA KAJROJA**

Bisedova me kryetarin e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Tiranës që u kthye nga Kajroja, ku kishte vajtur për t'i kthyer vizitën guvernatorit të këtij qyteti.

**QËNDRIMET ARMIQËSORE TË UDHËHEQJES
JUGOSLLAVE NDAJ VENDIT TONË
JANË TË VJETRA**

Lexova një material që është paraqitur si pjesë e një teme që do të zhvillohet në format e arsimit të Partisë. Porosita shokët që të mbajnë parasys shënimet që kam vënë në disa faqe të tij e që kanë të bëjnë me përmendjen shkurtimisht të veprimeve e të qëllimeve armiqësore të revizionistëve jugosllavë ndaj vendit tonë dhe Partisë sonë. Problemet që ngre në shënimet mund të zhvillohen më gjatë me gojë. Shënova, gjithashtu, që të theksohet se qëndrimet e udhëheqësve revizionistë jugosllavë karshi Partisë sonë, kanë qenë me prapamendime armiqësore që në vitet e Luftës sonë Nacionalçlirimtare.

Tema do të botohet edhe në broshurë.

E ENJTE
20 SHKURT 1958

TAKIM ME NJË UDHËHEQËS TË PK TË MARTINIKËS

Takova anëtarin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Martinikës, Armand Nikolas, që kishte ardhur për vizitë miqësore në Shqipëri. Ishte i kënaqur, i entuziazmuar dhe tha se fitoi shumë nga ç'pa në vendin tonë.

E SHTUNË
22 SHKURT 1958

MBLEDHJE SOLEMNE PËR 40-VJETORIN E USHTRISË E TË FLOTËS USHTARAKE SOVJETIKE

Asistova në mbledhjen solemne që u organizua në sallën e Teatrit të Operës e të Baletit me rastin e 40-vjetorit të krijimit të ushtrisë dhe të Flotës Ushtarake Detare të Bashkimit Sovjetik.

PRITJE NË AMBASADËN SOVJETIKE

Pritje në ambasadën sovjetike me rastin e 40-vjetorit të Ushtrisë e të Flotës Ushtarake Detare Sovjetike. Ngrita dolli për ushtrinë e lavdishme të Bashkimit Sovjetik.

SHENJA FLIRTI HRUSHOV-AJZENHAUER

Erdhi i ngarkuari me punë i Bashkimit Sovjetik, Novikov, natën, dhe më komunikoi se gjoja ka shpresa që Ajzenhaueri pranon takim dhe bisedime me Hrushovin.

TAKIM ME AMBASADORIN ÇEKOSLLOVAK

Prita ambasadorin çekoslovak¹ me rastin e largimit të tij nga Shqipëria.

¹ Jan Tebuh.

SHOKU HYSNI NISËT PËR NË MOSKË

Hysniu u nis sot për në Moskë në krye të një delegacioni partie për shkëmbim eksperience.

INFORMIM FORMAL I AMBASADORIT SOVJETIK

Takim me ambasadorin sovjetik Ivanov, që u kthye nga Moska. Më informoi për ngjarje të ndryshme që kanë ndodhur atje. Nga shtypi ne kemi marrë vesh më shumë e më gjerë nga sa më tha ai.

MORËM NË DORËZIM GJUAJTËSIT E FLOTËS DETARE USHTARAKE

Ceremoni në Portin e Durrësit, ku u morën në dorëzim gjuajtësit ushtarakë të flotës sonë detare.
Drekë me oficerët e marinës, shqiptarë e sovjetikë.

SOVJETIKËT NJOFTOJNË PËR NDRYSHIMET NË QEVERINË E TYRE¹

Takim me ambasadorin sovjetik Ivanov, i cili më njoftoi mbi ndryshimet që u bënë sot në qeverinë sovjetike¹ dhe për politikën e tyre atomike.

¹ Më 27 mars 1958, në një mbledhje të Sovjetit Suprem të Bashkimit Sovjetik, N. Bulganini u shkarkua nga detyra e kryetarit të Këshillit të Ministrave të BS dhe këtë post e mori N. S. Hrushovi.

shprehjet e shtetit në [MARS 1958] për
shprehjet e shtetit në [MARS 1958] për
shprehjet e shtetit në [MARS 1958] për

NJË DOKUMENT I RI TROCKIST-REVIZIONIST I TITISTËVE

Lexova tekstin e përkthyer të projektprogramit të së ashtuquajturës Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, botuar këto ditë në Beograd. Ai është një dokument trockist-revizionist i titistëve jugosllavë. Npërmjet tij Titoja përpigjet të revizionojë teorinë e marksizëm-leninizmit dhe të «shpjegojë shkencërisht» fenomenet e reja të kohës.

Gjatë leximit, në faqet e projektit, kam shënuar shumë vërejtje kritike ndaj këtij dokumenti të ri «neomark-sist». Duhet demaskuar me forcë përpjekjet që bën Titoja për të na ndaluar të kritikojmë revizionizmin titist, që do të thotë neorevizionizëm, e ta lëmë atë të lirë të kritikojë marksizëm-leninizmin. Jo! Këtë ne nuk do ta lejojmë kurrë.

Lidhur me disa nga tezat antimarksiste e antishkencore të titistëve:

— Revizionistët e vjetër pretendonin se krizat bëheshin gjithnjë e më të rralla, më të dobëta, dhe sigurisht, sipas tyre, kartelet dhe trustet do ta lejonin kapitalin t'i zhdukte krejtësisht ato.

Këtë teori e zhvillojnë edhe teoricienët e sotëm të imperializmit, dhe tok me ta edhe revizionistët e rinj, të cilët pretendojnë se ky moment tash është arritur dhe rezultatet janë «të dukshme».

— Revizionistët e vjetër, të cilët i ka djegur me zjarr

Lenini, pretendonin se gjoja antagonizmi i klasave ka tendenca të pakësohet, të zhduket.

Revizionistët e rinj të ngjyrës Tito-Kardel mbrojnë tezën e teoricienëve imperialistë se në stadin aktual të kapitalit monopolist, kjo gjë, pra zhdukja e antagonizmit klasor, po arrihet, për arsye të forcimit të kapitalizmit shtetëror monopolist!

— Revizionistët e vjetër pretendonin se që nga momenti kur shteti bëhet «demokratik», është «vullneti i shumicës» ai që dominon, prandaj, pas vendosjes së demokracisë, sipas tyre, nuk mundet, ose nuk duhet të shikohet më shteti si një organizëm dominimi klasor, as të refuzohen aleancat me borgjezinë progresive, socialreformiste dhe as të luftohet kundër reaksionarëve.

Të gjitha këto s'janë veçse koncepte liberale. Prandaj të flasësh e, ca më tepër, të kërkosh «aleancë dhe bashkëpunim» midis nesh dhe Tito-Kardelit, revizionistë me patentë, do të thotë që marksistë-leninistët të pajtoheshin me taktikën e socialistëve të Mileranit¹ dhe të kadetëve rusë.

— Tito-Kardel, këta bernshtajnianë të rinj, kanë bërë të tyren fjalët e këtij revizionisti të vjetër: «Qëllimi i

¹ A. Mileran (1859-1943). Duke qenë anëtar i Partisë Socialiste Franceze, më 1899 hyri në qeverinë reaksionare të Valdek Rusosë dhe si anëtar i qeverisë dhe më pas si kryeministër e president i republikës përkrahu dhe ndihmoi politikën shtypëse të borgjezisë. Ka afirmuar domosdoshmërinë e njëfarë shoqërizimi të mje-teve të prodhimit, por ka qenë edhe mbrojtës i pronës private. Pjesëmarrjen e Mileranit në qeverinë borgjeze, që ishte shprehje e qartë e politikës së bashkëpunimit klasor me borgjezinë, udhëheqësit oportunistë të Partisë Socialiste Franceze dhe ata të Internacionales II nuk e dënuan. Vetëm Lenini e demaskoi këtë shfaqje të parë praktike të revizionizmit, që tradhtonte haptazi interesat e proletariatit.

fundit s'është asgjë, lëvizja është gjithçka». Ata sakrifikojnë interesat jetike të proletariatit për dollarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për avantazhet reale ose të supozuara të çastit.

— Revizionistët i konsiderojnë reformat që ndërmerr në favor të saj borgjezia si realizim të pjesshëm të socializmit.

Sipas Marksit vetëm shkenca mund t'i përgjigjet pyetjes se cilat funksione shoqërore do të qëndrojnë analoge me funksionet e shtetit aktual dhe problemi nuk mund të avancohet duke bashkuar qoftë në një mijë mënyra fjalën «popull» me fjalën «shtet».

Pikërisht këto «kërcime» bëjnë Tito-Kardel në projektprogramin e tyre të së ashtuquajturës Lidhje të Komunistëve të Jugosllavisë.

Projektprogrami dhe shënimet e mia mbi të ndodhen në Arkivin Qendror të Partisë.

PRITJE NË AMBASADËN HUNGAREZE

Asistova në pritjen e dhënë nga ambasadori hungarez me rastin e ditës së çlirimit të Hungarisë. Ambasadori Zhatkullak mbajti një fjalim. Përshëndeta edhe unë.

LËKUNDJE TË RREZIKSHME TË SOVJETIKËVE

Prita ambasadorin sovjetik Ivanov. Më tha se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik nuk do të çojë delegacion në kongresin e ardhshëm të titistëve.

Shumë hezitime kanë pasur sovjetikët për këtë çështje. Ky qëndrim i tyre ka bërë që edhe të tjerë të lëkundeshin, përveç nesh që e kemi pasur, e kemi dhe do ta kemi kurdoherë të qartë tradhtinë e titistëve. Sovjetikët dhe disa të tjerë s'janë hiç në të për këtë çështje të madhe ideologjike.

TAKIM ME AMBASADORIN SOVJETIK DHE ATË KINEZ

Takim me ambasadorin kinez¹. Më njoftoi se ata nuk marrin pjesë në Kongresin e 7-të të titistëve. Ky qëndrim i Partisë Komuniste të Kinës është në rregull.

Takim me ambasadorin sovjetik², i cili më komunikoi se mbledhja e Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke shtyhet.

1 Lo Shi Gao.
2 V. I. Ivanov.

NUK DO TË MARRIM PJESE NË KONGRESIN E LK TË JUGOSLLAVISË

Takim me ambasadorin sovjetik Ivanov. I dorëzova kopjen e letrës që u dërguam jugosllavëve lidhur me ftesën që na bënë për të marrë pjesë në Kongresin e 7-të të LKJ.

Në këtë letër, pasi vëmë shkurtimisht në dukje se në projektprogramin e tyre shumë teza të rëndësishme të marksizëm-leninizmit janë revizionuar, se janë bërë vlerësime jo të drejta mbi lëvizjen komuniste ndërkombëtare e të tjera, njoftojmë se nuk do të marrim pjesë në kongresin e LKJ.

E ENJTE
17 PRILL 1958

PRITJE NË AMBASADËN SOVJETIKE

Pritje në ambasadën sovjetike me rastin e përvjetorit të parë të nënshkrimit të marrëveshjes ekonomike në Moskë në mes Qeverisë së RP të Shqipërisë dhe asaj të Bashkimit Sovjetik. Shkëmbyem fjalime ambasadori Ivanov dhe unë.

E MËRKURË
30 PRILL 1958

KONGRES I TROCKISTËVE JUGOSLLAVË

Teza të zgjeruara për një artikull demaskues mbi Kongresin e 7-të të së ashtuquajturës Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë¹, i cili u përgatit në frymën e projekt-programit trockist të klikës Tito-Kardel të publikuar në fillim të muajit mars të këtij viti në Beograd:

1) **Rrugë e vjetër oportunisto-revizioniste.** Teorizimet rreth kësaj vije dhe vendosmëria e titistëve që të mos lëvizin, të mos korrigjojnë gabimet, por t'i vazhdojnë ato.

2) **Tentativat e udhëheqësve jugosllavë që teoritë e tyre antimarksiste të fitojnë «të drejtën e qytetarisë»** në teorinë marksiste-leniniste dhe në praktikën e ndërtimit të socializmit.

3) **Në Jugosllavi pseudomarksistët janë në fuqi.** Ky është moment specifik i luftës së revizionistëve të sotëm kundër marksizëm-leninizmit. Në dallim nga revizionistët e mëparshëm, revizionistët jugosllavë janë në pushtet. Jugosllavia gjoja socialiste është bërë prej tyre një repart antimarksist, flet me gjuhë gjoja marksiste nga pozitat e një shteti gjoja socialist.

4) **Tito-Kardeli «komunizmin nacional» e predikojnë si një vijë «internacionale».**

5) **Socializmi askund nuk mund të ndërtohet duke për-**

¹ Enver Hoxha, Vepra, vëll. 15, f. 398.

gafuar teoritë antimarksiste dhe duke zbatuar në jetë këto teori antimarksiste.

— Si e kanë deformuar jugosllavët teorinë marksiste-leniniste mbi partinë, mbi diktaturën e proletariatit, mbi internacionalizmin proletar.

— «Teoritë» e Titos mbi shtetin, mbi demokracinë direkte, mbi këshillat e punëtorëve dhe mbi ndërtimin specifik të socializmit në fshat.

— Shteti jugosllav dhe LKJ janë shtet dhe parti antimarksiste, të tillë do ta kenë ata edhe politikën e jashtme.

— Këtë e vërtetojnë qëndrimet e tyre. Këtë e vërteton projektprogrami. Këtë e vërtetojnë fjalimet e Tito-Rankoviç-Kardelit.

— Çdo qëndrim i tyre, gjoja i drejtë e në dukje i favorshëm, s'mund të jetë veç një bluf. Qëndrime të tilla kanë vetëm efekt mashtrues, janë veprime koniunkturale të revizionistëve që synojnë të dobësojnë dhe të evitojnë goditjet tona. Ato janë qëndrime «tampon», janë manovrimet për të gënjyer, për të amortizuar goditjet, për të fituar kohë.

6) Antimarksizmi i jugosllavëve tashmë është më se i qartë. Ai ka kaluar në shumë faza, është zhvilluar e thelluar dhe s'është një mosmarrëveshje e vogël, siç e quajnë disa. Janë bërë shumë tentativa për afrim me titistët, për «ndreqjen» e tyre, por më kot. Ne këtë e kemi pasur të qartë kurdoherë. Përballë nesh nuk mund të kemi të ashtuquajtur shokë. Ne na ndan me ta një hendek i pakapërcyeshëm dhe këtë hendek nuk e krijuam ne, por e krijuan vetë Titoja me grupin e tij.

7) Të demaskojmë reagimin antimarksist të jugosllavëve ndaj kritikave tona të drejta e të mos e konsiderojmë sulmin e tyre si polemikë. Kongresi i tyre s'është gjë tjetër veçse sulm i hapët ndaj marksizëm-leninizmit. Ai

s'bie fare erë polemikë. Për kritikë parimore nga ana e tyre as që bëhet fjalë.

8) Revizionistët jugosllavë kërkojnë që ne të bashkëjetojmë nga ana ideologjike me ta. Kjo është e pamundur. Titistët atakojnë dhe revizionojnë marksizëm-leninizmin. Kjo nuk mund të lejohet dhe nuk mund të mos luftohet nga të gjithë ne me ashpërsinë më të madhe.

Revizionistët jugosllavë atakojnë sistemet tona shtetërore. Kjo nuk mund të lejohet. Duhet luftë e ashpër ndaj goditjeve të tyre.

Titistët thonë se gjoja ndërtojnë socializmin dhe bollëkun me sistemin e tyre «të bukur». A do ta pranojmë këtë gënjeshtëri? Në asnjë mënyrë! Të pranosh mashtrimin e tyre do të thotë t'u vish në ndihmë. Duhet të bëhet njëllloj si izolimi ideologjik edhe ai ekonomik. Dhënia e ndihmës ekonomike renegatëve jugosllavë do të thotë t'i zgjatësh jetën një regjimi që synon të bëjë punën që thamë më lart.

Të luftohet ideologjikisht, dhe në të njëjtën kohë të ndihmohet ekonomikisht, siç thonë disa, kjo s'ka asnjë logjikë dhe s'është aspak në rrugën marksiste.

Në artikull, meqë është për publik dhe për arsyet që ne dimë, do të bëhet kujdes.

— Të jepet në masën e duhur fryma polemike.

DARKE PËR HAJNRIK RAUN

Darkë për nder të shokut Hajnrik Rau, zëvendëskryeministër i Republikës Demokratike Gjermane, i cili ndodhet për pushime në Shqipëri,

TAKIM ME MIQ ARABË

Bashkë me shokun Mehmet pritëm miqtë arabë që kanë ardhur në Shqipëri të ftuar nga komisioni ynë për gatitor për krijimin e Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Vendet Arabe.

NË DARKËN E DHËNË PËR MIQTË ARABË

Mora pjesë në darkën që shtroi Mehmeti për nder të delegacioneve të vendeve arabe që ndodhen në vendin tonë.

AKTIVITETE POLITIKE

Prita ambasadorin e ri të Çekosllovakisë¹.

Takim me ambasadorin kinez².

Mora pjesë në pritjen e dhënë nga delegacionet arabe me rastin e qëndrimit të tyre në vendin tonë.

1 Frantishek Malik.

2 Lo Shi Gao.

**PRITJE NGA ÇEKOSLLOVAKËT ME RASTIN
E FESTËS SË TYRE**

Asistova në pritjen e dhënë nga ambasadori çekoslllovak me rastin e festës së tyre të çlirimit.

DARKE PËR DIPLOMATË SOVJETIKË

Patëm për darkë miqësore shokë sovjetikë me në krye ambasadorin e tyre në Tiranë.

MBRËMJE E MIQËSISË SHQIPTARO-SOVJETIKE

Shkuam në mbrëmjen e shkollave të kryeqytetit kush-tuar miqësisë shqiptaro-sovjetike.

NJË KRITIKË ME PAMBUK NDAJ REVIZIONISTËVE JUGOSLLAVË

Takim me ambasadorin sovjetik¹. Më dorëzoi një letër të gjatë që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u dërgon titistëve lidhur me Kongresin e tyre të 7-të.

Pasi «kritikon me pambuk» projektprogramin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë për përmbajtjen e tij antimarksiste si dhe disa qëndrime antisovjetike të revizionistëve jugosllavë, KQ i PK të BS njofton se nuk do të dërgojë delegacion në Kongresin e 7-të të LKJ, «për të mos shkaktuar një polemikë të ashpër» me ta.

1 V. I. Ivanov.

TAKIM ME MINISTRIN FUQIPLOTË TË INDISË JUGOSLLAVË

Prita të dërguarin e jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiptotë të Republikës së Indisë në RP të Shqipërisë, Kub Çand.

REVIZIONIZMI JUGOSLLAV DUHET DEMASKUAR PA MËSHIRË DHE PA LEJUAR ASNJË KOMPROMIS

Sot hodha në letër këto teza të zgjeruara për një artikull që mund të ketë titullin «Revizionizmi jugosllav duhet demaskuar pa mëshirë dhe pa lejuar asnjë kompromis me të». Artikulli mendoj të botohet në gazetën «Zëri i popullit»¹.

1) Me citate të Leninit kundër oportunistëve t'i futet sëpata e madhe në kokë revizionizmit në Jugosllavi. Të vihet në dukje se këtu, në Jugosllavi, bernshtajnzimi ka ngritur krye.

2) Revizionizmi jugosllav s'ka vetëm tiparet e bernshtajnzimit, por ai ka adoptuar të gjitha format, metodat e qëllimet e trockizmit. Të përmendet emri i Stalinit dhe të mbrohet ai si revolucionar e marksist i shquar.

3) Revizionizmi depërtoi në Partinë Komuniste Jugosllave, gënjeu masat e partisë dhe u afirmua duke marrë në dorë fuqinë shtetërore. Nga këto pozita udhëheqja jugosllave, me veprimtarinë e saj të gjatë, u vetafirmua kreshendo edhe si udhëheqja më aktive dhe më agresive e revizionizmit modern.

4) Qëllimet e revizionizmit jugosllav, me kë bashkëpunon ai dhe kujt i shërben (citime nga vetë ata).

5) Bernshtajni, Kautcki e kompani u orvatën të revizi-

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 40.

ziononin marksizmin dhe të forconin e të përjetësonin jetën e borgjezisë.

Trockistët u orvatën të likuidonin partinë e lavdishme dhe shtetin sovjetik. Revizionizmi jugosllav ka marrë përsipër të likuidojë kampin e socializmit, të përçajë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

6) Të numërohen veprimet e tyre të poshtra dhe këtu të theksohet mirë se këto veprime ata i kanë filluar para vitit 1948, pra të dalë qartë se revizionizmi jugosllav kishte nxjerrë brirët me kohë. Të theksohet se kritikrat e 1948-s qenë plotësisht të drejta. As mashtrojmë dhe as trembim njeri, se ne gjoja po bëkemi një «gjynah» meqë themi këto të vërteta për këta pseudomarksistë.

Të bëhet paralelizmi midis veprimtarisë së udhëheqjes jugosllave para 1948-s te ne, me veprimtarinë e tyre në çështjen hungareze më 1956.

T'i jepet përgjigjja e duhur pretendimit të tyre se «po fillohet si më 1948-n». «Zemërimi» i tyre synon të mbulojë veprimet antimarksiste e agresive që po bëjnë jo vetëm në fushën ideologjike, por edhe në atë praktike. Shantazhet dhe kërcënimet e Titos s'trembin dhe s'gënjejnë njeri.

7) Të dalë mirë, nga njëra anë, qëndrimi ynë i durueshëm pas gjithë atyre të këqijave që na kishin bërë, para e pas 1948-s, pas Hungarisë, pas Pulas dhe, nga ana tjetër, veprimtaria e tyre e përhershme minuese ndaj vendit tonë. Kjo u duk qartë edhe gjatë periudhës së përpjekjeve tona për t'i bërë udhëheqësit jugosllavë të kuptonin gabimet e tyre të tmerrshme antishqiptare.

Ata kujtuan se fituan, kujtuan se ne ishim të dobët dhe me projektprogramin në kongresin e tyre të fundit u hodhën në sulm më të hapët.

8) Disfata e tyre, uniteti ynë, lufta e pamëshirshme. Citate të «Pravdës» e të «Zhenminzhibaos».

9) Taktika e tyre: veprimet e tyre armiqësore ata kër-

kojnë t'i kalojnë në heshtje, si në gjalpë. Toni i tyre arrogant dhe provokues. Orvatjet për të na përçarë.

10) Orvatjet e tyre për të krijuar fuqinë e tretë; gjoja qëndrime pro politikës së kampit tonë për të gënjyer të lëkundurit dhe për t'u maskuar vetë. Marrja e ndihmave nga amerikanët. Nga njëra anë, prerja e bujshme e marrëdhënieve me Gjermaninë Perëndimore dhe, nga ana tjetër, marrja e kredive po nga gjermanoperëndimorët.

11) E dimë si «do t'i shpjegojnë» ata këto veprime tradhtie: gjoja për arsye të «bllokadës» sonë, por kjo nuk duhet kurrsesi të gënjejë njeri.

12) Rruga e tyre është rruga e tradhtisë së komunizmit; ata po i shërbejnë imperializmit amerikan, NATO-s; ata kanë hyrë kokë e këmbë në rrugën e socialshovinitëve borgjezë.

13) Mendimi ynë i qartë nëse ndërtohet ose jo socializmi në Jugosllavi.

14) Neve na vjen keq për popullin vëlla jugosllav, për shokët komunistë të vërtetë jugosllavë që shikojnë se përpjekjet dhe gjaku i tyre po shfrytëzohen nga grupi revizionist i udhëheqjes jugosllave në dëm të atdheut të tyre.

15) Demaskimi përfundimtar i revizionizmit jugosllav është jetik për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, është ndihma më e madhe dhe e vetme që u jepet popullit jugosllav dhe marksistë-leninistëve të vërtetë jugosllavë.

16) Kjo është një detyrë internacionaliste nga ana e çdo partie të vërtetë marksiste-leniniste. Grupi i Titos do të na akuzojë ne se ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë. Kjo është kënga e njohur dhe e vjetër e kënduar nga grupi titist për të fshehur komplotet e veta të kaluara dhe të ardhshme.

17) Ne kemi menduar dhe mendojmë se atdheu, liria dhe fitoret e socializmit në vendin tonë duhen mbrojtur me çdo kusht dhe do t'i mbrojmë përjetë.

Ne kemi menduar dhe mendojmë se miqësia me Bash-

kimin Sovjetik dhe me kampin e socializmit duhet mbrojtur.

Ne kemi menduar dhe mendojmë se idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit duhet t'i mbrojmë me guxim dhe do t'i mbrojmë kurdoherë e në çdo rrethanë.

Marksizëm-leninizmi do të fitojë si kurdoherë.

18) Ne kemi një përvojë të madhe për të luftuar revizionizmin, nën çdo taktikë që të paraqitet dhe kudo që të paraqitet.

Ne do t'i mbajmë të pastra radhët e Partisë nga elementët e lëkundshëm në vijë dhe të pabesë.

Në qoftë se revizionistët dhe dashamirësit e tyre mendojnë se lufta jonë kundër tyre do të na bëjë të preokupohemi vetëm me ata dhe do të harrokemi ndërtimin e socializmit në vendin tonë, gabohen rëndë. Lufta jonë do të jetë po aq e fortë në të dy frontet, dhe në të dy frontet ne do të fitojmë.

Në rast se ata mendojnë se do të lozin me nervat tona, përsëri gabohen, pse nervat tona janë të forta dhe në luftë ato kaliten edhe më shumë.

Politika e shtetit dhe e Partisë sonë ndaj Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe partisë së saj ka qenë kurdoherë e drejtë dhe e bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit.

Kjo politikë kurdoherë ka synuar e do të synojë edhe paskëtaj që të mbahen marrëdhënie të fqinjësisë së mirë në bazë të pesë parimeve të njohura të bashkekzistencës paqësore.

Ne përpara kemi pasur edhe marrëdhënie partie, të cilat, për fajin e udhëheqjes së ish-Partisë Komuniste Jugosllave, tash Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, degjeneruan nga ana e tyre në një punë antimarksiste, në një politikë nacionaliste-borgjeze dhe jomiqësore.

Janë të njohura prej të gjithëve qëllimet dhe synimet shoviniste të udhëheqjes jugosllave ndaj vendit dhe Par-

tisë sonë, si dhe metodat e dënueshme antimarksiste të përdorura prej tyre. Njihet plotësisht, gjithashtu, lufta e vendosur heroike e Partisë dhe e popullit tonë ndaj veprimtarisë antishqiptare të udhëheqjes jugosllave dhe likuidimi total i asaj pune armiqësore.

Në dritën e këtyre veprimeve të faktuara dhe të shumë të tjerave, Partia jonë jo vetëm kishte arsye ta aprovonte dhe ta quante plotësisht të drejtë kritikën parimore marksiste-leniniste që Byroja Informativë i bëri Partisë Komuniste të Jugosllavisë në vitin 1948, por ajo nuk e ndryshoi pikëpamjen e vet mbi këtë çështje as pas 1948-s dhe as pas përmirësimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë në vitin 1955.

Jeta tregoi se Partia jonë kishte të drejtë. Si një parti leniniste e tipit të ri, Partia jonë bëri të gjitha përpjekjet për të rivendosur në rrugë të drejtë marrëdhëniet shtetërore me Jugosllavinë.

Ne kemi konsideruar dhe vazhdojmë të konsiderojmë se përpjekjet për të likuiduar mosmarrëveshjet shtetërore me Jugosllavinë, nuk duhet të shërbejnë si shkas për të lëshuar në parimet e marksizëm-leninizmit.

Partia jonë ishte një nga ato parti që, megjithëse kishte vuajtur më tepër se çdo parti tjetër, deklaroi sinqerisht se ishte gati të përmirësonte marrëdhëniet shtetërore me Jugosllavinë në bazë të parimeve e normave të njohura.

Dihen nga të gjithë përpjekjet dashamirëse të Partisë dhe të Qeverisë sonë, qoftë në lëmin tregtar, qoftë në marrëdhëniet kulturore artistike, të bëra në drejtim të Jugosllavisë. Por udhëheqja jugosllave jo vetëm bëri vazhdimisht veshin e shurdhër, jo vetëm vazhdoi sulmet me të gjitha mjetet dhe mënyrat kundër vendit tonë, kundër Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj, por u përpoq me çdo mjet që të na gjunjëzonte. Natyrisht udhëheqja jugosllave kishte gabuar adresë, pse kjo praktikë gjatë gjithë

kimin Sovjetik dhe me kampin e socializmit duhet mbrojtur.

Ne kemi menduar dhe mendojmë se idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit duhet t'i mbrojmë me guxim dhe do t'i mbrojmë kurdoherë e në çdo rrethanë.

Marksizëm-leninizmi do të fitojë si kurdoherë.

18) Ne kemi një përvojë të madhe për të luftuar revizionizmin, nën çdo taktikë që të paraqitet dhe kudo që të paraqitet.

Ne do t'i mbajmë të pastra radhët e Partisë nga elementët e lëkundshëm në vijë dhe të pabesë.

Në qoftë se revizionistët dhe dashamirësit e tyre mendojnë se lufta jonë kundër tyre do të na bëjë të preokupohemi vetëm me ata dhe do të harrokemi ndërtimin e socializmit në vendin tonë, gabohen rëndë. Lufta jonë do të jetë po aq e fortë në të dy frontet, dhe në të dy frontet ne do të fitojmë.

Në rast se ata mendojnë se do të lozin me nervat tona, përsëri gabohen, pse nervat tona janë të forta dhe në luftë ato kaliten edhe më shumë.

Politika e shtetit dhe e Partisë sonë ndaj Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe partisë së saj ka qenë kurdoherë e drejtë dhe e bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit.

Kjo politikë kurdoherë ka synuar e do të synojë edhe paskëtaj që të mbahen marrëdhënie të fqinjësisë së mirë në bazë të pesë parimeve të njohura të bashkekzistencës paqësore.

Ne përpara kemi pasur edhe marrëdhënie partie, të cilat, për fajin e udhëheqjes së ish-Partisë Komuniste Jugosllave, tash Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, degjeneruan nga ana e tyre në një punë antimarksiste, në një politikë nacionaliste-borgjeze dhe jomiqësore.

Janë të njohura prej të gjithëve qëllimet dhe synimet shoviniste të udhëheqjes jugosllave ndaj vendit dhe Par-

tisë sonë, si dhe metodat e dënueshme antimarksiste të përdorura prej tyre. Njihet plotësisht, gjithashtu, lufta e vendosur heroike e Partisë dhe e popullit tonë ndaj veprimtarisë antishqiptare të udhëheqjes jugosllave dhe likuidimi total i asaj pune armiqësore.

Në dritën e këtyre veprimeve të faktuara dhe të shumë të tjerave, Partia jonë jo vetëm kishte arsye ta aprovonte dhe ta quante plotësisht të drejtë kritikën parimore marksiste-leniniste që Byroja Informativë i bëri Partisë Komuniste të Jugosllavisë në vitin 1948, por ajo nuk e ndryshoi pikëpamjen e vet mbi këtë çështje as pas 1948-s dhe as pas përmirësimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë në vitin 1955.

Jeta tregoi se Partia jonë kishte të drejtë. Si një parti leniniste e tipit të ri, Partia jonë bëri të gjitha përpjekjet për të rivendosur në rrugë të drejtë marrëdhëniet shtetërore me Jugosllavinë.

Ne kemi konsideruar dhe vazhdojmë të konsiderojmë se përpjekjet për të likuiduar mosmarrëveshjet shtetërore me Jugosllavinë, nuk duhet të shërbejnë si shkas për të lëshuar në parimet e marksizëm-leninizmit.

Partia jonë ishte një nga ato parti që, megjithëse kishte vuajtur më tepër se çdo parti tjetër, deklaroi sinqerisht se ishte gati të përmirësonte marrëdhëniet shtetërore me Jugosllavinë në bazë të parimeve e normave të njohura.

Dihen nga të gjithë përpjekjet dashamirëse të Partisë dhe të Qeverisë sonë, qoftë në lëmin tregtar, qoftë në marrëdhëniet kulturore artistike, të bëra në drejtim të Jugosllavisë. Por udhëheqja jugosllave jo vetëm bëri vazhdimisht veshin e shurdhër, jo vetëm vazhdoi sulmet me të gjitha mjetet dhe mënyrat kundër vendit tonë, kundër Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj, por u përpoq me çdo mjet që të na gjunjëzonte. Natyrisht udhëheqja jugosllave kishte gabuar adresë, pse kjo praktikë gjatë gjithë

historisë s'ka qenë kurrë zakon i popullit shqiptar dhe as i Partisë sonë dhe i anëtarëve të saj që kanë dalë nga gjiri i këtij populli dhe janë mbrojtur me teorinë e marksizëm-leninizmit. Shantazhet dhe kërcënimet e udhëheqësve jugosllavë ndaj Partisë sonë, natyrisht, i mori era. Partia jonë qëndroi e fortë si graniti në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, në mbrojtje të komunizmit, në mbrojtje të atdheut, në mbrojtje të kampit të socializmit, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik.

Josip Broz Titoja në fjalimin që mbajti në Pula jo vetëm mbrojtë kundërrevolucionin në Hungari, jo vetëm mbrojtë haptazi tradhtarit e popullit hungarez dhe të komunizmit, Imre Nagin dhe bandat e tij, por sulmoi dhe paralajmëroi edhe sulme të tjera kundër marksizëm-leninizmit, kundër kampit të socializmit, kundër Bashkimit Sovjetik, kundër vendeve të demokracisë popullore dhe veçanërisht kundër vendit tonë dhe Partisë sonë. Këto sulme arritën kulmin në Kongresin e 7-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Dhe kjo, veç të tjerash, ngjau pas takimit të Bukureshtit, ku, siç dihet mirë, nga ana e Partisë sonë edhe një herë u bënë përpjekje të sinqerta që të merreshim vesh me jugosllavët në rrugën marksiste-leniniste për përmirësimin e marrëdhënieve shtetërore midis dy vendeve.

Po me kë të merresh vesh? Udhëheqja e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, me projektprogramin e vet dhe me Kongresin e 7-të u tregoi përfundimisht të gjithëve se është plotësisht në rrugën antimarksiste, revizioniste. Ata vetë edhe një herë u afirmuan hapur si udhëheqës të më të zellshëm të revizionizmit modern.

Partia jonë mendon se me revizionizmin dhe me revizionistët kurrë nuk mund të ketë pajtim. Revizionizmi duhet demaskuar dhe duhet luftuar pa mëshirë. Kjo është abëcëja e marksizëm-leninizmit. Lenini i pavdekshëm dhe i lavdishëm na mëson se revizionizmin duhet ta urresh

dhe ta luftosh. Pikërisht këtë bën edhe Partia jonë dhe për këtë jemi plotësisht të bindur se rruga jonë është e drejtë.

Por, të luftosh pa kompromis revizionizmin jugosllav, mos vallë kjo mund të shpjerë në keqësimin e marrëdhënieve miqësore me popujt e Jugosllavisë dhe në prishjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me shtetin jugosllav?

Për çështjen e parë ne mendojmë se me popujt vëllezër të Jugosllavisë kemi qenë dhe do të mbetemi miq përjetë pse tok kemi luftuar, kemi derdhur gjak, i kemi lidhur plagët shoqi-shoqit në luftën e madhe antifashiste, kur rrezikohej jeta e popujve tanë dhe luhej fati i lirisë dhe i pavarësisë së popujve dhe të vendeve tona. Ne do ta ruajmë dhe do ta zhvillojmë miqësinë me popujt e Jugosllavisë, me gjithë vështirësitë dhe pengesat që kanë krijuar vetë udhëheqësit jugosllavë. Ne me popujt e Jugosllavisë kurrë nuk do të armiqësohemi.

Për sa i përket çështjes së dytë, mendojmë se marrëdhëniet në rrugën shtetërore duhet të zhvillohen normalisht në bazë të fqinjësisë së mirë, të mosndërhyrjes në punët e njëri-tjetrit, të përfitimit reciprok dhe të frymës së barazisë. Ne mendojmë se një vijë e tillë është në interesin e të dy popujve, të të dy vendeve. Nga ana jonë, nuk ka pasur e nuk do të ketë asnjë pengesë në këtë drejtim, por gjithmonë duke respektuar frymën që përmenda më lart.

Ideologjikisht ne nuk mund të bëjmë çështje të përbashkët veçse me ata që ecin në rrugën e marksizëm-leninizmit.

Kundërshtarët tanë ideologjikë kërkojnë ta spostojnë këtë kundërshtim e mospajtim në çështjet ideologjike në marrëdhëniet vëllazërore në mes popujve tanë dhe deklarojnë sikur ne, me kundërshtimet tona ideologjike ndaj udhëheqjes jugosllave, gjoja duam të fyejmë e të

shajmë popullin jugosllav. Kjo është një shpifje pa baza. Kjo kurrë nuk na ka shkuar dhe nuk do të na shkojë ndër mend.

Kundërshtimet tona me udhëheqësit jugosllavë kanë qenë dhe mbeten parimore.

Miqësia dhe dashuria me popujt e Jugosllavisë është për ne, gjithashtu, çështje e madhe parimore që e kemi mbrojtur dhe do ta mbrojmë.

E PREMTE
16 MAJ 1958

NË DARKËN E DHËNË NGA MINISTRI FUQIPLOTË I INDISË

I dërguari i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë i Republikës së Indisë në RP të Shqipërisë, shtroi sonte një darkë në hotel «Dajti». Mora pjesë edhe unë.

18 MAJ 1958

NISEMI PËR NË BASHKIMIN SOVJETIK

U nisëm për në Moskë me Mehmetin, Spiron e të tjerë për të marrë pjesë në një konsultë të nivelit të lartë të KNER-it dhe në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës. Në aeroport na priti Kuusineni.

19 MAJ 1958

**NË DARKËN E DHËNË PËR 70-VJETORIN
E SHVERNIKUT**

Morëm pjesë në darkën që u dha jashtë Moskës me rastin e 70-vjetorit të lindjes së Shvernikut.

FILLOI PUNIMET KONSULTA E KNER-IT

ТУШКРИВНЕС 1

Filloi në Kremlin Konsulta e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të vendeve pjesëmarrëse në Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke.

Kur u paraqit rendi i ditës u bë pyetja nëse do të kishte ndonjë pikë për çështje ideologjike, por u tha se nuk do të ketë; ndërsa për çështjen jugosllave, u tha se ajo ishte e qartë prandaj nuk do të flitej gjë.

Fola në seancën e parë.

TRIMI NË KONSULTËN E KNER-IT

ТУШКРИВНЕС 2

Sot në mëngjes rifilluan punimet e Konsultës së Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke.

Foli Spiro Koleka.

VAZHDOJNË PUNIMET E KONSULTËS SË KNER-IT

Vazhdon Konsulta e Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke.

PËRFUNDOI KONSULTA E KNER-IT

Pasdreke përfunduan punimet e Konsultës së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të vendeve pjesëmarrëse në KNER dhe u aprovua komunikata përkatëse.

**MBLEDHJE E KËSHILLIT POLITIK KONSULTATIV
TË TRAKTATIT TË VARSHAVËS**

Filloi mbledhja e Këshillit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës. Mareshali Koniev mbajti raportin. Foli Mehmeti.

Pas drekës së shtruar në Kremlin për përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore u mbajt seanca e fundit ku u firmos «Deklarata e shteteve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës».

Në drekën e dhënë në Kremlin për çudinë tonë merrte pjesë edhe ambasadori jugosllav në Moskë, Miçunoviç, dhe Hrushovi ngriti doli për «forcimin e kampit socialist, për Kinën, Vietnamin dhe për Jugosllavinë», bile edhe për «shëndetin e shokëve Tito e Miçunoviç»! Po kjo ç'do të thotë?! Të shohim(!).

U KTHYEM NË SHQIPËRI

U nisëm me avion për në Tiranë nëpërmjet Bukureshit, pse me ne udhëtoi edhe delegacioni rumun.

Mbërritëm mirë në Tiranë.

MBLEDHJE E BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH

Sot në Byronë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, në emër të delegacionit tonë, raportova për mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste mbi problemet ekonomike që u mbajt pak ditë më parë në Moskë¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 15, f. 415.

NISEM PËR NË BULLGARI

U nisa për në Sofje për të marrë pjesë në Kongresin e 7-të të Partisë Komuniste të Bullgarisë. Më pritën në aerodrom Zhivkovi, Jugovi, Ganevi.

NË MAUZOLEUN «GJERGJ DIMITROV»

Banojmë në vilën «Bujana». Shkova në mauzoleun «Gjergj Dimitrov», u përkula me nderim para kujtimit të të paharruarit Dimitrov, mikut të shtrenjtë të popullit shqiptar, dhe vendosa një kurorë me lule. Mbasdite mora pjesë në një miting të madh në Sofje kushtuar ditës së Kristo Botevit dhe dëshmorëve të lirisë të Bullgarisë.

NË KONGRESIN E 7-TË TË PK TË BULLGARISË

U hap Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Bullgarisë. Todor Zhivkovi mbajti raportin e parë.

Përsëritet delegacioni komunist i Shqipërisë.

NË KONGRESIN E PK TË BULLGARISË

- U mbajt raporti i komisionit të revizionimit.
- Përshëndeti Nikita Hrushovi.
- Përshëndeti delegacioni kinez.
- Përshëndeta edhe unë¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 15, f. 461.

NË KONGRESIN E PK TË BULLGARISË

Vazhduan diskutimet.

NË KONGRESIN E PK TË BULLGARISË

Në orën 16⁰⁰ në Kongresin e 7-të të PK të Bullgarisë, Jugovi mbajti raportin e dytë, atë mbi direktivat e planit të 3-të pesëvjeçar.

Në mbrëmje vajtëm në operë. Më morën në lozhën kryesore, ku ishte dhe Hrushovi.

NË KONGRESIN E PK TË BULLGARISË

U mbajt raporti i mandateve.

KONGRESI I 7-TË I PK TË BULLGARISË MBAROI

U bënë zgjedhjet dhe Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Bullgarisë mbaroi punimet.

Pasdreke u shpallën rezultatet e votimeve.

Në orën 19⁰⁰ miting i madh i popullit. Përshëndeta dhe unë.

VIZITIJMË VENDE TË NDRYSHME TË BULLGARISË

Shokët bullgarë më morën dhe bashkë me Hrushovin e Tupolevin shkuam në Borovec dhe Rila.

Mbrëmjen e kaluam në rezidencën e Hrushovit ku hëngrëm darkë.

VIZITË NËPËR BULLGARI

Në orën 18⁰⁰ u nisëm me automobil me Jugovin për të vizituar Plovdivin. Jugovi është i këndshëm dhe njeri i mirë, por i pëlqen të duket.

Miting në Pazarxhik. Fola unë. Në orën 14⁰⁰ arritëm në Kritçin. Vend i njohur dhe historik për ne. Këtu 11 vjet më parë nënshkrova traktatin e miqësisë me të paharruarin Dimitrov.

Pasdite vizituam hidrocentralin në Batak. Fola në miting, e pastaj fola edhe në Peshtar. Atje takuam edhe studentët tanë.

VIZITË NËPËR BULLGARI

Vizituam dy kooperativa, ku u fola kooperativistëve.

Arritëm në Plovdiv, ku vizituam një fabrikë tekstili.

Arritëm në Stara-Zagora. Vizituam një fabrikë birre dhe prej andej shkuam në Kazanllëk. Vizituam stacionin e trëndafilave.

Arritëm në Shipkë dhe në orën 14⁰⁰ u nisëm për në Tërново.

TAKIM ME ZHIVKOVIN

Në Tërnovo, ku erdhëm dje, u organizua sot një mi-
ting i madh. Folëm unë¹ dhe Jugovi.

U nisëm për në Sofje.

I bëra një vizitë Zhivkovit.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 15, f. 470.

SHIT U KTHEVA NË ATDHE

U nisëm për në Tiranë. Mbërritëm mirë në orën
10³⁰.

MBLEDHJE E BYROSË POLITIKE

Mbledhje e Byrosë Politike. Raportova mbi punimet e Kongresit të 7-të të Partisë Komuniste të Bullgarisë dhe mbi qëndrimin e delegacionit tonë atje¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 15, f. 477.

NJË ARTIKULL I MIRË I KINEZËVE

Takim me ambasadorin kinez. Biseduam për çështjen e revizionizmit jugosllav.

Sot në «Zërin e popullit», botuam tekstin e artikullit të Kan Shenit «Revizionizmi jugosllav u përshtatet plotësisht nevojave të imperializmit të Shteteve të Bashkuara», botuar pak kohë më parë në «Zhenminzhibao». Artikulli m'u duk i mirë e i fortë. Jeta po i bind edhe të tjerët se sa të drejta e parimore kanë qenë qëndrimet tona të vendosura kundër renegatëve të Beogradit.

NË MBLEDHJEN E PLENUMIT TË 10-TË TË KQ TË PARTISË

U mbledh Plenumi i 10-të i Komitetit Qendror të Partisë në të cilin raportova mbi punimet e Kongresit të 7-të të Partisë Komuniste të Bullgarisë, mbi qëndrimin e delegacionit tonë atje, si dhe mbi pikëpamjet anti-marxiste e antisocialiste të grupit të Titos, të shprehura në Kongresin e 7-të të LKJ¹.

Raportova, gjithashtu, edhe mbi zhvillimin e punimeve të mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste lidhur me KNER-in, që u mbajt në Moskë nga 20-24 maj 1958².

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 1.

2 Po aty, f. 25.

REVIZIONIZMI MODERN DUHET LUFTUAR PA MËSHIRË DERI NË SHKATËRRIMIN E TIJ TË PLOTË TEORIK E POLITIK

Sot gazeta «Zëri i popullit» botoi artikullin me titull «Revizionizmi modern duhet luftuar pa mëshirë deri në shkatërrimin e tij të plotë teorik e politik»¹ lidhur me luftën e vendosur që po zhvillojnë të gjitha partitë marxiste-leniniste kundër revizionizmit jugosllav.

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 40.

**SHËNIME PËR TAKIMIN ME DELEGACIONIN
QEVERTAR ÇEKOSLLOVAK TË KRYESUAR
NGA SHOKU VILIAM SHIROKI**

Po hedh disa shënime për takimin që do të bëhet në Kryeministri më 24 qershor midis delegacionit tonë dhe atij të qeverisë së Republikës Çekosllovaqe që kryesohet nga shoku Viliam Shiroki.

I. — Përshëndetje shokëve çekosllovakë dhe konsiderata e lartë e popullit, e Partisë dhe e Qeverisë sonë për vizitën e miqve.

1) Rëndësia politike, si brenda dhe jashtë vendit tonë, e vizitës së delegacionit çekosllovak të nivelit të lartë. Forcimi i mëtejshëm i pozitave ndërkombëtare të Shqipërisë, lidhjet vëllazërore të vendeve të kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye. Veçanërisht ç'rëndësi politike ka kjo në arenën ndërkombëtare. Brenda vendit: forcon miqësinë, forcon besimin, forcon lidhjet e popullit me Partinë dhe me Qeverinë, forcon ndjenjat e internacionalizmit proletar.

2) Rëndësia në lëmin ekonomik për vendin tonë, pse ne do të shtrojmë një sërë problemesh përpara shokëve çekosllovakë, të cilët na kanë ndihmuar me bujari, dhe mendojmë se, edhe në të ardhmen, ata do t'i shikojnë, brenda mundësive, me dashamirësi kërkesat tona. Këto

ndihma do të luajnë rolin e vet në kuadrin e përpjekjeve që bën populli ynë për ndërtimin e socializmit dhe për ngritjen e nivelit të jetesës së tij.

3) Në lëmin e këshillave të vlefshme në të gjitha drejtimet e punës sonë. Ne kërkojmë të shkëmbejmë mendime e të dëgjojmë këshillat e shokëve çekë duke folur me ta si vëllai me vëllanë që kanë të njëjtin qëllim. Kjo edhe për arsye se në punën tonë ne kemi të meta dhe e kemi çmuar dhe e çmojmë eksperiencën e shokëve çekë, veçanërisht në lëmin e industrisë.

II. — Rrugës nga aeroporti e gjer këtu ju patë entuziazmin e popullit tonë, popull i lashtë nga historia, por kurdoherë i ri nga zemra.

a) Shtypja, mjerimet, robëria e së kaluarës së largme dhe të afërt, e kanë bërë popullin tonë të vuajë, por e kanë kalitur, e kanë bërë të papërkulur përpara fatkeqësive dhe mjerimeve. Populli ynë ka luftuar në shekuj dhe kurrë s'është përkulur përpara armiqve. Partia e Punës e Shqipërisë e nxori atë në dritë dhe e futi në rrugën e socializmit.

b) Roli i Bashkimit Sovjetik në çlirimin e Shqipërisë dhe në ndërtimin e socializmit. Ndihamat e Çekosllovakisë. Ndihma internacionaliste e vendeve të kampit të socializmit.

c) Në momentet kritike të luftës dhe të pasluftës, populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij marksiste, qëndroi në lartësinë e detyrës.

— Liria duhej të fitohej me luftë.

— Në aleancë me Bashkimin Sovjetik, me gjithë forcat e vërteta revolucionare, mund të fitohej liria dhe pavarësia.

— Vetëm një parti marksiste-leniniste mund ta çonte popullin në fitore.

ç) Ne e ndoqëm me konsekuencë këtë vijë dhe kjo bëri që Shqipëria, e lënë në varfëri e prapambetje, të arrinte lirinë e pavarësinë e saj, të vendoste rendin e ri të demokracisë popullore, të ecte e sigurt në rrugën e socializmit. Shqipëria e vogël u qëndroi valëve dhe furtunave të luftës dhe të pasluftës dhe u afirmua si një shtet sovran dhe i zoti të ndërtojë me sukses socializmin.

e) Rreziqet e luftës dhe të pasluftës. Përpyekjet e imperialistëve dhe të titistëve. Lufta e Partisë sonë në këto drejtime.

f) Marrëdhëniet aktuale të vendit tonë, në radhë të parë, me vendet e tjera të kampit socialist si dhe me vendet borgjeze.

III. — Situata e brendshme ideopolitike e socialkulturore.

Partia dhe politika e saj.

a) Forcimi i brendshëm i Partisë, edukimi dhe ngritja ideologjike dhe kulturore e komunistëve dhe e masave.

b) Lidhjet me masat dhe uniteti i popullit.

c) Partia në ballë të përpjekjeve të popullit për ndërtimin e vendit.

ç) Ngritja në një nivel të lartë e patriotizmit të masave, forcimi i besimit në forcat krijuese dhe ngjallja e dashurisë për punë.

IV. — Situata ekonomike.

Vështirësi të mëdha ekonomike kemi kaluar, por të tilla kemi akoma, sido që situata çdo vit po përmirësohet.

Përpyekjet heroike të popullit tonë, të cilat kanë qenë e mbeten faktori vendimtar për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit në Shqipëri, kanë pasur edhe mbështetjen e Bashkimit Sovjetik, të Çekosllovakisë etj., me ndihma e kredi.

Industri e miniera

a) Nevojat tona shtohen dhe zgjerohen; na duhet të arrijmë një nivel jetese të përshtatshëm, pse popullsia shtohet dhe kultura ngrihet. Ne jemi një vend i pazhvilluar industrialisht, sapo kemi hedhur bazat e industrisë dhe na duhet të bëjmë akoma shumë që të shfrytëzohen si duhet edhe burimet e brendshme, edhe forcat e energjitë e njerëzve.

Ju do të shikoni vendin tonë, industrinë tonë dhe do të bindeni për ç'kemi bërë e ç'na duhet të bëjmë.

Ne jemi një vend që ka trashëguar vetëm një artizanat primitiv. Tash kemi një industri që plotëson çdo ditë e më tepër shumë nevoja, por na duhet të bëjmë shumë përpjekje për ta forcuar e për ta zgjeruar industrializimin tonë socialist, derisa ne të kemi një industri moderne për të shfrytëzuar të gjitha rezervat e brendshme që flenë ose shfrytëzohen pak dhe keq. Në këtë drejtim neve na duhet edhe ndihma e miqve.

b) Edukimi i kuadrove.

c) Pasuritë e nëntokës sonë dhe perspektivat e zhvillimit. Nga ritmi i zhvillimit të tyre varet edhe fuqizimi i ekonomisë sonë, edhe mundësia që t'ua kthejmë miqve ndihmën që na japin.

Mekanizmat. Mjetet për mekanizim dhe shumë lëndë të para ende jemi të detyruar t'i importojmë. Për këto tani për tani s'kemi si bëjmë, prandaj e çmojmë ndihmën nga miqtë.

ç) Ne jemi një vend malor dhe transporti kryesor, tani për tani, është ai automobilistik. Duhet ndërtuar e asfaltuar rrugët pse në gjendjen aktuale ato i konsumojnë shumë automjetet. Automjetet e marra te ju kanë qenë një ndihmë e madhe për ne. Ju do t'i shikoni rrugët tona dhe do të ndiheni krenarë për dy gjëra: për skodat tuaja

të mirënjohura dhe për shoferët tanë të mrekullueshëm që i shfrytëzojnë shumë mirë ato.

Bujqësia

Gjendja në të kaluarën. Hapja e tokave të reja. Bonifikimet. Mekanizimet. Frutikultura.

Konkluzione.

... të mirënjohura dhe për shoferët tanë të mrekullueshëm që i shfrytëzojnë shumë mirë ato.

... të mirënjohura dhe për shoferët tanë të mrekullueshëm që i shfrytëzojnë shumë mirë ato.

... të mirënjohura dhe për shoferët tanë të mrekullueshëm që i shfrytëzojnë shumë mirë ato.

... të mirënjohura dhe për shoferët tanë të mrekullueshëm që i shfrytëzojnë shumë mirë ato.

TAKIM ME AMBASADORIN SOVJETIK

Prita ambasadorin sovjetik bashkë me një shkencëtar sovjetik të dërguar nga Instituti i Studimeve të Lindjes i Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovjetik, që ka ardhur për të mbajtur leksione në Universitetin tonë.

E MARTË
24 QERSHOR 1958

ARRITI DELEGACIONI QEVERTAR ÇEKOSLLOVAK I KRYESUAR NGA V. SHIROKI

Me ftesën e Qeverisë së RP të Shqipërisë sot arriti për një vizitë në vendin tonë një delegacion qeveritar çekoslllovak i kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës Çekosllovake, shoku Viliam Shiroki. E pritëm në aeroport.

Pritje në Kryeministri. Filluam bisedimet. Fola unë¹.

Asistua në një koncert të dhënë për nder të Shirokit nga Teatri i Operës dhe i Baletit dhe Ansambli Shtetëror i Këngëve.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 60.

E MËRKURË
25 QERSHOR 1958

SHIROKI VIZITON VENDIN TONË

Shoku Shiroki u nis për në Korçë.

DARKË ME SHIROKIN

Hëngrëm darkë me Shirokin në hotelin Albturist në plazhin e Durrësit.

SHIROKI NISËT PËR NË VLOBË

Shoqërova Shirokin në Durrës, ku u bë miting. Shiroki pasdreke u nis për në Vlorë.

NË AMBASADËN ÇEKOSLLOVAKE

Shkuam në mbrëmjen e dhënë nga ambasada çekoslovakë për nder të Shirokit. Përshëndeta dhe unë¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 74.

BISEDIMET ME DELEGACIONIN ÇEKOSLLOVAK MBARUAN

Mbaruam bisedimet me delegacionin qeveritar çekoslovak dhe nënshkruam deklaratën e përbashkët.

Dekoruam shokët çekoslovakë dhe organizuam një miting të madh në Tiranë. Folëm unë¹ dhe Shiroki.

Mbrëmje nga ana jonë për nder të mysafirëve.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 81.

DELEGACIONI ÇEKOSLLOVAK U LARGUA

Miqtë çekoslllovakë u larguan për në Pragë. I përco-
llëm në aerodromin e Rinasit.

DOLI LIBRI I LENINIT PËR LUFTËN KUNDËR REVIZIONIZMIT

Sot u vu në qarkullim një vëllim i posaçëm me ma-
teriale (pjesë nga artikuj e nga vepra të veçanta) të
V. I. Leninit për luftën kundër revizionizmit në lëvizjen
ndërkombëtare dhe ruse. Libri është përgatitur nën kuj-
desin e Institutit të Historisë së Partisë pranë KQ të
Partisë.

E MARTE
8 KORRIK 1958

**TAKIM ME DELEGACIONIN PARLAMENTAR
TË VIETNAMIT**

Prita në selinë e Komitetit Qendror delegacionin parlamentar të Republikës Demokratike të Vietnamit të kryesuar nga Ton Dyk Thang¹ që ka ardhur para disa ditësh në vendin tonë.

¹ Në atë kohë kryetar i Asamblesë Kombëtare dhe i Frontit të Atdheut të Vietnamit.

E MËRKURË
9 KORRIK 1958

TAKIM ME USHTARAKË SOVJETIKË

Prita ish-atashetë ushtarakë sovjetikë në vendin tonë, gjeneralët Rodimcev, Glebov, Sokolov, që kanë ardhur me rastin e 15-vjetorit të Ushtrisë sonë, si dhe gjeneralin Sergackov dhe kolonelin Rura, atashe ushtarakë pranë ambasadës sovjetike këtu.

NISEMI PËR NË ÇEKOSLLOVAKI

U nisëm për pushime në Çekosllovakë. Në aeroportin e Pragës na priti shoku Dolanski¹ dhe të tjerë, na çuan në një vilë, ku kishte ndenjur dhe punuar shoku Gotvald gjatë kryengritjes së tetorit.

¹ J. Dolanski, ish-zëvendëskryeministër dhe anëtar i Byrosë Politike të KQ të PK të Çekosllovakisë.

VIZITË NËPËR PRAGË

Vizitua rrethet e Pragës. Pamë hidrocentralin e madh mbi Vltavë dhe u ulëm në një restorant buzë lumit. Dita ishte e nxehtë, po vendi shumë i bukur. Vizitua me automobil qytetin e Pragës.

PRAGË, E HËNË
14 KORRIK 1958

NË KËSHTJELLËN E PRAGËS

Vizituam kështjellën e bukur të Pragës dhe ekspozitën që ishte atje.

PRAGË, E MARTË
15 KORRIK 1958

NISEMI PËR NË KARLOVI-VARI

Në bazë të rekomandimit të mjekëve u nisëm për në Karlovi-Vari. Na vendosën në vilën «Margaret».

Karlovi-Vari më pëlqen, është vend e qytet i bukur balnear.

Na vizitoi doktori çek Zymo, mjek i zoti, ish-partizan.

NGA QËNDRIMI NË KARLOVI-VARI

Fillova kurat me ujërat e banjave të famshme të Karlovi-Varit.

Shkuam në «Grand Hotel Moska» ku pamë filmin çekoslovak «Legjioni i huaj».

Në këtë periudhë këtu zhvillohet festivali ndërkombëtar i filmit¹.

Lëvizje e madhe në qytet, artistë, regjisorë e të tjerë nga të katër anët.

¹ Festivali i 11-të Ndërkombëtar i Filmit me metrazh të shkurtër dhe me ngjyra.

NJIHEMI ME KURIOZITETET E KARLOVI-VARIT

Shëtita qytetin. Shumë i bukur, i këndshëm, i pastër, plot parqe dhe lule. Koha me diell. Flamurë dhe reklama të festivalit kudo. Populli i veshur mirë. Dyqanet plot me mall dhe ky i ekspozuar me shije. Duket që niveli i jetesës dhe ai kulturor është i lartë.

Në rrugë takuam një grup oficerësh tanë me gratë e tyre që kanë ardhur për pushime në Çekoslovakia.

NGA QËNDRIMI NË ÇEKOSLLOVAKI

Asistova në ndeshjen e futbollit «Dinamo» e Tiranës — «Karlovi-Vari». Dolën me barazim. Tanët mund të luajnë më mirë.

Takuam, në Kollonadë¹, Furcevën me Firiubin. Na ftuan për çaj në hotelin e tyre.

Takuam në rrugë Tishenkon.

¹ Kollonadë — vend i mbuluar në Karlovi-Vari ku njerëzit mbushin gotat me ujë e i pinë duke shëtitur.

TË MBËSHTETIM POPUJT E LIBANIT E TË JORDANISË

Në një radiogram që i dërgova sot shokut Hysni, midis të tjerave, e porosita të organizohen manifestime kundër agresionit imperialist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Britanisë së Madhe kundër Libanit dhe Jordanisë.

Takuam Valdek Roshenë, anëtar i Byrosë Politike të Partisë Komuniste Franceze.

NËPËR ÇEKOSLLOVAKI

Vizituam Marianskij Laznie (1 orë nga Karlovi-Vari),
qytet shumë i bukur me parqe, lule dhe hotele të mira.

Pasdreke na bëri vizitë në shtëpi shoku Novotni.
Ishin me të Kopecki, Firlingeri, Heindrihu dhe gratë e
tyre.

Në mbrëmje shkuam me Novotnin në festival në
«Grand Hotel Moska». Pamë «Donin e qetë». Atje takuam
gruan e Hrushovit, Nina Petrovnën. Po atje u takuam me
aktorët kryesorë të filmit.

NGA VIZITA NË ÇEKOSLLOVAKI

I bëra vizitë Firlingerit¹ në hotel «Bristol».

Bashkë me Nexhmijen i bëra vizitë Furcevës dhe
gruas së Hrushovit. Atje gjetëm dhe sekretarin e dytë të
KQ të partisë të Gjeorgjisë.

1 Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të PK të Çekosllovakisë.

NGA VIZITA NËPËR ÇEKOSLLOVAKI

Vizitua fabrikën e qelqit «Mozer». Artikuj shumë të bukur artistikë prodhoheshin aty. Pamë në ekspozitë dhe një takëm të porositur nga Zogu.

Në mbrëmje shkuam në festival dhe pamë filmin italian «Rruga e gjatë e kaltër».

NË SHTËPINË E GËTES

Vizitua qytetin e vogël historik Lohet. Pamë atje kështjellën e vjetër dhe ekspozitën e qeramikës. Pamë gjithashtu shtëpinë e moçme ku ka ndenjtur Gëteja.

Vizitua me automobil qytetin Sokolovo, ku qymyrguri ndodhet në shtresën e sipërme të tokës.

VAZHDOJME VIZITAT NËPËR ÇEKOSLLOVAKI

Vizituam qytetin krejt të ri Ostrov. Aty ka miniera uranumi.

Vizituam qytetin Jakovliev, ku ka burime ujërash minerale.

Pamë filmin francez «Le cerf volant».

NË NJË FABRIKË QERAMIKE

Vizituam një fabrikë qeramike. Drejtori i saj na ka ndihmuar në Tiranë për ngritjen e punishtes sonë të qeramikës.

NËPËR ÇEKOSLLOVAKI

Shkuam në qytetin Frantishkovi-Lazne. Vend banjash, veçanërisht për gratë që nuk lindin.

Pamë qytetin Heb.

Pamë filmin indian «Mëma Indi».

DO TË QËNDROJMË PËR VIZITË ZYRTARE NË ÇEKOSLLOVAKI

Erdhi më takoi zëvendësministri i Jashtëm çekoslovak, Gregor. Më foli lidhur me vizitën zyrtare, pas pushimeve, që do të bëjmë ne në Çekosllovakia në kthim të vizitës që pak kohë më parë bëri te ne delegacioni çekoslovak i kryesuar nga Shiroki.

NË KËSHTJELLËN E METERNIKUT

Vajtëm në Kinzhvar, vizituam kështjellën-muze të Meternikut.

PËR GJAH NË RRETHIN E SOKOLOVËS

Vajtëm për gjah kaprolli në rrethin e Sokolovës. S'vramë asgjë.

Pyje të bukura, të spastruara, të mbajtura me kulturë, me rrugë të asfaltuara brenda. Shëtitja qe e këndshme.

GJATE QËNDRIMIT NË ÇEKOSLLOVAKI

Shëtitje buzë liqenit.

U takuam me gjeneral Sokolovin, ish-atashe ushtarak sovjetik në Tiranë.

Takim me Firlingerin.

Sot bënte vapë, 30-35°.

PËR GJAH

Vamë për gjah sorkadhesh. Vrava një. Ishim e tërë familja dhe Koço Prifti me të shoqen.
Shkuam shumë mirë.

LAJME NGA SHQIPËRIA

Erdhën shokë nga Shqipëria për pushime. Më sollën lajme nga shokët. Çdo gjë shkon mirë.

**NË UZINAT «SKODA» DHE NË FABRIKËN
«PILZEN»**

Shkuam në Pilzen. Vizituam uzinat e mëdha «Skoda» dhe fabrikën e famshme të birrës «Pilzen».

CAKTUAM ITINERARIN E SHËTITJES NË ÇEKOSLLOVAKI

Vajta për gjah. Vrava një sorkadhe.
Me shokun Voita caktuam itinerarin e shëtitjes në
Çekosllovaki.

NJË KRIM I TITISTËVE

Vamë për gjah, por kësaj radhe nuk vrava gjë.

Mora radiogram nga Hysniu për vrasjen e qytetarit
shqiptar, Hasan Spata¹, nga titistët jugosllavë.

¹ Në rrugën për t'u riatdhesuar nga RF Gjermane në Shqipëri, Hasan Spata u ndalua në Beograd. Më 27 maj 1958 organet e sigurimit jugosllav e rrëmbyen nga hoteli ku ishte vendosur nga ambasada jonë për të kaluar natën, e çuan në një kamp përqendrimit dhe organizuan vrasjen e tij. Në përgjigje të kërkesave këmbëngulëse të Qeverisë sonë për kthimin e tij, autoritetet jugosllave deklaruan se ai ishte «vrasë gjatë përpjekjeve për t'u arratisur».

PRAGË, E HËNË

11 GUSHT 1958

TË DEMASKOJMË TITISTËT PËR KRIMET E TYRE TË SHËMTUARA NDAJ QYTETARËVE SHQIPTARË

Lidhur me vrasjen barbare të qytetarit shqiptar Hasan Spata nga ana e organeve titiste, u dërgova sot një radio-gram shokëve Mehmet e Hysni me udhëzime të hollësishme për veprimet që duhet të bëjmë e masat që duhet të marrim për të vënë përpara përgjegjësisë qeverinë jugosllave.

Midis të tjerave u rekomandoja shokëve se, sipas mendimit tim, qeverisë jugosllave duhet t'i dërgohet një notë tjetër e rreptë proteste duke e paralajmëruar për pasojat që mund të rrjedhin nga mospërgjegjia notës sonë të parë (nota mund të shoqërohet edhe me disa masa konkrete në fushën e marrëdhënieve shtetërore); nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të organizohet një konferencë shtypi me trupin diplomatik si dhe me gazetarët e huaj të akredituar në vendin tonë dhe me gazetarët vendas për demaskimin e titistëve; radioja dhe shtypi të flasin për këtë krim të titistëve, për demaskimin e tyre si vrasës e si shkelës të ligjeve e të normave ndërkombëtare; pa prekur çështje kufijsh e probleme territoriale, të mbrojmë të drejtat e shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta në Kosovë e në vise të tjera shqiptare në Jugosllavi nga persekutimi i titistëve, zbatues të politikës shoviniste të kralëve serbë.

I porosita shokët që, përpara se të vendosin për ma-

sat që duhen marrë, propozimet e mia t'i diskutojnë në Byronë Politike dhe për çka do të vendosin, të më njohojnë edhe mua.

TAKIM ME PAJETËN

Erdhi dhe u takua me mua Pajeta¹ dhe një shok tjetër i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Italiane.

Pajeta përpiqet para meje të maskohet, por ai mbetet ashtu siç është, një revizionist.

¹ Xhankarlo Pajeta, në atë kohë anëtar i sekretariatit të KQ të PK Italiane.

TAKIM ME SKOÇIMARON

U takova me Skoçimaron¹, i cili erdhi më bëri një vizitë. Ky është më i miri midis anëtarëve të udhëheqjes aktuale të Partisë Komuniste Italiane, por nuk është i qëndrueshëm, mund të bjerë lehtë në ujërat e revizionistëve.

¹ Mauro Skoçimaro.

VIZITË KORTEZIE SHIROKIT

U kthjem në Pragë. I bëra një vizitë shokut Shiroki në Kryeministri. Vizitë kortezie.

NË FUSHËN E BETEJËS SË AUSTERLICIT

U nisëm për në Brno. U takuam me sekretarët e komitetit të partisë.

Vizituam një fabrikë qilimash, si edhe fushën e betejës së Austerlicit.

BRNO, E PREMTE

15 GUSHT 1958

NË UZINËN E TRAKTORËVE «ZETOR»

Në Brno vizitua uzinën e traktorëve «Zetor».

Vizitua Spilberkun, qytetin dhe një fermë shtetërore të rritjes së derrave.

U nisëm për në Bratislavë.

BRATISLAVË, E SHTUNË

16 GUSHT 1958

VIZITË NË SLLOVAKI

Në Bratislavë hëngrëm drekë me anëtarët e Byrosë Politike. Në mëngjes me Bacilekun vizitua fabrikën e panelave, apartamente dhe shkolla të qytetit.

Pasdreke shëtitem me motoskaf mbi Danub. Kaluam në ujërat austriake.

Vizitua varrezat e ushtarëve sovjetikë.

Darkë nga Këshilli i Ministrave të Sllovakisë.

PËR GJAH

Më shpunë në kështjellën e Topolcanit.

Pasdreke vamë për gjah. Plagosa një dre dhe pas pak e gjetëm të vrarë.

VIZITË NËPËR ÇEKOSLLOVAKI

Vizitua fabrikën e aluminit, hëngrëm drekë në Shihac.

Vizitua muzeun e Banka Bisticës.

Vazhdojmë rrugën për në Tatra.

NË MALET E TATRAS

Arritëm në Tatra.
 Vizitë me automobil e shëtitje në këmbë.
 Vizituam shokun Dolanski në «Javorina».
 Fola në telefon me Nexhmijen dhe me fëmijët në Pragë.
 Dola për gjah. Vrava një sorkadhe në Tatra Llomnica.

TAKIM ME SHOKË TË HUAJ

Mbrëmje me shokët e Partisë Komuniste Italiane, Gjermane, Finlandeze që ndodhen në Çekosllovakia. Mbrëmja quhej «Zhivanka», domethënë «Kukureci» sllovak.

NË OSTRAVË

U nisëm për në Ostravë.
Hëngrëm drekë në Zhilina dhe biseduam me udhëheqësit e krahinës. Arritëm në Ostravë në mbrëmje dhe fjetëm në një vilë jashtë Ostravës.

VIZITË NË NJË UZINË METALURGJIKE

Vizituam Nova Hutën (Metalurgjia e re), fabrikën e nikelit, atë të ndërtimit të makinave «Hengen» dhe qytetin ku ndodhet uzina metalurgjike.

Për darkë te Kopecki.

NË GOTVALDOV

U nisëm për në Gotvaldov.
Vizituam fabrikën e këpucëve dhe pasdreke u kthyem me avion në Pragë. Kështu mbaroi udhëtimi shumë i këndshëm dhe interesant nëpër Çekosllovakia.

Për dashë të Kopçeki.

NË LIDICEN MARTIRE

Vizituam ambasadën tonë,

Vizituam Lidicen, e cila, ashtu si Borova në Shqipëri, u bë shkrumb e hi nga hitlerianët dhe u mbulua me gjakun e grave, të pleqve e të fëmijëve të pafajshëm.

PRAGË, E MARTË
26 GUSHT 1958

VIZITË NË MUZEUN «KLEMENT GOTVALD»

Vizituam muzeun «Klement Gotvald» në Pragë.

PRAGË, E MËRKURË
27 GUSHT 1958

SOT NË PRAGË

Vendosëm kurorë në Mauzoleun «Klement Gotvald».
Vizituam muzeun «Lenin».
Për darkë ishim të Shiroki. Merrnin pjesë dhe anëtarët e Byrosë Politike të KQ të Partisë Komuniste Çekoslovake.

NESËR NISEMI PËR NË SHQIPËRI

Nesër nisemi për në Shqipëri.
I tregova Nexhmijes për vdekjen e babait të saj. Lajmin për këtë vdekje unë e kisha marrë që më 8 gusht, por tregova Nexhmijes për të mos e dëshpëruar gjatë kohës që ndodheshim këtu.
Vizituam ambasadorin tonë në shtëpinë e tij.

U KTHYEM NË ATDHE

U nisëm me avion nga Praga dhe arritëm në Tiranë.

DARKE PËR NJË GRUP SHOKËSH ITALIANË

Darkë për shokët italianë Spano, Alikata e Sekia, të cilët, bashkë me gratë e tyre, po kalojnë pushimet në vendin tonë.

DREKË ME SOVJETIKË

Kishim për drekë ambasadorin sovjetik Ivanov dhe profesor Preqbrahenskin me gruan dhe vajzën e tij.

TAKIM ME DELEGACIONIN PARLAMENTAR BULLGAR

Prita në selinë e Komitetit Qendror delegacionin parlamentar bullgar të kryesuar nga Dimitër Dimovi¹ që po bën vizita në vendin tonë.

Në mbremje shtruam një darkë në Pallatin e Brigadave për nder të delegacionit parlamentar bullgar.

¹ Në atë kohë kandidat i Byrosë Politike të KQ të PK të Bullgarisë dhe anëtar i Presidiumit të Asamblesë Popullore të Bullgarisë.

MBRËMJE TE KOREANËT

Ambasadori korean dha sonte një pritje në hotel «Dajti» me rastin e 10-vjetorit të shpalljes së Republikës Demokratike Popullore të Koresë. Mora pjesë.

PËRKRAHIM ÇËSHTJEN E DREJTË TË POPULLIT KINEZ

Takim me ambasadorin kinez. I shpreha edhe një herë qëndrimin e patundur të Partisë sonë, të Qeverisë së Republikës sonë Popullore dhe të mbarë popullit shqiptar në përkrahje të çështjes së drejtë të popullit kinez kundër ndërhyrjes brutale, provokacioneve e kompleteve të imperializmit amerikan e reaksionarëve të Çan Kai Shisë në çështjet e brendshme të Kinës, e veçanërisht, kohët e fundit, në ngushticën e Tajvanit.

NË AMBASADËN E RP TË BULLGARISË

Mora pjesë në pritjen e dhënë nga ambasada bullgare me rastin e 14-vjetorit të çlirimit të Bullgarisë. Në pritje fola edhe unë¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 116.

MBRËMJE NË AMBASADËN SOVJETIKE

Mbrëmje në ambasadën sovjetike me rastin e muajit të miqësisë Shqipëri-Bashkimi Sovjetik. Folën ambasadori Ivanov, kryetari i delegacionit të Shoqërisë së Miqësisë BRSS-Shqipëri, Sizov¹. Fola edhe unë.

¹ N. T. Sizov, në atë kohë zëvendëskryetar i bashkimit të shoqërive sovjetike të miqësisë dhe lidhjeve kulturore me vendet e huaja.

TAKIM ME DELEGACIONIN E MIQËSISË BASHKIMI SOVJETIK-SHQIPËRI

Prita delegacionin kulturor të Shoqërisë së Miqësisë Bashkimi Sovjetik-Shqipëri, i kryesuar nga Sizovi që ka ardhur në vendin tonë me rastin e muajit të miqësisë Shqipëri-Bashkimi Sovjetik.

AKTIVITETE POLITIKE

Takim me gjeneral Antonovin.

Prita ansamblin shtetëror të valleve të BS, «Berjozka», që ka ardhur në vendin tonë me rastin e muajit të miqësisë shqiptaro-sovjetike.

DREKË PËR AMBASADORIN ÇEKOSLLOVAK

Kisha për drekë ambasadorin çek¹ në Shqipëri me gruan, si dhe ambasadorin tonë në Çekosllovakia, Koço Priftin, me gruan.

¹ I Frantishek Malik.

**TAKIM ME DELEGACIONIN PARLAMENTAR
HUNGAREZ**

Takim me delegacionin parlamentar hungarez të kryesuar nga Karoli Kish¹ që ka ardhur për vizitë në vendin tonë.

Pritje për delegacionin në Pallat.

¹ Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të KQ të Partisë Punëtore Socialiste të Hungarisë dhe kryetar i Komisionit të Punëve të Jashtme të Asamblesë Kombëtare të RP të Hungarisë.

NË AMBASADËN HUNGAREZE TONË

Pritje në ambasadën hungareze me rastin e vizitës në vendin tonë të delegacionit parlamentar hungarez. Folën ambasadori Zhatkullak, kryetari i delegacionit, Karoli Kish. Fola edhe unë.

DARKË TEK IVANOVI

Darkë tek Ivanovi në shtëpi. Ishim të tërë shokët e
Byrosë Politike.

«IZVESTIA» SHKRUAN PËR VENDIN TONË

Numri i sotëm i gazetës «Izvestia» i kushtohet vendit
tonë. Në këtë numër përfshihet edhe një artikulli im.

TAKIM ME NJË SHOK MAROKEN

Takim me shokun maroken që punon në Radio Tirana. Ai është anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Marokene.

NË AKTIVITETET PËR PËRVJETORIN E SHPALLJES SË RP TË KINËS

Sot vizitua dy ekspozita kineze¹ të hapura në Tiranë dhe në mbrëmje morëm pjesë në pritjen e dhënë nga ambasadori Lo Shi Gao me rastin e përvjetorit të shpalljes së RP të Kinës. Folëm unë² dhe ambasadori kinez.

1 «RP e Kinës në rrugën e transformimeve të mëdha» dhe «Arti grafik kinez».

2 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 156.

TAKIM ME AMBASADORIN EGJIPTIAN

Prita ambasadorin e Republikës Arabe të Bashkuar në RP të Shqipërisë¹.

¹ Dr. Hysein Shauki.

TAKIM ME SHOKË FINLANDEZË

Takim me shokët finlandezë¹ që ishin për pushim te ne.

Shtruam sonte një darkë për shokë nga Partia Komuniste e Finlandës dhe nga Partia Komuniste e Indonezisë që ndodhen në vendin tonë për pushime.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 198.

TAKIM ME SHOKË INDONEZIANË

Takim me shokët indonezianë që kalojnë pushimet në vendin tonë¹.

NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADORI SOVJETIK PËR 41-VJETORIN E REVOLUCIONIT TË TETORIT

Sot në sallën e hotel «Dajtit», ambasadori i Bashkimit Sovjetik në vendin tonë dha një pritje me rastin e 7 Nëntorit, 41-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, në të cilën mbajta një fjalim përshëndetje¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 234.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 16, f. 396.

TAKIM ME SHOQE TË HUAJA

Takim me delegacionin e Federatës Demokratike Ndërkombëtare të Grave dhe me përfaqësueset e grave të Algjerisë, Tunizisë, Sirisë, Libanit dhe Irakut që kanë ardhur për vizitë miqësore në Shqipëri dhe me rastin e 15-vjetorit të themelimit të BGSH-së.

**HUNGAREZËT NUK NA JAPIN KREDINË
QË U KËRKUAM**

Takim me ambasadorin hungarez. Më dorëzoi një letër nga Kadari në përgjigje të letrës sonë të datës 7 tetor, me anë të të cilës ne u kërkonim një kredi fare modeste për ta përdorur gjatë pesëvjeçarit të tretë.

Na njoftojnë se nuk mund ta plotësojnë kërkesën tonë «për shkak të vështirësive që u kanë shkaktuar ngjarjet e vitit 1956». Të jetë kjo arsyeja e vërtetë?!

TAKIM ME KRYETARIN E NJË DELEGACIONI AZERBAJXHANAS

U takova me kryetarin e delegacionit të Shoqatës për Marrëdhëniet Kulturore me vendet e huaja të RSS të Azerbajxhanit¹ që ka ardhur në vendin tonë.

¹ Abdulla Bajramov, në atë kohë sekretar i KQ të PK të Azerbajxhanit.

NGUSHËLLIME PËR VDEKJEN E DAMIANOVIT

Takim me ambasadorin bullgar. I paraqita ngushëllimet për vdekjen e Damianovit¹.

¹ Georgi Damianov, në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, president i Presidiumit të Asamblesë Popullore të Republikës Popullore të Bullgarisë.

TAKIM ME DELEGACIONIN AZERBAJXHANAS

Takim me delegacionin e Shoqatës për Marrëdhëniet Kulturore me vendet e huaja të RSS të Azerbajxhanit.

NISEMI PËR NË BASHKIMIN SOVJETIK

U nisëm me Mehmetin për në Moskë. Po sot, në orën 19⁰⁰ na priti Hrushovi. I paraqitëm kërkesat tona për një ndihmë nga ana e Bashkimit Sovjetik për realizimin e planit tonë të ardhshëm pesëvjeçar (1961-1965). Këtë radhë na u duk se shkoi mirë biseda. Na premtuan ndihma. Darkë në Kremlin.

NË TEATRIN «BALSHOI»

Rezidencën na e kanë caktuar në Kremlin.

Në mbrëmje shkuam në teatrin «Balshoi», zhvillohej dekada e artit dhe e kulturës uzbeke.

TAKIM ME BASHKATDHETARËT

Bisedë në ambasadën tonë në Moskë me studentët shqiptarë në Shkollën e Lartë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

MARRIM PJESË NË PLENUMIN E PK TË BS

Mehmeti dhe unë asistuaam në mbledhjen e plenumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për bujqësinë.

NDALESE E RASTIT NË BUDAPEST

U nisëm nga Moska për në Tiranë.

Ndaluam në Budapest, pse koha ishte e keqe.

U takuam me Kadarin dhe shokë të tjerë. Bisedimet ishin të përzemërta.

E MËRKURË
17 DHJETOR 1958

U KTHYEM NË SHQIPËRI

Mbërritëm në Tiranë, pas një ndalese në Hungari për arsye të kohës së keqe.

E PREMTE
19 DHJETOR 1958

TAKIM ME AMBASADORIN KOREAN

Prita ambasadorin korean¹ me rastin e largimit të tij nga Shqipëria.

¹ Lim Çun Çu.

TAKIM ME AMBASADORIN RUMUN

Prita ambasadorin e jashtëzakonshëm e fuqplotë të
RP të Rumanisë¹.

¹ Georgi Velçesku.

**TAKIM ME DELEGACIONIN E KOMSOMOLIT
DHE SHKRIMTARIN PERVERCEV**

Takim me delegacionin e Komsomolit që po bën vizita
në Shqipëri.

Takim me shkrimtarin Pervencev dhe me regjisorin
e filmit tonë të ardhshëm, «Furtuna».

TAKIM ME AMBASADORIN KOREAN

Prita ambasadorin e ri korean¹.

¹ Kim Re Zun.

1959

AMBASADORI SOVJETIK MË URON VITIN E RI

Siç e kanë bërë zakon çdo vit, erdhi ambasadori sovjetik, Ivanov, për të më bërë urimet e Vitit të Ri. Si kurdoherë ai solli edhe peshqeshin «tradicional» të tyre, dy shishe me vodka dhe një shishe konjak të shoqëruar me dy paqeta «Papiros».

1959

**PËRGATITEM PËR T'U NISUR PËR NË RD
GJERMANE**

Sot u përgatitem të shkonim në aerodrom për të pritur Grotevolin, i cili do të kalonte tranzit gjatë udhëtimit që bën për në Egjipt dhe në vendet e tjera të Lindjes së Afërt. Por, për arsye të kohës së keqe, avioni nuk u ndal fare në Rinas.

Po përgatitem të nisem për në Republikën Demokratike Gjermane. Do të shkoj me një delegacion zyrtar të Partisë dhe të Qeverisë.

**NISEMI PËR NË RD GJERMANE. NJË NDALESË
E SHKURTËR NË BUDAPEST**

Në orën 11 të mëngjesit delegacioni ynë i Partisë e i Qeverisë, ku bëjmë pjesë unë, Mehmeti, Manushi, Behari e të tjerë, u nis për një vizitë miqësore në Republikën Demokratike Gjermane. Së bashku me ne janë edhe shokët Nexhmije e Fiqret.

Bëmë një ndalesë në Budapest, ku do të qëndrojmë sot. Në aerodrom kishin dalë për të na pritur shokët hungarezë, me shokun Mynih në krye. Na thanë se shoku Kadar nuk kishte dalë sepse ishte i sëmurë nga gripi. Mund të jetë kështu, por një arsye e tillë na është thënë edhe disa herë të tjera. S'ka gjë, ne nuk i vëmë re shumë këto qëndrime.

Vizituam shpejt e shpejt me automobil disa kuriozitetet e pamje të Budapestit, i cili është një qytet i bukur karakteristik dhe Danubi i jep një hijeshi të veçantë.

Në mbrëmje, Komiteti Qendror i Partisë Socialiste Punëtore të Hungarisë dhe këshilli i ministrave dhanë një darkë për nderin tonë në godinën e parlamentit. Në darkë ishin Mynihu dhe shokë të tjerë të byrosë me gratë e tyre. Kadari nuk ishte. Mynihu ngriti dolli për miqësinë. Iu përgjigja edhe unë. Darka ishte e ngrohtë dhe me muzikë tradicionale cigane, por orkestra m'u duk ordinere.

6 JANAR 1959

KADARI NA BËN VIZITË KORTEZIE

Në mëngjes na erdhi në vilën ku banojmë shoku Kadar për të na bërë një vizitë kortezie. Si duket u shërua nga gripi. Hëngri mëngjesin me ne, u tregua i afruar dhe, ndërsa hanim, biseduam për gjendjen e përgjithshme ekonomiko-politike të vendeve tona. Bisedë e përciptë dhe e përgjithshme. Pas largimit të Kadarit shkuaam përsëri me automobil për të vizituar qytetin.

Në orën 15³⁰ u nisëm me tren të posaçëm për në Berlin. Përcjellja në stacionin qendror ishte gjysmëzyrtare. Kishte dalë Mynihu me po ata shokë që na pritën në aerodrom. Përveç këtyre ishin edhe ambasadori sovjetik dhe ai gjerman të akredituar në Hungari. Në stacion kishte dalë edhe studentët e studentet shqiptare që mësojnë në Budapest. Këta, si të gjithë njerëzit tanë, ishin të gëzuar, të përmallur, entuziastë.

7 JANAR 1959

ARRITËM NË BERLIN. FILLUAM BISEDIMET

Në orën 9 të mëngjesit arritëm në Berlin. Është e para herë që vij këtu. Në stacion na pritën shokët gjermanë me Valter Ulbrihtin në krye. Bie borë dhe bën ftohtë, por të gjithë jemi veshur mirë. Masat i kemi marrë si ne, si gratë tona. Jashtë stacionit, përpara tribunës, ishte radhitur një kompani ushtarësh për të bërë nderimet e rastit dhe ca popull. U bënë ceremonitë e zakonshme. Foli Ulbrihti, fola dhe unë. Entuziazmi këtu ka vdekur, mundet edhe pse bën ftohtë. Sidoqoftë, nga çdo pikëpamje ftohtë ishte. Çështja e revizionizmit jugosllav, — me folë ose mos me folë për ta, — udhëheqjen gjermane e shqetëson, kurse ne jo. Ne bëjmë tonën, ata le të bëjnë të tyre. Miqësia jonë këtu ndahet.

Na kanë vënë e banojmë në Pankov, afër banon dhe Piku. Simfoni e bardhë bore mbi Berlin.

I bëmë vizitë protokollare Ulbrihtit në Komitetin Qendror. Bisedimi që i shkurtër, i përgjithshëm, i ftohtë; ai fliste nga pozita «të larta». Ulbrihti lëshoi një thumb në lidhje me qëndrimin tonë karshi revizionistëve jugosllavë. Edhe ne iu përgjigëm me një thumb po të atillë.

Vendosëm kurora në përmendoren ku ndodhen varret e shokëve të shquar gjermanë Karl Libkneht, Roza Luksemburg, Ernest Telman e të tjerë dhe në monumentin e ushtarëve sovjetikë në Treptov.

Filluam bisedimet. Unë i pari u bëra shokëve gjermanë një ekspozitë të pikëpamjeve tona mbi problemet ndërkombëtare, theksova mbështetjen tonë të vendosur mbi të gjitha aspektet e problemit gjerman, mbi çështjen e paqes e të çarmatimit etj. U fola për pikëpamjet tona ndaj revizionizmit jugosllav dhe për luftën e vendosur e parimore të Partisë së Punës të Shqipërisë në këtë drejtim. U fola për situatën e brendshme tonën, për çështjet ekonomike, u parashtrova edhe kërkesat tona për një kredi. Në këtë seancë shokët gjermanë dëgjuan me vëmendje. Ata do të flasin më vonë.

Vizituam shokun Pik, shok i lavdishëm. Ishte shumë i plakur. Ndenjëm afër tij, na shtrëngonte dorën, dolëm në fotografi, po nuk fliste dot. Vetëm na dëgjonte. Kur ikëm na përqafoi i heshtur. Shkuam shumë të impresionuar nga ky takim i paharruar për ne me një shok kaq të shquar të Internacionales Komuniste.

Mbrëmje nga ana e udhëheqësve gjermanë në sallën e madhe të kryeministrit në Berlin, ish-pallati i Gëringut.

BERLIN, E ENJTE
8 JANAR 1959

NË SHTËPINË KU U MBAJT KONFERENCA E POTSDAMIT

Shkuam në Potsdam. Rrugës kudo borë. Autostrada është e mrekullueshme. Anash rrugës fshatra moderne, disiplinë rrugore e përsosur. Qyteti i Potsdamit — i bukur, por i rëndë si prusianët. Vizituam shtëpinë «Cicilien Hof» ku më 1945 u mbajt Konferenca e Potsdamit. Pamë sallat me radhë. Vizituam apartamentin ku banonte Stalini, pamë edhe kolltukun e tij, të shqyer prej një amerikani që kishte marrë një copë lëkurë për kujtim.

Kudo në këtë shtëpi zotëronte hija madhështore, e qetë e tejpamëse e të madhit Stalin. Ai rron i gjallë në zemrat tona dhe dukej sikur na thoshte: «Jini vigjilentë kundër fashizmit, kundër imperializmit, kundër revizionizmit».

Në zemrën time, në kujtimet e mia, që s'do të shlyhen kurrë, qëndrojnë takimet me të, fjalët e tij të urta e të mira, këshillat e vlefshme, të qeta, të thella, plot dashuri e respekt për popullin dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë. Në këto salla ndien në zemër veprën gjerniale të këtij titani leninist.

Vizituam kështjellën «Sans-Souci» të Frederikut të 2-të dhe dhomën e fjetjes të Volterit. Buzëqeshja ironike e patriarkut Fernez dominon Frederikun dhe prusianizmin. Për drekë u kthyem në Berlin.

Vizitua uzinën e tornove «Berkman». Punëtorët na pritën nxehtësisht.

Në mbrëmje vajtëm në Operën Shtetërore të Berlinit, pamë baletin «Gajane» të Haçaturianit.

LAJPCIG, E PREMTE

9 JANAR 1959

NË LAJPCIG VIZITJMË MUZEUN «DIMITROV»

Arritëm në Lajpcig. Na pritën shumë ngrohtë dhe me dashuri. Qytet shumë interesant dhe me lëvizje të madhe.

Vizitua uzinën e makinave automatike, uzinë e madhe, e vjetër dhe me punëtorë shumë të kualifikuar.

Vizitua gjithashtu shtëpinë e vogël muze ku në vitin 1900 u shtypën numrat e parë të «Iskrës» leniniste.

Vizitua muzeun «Dimitrov». Atje, veç të tjerash, ishte edhe një ekspozitë fotografish që tregonte rrugën e luftës heroike të këtij komunisti të madh. Në këto momente patetike mendja dhe zemra jonë shkante te Dimitrovi. Në sallën e gjyqit të famshëm dëgjua të regjistruar në magnetofon zërin e Dimitrovit që përleshej me Gëringun, Gëbelsin dhe me ujqit e tjerë nazistë. Dëgjoni Dimitrovën që mbronte me heroizëm komunizmin, Bashkimin Sovjetik, jetën e njerëzve, paqen dhe brezat e ardhshëm.

Përballë tavolinës së trupit gjykues ishte një qeli e vogël, ku mbahej i burgosur Dimitrovi para se ta nxirrnin në gjyq. Në një stendë xhami pamë disa nga objek-

tet e Dimitrovit të përdorura kur ishte në gjyq — një palë rroba të thjeshta, një krehër i vogël e disa letra të tij. Lamë një shënim në librin e përshtypjeve ku, midis të tjerash, shkruam: «Dimitrovi, udhëheqës i shquar i klasës punëtore dhe i Partisë Komuniste Bullgare, ishte dhe mbetet një nga figurat më të mëdha të proletariatit botëror, një luftëtar i shquar e i paepur kundër fashizmit... Lavdi në shekuj Gjergj Dimitrovit! Lajpcig, 9 janar 1959».

Me automobil i hodhëm një vështrim qytetit dhe u kthyem në rezidencë, ku patëm një bisedë të gjatë dhe të ngrohtë me shokë udhëheqës të qytetit.

Në darkën zyrtare që u dha për ne, sekretari i partisë për qytetin foli shumë mirë për Shqipërinë dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë. Këtu njoha edhe albanologun e njohur Lamerc të cilin ne e kemi dekoruar për shërbimet e mira që u ka bërë gjuhës dhe vendit tonë. Ai fliste edhe vetë shqip. E ftuam për pushime në Shqipëri.

LAJPCIG, E SHTUNË

10 JANAR 1959

**VAZHDON VIZITA NËPËR RD GJERMANE,
FESTOJMË 46-VJETORIN
E SHOKUT MEHMET**

Qysh në mëngjes herët, midis nesh, organizuam një festë të vogël. Mehmeti sot mbush 46 vjeç. I uruam shokut tonë të dashur jetë të gjatë dhe suksese në punën e tij të madhe për çështjen e Partisë e të popullit tonë. Një mesazh urimi i dërgoi Mehmetit edhe Ulbrihti që nga Berlini. Festa jonë u bë edhe më e gëzueshme kur na erdhi një grup studentësh shqiptarë që studiojnë në Lajpcig. U uruam suksese dhe i porositëm që me qëndrimin, sjelljet e zellin e tyre në mësimet të mbajnë lart emrin e mirë të popullit e të Partisë sonë.

Vizituam kombinatin elektrokimik të Biterfeldit. Punëtorët shfaqën një entuziazëm të madh për vendin tonë. Në një nga repartet e uzinës u organizua një miting ku foli sekretari i parë i qarkut. Foli edhe shoku Manush.

Vizituam një kooperativë bujqësore në Brema ku rriteshin kryesisht lopë dhe derra. Kudo borë e madhe. Pritja e mirë.

Drekën e hëngrëm në «Kafe Tirana» në Desau. Vetëm emrin kishte «Tirana» ky lokal, se pikturat në mur ishin futuriste. Kërkuan ndihmë nga ne për disqe me këngë karakteristike shqiptare.

U kthym në Berlin me automobil nëpërmjet autostradës së mrekullueshme. Na thanë se autostrada mund të shërbente dhe si pistë avionësh dhe se ishte «e vetmja gjë e mirë që bënë nazistët» (natyrisht për luftë e bënë) e që kushtoi rrëke të tëra gjaku.

MBARUAN BISEDIMET ME GJERMANËT. NISEMI PËR NË ÇEKOSLLOVAKI

Vazhduam bisedimet. Foli Ulbrihti. Bëri një ekspozë të zakonshme dhe të thatë të politikës së jashtme, kurse për politikën e brendshme foli sa për të shkuar radhën dhe për të vënë në dukje «vështirësitë e mëdha» ekonomike (që në realitet s'janë të tilla, pse niveli i jetesës këtu mbahet shumë lart nga ndihmat dhe kreditë e mëdha që u japin sovjetikët). Ai i përmendi «vështirësitë» për të mos plotësuar kërkesat e palës sonë në lidhje me një kredi të vogël që u kërkua. Gjermanët kanë pretendime të ekzagjeruara dhe, nën pretekstin se «çështja gjermane është nevralgjike», kërkojnë ndihma pa kurrfarë turpi. Dyqanet e tyre të ushqimeve janë plot dhe të sistemuara si farmaci. Përfundimisht udhëheqësit gjermanë na i shkurtuan shumë kërkesat tona modeste dhe, ato pak që na akorduan, do të fillojnë të na i japin nga viti 1963, viti i tretë i pesëvjeçarit tonë. Dëshëm, s'dëshëm, i falënderuam.

Drekën e hëngrëm me Ulbrihtin.

Nënshkruam dokumentet zyrtare, pastaj i bëmë vizitën tradicionale Oberburgemestrit, (kryetarit të bashkisë) të Berlinit Lindor. Vizitë ceremoniale; foli ai, fola dhe unë.

Dha pritje ambasada jonë. Kishte plot pjesëmarrje. Ambasadori sovjetik Pervuhin na rrinte afër, por s'u hap asnjë muhabet për ç'na preokuponte ne në lidhje me kreditë që kërkuam. Pervuhini sillej i dashur me ne, si gjithë sovjetikët që ishin në darkë dhe, veçanërisht disa gjeneralë, me të cilët ngritëm dollari për miqësinë.

Në orën 22 u nisëm me tren për në Pragë. Përcjellja u bë zyrtare. U mbajtën fjalime në stacion.

PRAGË, E HËNË

12 JANAR 1959

ARRITËM NË ÇEKOSLLOVAKI. FILLUAM BISEDIMET

Arritëm në Pragë. Në stacion na pritën me ceremoni zyrtare. Kishin dalë Novotni, Shiroki e të tjerë. Shkëmbyem fjalimet e rastit Novotni dhe unë. Në stacion dhe në rrugë shumë popull dhe entuziazëm, e kundërta e Berlinit.

Shkuam në kështjellën e Pragës, ku i bëmë vizitën protokollare presidentit Novotni, i cili foli shkurt për vendin tonë.

Vendosëm kurora në mauzoleun «Klement Gotvald». Gotvaldi që vdiq në moshë relativisht të re, ka qenë një shok shumë i mirë, një revolucionar i shquar dhe besnik i Stalinit të madh. Këta, të rinjtë, sikur s'e përmendin shumë, për të mos thënë fare, emrin e Stalinit.

Filluam bisedimet. Fola unë i pari. Novotni foli pas meje. Fjalimin ai e kishte të gjatë dhe me shkrim. Kohë sa duhet s'kishte në dispozicion, përkthyesi i tij nuk ia shkrephte, prandaj Novotni bëhej nervoz e mezi priste sa ta lexonte atë ç'kishte shkruar. Ai na tha të tijat. Sikur

bëri një detyrë që kishte. Nejse. Edhe ne ia thamë ç'kishim, pastaj u ngritëm e ikëm.

Shkuam në Teatrin Kombëtar dhe pamë operën «Rusalka» të Dvorzhakut. Pjesë shumë e bukur, më pëlqeu.

PRAGE, E MARTË

13 JANAR 1959

ÇEKËT I SHIKOJNË ÇËSHTJET VETËM NGA ANA E INTERESIT TË TYRE

Pritja në Çekoslovakë në përgjithësi (sidomos në pamjen e jashtme) është e mirë, por te shokët çekoslovakë gjithnjë e më tepër duken ndjenja të theksuara prej tregtari. Ata i shikojnë çështjet nga ana e interesit të tyre, duke mos parë sa duhet në to frymën e vërtetë internacionaliste. Po s'kemi çfarë bëjmë. Po të ishim ne në vend të tyre, nuk do të vepronim kështu.

Sot shkuam në qarkun e Budjejovicës (Çekia Jugore), ku vizituam uzinën e madhe «Kovosvit» në qytetin Zasimove-Usti. U bë miting me punëtorët. Fola përpara tyre për miqësinë, për gjendjen në vendin tonë dhe për çështjet ndërkombëtare. Punëtorët e pritën shumë mirë fjalimin.

Vizituam kooperativën bujqësore «Zheçne Radimovice». Pritje e ngrohtë në klub. E futëm në garë me kooperativën tonë bujqësore «Jeta e re» të Lushnjës. Kooperativa ishte e mirë, e pasur dhe e përparuar.

Pritje në kështjellë. Foli Novotni, fola edhe unë. Njerëz kishte plot, po pritja ishte një gjë e ftohtë. Bisedë të ngrohtë bëra me Nedjelnin. E ftova të vijë të pushojë te ne.

BRATISLAVE, E MËRKURE

14 JANAR 1959

VIZITJËMË SLOVAKINË

U nisëm për në Sllovaki dhe arritëm në Bratislavë. Na pritën me popull e me ceremoni. Foli sekretari i parë i partisë për Sllovakinë Karol Bacilek, përshëndeta dhe unë.

Bacileku është njëfarë babaxhani, plak i thjeshtë e i lezetshëm. Pi duhan më tepër se unë, bile kutinë nuk e mban fare në xhep, por në dorë, si dhe Kopecki, që e mban nën sqetull. Këtu s'ka forma, mënyra dhe luks si në Çeki; e ndien veten më lirë dhe shokët sllovakë janë me më pak «maniera», më të qeshur e më të dashur. Kundër Titos flitet më hapur dhe pa ceremoni siç bëjnë çekët.

Shkuam në Komarno, një qytet buzë Danubit, ku vizituam kantierin e ndërtimit të anijeve. U organizua një miting ku përshëndeti sekretari i parë i partisë për qarkun. Nga ne foli shoku Mehmet. Hëngrëm drekë në një anije që do ta marrin sovjetikët. Jam i lodhur dhe më dhemb koka.

Vizituam kooperativën bujqësore Topolniki (minoritet hungarez). Fjalimin e mbajta në shqip, pastaj u për-

ktheje në çekisht, nga çekishtja në sllovakisht dhe më së fundi nga kjo në hungarisht. U masakrua fare.

Mbrëmje solemne në Bratislavë. Më dhembti shumë koka, piva dy aspirina, por e mbajta veten me forcë. Foli Bacileku, pastaj fola unë. Mbrëmja ishte e ngrohtë, kishte edhe sovjetikë që punojnë në këto anë dhe këta u treguan shumë të dashur. Pas pritjes u nisëm me tren për në Brno. Po bie të fle se jam shumë i lodhur nga dhimbja e kokës.

15 JANAR 1959

NË BRNO

Në Brno na pritën nxehtë sekretari i komitetit të partisë të qarkut me gjithë shokët e tij; na vunë në një shtëpi të mirë, me pamje nga qyteti.

Pas një bisede të shkurtër dhe si hëngrëm mëngjesin, shkuam vizituar uzinën «Kravolboice Trojerni», e cila prodhon makina të rënda për industrinë kimike. Fola në aktivin e Partisë. Shokët çekë bënë pyetje dhe mbetën të kënaqur. Komunistët dhe punëtorët çekë treguan një interesim dhe një dashuri të madhe për vendin dhe për Partinë tonë.

Drekën e hëngrëm në tren, me qëllim që në mbrëmje të kthehem në Pragë.

16 JANAR 1959

PËRFUNDUAN BISEDIMET ME ÇEKOSLLOVAKËT

Vizitë në uzinën «Vilhelm Pik». Fola në aktivin e partisë të uzinës dhe përpara punëtorëve. Folën edhe Mehmeti me Dolanskin. Dolanski tregohet më i dashur me ne se të tjerët, është më i thjeshtë.

Vazhduan bisedat në kështjellë me Novotnin dhe shokët e tij. Ata nuk e pranuan kërkesën tonë të arsyeshme dhe për pesëvjeçarin e tretë na akorduan një kredi të kufizuar. Shiroki më bëri «teori» se ata japin kredi për investime në vendet mike, «atje ku shihet interesi i përbashkët», por mua më duket se kredi japin atje ku interesi i tyre është më i madh. Sidoqoftë unë iu përgjigja, natyrisht në mënyrë diplomatike, por që ai e kuptoi mirë se ne nuk jemi syleshë.

Firmuam dokumentet me ceremoni.

Darkë nga ana jonë. U njoha me shoqen Neumanova, plakë revolucionare komuniste, bashkëshorte e poetit revolucionar çek S. K. Neuman¹. E ftova të vijë në Shqipëri dhe ajo do të vijë.

¹ S. K. Neuman (1875-1947), poet revolucionar çek. Gjatë Luftës së Parë Botërore, duke qenë i mobilizuar në ushtrinë austro-hungareze, u dërgua në Shqipëri ku qëndroi një vit e gjysmë në Elbasan dhe në Beragozhdë të Pogradecit, të cilave u kushtoi vëllimet «Elbasani» dhe «Beragozhda», me vjersha e kujtime me tema krejt shqiptare.

MBAROI VIZITA JONË ZYRTARE NË ÇEKOSLLOVAKI

U larguam nga Praga, pasi u bënë ceremonitë e zakonshme. Në ndarje folëm unë dhe Shiroki për miqësinë, për unitetin dhe u nisëm me tren për në Tatra. Atje, unë dhe Mehmeti, do të pushojmë disa ditë, para se të nisemi për në Moskë ku do të marrim pjesë në Kongresin e 21-të të PK të BS.

GJAH I MBARË

Jemi në malet e larta Tatra në "Javovina". Koha është jashtëzakonisht e mirë, dielli shkëlqen mbi borë. Jemi në një vilë të bukur të rrethuar me pisha. Po çlodhemi e po përgatitemi të shkojmë për gjah.

Pasdreke e filluam gjahun. Unë shkova për dhi të egra, Mehmeti për kaproj ose për drerë. U ngjita në Tatra Llomnica me teleferik, pastaj kalova gërxhet përpjetë me këmbë, mbi borë e gurë. Lodhje e madhe, djersët çurkë, po dhitë asgjekundi nuk dukeshin. Zbritëm në stacionin e teleferikut. Këtu shoqëruesit m'u lutën të ngjiteshim edhe një stacion me teleferik dhe që këndej mund të qëllonim mbi gjahun në hon. U ngjitëm pa shpresë, por më së fundi ja, si pika të zeza në borë, në hon u duk një tufë dhish të egra rreth 250 m larg. Ngrita pushkën me dylbi, qëllova dhe dhia u godit. Ajo bëri disa dhjetëra metra përpara e plagosur, pastaj mbeiti në borë. Të tjerat «fluturuan». Në të kthyer në Tatra Llomnica vrava edhe një dre. Gjah i mirë sot.

NË TATRA PO E KALOJMË MIRË

Tërë ditën e kaluam në vilë, herë duke lexuar, herë duke luajtur domino pranë zjarrit bubulak, por herë duke dalë edhe në diell që të ngroh mirë. Nexhmija e ndien veten më mirë dhe është e kënaqur.

Pasdreke shkuam përsëri për gjah. Mehmeti nga një anë, unë nga një anë tjetër me Pavlin dhe me drejtorin e Parkut Kombëtar të Tatrës. Udhëtuam me karrocë, larg nga kufiri polak thellë në mal. Gjë e mrekullueshme. Kasollet ishin përgatitur, qenë përgatitur gjithashtu ushqimet (gështenjë dhe bar) për kopetë e drerëve. Nata duhet të na zinte në kasolle dhe atje të mbyllur, të heshtur, pa pirë as cingar, duke vëzhguar nga dritaret e vogla, të prisnim ardhjen e drerëve. Mbërritëm në vend, kur perëndoi dielli. Natyrë madhështore, e egër, e bukur, e bardhë, e heshtur. Prit e prit, pastaj larg nesh u duk një dre, po s'levizte. Duke e fiksuar aq shumë me sy, na dukej sikur ai e ndiente rrezikun. Më në fund u afrua, e qëllova në kokë, mbeti në vend. Gjah i bukur. E hodhëm në karrocë dhe u kthyem. Rrugës në dritën e hënës dukej vetëm borë. Bënte ftohtë, po ne ishim veshur mirë.

Kishim për darkë në vilë miq sllovakë, sekretarin e parë të komitetit të partisë të Kozhices, sekretarin e ko-

mitetit të partisë të Tatra Llomnicës, si dhe kryetarin e komitetit ekzekutiv të këtij stacioni të bukur dimëror. Darka kaloi e gëzueshme. Shokë e miq të mirë të Shqipërisë.

PËRSËRI PËR GJAH

Shkuam përsëri për gjah që në mëngjes, por këtë herë bashkë me presidentin e Presidiumit të Sllovakisë që po pushon këtu. Kësaj radhe thamë do të gjuajmë ç'të na dalë, nuk do të shkojmë lart në mal për drerë, por për lepuj, dhelpra, kaproj etj. në Tatra Llomnica. Jemi një grup i madh, kemi zënë prita në pyll. Ka të tjerë që e trembin gjahun drejt nesh. E presim gjahun në akull e në borë, duke pirë kafe të nxehtë po dhe sytë i hedh sa andej-këndej, ndërsa dyfekun e mbaj në dorë gati. Zhurmat janë akoma larg. Në të majtë, në një qoshe, fshehur në shkurret e mbuluara me borë vë re dy sy që shndritin, lëvizin, ato na gjurmojnë. Duket një kokë e vogël dhe një pjesë bishti që fshin borën: Dhel-për! Me ngadalë ngre pushkën, marr shenjë dhe qëlloj. Dhelpra mbeti e shtrirë në borë. I qasem me kujdes se ajo është kafshë hileqare, dhelprë me një fjalë; lëviz bishtin me përtaci, sikur donte të më thoshte: «S'më shkojnë më dhelprët». E para dhelprë që vras në jetën time. Edhe sot vetëm unë qëllova që vrava një dhelprë, pse shokëve s'u doli gjë fare në pritë.

NJË SHËTITJE E KËNDSHME ME SLITË
NËPËR BORË

Dolëm shëtitje me karrocë të hapët (slitë) nëpër borë me Nexhmijen në drejtim të kufirit polak. Vajtëm deri tek ura e kufirit. Koha është shumë e bukur, shëtitje e këndshme dhe e shëndetshme. Bëmë fotografi. Kujtime të mira, do t'ua tregojmë fëmijëve kur të kthehemi. I kemi larg e na ka marrë malli. Çekët që na shoqëruan na folën keq për polakët.

22 JANAR 1959

NË BASHKIMIN SOVJETIK

Në orën 11 u nisëm me tren drejt kufirit sovjetik. Arritëm në Çop, atje na priste «miku» ynë, Llaptievi.

Drekën e hëngrëm në stacion me sekretarin e partisë të rajonit. Jemi të kënaqur dhe ca të çlodhur nga pushimi i shkurtër që bëmë në Tatra.

23 JANAR 1959

UDHËTOJME NËPËR UKRAINE

Treni po çan përpara, vagonat i kemi specialë, të veçantë, komodë. Vende të njohura, të dashura. Kudo ka borë, por jo borë e madhe.

Fshatrat e Ukrainës nuk të lënë përshtypje të mirë, pse shtëpitë njëkatëshe duken të varfra, të mbuluara me kashtë, të zymta. Ç'ndryshim me fshatrat e Gjermanisë e të Çekosllovakisë! Pse kështu? Çudi?! Ukraina është edhe e pasur. Stacionet e dyta në linjat hekurudhore janë të papastra, të zymta.

Sovjetikët kanë shumë për të bërë në këtë drejtim.

ARRITËM NË MOSKË

Mbërritëm në Moskë. Koha ishte me mjegull. Në stacion kishte dalë për të na pritur Hysniu, i cili ka mbërritur në Moskë para nesh, kurse nga sovjetikët na pritën Aristovi, Pospjelovi, Zasiadkoi, Danilovi, Firiubini, Konstantinovi e të tjerë.

Përqaftime me shokët, biseda të zakonshme. Ua hipëm automobilave dhe shkuam në një vilë, brenda në Moskë ku kemi qenë edhe herë tjetër.

Në mbrëmje, si zakonisht, bilardo dhe film. Bisedë e përzemërt me Lesakovin («mikun» tonë të përherëshëm), që s'di të thotë gjë tjetër përveç se «stariçok», «u plake», «u plaka» e të tjera shakara të tilla që janë bërë bajate. Por sidoqoftë ai është i dashur me ne. Duhet thënë se atij s'ia vë veshin njeri dhe s'i thonë gjë për të na komunikuar, përveç gjërave të zakonshme.

NË EKSPOZITËN E ARTEVE FIGURATIVE
TË VENDEVE SOCIALISTE

Vizituaam ekspozitën e arteve figurative të vendeve socialiste. Ishin dhe shumë delegatë të tjerë nga partitë motra që kanë ardhur për të marrë pjesë në Kongresin e 21-të. Ekspozitë pak a shumë e mirë. Pjesa e sovjetikëve ishte më e madhe dhe e pasur me piktura e ekspozate nga të gjitha llojet. Po kështu dhe ajo e çekoslovakëve, ku kishte një sërë pikturash të avancuara. Ajo e polakëve ishte për të vënë duart në kokë; tablo futuriste, statuja si ato të vjetrat, të popujve primitivë të pyjeve afrikane dhe pa asnjë shije. Mizerje. Stenda jonë paraqitej mirë si në pikturë, edhe në skulpturë dhe vizitorët, siç na thanë, e kanë pëlqyer.

Përshtypje më bëri gjithashtu pjesa kineze e ekspozitës dhe ajo e Vietnamit.

FILLOI PUNIMET KONGRESI I 21-TË I PK TË BS

U çel Kongresi i 21-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në pallatin e Kremlinit.

Na kanë caktuar në tribunë. Kongres solemn dhe salla e mbushur plot. Pasi u mbajt fjala e hapjes dhe u bënë zgjedhjet e zakonshme të presidiumit, të sekretarisë etj., e mori fjalën Nikita Hrushovi, i cili mbajti raportin e Komitetit Qendror të PK të BS. Raporti ishte i gjatë, mbi 6 orë, pa përfshirë pushimet. Unë e dëgjoj në frëngjisht. Por duhet të marrim kopjen dhe ta lexojmë me kujdes.

NË KONGRESIN E 21-TË TË PK TË BS

Sot filluan diskutimet. Çdo diskutant ka në dispozicion 20 minuta kohë. Ato flasin për aktivitetin e sektorit që përfaqësojnë dhe pastaj mbështetin raportin. Diskutimet janë pothuajse standard.

Në pushime shkuam në sallën e veçantë, Ekaterinski Zall, me mobiljet e vjetra e rokoko, të lyera me ar e me perde të kuqe. Tryezat janë plot — kënaqësi kjo për Harri Politin, i cili, qoftë në pushime, qoftë në seanca, vazhdimisht mbllaçitet. Atje takohemi me shokë të ndryshëm të partive. U takova me Dyklonë, i cili tregohet më i afruar me mua, me Pasionaren, që mbahet mjaft rëndë, me Ghoshin, shok që më qëndron afër, pse njihemi, kemi qenë me pushime tok në Kislovodsk. Ghoshi s'më duket shumë i thellë e me mendime të pjekura e të vendosura; duket si kalama sido që nga mosha është i shkuar.

Nexhmija u shtrua në spitalin «Kremlovskaja» për ekzaminime para operacionit që duhet të bëjë.

PËRSHËNDETA KONGRESIN E 21-TË TË PK TË BS

Vazhdojnë diskutimet në Kongres.

Sot pasdreke m'u dha fjala edhe mua. Përshëndetja ime u prit mirë dhe pati shumë duartrokitje.

Njerëzit sovjetikë i duan popullin e Partinë tonë me gjithë shpirt, pavarësisht se mund të ketë disa që na nënçmojnë, pse jemi një vend dhe një Parti e vogël.

NË KONGRESIN E 21-TË TË PK TË BS

Vazhdojnë diskutimet dhe përshëndetjet.

Shkova në spital për të parë Nexhmijen.

VAZHDOJNË PUNIMET E KONGRESIT TË 21-TË TË PK TË BS

Vazhdojnë diskutimet e delegatëve dhe përshëndetjet e delegacioneve të huaja.

Në mbrëmje në shtëpi luajmë bilardo dhe shohim filma, pse tjetër s'ke ç'bën në një vilë në pyll, jashtë Moskës, ose mbyllur në një vilë në qytet. Lesakovi vjen çdo mbrëmje dhe çdo mbrëmje po ai avaz, po ajo «këngë e Mukës» nga ana e tij.

POLJANSKI NA FTON PËR DREKË

Bashkë me Mehmetin na kishte ftuar për drekë Poljanski në një vilë jashtë Moskës¹. Kudo borë dhe shumë ftohtë. Poljanski tok me shokë të tij, na priste te dera e jashtme e vilës, një ndërtesë e madhe dhe e bukur. «Kjo, — tha si me mburrje Poljanski, — është daça ku pushonte Lenini». Këtë daçë, siç na tha ai, e ka në dispozicionin e tij dhe shkon kur të dojë për të pushuar. Pastaj na paraqiti të shoqen dhe shokët e tij. Njërën e quanin Jefremov, tjetrin, nga Krimeja, s'e mora vesh kush ishte. Më vonë erdhi edhe një tjetër i cili, kur ika, më dha për kujtim një kuti prej teneqeje për të mbajtur duhan. «E kam, tha ai, që në kohën e luftës partizane».

Dhomat e vilës ishin të mëdha dhe të mobiluara me mobilje tepër të rënda, me gusto, siç i bëjnë zakonisht sovjetikët. Tryeza në mes të njërës nga dhomat ishte e shtruar plot për plot dhe Poljanski me të tijtë filluan ngrënien e pijen pa mbarim. Ne, si me dietë, nuk hanim dhe s'pinim fare, por hanim e pinim sovjetikët edhe për ne; sidomos pinin, pinin. U lodhëm në tryezë. Kërkova të largoheshim nga pija dhe më vajti mendja te bilardoja. Shkuam e luajtëm sa u lodhëm. Koha s'po kalonte. Ne dëshironim të iknim, por ata s'na linin. Na çuan prapë në dhomën e bukës ku ishte shtruar dreka. Ajo që hën-

¹ Enver Hoxha. «Hrushovianët», f. 403-406.

grën më parë kishte qenë mëngjesi. U kthyem pra prapë në tryezë, ku rifilloi pija pa mbarim. Për të shpëtuar disi nga vodka Mehmetit i ra ndërmend të kërkonim të shihnim ndonjë film. Na shfaqën një film meksikan, biçim «revolucionar», dhe ndërsa ne qëndruam në sallën e filmit, Poljanski me shokë prapë ishin shtruar në pije. Poljanski gjatë gjithë ngrënies e pirjes kolosale fliste për Partinë tonë dhe për Shqipërinë, thoshte se na donte shumë e se kishte kujtime të paharruara nga pushimet që kishte bërë në Shqipëri. Fol e pi, ha e ngri dolli, kështu vajti gjithë e diela.

Kur mbaroi filmi na ftuan të uleshim përsëri në tryezë, por nuk pranuan. Atëherë Poljanski na propozoi një shëtitje «ala ruse» në borë. Ishte natë kur dolëm. Në atë kohë erdhi njëfarë Popovi, të cilin e njihja që në Leningrad. Ai punonte në aparatën e Partisë të Leningradit, kur atje sekretar i parë ishte Kozlovi. E pyeta: «Kur ke ardhur», ai më tha: «Pse, nuk e di? Unë tash jam ministër i Kulturës i Republikës Ruse». «Që kur?», — e pyeta. «Që kur u bë Kozlovi sekretar i Komitetit Qendror», — m'u përgjigj. E paska marrë suitën me vete Kozlovi mendova, por s'bëra zë. Momenti e donte që ta uroja Popovin për gradimin dhe kështu bëra.

«Shkuam një të diel të mirë» — më thoshte Poljanski që i qe trashur gjuha, kurse unë, përveç mërziisë dhe ndjenjës së pakënaqësisë për këtë mënyrë të sjelluri nga ana e shokëve sovjetikë që më shkaktoi, atë «të diel të mirë» e pagova, gjatë shëtitjes u ftoha, mora një rrufë të fortë e me temperaturë.

MOSKË, E MARTË
3 SHKURT 1959

ME SA DUKET KONGRESIN NUK DO TA NDJEK MË

Dje, në datën 2, dhe sot vazhduan diskutimet dhe përshëndetjet në kongres.

Shkova në spital për të vizituar Nexhmijen. Ajo ishte mirë, në mbikëqyrjen e doktorëve, plot kurajë. Ajo nuk kanë caktuar se kur do ta operojnë.

Pasdreke nuk e ndjeva veten mirë. Si duket i ftohti i fortë që mora të dielën në darkë, kur ishim te Poljanski, po më rëndon. Doktorit që më vizitoi, konstaton grip. Më detyroi të qëndroj në dhomë.

Vajti kongresi, s'do ta ndjek dot më.

PUNIMET E KONGRESIT PO I NDJEK ME ANË TË SHTYPIT

Erdhi përsëri mjeku. Kam temperaturë. Më këshilloi të mos dal. Kongresin e ndjek disi me gazeta. Le sakovi vjen më mollois, më inkurajon të mos mërzitem e më bën të njëjtat shakara bajate, siç e ka zakon. Por çka, shkoj kohën, nuk është njeri i keq. Ai është ca i përciptë, po i dashur me ne. Pasioni i tij është bilardoja, të pirët, disa gota me konjak dhe të vijë vërdallë. Kur punon ky njeri? Është zor të mendosh se bën ndonjë punë përveç pritjeve, përcjelljeve e shoqërimeve të delegacioneve.

MBETA BRENDA NGA GRIPI

Vazhdoj të jem i shtrirë. Kongresit ia piva lëngun. Nexhmija më njofton se është mirë, por, për të mos më hidhëruar dhe mërzitur mua, tregohet optimiste dhe ma fsheh të vërtetën, kurse unë e di se nesër do të operohet. Jam shumë i shqetësuar. Dëshiroj të jem pranë saj, po s'më lënë mjekët.

SË SHPEJTI DO TË NISEM PËR SHQIPËRI

Dje Nexhmija u operua me sukses. Ishte fillikat vetëm. S'më lanë të veja as mua, as Fiqretin e Viton që janë këtu, se në Moskë ka shumë grip këto ditë. Nexhmija ka ca temperaturë e dhimbje, por më siguruan se janë të natyrshme.

Unë jam më mirë, nesër do të dal patjetër dhe do të vete drejt e në spital tek ajo, sepse ka dhe ditëlindjen.

Këto ditë do të largohemi për në Shqipëri, por Nexhmijen do ta lë në Moskë, në spital. Unë do të gjej shokët, popullin, atdheun, fëmijët e dashur, kurse Nexhmija e shkretë do të ngelë vetëm.

PRITJE TE HRUSHOVI. TAKIM ME ÇUVAHININ

Pritje te Hrushovi. Ishim unë, Mehmeti e Hysniu. Nga sovjetikët ishte edhe Andropovi. Një takim më tepër kortezie e lamtumire.

Për darkë na erdhi Çuvahini, ish-ambasadori sovjetik në Shqipëri në vitet kur ishte gjallë dhe drejtonte i madhi Stalin. U gëzuam shumë, kishim pa e parë gati që kur iku nga Shqipëria. Edhe ky është një zakon tjetër i keq i sovjetikëve: nuk i pjek dot të njohurit e mëparshëm. Në darkë, e cila kaloi e gëzuar, ishin Medvedjevi, Lesakovi, Llaptievi. U çmallëm. Çuvahini është po ai që ka qenë, nga shëndeti dhe nga tabietet: i dashur, i malluar për Shqipërinë dhe për ne. Mendoj se mbetet një mik i mirë e i sigurt për Partinë tonë dhe për Shqipërinë.

U KTHYEM NË SHQIPËRI

Sot u nisëm me avion për në Tiranë. Na përcollën në aerodromin e Moskës ata që na pritën.

Mbërritëm mirë në Tiranë në orën 10 paradite. Shokët kishin dalë të na prisnin. U gëzuam pa masë që u kthjem në atdheun tonë të bukur plot diell, megjithëse jemi në shkurt. Malli na kishte marrë shumë për vendin tonë, edhe për gurët e rrugës, siç thotë populli. Ikëm nga të ftohtit e Moskës, nga bora, nga klima e zyrtë, nga dhomat e mbyllura e pa ajër, nga frika e të ftohtit dhe e gripit. Pak ndenjëm në Moskë dhe çështjet që u shtruan atje ishin të rëndësishme për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Për disa çështje ne kemi mendimin tonë, të tjera çështje kapitale janë të diskutueshme dhe meritojnë që të reflektojmë mirë që asgjë të mos na gjejë në befasi.

PLENUMI I KQ APROVON VEPRIMTARIË
E DELEGACIONIT TONË NË RD GJERMANE,
NË ÇEKOSLLOVAKI DHE NË BASHKIMIN SOVJETIK

Sot hapëm Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë, ku raportova mbi rezultatet e vizitës së delegacionit tonë në RD Gjermane dhe në Republikën Çekoslllovakë. Raportova gjithashtu mbi zhvillimin e punimeve të Kongresit të 21-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. U aprovua njëzëri veprimtaria e delegacionit.

DARKE NË AMBASADËN SOVJETIKE

Ishim për darkë në ambasadën sovjetike me rastin e festës së Ushtrisë së Kuqe. Doli andej e këndej. Ivanovi — plot shaka si ngaherë.

U KTHYE HYSNIU NGA MOSKA

Erdhi shoku Hysni nga Moska ku ndenji disa ditë për ekzaminime mjekësore. Më solli dhe letër nga Nexhmija.

**DO TË MARRIM PJESE NË MBLEDHJEN
E MINISTRAVE TË TREGTISË SË JASHTME
TË VENDEVE TË KAMPIT SOCIALIST**

Bisedova dhe udhëzova ministrin tonë të Tregtisë, që niset për në Republikën Demokratike Gjermane, në lidhje me mbledhjen e ministrave të tregtisë së jashtme të kampit socialist.

**ALGJERIANËT KËRKOJNË T'I NDIHMOJMË
PËR SHËRIMIN E TË PLAGOSURVE**

Më informuan se përfaqësuesi i Algjerisë në OKB i ka kërkuar përfaqësuesit tonë në këtë organizatë që të dërgojnë për shërim në Shqipëri 10 algjerianë të plagosur. Jam dakord. Të merret edhe mendimi i shokëve të tjerë të Byrosë Politike.

IVANOVI IKËN PËR PUSHIME

Erdhi ambasadori Ivanov për t'u takuar; shkon në Moskë për pushime.

BISEDË FORMALE E PËRFAQËSUESIT SOVJETIK

Erdhi këshilltari i ambasadës sovjetike, Novikov, ose «Samojgllavni», siç e quajmë, pse, me të filluar bisedën, e pyet për shëndetin, menjëherë thekson «samoje gllavnoje» e nis të thotë ç'ka për të thënë. Por në fakt s'na thotë asgjë të rëndësishme, ose na raporton për ato që ne i kemi lexuar me kohë dhe më me hollësi nga TASS-i ose buletinet e lajmeve të agjencive të huaja. Edhe sot «samoje gllavnoje» e tij ishte një informim për vizitën, tashmë të njohur, të kryeministrit të Anglisë, Makmilan, në Moskë.

TË DEMASKOJMË SYNIMET ARMIQËSORE TË GRUPIT REVIZIONIST TË BEOGRADIT

Në seancën e sotme të Konferencës së Partisë të Qytetit të Tiranës, mbajta një fjalim. Përveç problemeve të jetës së brendshme të vendit fola edhe mbi shpifjet dhe provokacionet kundër vendit tonë që bën grupi revizionist i Beogradit si dhe mbi konceptet e tij anti-marksiste, shoviniste dhe nacionalisto-borgjeze¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 52.

NË RRUGËN E PROVOKIMEVE DHE TË AVENTURAVE

Sot në gazetën «Zëri i popullit» u botua artikulli me titull «Intrigat, shantazhet dhe kërcënimet janë baza e politikës së revizionistëve jugosllavë», i shkruar në bazë të shënimeve dhe të tezave të zgjeruara që kisha përgatitur në lidhje me udhëtimin tremujor të Titos në një sërë vëndesh të Azisë dhe të Afrikës¹.

¹ Shënimet në formë tezash të zgjeruara me titullin «Në rrugën e provokimeve dhe të aventurave» të shokut Enver Hoxha ndodhen në Arkivin Qendror të KQ të PPSH.

PRITJE NË AMBASADËN HUNGAREZE

Pritje në ambasadën hungareze me rastin e 14-vjetorit të çlirimit. Foli ambasadori Zhatkullak, fola edhe unë.

BISEDË ME DELEGACIONIN E MINISTRISË SË GJEOLGJISË TË BASHKIMIT SOVJETIK

Bisedë me delegacionin e Ministrisë së Gjeologjisë dhe ruajtjes së pasurisë së nëntokës të Bashkimit Sovjetik që mori pjesë në konferencën tonë tekniko-shkencore të gjeologjisë¹.

¹ Delegacioni përbëhej nga zëvendësministri i Gjeologjisë dhe ruajtjes së pasurisë së nëntokës, Sollopov, dr. prof. Jakzhin dhe dr. prof. Djakov.

E PREMTE
17 PRILL 1959

TROCKISTI TITO — KOMUNIST SPECIFIK

(Shënime e teza)

Kam në dorë deklaratën e renegatit Tito bërë fle-tushkës «Komunist» me rastin e 40-vjetorit të së ashtu-quaajturës Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë. Cili ësh-të qëllimi i tij me këtë deklaratë, çfarë del prej saj?

— Diskreditimi i Bashkimit Sovjetik dhe i PK të Bashkimit Sovjetik.

— Diskreditimi i lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

— Tentativat e tij të kota për të rehabilituar troc-kizmin.

a) — **Rëndësia e Kominternit** dhe si përpiqet troc-kisti Tito ta diskreditojë gjithë veprimtarinë e Komin-ternit, duke marrë për bazë «çështjen Gorkiç»¹.

Fakti që trockisti Gorkiç u demaskua prej Komin-ternit, qoftë edhe me vonesë, nuk vërteton tezën e Titos. (Trockistët dhe gjithë tradhtarët e marksizmit kanë përdorur e përdorin shumë taktika të stërholluara për t'u maskuar.)

Faktet historike tregojnë të kundërtën, se ishin PK e BS dhe Kominterni ata që kanë dhënë shembullin, si

¹ Milan Gorkiç. Nga viti 1932 gjer më 1937 ka qenë udhëheqësi kryesor i KQ të PKJ dhe në udhëheqjen e Kominternit. Më 1937 u dënua prej Komitetit Ekzekutiv të Internacionales Komuniste.

nga ana teorike, ashtu dhe nga ana praktike, për de-maskimin dhe dërrmimin e trockistëve dhe të renegatëve të marksizëm-leninizmit, si në Bashkimin Sovjetik ashtu dhe në gjirin e partive të tjera, kur këto bënë pjesë në Komintern. Të njëjtën gjë ato bënë edhe ndaj troc-kistit Gorkiç më 1937.

b) Duke ngritur «çështjen Gorkiç» Titoja, mbrojtës i trockistëve, kërkon të hiqet sikur ai ishte i vetmi «luf-tëtar» kundër trockistëve dhe Kominternit. Sa qesharake!

c) Jeta vërtetoi se Titoja s'ishte veçse një Gorkiç tje-tër, dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare iu desh gjith-ashtu një kohë mjaft e gjatë për ta zbuluar dhe për ta demaskuar Titon dhe bandën e tij trockiste.

ç) Kuptohen lehtë nga marksistë-leninistët kujdesjet e Titos për t'u fshehur nga kontrolli marksist i Komin-ternit (dhe jo nga telefonat e të tjera shpifje të tij). Që atëherë, pra Titoja s'ishte veçse një trockist. Përpjekjet e Titos (dhe ia arriti qëllimit), për të zëvendësuar Gorkiçin s'ishin veçse rivalitete trockistësh të maskuar.

d) Shohim pra, pavarësisht nga «çështja Gorkiç», se që atëherë renegati Tito ishte në fakt kundër Kominternit, vepronte kundër tij, vepronte kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kundër Bashkimit Sovjetik dhe përpiquej, në mënyrë të fshehtë, të hidhte në dorë udhëheqjen e PK Jugosllave, sikundër e hodhi. Me këto ai synonte të rea-lizonte ëndrrën e trockistëve, për të krijuar një parti trockiste, ta çonte atë në pushtet dhe nga këto pozita t'i bënte luftë të hapët lëvizjes komuniste ndërkombëtare, Bashkimit Sovjetik dhe socializmit.

Renegati i vjetër Tito dhe grupi i tij mundi për një kohë (si në kohën e tij Gorkiçi) të maskohej mirë, dhe të shfrytëzonte udhëzimet marksiste-leniniste të Komin-ternit dhe heroizmin e popujve të Jugosllavisë dhe të komunistëve jugosllavë, për t'ia arritur qëllimit të tij djallëzor. Kur populli dhe komunistët jugosllavë luftonin

heroikisht, Titoja përgatiste puçin e tij, tragjedinë e Partisë Komuniste Jugosllave.

Ai pati përkrahjen e plotë, të fshehtë dhe publike të Uinston Çerçillit. Asnjëherë s'është parë në historinë e reaksionit anglez që të braktisen aleatët e tij, siç ishin monarkia e Karagjorgjeviçëve dhe reaksioni serbo-kroat, në favor të një aleati të ri, «komunistit specifik Tito». Pikërisht kjo gjë u bë nga Uinston Çerçilli gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në dritën e fakteve duket qartë se kundërshtimet e Titos me Kominternin nuk e kishin burimin «në gabimet e Gorkiçit», por në armiqësinë e thellë e radikale të Titos kundër komunizmit, socializmit dhe Bashkimit Sovjetik.

Titoja dhe grupi i tij ishin nga themeluesit e Byrosë Informative. Por këta trockistë të vjetër hodhën shqelmat e parë dhe dolën prej saj, natyrisht këtë herë jo për «çështjen Gorkiç», çështja e tyre ishte vetë një çështje e dytë «Gorkiç», ishte një vepër e ndyrë trockiste për Partinë Komuniste Jugosllave dhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Tito-Gorkiçit iu zbuluan të palarat. Puna diversioniste e tij u demaskua.

Rëndësia e Byrosë Informative, karakteri i saj dhe anët e mira pozitive. Krahasimet e nevojshme.

Programi i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, program trockist; rehabilitimi i trockizmit në konditat aktuale, por me të gjitha tiparet e vjetra të trockizmit.

Trockizmi, agjenturë e imperializmit.

Lufta aktuale e Titos nga këto pozita kundër komunizmit, PK të Bashkimit Sovjetik, partive komuniste dhe punëtoresh, kundër Bashkimit Sovjetik, kundër kampit socialist është vazhdimi konsequent i luftës së po këtij trockistij kundër Kominternit, kundër Informbyrosë, kundër socializmit.

Kominterni dhe Informbyroja, ndryshimet në mes tyre dhe qëllimi i madh i forcimit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. **Konkluzion, Titoja kundër Kominternit**, kundër Byrosë Informative, kundër çdo forme organizimi dhe bashkëpunimi në favor të forcimit të komunizmit. Konsekuencë në idetë dhe veprimet trockiste të Titos dhe grupit të tij.

Taktika e sulmeve, e shpifjeve, e sabotazheve kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore dhe partive komuniste dhe punëtoresh, nga grupi trockist i Beogradit pas 1948-s.

Zhvillimi i «teorisë së re» titisto-trockiste në konditat e reja, ku Lidhja Komuniste e Jugosllavisë është në fuqi dhe qëndron në fuqi me terror, me demagogji. Duhet çjerrë plotësisht maska. Në çdo hap ai duhet demaskuar. Kjo është ndihma më e madhe që mund t'u jepet popujve të Jugosllavisë dhe komunistëve të vërtetë të Jugosllavisë.

Demaskimi i grupit renegat titist na bashkon, na miqëson me popujt e Jugosllavisë dhe nuk na largon.

E kemi për detyrë të ndihmojmë popujt e Jugosllavisë dhe komunistët e vërtetë jugosllavë. E kundërta na ngarkon me përgjegjësi të rëndë morale karshi marksistëve jugosllavë dhe popujve vëllezër të Jugosllavisë.

Të mbrojmë komunistët e vërtetë jugosllavë, jeta e të cilëve kërcënohet nga klika Tito-Rankoviç (duke marrë shkak nga ai komunist jugosllav, që përmendin titistët që gjoja është pushkatuar nga Stalini; shih agjencinë Tanjug), të numërojmë një nga një edhe me biografite e tyre, të gjithë bolshevikët e vjetër që ka vrrarë Titoja dhe që figurojnë në materialet që disponojmë. Për vrasjet e tjera që kanë bërë titistët të thuhet vetëm se do të rikthehemi më vonë dhe të dilet me konkluzion se duke përmendur atë fakt (të Tanjugut), qëllimi i titistëve është të fshehin krimet e tmerrshme të tyre dhe të

hedhin baltë mbi PK të Bashkimit Sovjetik dhe Partinë Bolshevike.

Si konkluzion i dytë i përgjithshëm — të mbrojmë pastërtinë e marksizëm-leninizmit nga trockizmi titist.

Si konkluzion i tretë, të mbrojmë kampin tonë të socializmit dhe Bashkimin Sovjetik (të përmendet fraza e Titos «Kinë-Bashkimi Sovjetik») dhe të vihet në dukje se deri ku vete armiqtësia konsekuente e tij.

Si konkluzion i katërt i përgjithshëm — të mbrojmë fort atdheun tonë socialist që Titoja i ka vënë si detyrë vetes ta shkatërrojë, ta copëtojë, ta aneksojë.

Prandaj ne deri në fund, pa druajtje, pa asnjë kompromis do të luftojmë trockistët titistë renegatë dhe agjentë të imperializmit botëror.

E ENJTE
30 PRILL 1959

NË EKSPOZITËN INDUSTRIALE ÇEKOSLLOVAKE

Shkuam në inaugurimin e ekspozitës industriale çekosllovake.

E ENJTE
7 MAJ 1959

**TAKIM ME DJALIN E MINISTRIT GJERMAN
TË KOMUNIKACIONEVE**

Prita djalin e ministrit të Komunikacioneve të Republikës Demokratike Gjermane. Ishte tok me të fejuarën e tij, një vajzë e re shqiptare. Ata u martuan këto ditë në Tiranë.

E SHTUNË
9 MAJ 1959

**NË PRITJEN E DHENË NGA AMBASADA
ÇEKOSLLOVAKE ME RASTIN E FESTËS**

Me rastin e 14-vjetorit të çlirimit të Çekosllovakisë, ambasada e këtij vendi dha pritje. Mora pjesë dhe mbajta fjalimin e përshëndetjes.

HRUSHOVI DO TË VIJË NË SHQIPËRI

Takim me ambasadorin sovjetik. Më dha lajmin e ardhjes së Hrushovit në Shqipëri.

FILLOI MBLEDHJA E KNER-IT

Prita A. Kosçinin. Ka ardhur në Shqipëri për të marrë pjesë në sesionin e 11-të të KNER-it që do të zhvillohet në Tiranë.

Filloi mbledhja e KNER-it.

SISTEMI
14 MAJ 1959

E ENJTE
14 MAJ 1959

KONCERT PËR PJESEMARRËSIT NË MBLEDHJEN E KNER-IT

Koncert në Teatrin e Operës dhe të Baletit për delegacionet që morën pjesë në sesionin e 11-të të KNER-it.

14 MAJ 1959

SISTEMI
15 MAJ 1959

E PREMTE
15 MAJ 1959

GROTEVOLI VJEN NË VENDIN TONË PËR PUSHIME

Me ftesën tonë, sot arriti në Tiranë Oto Grotevoli¹ me gjithë bashkëshorten e tij për të kaluar pushimet në Shqipëri. Ishim për drekë me të. Foli shumë mirë për vendin tonë.

Darkë në Pallatin e Brigadave për delegacionet e KNER-it. I përshëndeta me një fjalim. Në darkë ishte edhe Grotevoli.

¹ Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të KQ të Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë dhe Kryeministër i RD Gjermane.

BISEDE ME KOSIGININ

U takova me Kosiginin. Biseduam për çështje ekonomike.

Darke në Pallatin e Brigadave për delegacionet e KNER-it. I përshëndeta me një fjalim. Ishte darke jashtë

DARKE PËR DELEGACIONIN SOVJETIK

Darke në Pallatin e Brigadave për Kosiginin dhe për sovjetikët e tjerë, anëtarë të delegacionit sovjetik në sessionin e KNER-it.

Darke në Pallatin e Brigadave për delegacionet e KNER-it. I përshëndeta me një fjalim. Ishte darke jashtë

HRUSHOVI VENDOS KUSHTE PËR ARDHJEN NË SHQIPËRI

Takim me Ivanovin. Më dorëzoi një radiogram të Hrushovit, ku, si kusht për vizitën e tij të ardhshme në Shqipëri, na kërkon që as ai, as ne gjatë fjalimeve publike të mos e prekim fare çështjen e revizionizmit jugosllav. Ja gjer ku paska arritur puna! Kërkon të na mbyllë edhe neve gojën! Megjithatë kërkesën do ta diskutojmë me shokët në Byronë Politike e do t'i japim përgjigje «mysafirit» që presim të na vijë.

PRANOJMË KUSHTIN E HRUSHOVIT POR VETËM PËR AQ DITË SA DO TË QËNDROJË NË VENDIN TONË

Pasi diskutuam në Byronë Politike për radiogramin e Hrushovit, vendosëm që ta pranojmë kushtin e tij (të mos flasim për Titon gjatë ditëve të vizitës së tij në Shqipëri). Titon dhe ata që mendojnë e veprojnë si Titoja, le t'i gënjejë mendja. Por me të ikur Hrushovi, ne do t'i lëshojmë përsëri bateritë kundër revizionizmit modern.

Ne kemi arsyet tona për pranimin e këtij kushti. Është hera e parë, që nga Çlirimi, që në vendin tonë vjen për vizitë zyrtare Sekretari i parë i KQ të PK të BS dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave të Bashkimit Sovjetik. Kjo shpresoj se do t'i shërbejë forcimit të miqësisë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të marrëdhënieve ekonomike midis të dy vendeve. Shpresojmë që të vazhdojnë të na ndihmojnë për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë e të bujqësisë sonë, ndihmë për të cilën ne kemi akoma nevojë. Edhe në arenën ndërkombëtare, armiqtë do të jenë të detyruar ta respektojnë më shumë pavarësinë e vendit tonë.

Takova sot Ivanovin dhe i komunikova se e pranojmë kërkesën e udhëheqjes sovjetike.

AKTIVITETE POLITIKE

Takim me redaktorët e revistës «Probleme të paqes dhe të socializmit» (që të dy sovjetikë). Muhabete të kota. Më kërkuan një artikull që me siguri do ta hedhin në shportë.

Takim me Ivanovin, Molloçkovin dhe Diedushkinin, ardhur për vizitën e Hrushovit.

...

...

ERDHI HRUSHOVI. FILLUAM BISEDIMET

Erdhi në Shqipëri Nikita Hrushovi. E pritëm në aerodrom me fjalim. Pastaj gjithë delegacionin sovjetik e pritëm në selinë e Qeverisë ku çështja e parë që Hrushovi zuri në gojë ishte: «Unë nuk do të flas kundër Jugosllavisë».

Filluan bisedimet. Ekspozenë nga ana jonë e bëra unë.

Delegacioni sovjetik vendosi kurora në Varrezat e Dëshmorëve.

...

NGA VIZITAT E HRUSHOVIT NË TIRANË

Vizitua kombinatin e tekstileve «Stalin». Folëm unë dhe Hrushovi. Entuziazmi i punëtorëve që i madh. Atij i pëlqeu kombinati dhe organizimi dhe tha se në plenumin e ardhshëm të partisë së tyre do të flasë për këtë kombinat.

Vizitua Muzeun e Luftës Nacionalçlirimtare dhe vreshtat e NBSH «Gjergj Dimitrov». I pëlqyen.

Mbrëmje dhe koncert në Teatrin e Operës dhe të Baletit. Koncert shumë i mirë. U habit dhe mbeti i kënaqur.

FILLOI VIZITA NËPËR VENDIN TONË

U nisëm për në Shkodër.
U ndalëm në Thumanë për të parë bonifikimet.
U ndalëm gjithashtu në Lezhë. Manifestim i madh për Bashkimin Sovjetik. Foli shkurt Hrushovi.

Miting i madh në Shkodër. Foli Hrushovi.
Vizitua vreshtin e Shtoit. Nuk i pëlqeu. «Pse i prishni lekët kot», na tha miku.

U kthyem me avion në Tiranë.

NGA VIZITAT NË RRETHIN E KORÇËS

U nisëm me avion për në Korçë ku u organizua një miting i madh. Foli Hrushovi.

Bëmë vizitë në NBSH-në e Maliqit, pastaj në kooperativën e Bulgarecit.

Drekë zyrtare. Folëm Hrushovi dhe unë.

Vizituam pemëtoren e Dvoranit.

U kthyem me avion në Tiranë.

PIN DE HUAJA VJEN NË VENDIN TONË

Bashkë me Mehmetin pritëm në Komitetin Qendror mareshalin kinez, Pin De Hua, i cili mbërriti sot në Shqipëri në krye të një delegacioni ushtarak kinez. Në mbremje dhamë darkë për të. Folëm unë dhe Pin De Hua.

VAZHDOJNË BISEDIMET ME SOVJETIKËT

Vazhduam në Tiranë bisedimet me delegacionin sovjetik.

Në mbrëmje u dha një pritje nga pala sovjetike, ku u ftuan të merrnin pjesë edhe Oto Grotevoli dhe delegacioni ushtarak kinez me Pin De Huanë në krye.

U NËNSHKRUA DEKLARATA E PËRBASHKËT SHQIPTARO-SOVJETIKE

U zhvillua në komitetin ekzekutiv të kryeqytetit një ceremoni ku Hrushovi u shpall Qytetar nderi i Tiranës.

Vizitë në Universitet. Foli Hrushovi.

Nënshkruam deklaratën e përbashkët të delegacioneve të Partisë dhe të Qeverisë të BS dhe të RPSH. Prej këndeje shkruam në mitingun e madh që u mbajt përpara komitetit ekzekutiv. Folëm unë dhe Hrushovi.

Pritje në Pallatin e Brigadave nga ana jonë.

NGA VIZITA NË RRETHIN E VLORËS

U nisëm për në Vlorë. Ndalum në Tërbuf, ku Hrushovi pa punimet për bonifikimin e kënetës.
Miting në Vlorë. Folëm unë dhe Hrushovi.
Darkë në plazhin e Ujit të Ftohtë.

U nisëm për në Vlorë. Ndalum në Tërbuf, ku Hrushovi pa punimet për bonifikimin e kënetës.
Miting në Vlorë. Folëm unë dhe Hrushovi.
Darkë në plazhin e Ujit të Ftohtë.

U nisëm për në Vlorë. Ndalum në Tërbuf, ku Hrushovi pa punimet për bonifikimin e kënetës.

TAKIM ME NJË GAZETAR ÇEKOSLLOVAK

Gazetari çekoslovak, Josef Ruttkay, i cili ndodhet në vendin tonë, më kërkoi një intervistë¹. Iu përgjigja pyetjeve që paraqiti.

Gazetari çekoslovak, Josef Ruttkay, i cili ndodhet në vendin tonë, më kërkoi një intervistë¹. Iu përgjigja pyetjeve që paraqiti.

¹ Intervista është botuar në gazetën «Rude Pravo» të Sllovakisë.

NGA VIZITA NË RRETHET E JUGUT

Shkuam me Hrushovin për peshk, pastaj vizituam bazën e Pashalimanit.

Drekën e hëngrëm me Grotevolin që pushon në Vlorë.

U nisëm me vapor për në Sarandë.

Hëngrëm darkë dhe fjetëm në vapor në Portin e Sarandës.

HRUSHOVI VAZHDON VIZITËN NË JUG.
PIN DE HUAI U LARGUA

Vajtëm për të parë plantacionin e agrumeve në Stjar. Vizituam Butrintin.

Ndërsa po sodisnim bukuritë e Butrintit, Hrushovi thirri pranë Malinovskin dhe i dëgjova tek pëshpëritnin: «Ç'mrekulli. Këtu mund të ndërtohet një bazë ideale për nëndetset tona... Që këtej mund të paralizojmë e të sulmojmë gjithçka».

Më çuditi ky mendim i llogaritur prej tij pa pyetur fare të zotët e shtëpisë, siç thotë populli ynë.

U kthyem përsëri me vapor në Vlorë. Ishte edhe Grotevoli me ne.

Sot u largua nga Shqipëria mareshali Pin De Hua.

NGA QËNDRIMI I HRUSHOVIT NË SHQIPËRI

Kur nga veranda e vilës tek Uji i Ftohtë, ku po pushonim, sodisnim detin përpara nesh, ashtu si dje në Butrint, Hrushovi diskutonte, nën zë, me Malinovskin: «Çfarë gjiri i sigurt rrëzë këtyre maleve! Që këtej me një flotë të fuqishme ne kemi në dorë krejt Mesdheun, që nga Bosfori e gjer në Gjibraltar!».

Ç'plane të tmerrshme bën ky njeri që flet aq shumë për paqen. Le të shpresojmë të jenë vetëm «shakara» nga ato të tijat. Të shohim a do t'i ngrejë në bisedimet zyrtare. Po i ngriti atëherë do t'i japim përgjigjen tonë.

U kthyem me avion në Tiranë. Në Rinas u ndalëm për të vizituar aeroplanin TU-114 që kishte ardhur me akademikun Tupolev, kryekonstruktor i këtij tip avioni.

Vumë gurin e parë të ndërtimit në Pallatin e ri të Kulturës në Tiranë.

Darkë në Pallatin e Brigadave për delegacionin sovjetik.

HRUSHOVI U LARGUA

Sot përcollëm Hrushovin, i cili do të ndalet në Budapest.

Darkë me Grotevolin.

**KRYETARI I PRESIDIUMIT TË ASAMBLESE SË
LARTË POPULLORE TË RDP TË KORESË
VJEN NË SHQIPËRI**

Erdhi për vizitë zyrtare kryetari i Presidiumit të Asamblesë së Lartë Popullore të Republikës Demokratike Popullore të Koresë, Çoi Yon Gën.

Pritje e presidentit korean në Komitetin Qendror të Partisë.

Darkë me presidentin e Koresë.

DARKË PËR GROTEVOLIN

Bashkë me Mehmetin dhamë sonte një darkë për Oto Grotevolin dhe bashkëshorten e tij.

GROTEVOLI U LARGUA

Përcollëm në aeroport Oto Grotevolin, i cili kaloi pushimet në vendin tonë.

TAKIM ME ÇOI YON GËNIN

Prita kryetarin e Presidiumit të Asamblesë së Lartë të RDP të Koresë, Çoi Yon Gën dhe personat që e shoqërojnë.

E SHTUNË
6 QERSHOR 1959

**DISA GJËRA QË NGJALLIN DYSHIM NGA BISEDAT
ME HRUSHOVIN**

Në mbledhjen e Byrosë Politike që bëmë sot për ta informuar rreth bisedimeve që patëm me Hrushovin gjatë qëndrimit të tij në vendin tonë, bëra fjalë edhe për disa shprehje e mendime të tij që më kanë ngjallur dyshime. Kështu, gjatë diskutimit të kërkesave ekonomike që pala jonë i parashtrroi palës sovjetike, ai, si me shaka, na tha «nuk kam ardhur këtu për këto gjëra», ndërsa kur po diskutohej rreth çështjes së zhvillimit të industrisë së naftës, ngriti pretendimin se «nafta jonë ka përmbajtje të lartë squfuri» dhe na «këshilloi të mos investojmë atje ku nuk kemi leverdi». Në fushën e zhvillimit të bujqësisë na foli për gatishmërinë e tij për të kooperuar në mbjelljen e sa më shumë agrumeve dhe dafinave (nga kjo, tha, mbillni mijëra hektarë) sepse me të do të mund të blenim në Bashkimin Sovjetik mish e bukë sa të deshëm.

Nga pikëpamja ushtarake, Shqipërinë Hrushovi e pa si një vend të madh strategjik në Mesdhe që duhet t'i shërbente Bashkimit Sovjetik si bazë për vendosjen dhe nisjen e flotës detare ushtarake e të raketave sovjetike. (Në Butrint e në Vlorë, sikurse kam shkruar, ai bëri aluzione të hapëta për një gjë të tillë.)

Këto shprehje e mendime shumë të kamufluara e të

thëna herë me shaka e herë seriozisht nuk më duken as shumë miqësore as shumë internacionaliste ndaj vendit dhe popullit tonë. Koha do të vërtetojë saktësinë ose jo të këtyre përshtypjeve të mia.

PRITJE PËR ÇOI YON GËNIN

Shoku Haxhi Lleshi dha sonte një pritje për kryetarin e Presidiumit të Asamblesë së Lartë Popullore të RDP të Koresë, Çoi Yon Gën, që ka ardhur për vizitë zyrtare në vendin tonë. Mora pjesë edhe unë.

PRITJE NË AMBASADËN KOREANE

Pritje nga ambasada koreane për Çoi Yon Gënin.

ÇOI YON GËNI U LARGUA NGA VENDI YNË

U largua nga vendi ynë kryetari i Presidiumit të Asamblesë së Lartë Popullore të RDP të Koresë. E përcollëm në aeroport.

DREKË PËR KOPALININ

Kisha për drekë Kopalinin, Ivanovin dhe bashkëshortet e tyre.

MIQ ÇEKOSLLOVAKË VIJNË PËR PUSHIME

Pritëm Bacilekun dhe Davidin¹ që erdhën për pushime në Shqipëri.

¹ Vaclav David, në atë kohë ministër i Punëve të Jashtme të Republikës Çekosllovake.

NE DËSHIROJMË TË JETOJMË NË MIQËSI ME TË GJITHË POPUJT, VEÇANËRISHT ME POPUJT FQINJË

Vizitova kooperativën e bashkuar të Sofratikës në krahinën e Dropullit të Poshtëm. Fola në mitingun e organizuar me këtë rast.

Duke prekur politikën tonë të jashtme theksova se ne dëshirojmë të jetojmë në miqësi me të gjithë popujt, veçanërisht me popujt fqinjë. Theksova gjithashtu se populli shqiptar e do popullin grek, që është një popull i mirë, punëtor, me kulturë dhe me tradita të mëdha revolucionare, por në të njëjtën kohë fola edhe për rrezikun që paraqet politika e qeveritarëve të këtij vendi dhe ajo e Italisë që kanë pranuar vendosjen e raketave në tokat e vendeve të tyre¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 209.

PARALAJMËRIM PËRKRAHËSVE TË POLITIKËS SË RAKETAVE

Në fjalimin që mbajta sot në mitingun e madh të organizuar me rastin e inaugurimit të Kanalit të Çukës, përmenda çështjen e vendosjes së bazave të raketave në shtetet fqinje me vendin tonë. Deklarova, midis të tjerave, se në Shqipëri nuk ka baza raketash, por ne do të detyrohemi t'i vendosim ato, në interes të mbrojtjes së lirisë dhe të pavarësisë së atdheut tonë, pasi shtetet rreth nesh, pa asnjë arsye, janë duke ndërtuar baza të tilla.

Le të vlejë kjo si paralajmërim për të gjitha ato forca që ecin në rrugë të rrezikshme¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 225.

HAILE SELASIE I NDALON NË RINAS

Pritëm në Rinas përandorin e Etiopisë, Haile Selasie I që kaloi për në Moskë. Ndenji në Rinas një orë.

TAKIM ME AMBASADORIN ÇEKOSLLOVAK

Prita ambasadorin e jashtëzakonshëm e fuqiplotë të RP të Çekosllovakisë, Frantishek Malik.

DREKË PËR SHOKËT ÇEKOSLLOVAKË

Drekë në plazhin e Durrësit për shokët Bacilek e David.

Shoku Gogo u kthye nga Parisi ku kishte shkuar për të marrë pjesë në kongresin e Partisë Komuniste Franceze.

TAKIM ME AMBASADORIN BULLGAR

Takim me ambasadorin bullgar¹ me rastin e largimit të tij nga Shqipëria.

U nisëm për në Pragë për pushime me Nexhmijen e fëmijët me aeroplanin TU-104 që kishin dërguar çekët. Në aerodrom na pritën sekretari i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Çekosllovake, Vladimir Koucki, dhe shokë të tjerë.

¹ Grudi Atanasov Dimitrov.

NË ÇEKOSLLOVAKI PËR VIZITË

U nisëm për në Pragë për pushime me Nexhmijen e fëmijët me aeroplanin TU-104 që kishin dërguar çekët. Në aerodrom na pritën sekretari i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Çekosllovake, Vladimir Koucki, dhe shokë të tjerë.

BISEDE ME NOVOTNIN

Më bëri vizitë shoku Novotni. Biseduam një orë.
Hëngrëm drekë me shokët Koucki, Saukel dhe Mu-
ravec.

Shkuam në Karlovi-Vari. U vendosëm në vilën «Ja-
vorina». Këtu gjetëm edhe Kosiginin me gruan dhe nipin.

NË KARLOVI-VARI

Shkuam në Karlovi-Vari. U vendosëm në vilën «Ja-
vorina». Këtu gjetëm edhe Kosiginin me gruan dhe nipin.

TAKIM ME OFICERË SHQIPTARË

Filluam kurat me ujërat e llixhave.

Takua një grup oficerësh tanë që pushojnë këtu.

NGA QËNDRIMI NË KARLOVI-VARI

Kaloj nga Karlovi-Vari Haile Selasia. U përfaqësova nga familja e tij dhe një nip, të vajzës a të djalit, në një tavolinë tjetër.

Në darkë kaluam mbrëmjen me Kosiginin dhe të shoqen në një sallë buke, unë me Nexhmijen e fëmijët veç, ai me familjen e vet, gruan e tij dhe një nip, të vajzës a të djalit, në një tavolinë tjetër.

NGA QËNDRIMI NË KARLOVI-VARI

U poqëm me gjeneralin sovjetik Antonov dhe me gruan e tij, balerinën e mirënjohur Lepeshinskaja.

U takova me Kozlovin (ish-udhëheqës partizanësh bjellorusë).

VIZITË NË OSTRAVA

Vizituam Ostravën.

NË PILZEN

Shkuam në Pilzen për vizitë.

SHOKËT NA SJELLIN LAJME NGA SHQIPËRIA

Takuam shokun Koço Prifti dhe dr. Xhavit Gjatën.
Na sollën lajme nga Shqipëria.

NË KARLOVI-VARI

Shëtitje me automobil në rrethet e Karlovi-Varit.

PËR GJAH

Vajta për gjah. Vrava një sorkadhe.

KARLOVI-VARI, E HËNË
27 KORRIK 1959

TAKIM ME MAURERIN

U takuam me Maurerin, kryetar i Presidiumit të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Rumanisë, i cili banon po në vilën ku banojmë edhe ne.

KARLOVI-VARI, E MËRKURË
29 KORRIK 1959

NË KINEMA ME MAURERËT

Shkuam në kinema me Maurerët.

SHËTITJE ME KONJEVIN

Shëtitje me mareshal Konjevin.

Bisedë me Skoçimaron. M'u qa për udhëheqjen e partisë së tij.

Pamë një film me Maurerin.

VIJNË SHOKË NGA TIRANA

Erdhën këtu për pushime Manushi me Nefon dhe Ramizi familjarisht. Kishte ardhur edhe Zylyftar Velehnja.

PAMË NJË FILM ANGLEZ

Vamë pamë filmin anglez «Rikardi i 3-të» (sipas një-rës nga veprat e Shekspirit).

VIZITË NË MARIANSKIJ-LAZNE

Shkuam vizituam Ramizin e Manushin në Marian-skij-Lazne.

NË MARIANSKIJ-LAZNE

Shëtitje nëpër qytet.

NË KARLOVI-VARI

Vajta për gjah, plagosa një sorkadhe.

Erdhi nga Tirana ambasadori ynë, Siri Çarçani.

BISEDË ME SKOÇIMARON

Bisedë me Skoçimaron, që ndodhet këtu me pushime.

PËRSËRI NË PRAGË

Sot mbaruam kurën dhe u nisëm për në Pragë. Ka ardhur avioni ynë të na marrë për t'u kthyer në atdhe. Pashdreke shkuam në kinema.

SHIROKI NA FTON PËR DARKË

Darkë te Shiroki, (Shiroki dukej mjaft i vrarë).

NISEMI PËR NË BULLGARI

Sot u larguam nga Çekosllovakia për në Bullgari.

U nisëm për në Sofje. Na përcollën Hendrihu dhe ambasadori bullgar. Në Sofje na pritën Zhivkovi dhe Jugovi.

Shkuam në Vitosha.

NË VITOSHA ME JUGOVIN

Rrimë tok me Jugovin në Vitosha, (2400 m lartësi).
Bën mjaft fresk, për të mos thënë ftohtë. Këtu shkon
mirë shprehja e popullit tonë: «Gusht e gunë».

NË VITOSHA

Në Vitosha. Ajri është i lehtë, vila ku banojmë është e bukur, por vend i vetmuar.

TAKIM ME SHOKE BULLGARE

Shkuam tok me fëmijët e me Jugovin në Kritçin.
Erdhën në mbrëmje Trajkovi dhe Todorovi.

NË DIMITROVGRAD DHE NË PLOVDIV

Shkuam me Jugovin në Dimitrovgrad, ku vizitua
kombinatit kimik, fabrikën e çimentos dhe repartin e
eternitit.

Mbrëmjen e kaluam me sekretarin e komitetit të
partisë dhe kryetarin e pushtetit të qytetit të Plovdivit.

SOFJE, E ENJTE
13 GUSHT 1959

PËRSËRI NË SOFJE

U kthjem në Sofje, ku qëndruam në vilën «Bojana».
Ditë me shi.

BULLGARI, E DIEL
16 GUSHT 1959

NË PANÇEVO

Shëtitje në Pançevo.

NË PALLATIN E VRANJËS

Shkuam në pallatin e Vranjës. Vizituam apartamentin e Dimitrovit.

NGA VIZITA NËPËR BULLGARI

Vamë për gjah, po organizuar keq. S'vramë dot asgjë.

BOROVEC, E SHTUNË
22 GUSHT 1959

NË BOROVEC

Shkuam në Borovec. Kohë shumë e bukur. Edhe vila ku jemi vendosur është shumë e lezetshme.

BOROVEC, E DIEL
23 GUSHT 1959

NISEMI PËR NË SOFJE

Edhe ditën e sotme e kaluam në Borovec. Në mbrëmje u nisëm për në Sofje.

DREKË ME ZHIVKOVIN

Hëngrëm drekë me Zhivkovin. Në mbrëmje vajtëm në operë.

VIZITË NË UZINËN «VASIL KOLAROV»

Vizitua uzinën e materialeve elektrike «Vasil Kolarov».

Kishim për darkë Trajkovin, Cankovin dhe Prihodin.

VIZITË NËPËR BULLGARI

U nisëm me Zhivkovin për në rrethin e Bllagojevgradit.

Morëm pjesë në një festë partizane.

Në Bansko vizituam muzeun «Vapcarov»,
Vizituam kooperativën e bashkuar «Belica».

KTHEHEMI NË SOFJE

Në qytetin Petriç vizituam një kooperativë bujqësore, ku hëngrëm drekë dhe u kthyem natën në Sofje.

LAJM I HIDHUR NGA ATDHEU

Mora lajmin e hidhur të tërmetit në Shqipërinë e Mesme¹. I dërgova radiogram Hysniut për të marrë menjëherë kontakt me popullin e zonave të prekura nga tërmeti e të qetësohen njerëzit, të merren masa në mënyrë që brenda një kohe rekord të zhduken pasojat e tërmetit.

Më vjen shumë keq që s'u ndodha edhe unë në Shqipëri.

¹ Gjatë ditëve të fundit të muajit gusht, sidomos më 1 shtator të vitit 1959, pati lëkundje të forta tërmeti në territorin e RP të Shqipërisë e veçanërisht në rrethet Lushnjë, Fier, Berat dhe Elbasan (Peqin).

VIZITË NË AMBASADËN TONË

Më vizitoi kryetari i Komisionit të Planit të Bullgarisë, Kristozov.

Bëmë një vizitë në ambasadën tonë.

NË VRAÇA DHE MIHAILLOVGRAD

U nisëm me Zhivkovin për në Vraça dhe Mihaillovgrad. Gjatë udhëtimit vizituam shumë kooperativa. Fola në më shumë se 10 mitingje. U këputëm nga lodhja. Në mbrëmje u kthyem në Sofje.

DARKË NË AMBASADËN SOVJETIKE

Na ftuan për darkë në ambasadën sovjetike. Atje ishte edhe Zhivkovi. Një gjë e ftohtë. Pamë një palo film.

TAKIM ME GAZETARË BULLGARË

Prita kryeredaktorët e gazetave bullgare: «Rabotni-cesko Delo» dhe «Zemledelskie Znanie».

KURORË NË MAUZOLEUN E DIMITROVIT

U bëra vizitë protokollare shokëve Zhivkov dhe Jugov.

Bashkë me Nexhmijen vendosëm kurorë në Mauzoleun e Dimitrovit dhe në përmendoren e Vasil Kolarovit.

Vizitë në Shtëpinë-muze të Dimitrovit.

Vizitë në uzinën e riparimit dhe të ndërtimit të vagonave «Gjergj Dimitrov» me Zhivkovin për festë. Foli Zhivkovi, fola dhe unë.

NË MBRËMJEN SOLEMNE PËR 15-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË BULLGARISË

Mbrëmje solemne kushtuar 15-vjetorit të çlirimit të Bullgarisë.

Takojmë Ustinovin dhe mareshalin Beriuzov.

Jivov

Vizita në Sofje me Ustinovin dhe Beriuzov.

PARADË E MANIFESTIM NË SOFJE

Paradë dhe manifestim në Sofje me rastin e 15-vjetorit të çlirimit të vendit.

Darkë e madhe.

NË BUDAPEST, TAKIM ME KADARIN DHE KISHIN

U nisëm nga Sofja për në Budapest ku do të qëndrojmë një natë.

Arritëm në Budapest. Takim dhe drekë me Janosh Kadarin dhe Karoli Kishin.

U KTHYEM NË ATDHE

U kthjem në Tiranë pas pushimeve që bëmë në Çekosllovakia dhe në Bullgari.

Prita delegacionin e Shoqërisë së Miqësisë Bashkimi Sovjetik — Shqipëri të kryesuar nga Orllov¹, i cili ka ardhur në vendin tonë me rastin e muajit të miqësisë shqiptaro-sovjetike dhe të Kongresit të 5-të të Shoqërisë së Miqësisë Shqipëri — Bashkimi Sovjetik.

¹ S. D. Orlov, në atë kohë sekretar i Presidiumit të Sovjetit Suprem të RSFSR dhe nënkryetar i Shoqërisë së Miqësisë Bashkimi Sovjetik — Shqipëri.

TAKIM ME AMBASADORIN BULLGAR

Prita ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të RP të Bullgarisë, Vëllko Shivarov.

Prita ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të RP të Bullgarisë, Vëllko Shivarov. Prita ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të RP të Bullgarisë, Vëllko Shivarov.

Prita ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të RP të Bullgarisë, Vëllko Shivarov.

UDHËHEQJA REVIZIONISTE JUGOSLLAVE PËRPIQET QË TË NA PENGOJË E TË NA DËMTOJË

Përveç problemeve të brendshme që preka në fjali-min që mbajta sot në mitingun e organizuar në Bicaj me rastin e 16-vjetorit të themelimit të Çetës së Lumës, fola edhe për punën armiqësore të udhëheqësve revizionistë jugosllavë ndaj vendit tonë, për pengesat që na sjellin, për përpjekjet e tyre për të na dëmtuar me veprimtari diversioniste e në rrugë propagandistike¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 294.

DELEGACIONI YNË NISËT PËR NË RP TË KINËS

Sot u nisën për në Kinë anëtarët e delegacionit tonë të Partisë e të Qeverisë, shokët Haki Toska dhe Adil Çarçani, për të marrë pjesë në 10-vjetorin e shpalljes së RP të Kinës. Delegacionin do ta kryesojë shoku Mehmet Shehu, i cili do të nisët nga Moska.

Prita ministrin e Postave dhe të Telekomunikacioneve të Çekoslovakisë¹ dhe ambasadorin çekoslovak në vendin tonë.

¹ Dr. Alois Neuman.

TAKIM ME MACKIEVIÇIN

Prita ministrin e Bujqësisë të Bashkimit Sovjetik, Mackieviç, i cili ndodhet me pushime në vendin tonë. Mbrëmje në Pallatin e Brigadave për Mackieviçin.

MBLEDHJE SOLEMNE PËR FESTËN E KINEZËVE

Mbledhje solemne me rastin e 10-vjetorit të Republikës Popullore të Kinës.

NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA KINEZE

Vajta në pritjen e dhënë nga ambasadori kinez për 10-vjetorin e RP të Kinës. Mbajta fjalën e përshëndetjes¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 323.

E DIEL
4 TETOR 1959

SUKSES I RI I SHKENCËS SOVJETIKE

Në Bashkimin Sovjetik u lëshua raketa e tretë kozmike me një stacion ndërplanetar automatik, i cili do të kalojë pranë Hënës dhe do të fluturojë rreth saj. Në stacion janë vendosur aparatet shkencore, radioteknike e të tjera. Sukses i madh i shkencës sovjetike.

E HËNË
5 TETOR 1959

TAKIM ME AMBASADORIN BULLGAR

Takim me ambasadorin bullgar, Vëllko Shivarov.

SHKURTIM I AKTIVITETE POLITIKE

Prita ministrin çekoslovak të Arsimit e të Kulturës, Frantishek Kahuda.

Shkova në mbledhjen solemne kushtuar 10-vjetorit të Republikës Demokratike Gjermane.

ZHIVKOVI ERDHI PËR VIZITË MIQËSORE TE NE

Erdhi për vizitë miqësore në Shqipëri shoku Zhivkov. Drekë për Zhivkovin.

Vizituam kombinatin e tekstileve «Stalin». Folëm ai dhe unë.

Darkë te gjermanët me rastin e 10-vjetorit të Republikës Demokratike Gjermane. Foli ambasadori, fola edhe unë¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 328.

NGA VIZITA E ZHIVKOVIT NË TIRANË

Bashkë me Zhivkovin pamë programin e çeljes së Spartakiadës së Parë Kombëtare, një manifestim i madh fizikulturorë-sportiv.

Mbrëmje nga ambasada sovjetike për Zhivkovin.

NË VLORE PËR VIZITË

U nisëm për në Vlorë me Zhivkovin.

U ndalëm më parë në Lushnjë, vizituam ndërmarrjen bujqësore «29 Nëntori» dhe kooperativën e Këmish-tajt. Folëm ai dhe unë para popullit.

Prej këtej shkua në Qytetin Stalin ku folëm që të dy në mitingun e organizuar aty.

Pasdite arritëm në Vlorë. Në Sheshin e Flamurit ishte organizuar një miting. Folëm Zhivkovi edhe unë.

VIZITË NË PASHALIMAN

Në Vlorë vizitua bazën detare të Pashalimanit.

U nisëm nga Vlorë në autobus për të vizituar bazën detare të Pashalimanit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit. Bazën e vizituar e kishim në qendër të qytetit.

VIZITË NË RRETHIN E SARANDES

U nisëm nga Vlorë në mëngjes dhe mbërritëm në Sarandë. Rrugës u ndalëm në Dhërmi dhe në Pëqeras.

NË BUTRINT

Sot qëndruam në Sarandë. Kohë e keqe, me shi. Vizituam Kanalën e Çukës dhe Butrintin.

VIZITË NË RBETHIN E GJIROKASTRËS

Duke shkuar për në Gjirokastrë vajtëm në Stjar dhe në kooperativën e Bamatatit. Folëm Zhivkovi dhe unë,

Drekë në Gjirokastrë.

Miting në sheshin «Çerçiz Topulli». Folëm ai dhe unë.

Gjatë rrugës për në Vlorë qëndruam në Ujin e Ftoh-të të Tepelenës.

Nga Vlora u kthyem me avion në Tiranë.

Darkë në ambasadën bullgare.

KONCERT PËR ZHIVKOVIN

Zhivkovi shkoi me Mehmetin në Shkodër dhe u
kthyen në mbrëmje.

Koncert për Zhivkovin.

DARKË PËR ZHIVKOVIN

Darkë për nder të Zhivkovit.

ZHIVKOVI U LARGUA NGA SHQIPËRIA

Sot u largua Zhivkovi, e përcollëm në aerodrom.

REVIZIONISTËT JUGOSLLAVË TREMBEN NGA E VËRTETA

Në gazetën «Zëri i popullit» u botua sot artikulli me titullin «Revizionistët jugosllavë tremben nga e vërteta»¹, në të cilën demaskohen përpjekjet e titistëve për të ulur tensionin e luftës kundër revizionizmit.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 357.

MBI PARIMIN SOCIALIST TË BARAZISË SË POPUJVE

Ditët e fundit mbarova së hedhuri në letër mendimet e mia rreth parimit socialist të barazisë së popujve dhe teorisë e praktikës së revizionizmit. Në shënimet që kam shkruar rreth kësaj çështjeje, jam përpjekur të tregoj se sistemi socialist botëror është një shembull i gjallë i triumfit të parimit të barazisë së popujve dhe të hedh poshtë mburrjet e revizionistëve jugosllavë që reklamojnë veten me të madhe si «zbuluesit e parë» të rrugëve të zgjidhjes së problemeve sociale në epokën e re historike¹.

¹ Mendimet e shokut Enver në formë shënimesh, ndodhen në Arkivin Qendror të KQ të PPSH.

ÇËSHTJEN E REVIZIONISTËVE JUGOSLLAVË PARTIA JONË E KA PARË, E SHEH DHE DO TA SHOHE KURDOHERË DREJT

Dje dhe sot u mbledh Plenumi i 14-të i KQ të PPSH për të dëgjuar e diskutuar rreth dy raporteve të Byrosë Politike mbi zhvillimin e ekonomisë pyjore dhe mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujitshme. Sot unë mbajta fjalën e mbylljes së punimeve. Fola me këtë rast edhe për çështjen e revizionistëve jugosllavë, të cilën Partia jonë e ka parë, e sheh e do ta shohë kurdoherë drejt. Partia jonë u bën ballë të gjitha intrigave të armiqve, si dhe atyre të revizionistëve jugosllavë që s'kanë pushuar për asnjë çast kundër vendit tonë¹.

¹ Enver Hoxha, Vepra, vëll. 17, f. 365.

E PREMTE
6 NËNTOR 1959

**MBLEDHJE SOLEMNE ME RASTIN E 42-VJETORIT
TË REVOLUCIONIT TË TETORIT**

Mbledhje solemne me rastin e 42-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

E SHTUNË
7 NËNTOR 1959

DARKË NË AMBASADËN SOVJETIKE

Darkë nga ambasada sovjetike me rastin e 42-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit. Foli ambasadori Ivanov, fola edhe unë.

**PRITA ANSAMBLIN E KËNGËVE E TË VALLEVE
TË VIETNAMIT**

Prita drejtuesit dhe një grup të ansamblit të këngëve dhe të valleve popullore të RD të Vietnamit.

Pasdite vajta në koncertin e tyre.

PAMË FILMIN «LULËZO SHQIPËRI»

Pamë filmin «Lulëzo Shqipëri» të Kopalinit e të kinoregjisorit tonë Endri Keko. Shumë i bukur.

TAKIM ME KOPALININ

Prita në Komitetin Qendror Kopalinin dhe shokët tanë, që punuan për të përgatitur filmin «Lulëzo Shqipëri».

ERDHI DELEGACIONI SOVJETIK

Pritëm në aeroport delegacionin e PK dhe të Qeverisë së Bashkimit Sovjetik, të kryesuar nga I. V. Spiridonov, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Leningradit dhe anëtar i Presidiumit të Sovjetit Suprem të BS, që do të marrë pjesë në festimet e 15-vjetorit të Çlirimit.

Në sallën e Teatrit të Operës e të Baletit u dha koncerti «Miqësia», me pjesëmarrjen e artistëve nga vendet mike që kanë ardhur te ne për 15-vjetorin e Çlirimit.

DO TË MBROJME DERI NË FUND PASTËRTINË E MARKSIZËM-LENINIZMIT

Në fjalimin që mbajta në mbledhjen solemne kush-tuar 15-vjetorit të Çlirimit, që u organizua në sallën e Teatrit të Operës e të Baletit, krahas bilancit të fitoreve të arritura, fola edhe për rrezikun serioz që përbën revizionizmi jugosllav për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, për përpjekjet e tij që ta çorientojë ideologjikisht klasën punëtore, ta nxjerrë nga binarët e marksizëm-leninizmit e ta çarmatosë përpara borgjezisë dhe reaksionit ndërkombëtar etj. U ndala pak më gjatë edhe mbi veprimtarinë e shfrenuar armiqësore të titistëve jugosllavë kundër vendit tonë¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 427.

PRAVDA BOTON NJË ARTIKULLIN TIM

Sot gazeta «Pravda» faqen e saj të katërt ia kush-ton festës së Çlirimit të vendit tonë. Përveç disa materialeve të tjera, në këtë faqe ajo boton edhe një artikullin tim me titullin «Rruga drejt lulëzimit, drejt lumturisë».

MITI I AKTIVITETE POLITIKE

Prita sot shokun Pol Balmizher, kandidat i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Franceze dhe sekretar i Komitetit të Partisë Komuniste të federatës së qarkut Herolt.

Prita gjithashtu anëtarin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Italiane, senatorin Antonio Roasio dhe sekretarin e Partisë Komuniste Italiane për qytetin e Kaljarit, Umberto Gardia.

Po sot prita sekretarin e përgjithshëm të Këshillit Botëror të Paqes Ferdinand Vinj.

Të gjithë kanë ardhur në vendin tonë me rastin e festës së 15-vjetorit të Çlirimit.

DARKË PËR DELEGACIONIN SOVJETIK

Darkë për delegacionin sovjetik të kryesuar nga Spiridonov. Fola unë, foli edhe Spiridonovi. Fjalimi i tij ishte pa kripë, asnjë fjalë kundër imperializmit.

DARË NË AMBASADËN SOVJETIKE

Darë tek Ivanovi me rastin e qëndrimit në Shqipëri të delegacionit sovjetik.

Pratë së bashku me delegacionin sovjetik të Komunistëve të Shqipërisë, të udhëhequr nga Partia Komuniste, të cilët janë në vizitë të miqësisë në Tiranë.

Delegacioni sovjetik, i udhëhequr nga Ivanovi, është në vizitë të miqësisë në Tiranë.

DELEGACIONI SOVJETIK U LARGUA

Përcollëm për në Moskë delegacionin e PK dhe të Qeverisë Sovjetike të kryesuar nga Spiridonovi.

Delegacioni sovjetik, i udhëhequr nga Spiridonovi, është në vizitë të miqësisë në Tiranë.

Delegacioni sovjetik, i udhëhequr nga Spiridonovi, është në vizitë të miqësisë në Tiranë.

Delegacioni sovjetik, i udhëhequr nga Spiridonovi, është në vizitë të miqësisë në Tiranë.

I Bavar-Hozin Vopis VIII 11 1959

SIGURIMI DHE MIRËQENIA E POPULLIT TONË VLEJNË MË SHUMË SE BUZËQESHJET E UJKUT

Në seancën e sotme të konferencës kombëtare për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës në fshat, përshëndeta të pranishmit në emër të KQ të Partisë dhe të Qeverisë. Me këtë rast, përveç disa problemeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të kulturës në fshatin tonë socialist, fola edhe për disa çështje të gjendjes së sotme ndërkombëtare.

Vendin tonë imperialistët dikur e kanë quajtur barbar, se mbronte me luftë atdheun e vet. Ata e quanin popullin tonë injorant e të prapambetur se nuk u bindej pushtuesve. Por fakti që një popull i vogël si yni, i shtypur në shekuj, dhe çfarë shtypje, i cili i ruajti të paprekur gjuhën, zakonet, kulturën e tij të lashtë dhe nuk u zhduk, as u asimilua nga të tjerët, tregon se populli ynë nuk ishte as injorant dhe as pa kulturë.

Tani imperialistët na quajnë vendi «më i mbyllur» i Evropës. Për njerëzit e mirë, për miqtë dhe njerëzit e ndershëm, nga çdo anë qofshin, vendi ynë ka qenë dhe është i hapur, por për armiqtë, sabotatorët dhe provokatorët ai ka qenë i mbyllur dhe do të mbetet i mbyllur. Sigurimi dhe mirëqenia e popullit tonë vlejnë më shumë se buzëqeshjet e ujkut¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 480.

KUVENDI POPULLOR APROVOI POLITIKËN E JASHTME TË QEVERISË SONË

Në seancën e sotme të sesionit të 4-t të Kuvendit Popullor (të cilën unë e ndoqa nga shtëpia) ministri ynë i Punëve të Jashtme, Behar Shtylla, mbajti raportin «Mbi gjendjen e sotme ndërkombëtare dhe mbi politikën e jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë».

Kuvendi Popullor, pas diskutimeve, aprovoi plotësisht politikën e jashtme të Qeverisë sonë.

Po sot Kuvendi aprovoi rezolutën mbi «Thirrjen e Sovjetit Suprem të BRSS drejtuar parlamenteve të botës në lidhje me çarmatimin e përgjithshëm e të plotë» dhe rezolutën mbi «Letrën e Asamblesë së Lartë Popullore të Republikës Demokratike Popullore të Koresë lidhur me vendosjen e unitetit kombëtar të Koresë».

**MANOVRAT E REVIZIONISTËVE JUGOSLLAVË
KUNDËR PARTISË DHE VENDIT TONË
NUK DO TË PINË KURRË UJË**

Sot paradite në komitetin e Partisë të rrethit të Elbasanit pata një takim me aktivin e Partisë të këtij rrethi me rastin e punimit të materialeve të Plenumit të 14-të të KQ të PPSH.

Përveç problemeve të brendshme, që lidheshin me materialet e Plenumit, fola edhe për disa çështje të situatës ndërkombëtare. Ndër të tjera fola edhe për përpjekjet dhe manovrat e revizionistëve jugosllavë kundër Partisë dhe vendit tonë, manovra që nuk do të pinë kurrë ujë¹.

1960

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 17, f. 538.

BISEDË ME DREJTORIN E RADIODIFUZIONIT TË IRAKUT

Sot paradite prita drejtorin e Radiodifuzionit të Republikës së Irakut dhe kryeredaktor i gazetës «Al Insania», Khadhim al Samavi¹. Më foli me shumë simpati për vendin tonë. Tha se kishte ngelur shumë i kënaqur nga pritja që iu bë kudo. Kërkoj dhe i dhashë një intervistë² për gazetën «Al Insania».

Po sot u takova me ambasadorin sovjetik, V. I. Ivanov, i cili u kthye këto ditë nga Moska. Ai më informoi shkurtimisht mbi punimet e plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 18, f. 17.

² Po aty, f. 29.

ERDHI SHOKU AIDIT

Me ftesë të Komitetit Qendror të Partisë sonë erdhi në vendin tonë shoku Aidit, kryetar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Indonezisë. E pritëm në aerodromin e Rinasit dhe hëngrëm drekë së bashku. Gjatë drekës biseduam përزمërsisht për punët e partive tona.

Po sot u takova me ambasadorin sovjetik, V. I. Ivanov, dhe i shfaqja pikëpamjen e Partisë sonë lidhur me propozimin që qeveria bullgare i ka bërë qeverisë greke për të përfunduar një traktat mossulmimi midis Bullgarisë e Greqisë.

**DUKE VEPRUAR KËSHTU, UDHËHEQËSIT BULLGARË
SHKELIN TRAKTATIN E MIQËSISË
QË KANË ME NE**

Sot u takova me ambasadorin sovjetik, V. I. Ivanov, dhe i shfaqja pikëpamjen e Partisë sonë lidhur me propozimin që qeveria bullgare i ka bërë qeverisë greke për të përfunduar një traktat mossulmimi midis Bullgarisë e Greqisë.

Shokët bullgarë, megjithëse Bullgaria ka një traktat të miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke me Shqipërinë, nuk u konsultuan fare me ne lidhur me propozimin që i bënë Greqisë për nënshkrimin e një traktati të tillë, në një kohë kur Greqia, nga ana e saj, vazhdon ta quajë veten në gjendje lufte me ne dhe të ketë rivendikime tokësore ndaj vendit tonë. Gjithashtu, Zhivkovi, pa u konsultuar me ne, në një fjalim që ka mbajtur para disa ditësh në Asamblenë Kombëtare të Bullgarisë, deklaroi se shtetet e Ballkanit janë gati të çmobilizohen, në qoftë se e bën këtë Greqia. Këtë deklaratë ai e bëri pa u menduar se Shqipëria ka në kufi Italinë dhe aq më tepër asnjëri s'e kishte autorizuar atë të fliste edhe në emrin e shtetit shqiptar.

**GJENDJE E ERRËT, E PARREGULLT DHE
SHQETËSUESE PËR MBROJTJEN
E KAMPIT SOCIALIST**

Nikita Hrushovi shpalli në Sovjetin Suprem çmobilizimin e 1 200 000 ushtarëve sovjetikë. Të shohim ku do t'i dalë tymi këtij «çmobilizimi». Nga pikëpamja propagandistike, masa e njoftuar duket tërheqëse, por në realitet si një hap i njëanshëm që është, ajo mund të dobësojë mbrojtjen e kampit tonë socialist përpara kërcënimit të kampit imperialist, i cili armatohet vazhdimisht.

Asnjëherë Nikita Hrushovi problemet ushtarake e të mbrojtjes s'i ka shtruar për shqyrtim me aleatët e Bashkimit Sovjetik, me shtetet anëtare të Traktatit të Varshavës. Se si e qysh do të mbrohemi në rast se rrezikohemi prej armikut, këtë «e di vetëm Hrushovi». Me fjalë ai thotë «mos çani kokën, se ju mbrojmë ne», por në të vërtetë nuk dimë që për këtë çështje të ketë një plan operativ të përbashkët. Kjo gjendje është e errët, e parregullt dhe shqetësuese.

**INTRIGA DHE DALLAVERE NËPËR KULISA
TË REVIZIONISTËVE MODERNË**

Ambasadori sovjetik Ivanov më bëri një vizitë gjatë së cilës më vuri në dijeni për kërkesat që ka bërë Vukmanoviç Tempoja, që ndodhet në Bashkimin Sovjetik, gjoja për pushime. Tempoja ka shfaqur dëshirë të zhvillojë bisedime me udhëheqjen e Bashkimeve Profesionale të Bashkimit Sovjetik dhe Ivanovi më tha se, po të shfaqë dëshirën për të biseduar me Hrushovin, ky do ta presë, do ta dëgjojë dhe për bisedimet që do të bëhen midis tyre do të na informojë edhe ne. Tempoja gjoja i ka thënë ambasadorit sovjetik në Beograd se dëshiron të bisedojë me udhëheqësit sovjetikë edhe për rivendosjen e lidhjeve midis partive të të dy vendeve.

Këtë komunikim Ivanovi ma bëri në orën 12⁰⁰, kurse agjencia sovjetike e lajmeve TASS takimin Tempo-Hrushov e kishte njoftuar që në orën 10⁰⁰ të po kësaj dite. Kjo tregon falsitetin dhe qëndrimin hipokrit të sovjetikëve ndaj nesh. Takimi i tyre ka qenë i organizuar që më parë, kurse ne, që të mos i akuzojmë më vonë, na vunë në dijeni vetëm në minutën e fundit dhe bile, siç thashë më parë, në mënyrë të djallëzuar, duke na thënë se takimi do të bëhej në qoftë se do të «shfaqte dëshirën» Tempoja. Kush e di çfarë intrigash e dallaveresh luhën në kulisa e në hije nga revizionistët modernë. **Vigjilencë!**

HRUSHOVI PËRPIQET TË FUTË UJQIT TITISTË NË VATHË

Informohem se Hrushovi ka pasur një takim me ambasadorin jugosllav në Moskë, Mojsov¹, gjatë të cilit ky i fundit ka kërkuar që Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik të forcojnë marrëdhëniet edhe në rrugë partie. Hrushovi, në mes të tjerave, i ka thënë Mojsovit: Pse Jugosllavia nuk futet në kampin socialist? Duke u futur në të, ju do të keni më shumë fitime sesa dëme.

Kështu, pra, Nikita Hrushovi është i gatshëm të pu-
thet me revizionistët jugosllavë dhe, pa pyetur kërënd
e duke shkelur marksizëm-leninizmin, përpiket t'i lajë e
t'i rehabilitojë tradhtarët titistë, me një fjalë, t'u veshë
lëkurën e qengjit e «t'i futë ujquit në vathë»!

Ky është një krim i rëndë kundërrevolucionar, po
me ne Hrushovit nuk do t'i shkojë kurrë. Ne do ta va-
zhdojmë deri në fund luftën kundër revizionistëve mo-
dernë. Nëse Nikita do të vazhdojë rrugën që ka nisur, ne
edhe atij kokës do t'i biem. Marksistë-leninistët nuk le-
jojnë lëshime në çështjet parimore; lufta kundër revizio-
nizmit për ne është një çështje parimore e madhe.

¹ Lazar Mojsov, ambasador i Jugosllavisë në Bashkimin So-
vjetik në vitet 1958-1961.

TAKIM ME AMBASADORIN SOVJETIK

Sot u takova me ambasadorin sovjetik, Ivanovin, dhe
i dorëzova materialin në lidhje me mbledhjen e afërt të
përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vende-
ve socialiste të Evropës që do të mbahet në Moskë për
çështjet e zhvillimit të bujqësisë në këto vende.

BISEDE ME SHOKUN AIDIT DHE SHOKË TË TJERË INDONEZIANË

Sot pata një takim me shokun Aidit dhe me shokët e tjerë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Indonezisë¹. Shokët indonezianë kanë mbetur shumë të kënaqur nga vizita nëpër vendin tonë. Ata folën me admirim për Partinë, për popullin dhe për kuadrot tanë.

Diskutuam me ta shumë çështje të politikës ndërkombe-tare dhe të strategjisë e të taktikës së partive komuniste dhe punëtore të botës për luftën kundër revizionizmit modern dhe veçanërisht kundër atij jugosllav, luftën për paqen, çështjen e luftës kundër imperializmit amerikan, për rrugët dhe format e marrjes së pushtetit dhe për probleme të tjera partie. Pikëpamjet tona pugeshin plotësisht.

Aiditi është shok i mirë e i dashur, komunist i vendosur.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 18, f. 45.

NËNSHKRUAM DEKLARATËN E PËRBASHKËT ME PK TË INDONEZISË

Sot nënshkruam solemnisht me shokun Aidit deklaratën e përbashkët të delegacioneve të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Indonezisë.

Në mbrëmje, në Pallatin e Brigadave dhamë një dar-kë për nder të delegacionit të Partisë Komuniste të Indonezisë, të kryesuar nga shoku Aidit. Fola unë, foli edhe Aiditi.

AIDITI U LARGUA

Përcollëm nga Durrësi për në Itali shokun Aidit. Ai do të përfaqësojë Partinë Komuniste të Indonezisë në Kongresin e 9-të të Partisë Komuniste të Italisë që do të mbahet së shpejti.

SOVJETIKËT PËRPIQEN TË MËSOJNË SI SHKUAN BISEDIMET TONA ME AIDITIN

Prita ambasadorin sovjetik Ivanov, i cili më dorëzoi letrën zyrtare të udhëheqjes sovjetike për mbledhjen e Komitetit Konsultativ Politik të Traktatit të Varshavës, që do të mbahet së afërmi në Moskë.

Natyrisht letra ishte preteksti për këtë takim. Në të vërtetë Ivanovi donte të mësonte si shkuan bisedimet që ne zhvilluam me Aiditin.

Ivanovi luan rolin e budallait, por te ne nuk i kalojnë këto gjëra. I fola diçka rreth bisedimeve dhe sidomos me qëllim i theksova se Aiditi është qind për qind i vendosur në luftën kundër revizionistëve jugosllavë.

IVANOVI E MORI PËRGJIGJEN E ASAJ QË KËRKONTE TË MËSONTE

Më bëri vizitë ambasadori Ivanov dhe në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik më komunikoi se ministri i Mbrojtjes i vendit tonë duhet të jetë në Moskë më 31 janar, pse do të bëhet mbledhja e ministrave të mbrojtjes të kampit socialist.

Duke e çuar bisedën rreth gjendjes në Itali, Ivanovi u mundua të mësonte pikëpamjen tonë mbi qëndrimet e Partisë Komuniste Italiane. Ia thashë troç se qëndrimi i udhëheqësve të asaj partie neve nuk na pëlqen dhe, në shumë çështje, kurrë nuk mund të jemi dakord me ta, pse vija e udhëheqjes së Partisë Komuniste Italiane, për të mos thënë revizioniste, është në mënyrë të theksuar oportuniste. Udhëheqja e kësaj partie, pavarësisht se nuk e shfaq haptazi, është solidare me titistët dhe me tërë kuptimin e fjalës është pacifiste. Ajo ka shtrembëruar të gjitha tezat themelore të marksizëm-leninizmit, ka mënjeluar kuadrot revolucionarë dhe ndjek një rrugë krejtësisht të gabuar, antimarksiste e borgjeze me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me Republikën tonë Popullore.

DO TË MARRIM PJESE NË KONGRESIN E 9-TË TË PK TË ITALISË

Ramizi u nis sot për në Romë, në krye të një delegacioni që do të përfaqësojë Partinë tonë në punimet e Kongresit të 9-të të Partisë Komuniste të Italisë.

**DO TË MARRIM PJESE NË MBLEDHJEN PËR
ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË VENDET
E EVROPËS LINDORE**

Sot u zhvillua mbledhja e Byrosë Politike, në të cilën u diskutua dhe u vendos qëndrimi që do të mbajë delegacioni ynë në mbledhjen e Moskës të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës mbi çështjet e zhvillimit të bujqësisë.

NISEMI PËR NË MOSKË

U nisëm si delegacion i Partisë së Punës të Shqipërisë për në Moskë, me TU-104, për të marrë pjesë në mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës mbi çështjen e zhvillimit të bujqësisë. Gjatë rrugës ndalua në Budapest për një orë. Në aerodromin e Moskës na priti Muhitdinovi. Pastaj na çuan si zakonisht në Zareçie.

Sapo arritëm, një funksionar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik më lajmëroi se nesër Mikojani dëshiron të ketë një takim personal me mua. Iu përgjigja sovjetikut se jam gati të vij në takim që më kërkohet tok me shokun Mehmet.

SOVJETIKËT PËRPIQEN TË NA PËRPUNOJNË KUNDËR KINËS

Bashkë me shokun Mehmet shkuam sot në shtëpinë e Mikojanit. Ky për pesë orë rresht u përpoq të na përpunonte kundër Kinës. Çfarë të këqijash nuk tha ai kundër saj?!

Të gjitha sa na tha, na çuditën, na ngjallën dyshime, pse mënyra si na i tha nuk është aspak në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Qëllimi i sovjetikëve ishte të na përgatitnin ne kundër Kinës.

Sot pasdite erdhën nga Tirana shokët tanë që do të marrin pjesë në mbledhjen e Komitetit Konsultativ Politik të Traktatit të Varshavës.

Në mbrëmje shkuam në Lluzhinski për të parë baletin çek në akull. Atje takuam Hrushovin dhe shokë të tjerë sovjetikë.

NGA QËNDRIMI NË MOSKË

Qëndruam brenda në vilë. Punuam materialet për mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të vendeve socialiste të Evropës dhe pamë filma.

Kinës iu dha një përkrahje e fortë nga sovjetikët. Kjo ishte një mbledhje e shprehur dhe pa ekuivok. Në këtë mbledhje, Hrushovi mbledhën të gjithë ata që ishin të interesuar në mbledhjen e mbledhjes së filmit përfaqësues të vendeve socialiste të Evropës dhe pamë filma. Kjo ishte një mbledhje e shprehur dhe pa ekuivok. Në këtë mbledhje, Hrushovi mbledhën të gjithë ata që ishin të interesuar në mbledhjen e mbledhjes së filmit përfaqësues të vendeve socialiste të Evropës dhe pamë filma.

Kjo ishte një mbledhje e shprehur dhe pa ekuivok. Në këtë mbledhje, Hrushovi mbledhën të gjithë ata që ishin të interesuar në mbledhjen e mbledhjes së filmit përfaqësues të vendeve socialiste të Evropës dhe pamë filma.

NJË Mbledhje e shpëlarë

Në Kremlin u hap mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës mbi çështjen e zhvillimit të bujqësisë. Përfaqësuesi kinez nuk mori pjesë as si vëzhgues. Nuk e dimë nëse e kishin ftuar Partinë Komuniste të Kinës apo jo.

Pas një fjalimi të hapjes, shumë të shkurtër, të Hrushovit, mbledhjen e drejtova unë. Në këtë seancë foli edhe unë dhe po sot mbaruan së foluri përfaqësuesit e të gjitha partive.

Kjo ishte një mbledhje e shpëlarë dhe pa qëllime të caktuara e të qarta. Të gjithë paraqitëm nga një raport. Secili foli për rezultatet, sukseset e të metat dhe nevojat që ka çdo vend në fushën e bujqësisë.

Ç'do të dalë nga kjo? Të shohim e të presim!

Hrushovi kërcënon!

Në vazhdim të mbledhjes së djeshme, sot seancat e mëngjesit iu kushtuan punës së ekspertëve.

Pasdreke, në seancë plenare, foli Hrushovi, i cili në substancë na vuri në dijeni mbi punimet e plenumit të Komitetit të tyre Qendror për bujqësinë. Pasi foli për sukseset e arritura, ai tha se Bashkimi Sovjetik nuk do të blejë më nga vendet e demokracisë popullore as pije, as verë, as duhan. Pastaj bëri një kërcënim në drejtimin e të gjithëve duke thënë se këto vende, domethënë demokracitë popullore, duhet ta prodhojnë vetë bukën dhe jo t'i bien në qafë Bashkimit Sovjetik etj.

Në seancën e fundit, të cilën e drejtova përsëri unë, aprovaam me «unanimitet» komunikatën e përbashkët.

Përshtypja ime është se kjo mbledhje nuk dha asgjë, përveç 15 referateve që ishin mbajtur në mbledhjen e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për bujqësinë, të cilat na u rekomanduan t'i lexojmë si djemtë e shkollës.

NË MBLEDHJEN E KOMITETIT KONSULTATIV POLITIK TË TRAKTATIT TË VARSHAVËS

Zhvilloi punimet mbledhja e zakonshme e Komitetit Konsultativ Politik të Traktatit të Varshavës, ku folën përfaqësuesit e të gjitha delegacioneve të vendeve anëtare. Nga ne foli Mehmeti.

Në fund e mori fjalën edhe Hrushovi, i cili foli për çështje të njohura mbi çarmatimin e paqen dhe mbi bisedimet e ardhshme të nivelit të lartë me perëndimorët.

Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte gjoja të na komunikoheshin qëndrimet e qeverisë sovjetike në bisedimet e ardhshme ndërkombëtare dhe të merrej aprovimi i të gjithë pjesëmarrësve në Traktat. Në mes të tjerash, u vendos që, në qoftë se qeveritarët e Gjermanisë Perëndimore dhe anglo-amerikanët nuk do të duan të nënshkruajnë traktatin e paqes me Gjermaninë, atëherë ne do ta nënshkruajmë atë me Republikën Demokratike Gjermane.

Në mbrëmje morëm pjesë në darkën e shtruar nga Hrushovi, gjatë së cilës ai mburri shumë veten dhe sulmoi egër, po pa përmendur me emër, Kinën. Pjesëmarrja në darkë ishte shumë e gjerë dhe u ngritën shumë doli. Pas darke pamë filmat «Qyteti im» dhe «Kaçubei».

VIZITË PROTOKOLLARE HRUSHOVIT

Sot i bëmë një vizitë protokollare Nikita Hrushovit në Kremlin. Vizita zgjati shumë pak dhe nuk biseduam ndonjë problem.

U vizitova te doktor Preobrazhenski, në Kremlovskaja-Balnica. Gjendja ime shëndetësore shumë e mirë.

MOSKË, E SHTUNË
6 SHKURT 1960

NË AMBASADËN TONË NË MOSKË

Shkuam në ambasadën tonë në Moskë, për të parë maketin dhe planet e Pallatit të Kulturës që do të ndërtohet në Tiranë. Atje ishin dhe projektuesit sovjetikë.

Maketi i ekspozuar dhe projekti i Pallatit nuk na pëlqeu, prandaj i bëmë shumë vërejtje dhe dhamë porosi që të na sjellin në Tiranë projekte të tjera.

Më zuri rrufa, por pa temperaturë. Jashtë bën ftohtë dhe ka borë.

MOSKË, E DIËL
7 SHKURT 1960

NGA QËNDRIMI NË MOSKË

Në vilën ku ne banojmë, sot na erdhën për një vizitë Petrovi, Lesakovi dhe Medvedievi. Gjatë gjithë kohës nuk bëmë gjë tjetër veçse pamë filma dhe luajtëm bilardo.

Rrufa vazhdon, prandaj qëndruam brenda në vilë.

**PËRSËRI NË GJIRIN E ATDHEUT TË DASHUR,
TË NGROHTË E PLOT DIELL**

U nisëm për në Tiranë me avion special TU-104. Në aerodrom na përcolli Muhitdinovi dhe disa shokë të tjerë të udhëheqjes sovjetike.

Po sot mbërritëm shëndoshë e mirë në Tiranë. Nga bora e të ftohtit e Moskës erdhëm në atdheun tonë të dashur, të ngrohtë dhe plot diell.

MBLEDHJE E BYROSË POLITIKE

Në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike raportova për punimet e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të vendeve socialiste të Evropës mbi çështjen e bujqësisë, që zhvilloi punimet në Moskë.

NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA KINEZE

Ambasada e RP të Kinës dha një pritje në hotel «Dajti», me rastin e 10-vjetorit të nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë e të Bashkëpunimit midis Bashkimit Sovjetik e Kinës. Përshëndeta në emër të Partisë.

PRITJE E DHËNË NGA AMBASADA SOVJETIKE

Mora pjesë në një pritje të dhënë nga ambasada sovjetike me rastin e 10-vjetorit të nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë e të Bashkëpunimit midis Bashkimit Sovjetik e Kinës. Përshëndeti shoku Mehmet.

QENDRIM I ÇUDITSHËM NDAJ UDHËHEQËSVE TË BORGJEZISË INDIANE

Sot pata një takim me ambasadorin sovjetik në Tiranë, Ivanov, i cili më vuri në dijeni për bisedimet e zhvilluara në Indi midis Hrushovit dhe kryeministrit indian Nehru.

Në pamje të jashtme duket sikur bisedat e Hrushovit me Nehrunë janë të lezetshme, por nuk është kështu. Unë mendoj se politika që bën Bashkimi Sovjetik me Indinë është e nevojshme, por Hrushovi sikur e tepron në miqësinë dhe besimin që ka te Nehru. Këtij nuk i duhet besuar, pse është përfaqësuesi i kapitalit të madh indian dhe armik i komunizmit. I çuditshëm është qëndrimi i Hrushovit karshi njerëzve të tillë, udhëheqës të borgjezisë! Gjithashtu, kurdoherë që kam shkuar në dhomën e punës të Hrushovit, në Kremlin, kam parë bustin prej fildishi të Gandit. Kjo s'bëhet kot dhe as do të thotë se Hrushovi «bën politikë». Një veprim i tillë tregon se në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me çështje qëndrimesh joparimore, me pikëpamje ideologjike dhe politike të gabuara të Hrushovit dhe shokëve të tij ndaj Nehrusë e borgjezisë indiane.

POLITIKË ZBUTËSE, KOMPROMISESH DHE LËSHIMESH NDAJ IMPERIALIZMIT AMERIKAN

Ambasadori sovjetik Ivanov më vuri sot në dijeni mbi korrespondencën që Hrushovi ka pasur gjatë këtij muaji me Ajzenhauerin në lidhje me armët atomike.

Shumë shpresa ka Hrushovi te presidenti amerikan, që është një qen i tërbuar imperialist! Politika e Bashkimit Sovjetik ndaj imperializmit amerikan nuk është parimore, e fortë dhe e vendosur, por është shumë e lëshuar, si me thënë «lypëse». Nga ana e tyre, imperialistët amerikanë, të cilët e shohin këtë politikë të Hrushovit, tregohen ekzigjentë.

Një politikë e tillë zbutëse dhe kompromisi, pa asnjë fryt, nuk është e drejtë të vazhdohet. Lufta që bëjmë për mbrojtjen e paqes e për çarmatimin, nuk do të thotë kurrë që të qëndrojmë në mëshirë dhe në bisht të amerikanëve. Nuk duhet lejuar që ngjarjet të zhvillohen kur të duan ata dhe si të duan ata. Hrushovi ka shumë llafe.

VIGJILENCË!

Dje ambasadori Ivanov më informoi për korrespondencën e shkëmbyer midis Hrushovit dhe Ajzenhauerit lidhur me armët atomike. Sot ai erdhi përsëri për të më njohur rreth bisedimeve që ambasadori sovjetik në Beograd ka bërë me dy nga krerët revizionistë jugosllavë, Tempon dhe Vllahoviçin. Por në të vërtetë nëpërmjet këtij takimi me mua, Ivanovi u përpoq të bënte sondazhe për të mësuar se ç'qëndrim do të mbajë Partia e Punës e Shqipërisë në lidhje me Kongresin e 5-të të Frontit Jugosllav¹. Ia dhashë përgjigjen për qëndrimin tonë. Pas kësaj Ivanovi më tha se ata (sovjetikët) nuk do të dërgojnë delegacion në këtë kongres, sepse s'kanë organizatë fronti në Bashkimin Sovjetik. Ky është një qëndrim oportunist. I thashë, e drejta është se titistëve duhet t'u refuzohet ftesa, që u kanë dërguar, mbasi ky kongres është një kongres fronti i revizionistëve. Ivanovi në mënyrë hipokrite e pranoi pikëpamjen time.

Jugosllavët vazhdojnë ofensivën e tyre revizioniste dhe zhvillojnë intriga, të cilat gjejnë vend në radhët e disa prej udhëheqësve të vendeve të kampit socialist. Nëpërmjet këtyre agjentëve revizionistë të maskuar, jugosllavët po përgatitin puçe dhe kundërrevolucione të reja, si ai i Hungarisë. Synimet e tyre drejtohen sidomos kundër vendit tonë.

Duhet vigjilencë e madhe!

¹ Lidhja socialiste e popujve punonjës të Jugosllavisë.

VËRTETOHEN DYSHIMET MBI PUNËN E PARREGULLT TË GJEOLGËVE SOVJETIKË

Nga biseda në lidhje me gjeologjinë e naftës, që zhvillova me dy gjeologë tanë të Ministrisë së Minierave, vërtetohen dyshimet e mia se grupet e gjeologëve sovjetikë nuk janë të rregullt në punën e tyre; ata veprojnë sipas kokës së vet dhe nuk japin rezultate të kënaqshme. Por edhe nuk kontrollohen nga ana jonë. Fushat dhe pikat, që ata paraqesin për shpim e kërkim, nuk japin naftë. Veprimet e tyre nuk janë të rastit, prandaj ne nuk mund të lejojmë të vazhdojmë më tej një situatë e tillë. Për këtë çështje kaq serioze bisedova me shokët Spiro Koleka dhe Adil Çarçani. Thirra edhe ambasadorin Ivanov dhe mendimet e mia ia thashë troç. Porosita Spiron, që, kur të vejë në Moskë, t'ia shtrojë hapur Kosiginit këtë çështje, që Moska të ushtrojë kontroll mbi punën e gjeologëve sovjetikë. Por edhe ne vetë ta rritim më tepër kontrollin mbi veprimtarinë e grupeve të gjeologëve sovjetikë.

TAKIM ME SHOKUN BEHAR SHTYLLA

U takova me shokun Behar për të zgjidhur disa çështje të jashtme dhe të vetë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

PRITJE NGA AMBASADA HUNGAREZE

Pritje në ambasadën hungareze me rastin e 15-vjetorit të çlirimit të RP të Hungarisë. Foli ambasadori Zhatkullak, fola edhe unë.

ÇFARË FSHIHET PRAPA KËSAJ KTHESE?!

Ambasadori sovjetik Ivanov më lajmëroi sot për pranimin në Bashkimin Sovjetik të 15 emigrantëve jugosllavë, në mes të të cilëve është edhe Vllado Dapçeviçi.

Emigrantët në fjalë kishin bërë kërkesa të vazhdueshme për t'u pranuar në BS, por autoritetet sovjetike nuk kishin pranuar t'ua plotësonin ato, sigurisht për të mos u komprometuar me titistët. Tash pranimi i tyre duket i çuditshëm. Të shohim ku do t'i dalë tymi.

Ivanovi më tha gjithashtu se «shtypi sovjetik do të zhvillojë fushatë kundër terrorit në Greqi»!

BISEDË ME SHOKUN SPIRO KOLEKA

Bisedë me shokun Spiro Koleka që shkon nesër në Moskë.

MBRËMJE TRADICIONALE SHQIPTARO-SOVJETIKE

Asistuaam në mbrëmjen tradicionale shqiptaro-sovjetike të nxënësve dhe studentëve të kryeqytetit, organizuar me rastin e 90-vjetorit të lindjes së V. I. Leninit. Mbrëmja ishte e kënaqshme. Midis të rinjve po dalin talente të mira amatorësh.

REVISTA «PROBLEME TË PAQES E TË SOCIALIZMIT» ËSHTË NË DORË TË SOVJETIKËVE

Ramizi më raportoi mbi çështjet që u trajtuan në mbledhjen e revistës «Probleme të paqes dhe të socializmit», që zhvilloi punimet në Pragë.

Sipas mendimit tim, puna e sovjetikëve atje jo vetëm që s'është shumë e qartë, por është bërë bile e dyshimtë. Ndërsa kinezët në shumë çështje, përgjithësisht, kanë mbajtur qëndrime të drejta.

ORIENTIME KUNDËRREVOLUCIONARE TË RENEGATIT TITO

Lexova fjalimin që Titoja mbajti këto ditë në Kongresin e 5-të të Lidhjes socialiste të popujve punonjës të Jugosllavisë. Në të duken haptazi orientimet konkrete kundërrevolucionare të këtij renegati. Titizmi duhet demaskuar. Për këtë të përdoren momente nga vetë fjalimi i tij.

Nga përmbajtja e pjesës së politikës së jashtme del se:

1. — Titoja fatin e paqes ose të luftës e lë në dorë të disa «personaliteteve» **dhe jo të luftës së popujve për paqen.**

2. — Forcat e paqes, sipas tij, janë më të mëdha në vendet kapitaliste, sesa në vendet socialiste.

3. — Sipas këtij renegati, vetëm Hitleri i çmendur e bëri luftën dhe jo sistemi i tij, jo imperializmi e fashizmi.

4. — Në të gjithë fjalën e tij, Titoja nuk guxon të përmendë me emër imperialistët, revanshistët dhe për këtë arsyet dihen. Po kështu vepron edhe kur flet për vendet koloniale.

I dërgova Ramizit edhe tekstin e fjalimit të Titos me shënimet që kam bërë në disa faqe, që t'i ketë parasysh.

MBLEDHJE SOLEMNE PËR DITËLINDJEN E LENINIT

Mbledhje solemne në sallën e Teatrit e të Operës me rastin e 90-vjetorit të lindjes së Leninit.

Mbledhjen e hapi shoku Hysni. Shoku Ramiz mbajti fjalimin e rastit.

LETËR NGA DEZHI

Prita ambasadorin rumun. Ai më dorëzoi një letër nga Dezhi ku propozon që njëri nga ne të shkojë në Bukuresht për të biseduar në lidhje me problemin ekonomik dhe ndihmën në këtë fushë që i kemi kërkuar Rumanisë në shkurt të këtij viti.

TAKIM ME SHOKUN SPIRO KOLEKA

Spiroja u kthye nga Moska dhe më raportoi për bisedimet që pati atje me Kosiginin për problemin e peshkut, të gjeologjisë etj.

TAKIM ME SHOKUN MANUSH MYFTIU

Më raportoi Manushi për çka ka parë në Bashkimin Sovjetik në lidhje me reformën arsimore.

PRAVDA BOTON NJË ARTIKULLIN TIM

Gazeta «Pravda» botoi sot artikullin tim me titullin «Leninizmi triumfon».

SHENJË «BEHARI» NGA MOSKA!

Ambasadori sovjetik Ivanov më dorëzoi letrën që na dërgon Hrushovi, në përgjigje të letrës sonë të shkurtit për kërkesë kredie, me anë të së cilës na njofton se Bashkimi Sovjetik na shtyn shlyerjen e kredive dhe të kësteve të viteve 1960-1965, të cilat ne duhet t'i paguajmë në vitin 1975. Kështu në dispozicionin tonë vihen praktikisht 85 milionë rubla për mallra konsumi dhe për ndërtime.

Ç'të jetë kjo shenjë «behari» nga Moska?! Kushedi se ç'është duke përgatitur Hrushovi, gjersa do të na marrë me të mirë! Por ne jemi mësuar me këto metoda të tij, ia kemi parë edhe «kulaçin», edhe «kërbaçin». Të shohim tash ç'fshihet pas «kulaçit».

VEPRIME QË NA IMPONOJNË RITJEN E VIGJILENCËS PËR MBROJTJEN E ATDHEUT TONË

Sot prita Ivanovin, i cili, në emër të udhëheqjes sovjetike, kërkoi zyrtarisht nga ne pëlqimin që komandant i përgjithshëm i forcave të bashkuara të Traktatit të Varshavës të jetë mareshali Greçko, në vend të mareshal Konievit, i cili hiqet për shkak se është «i sëmurë».

Ne i dhamë atij pëlqimin, por s'jemi aspak të bindur për këtë ndryshim që bëhet. Konievi nuk është i sëmurë fizikisht, por s'i pëlqen Hrushovit, prandaj ai e heq dhe e zëvendëson me një njeri të tij.

Në ushtrinë sovjetike vazhdon spastrimi i gjeneralëve dhe i mareshalëve të shquar sovjetikë. Sigurisht që spastrimi i kuadrove të mirë të ushtrisë sovjetike është bërë me forcë të madhe nëpërmjet masave të çmobilizimit në radhët e kuadrove të ushtrisë.

Në këto kushte, ne duhet të jemi shumë vigjilentë për çështjen e mbrojtjes së vendit tonë!

SHOKU MEHMET DO TË SHKOJË NË RUMANI

Fola me shokun Mehmet lidhur me vajtjen e tij në Bukuresht. Siç kam shkruar, Dezhi na ka bërë kërkesë që njëri prej nesh të shkojë në Rumani për të biseduar rreth marrëdhënieve ekonomike midis vendeve tona.

Me rastin e 15-vjetorit të çlirimit të Çekosllovakisë ambasadori i këtij vendi dha mbrëmë një pritje në hotel «Dajti». Foli ambasadori, fola edhe unë.

TAKIM ME AMBASADORIN KOREAN

Prita sot ambasadorin korean, i cili, në emër të Kim Ir Senit, më vuri në korenit mbi situatën në Korenë e Jugut.

DEKLARATA TË DËMSHME NDAJ VENDIT TONË TË AMBASADORIT SOVJETIK NË ATHINË

Thirra në takim ambasadorin sovjetik Ivanov, të cilit i thashë se protestoja dhe se i hidhja poshtë pikëpamjet e shprehura nga ambasadori sovjetik në Athinë, Sergejev, sipas të cilit vendi ynë, për të përmirësuar marrëdhëniet me Greqinë, duhet të ngrejë ose në OKB ose në Gjqin Ndërkombëtar të Hagës çështjen se përse Greqia thotë se është «në gjendje lufte» me Shqipërinë dhe «pse ka rivendikime territoriale» ndaj vendit tonë. I thashë Ivanovit se pikëpamje të tilla të ambasadorit Sergejev janë të dyshimta dhe të padrejta mbasi favorizojnë reaksionin grek që ai të fillojë të bëjë zhurmë rreth këtyre çështjeve.

Ivanovi, natyrisht, si ngaherë dhe për të dalë nga situatat, tha se nuk dinte gjë dhe se do t'ia transmetonte udhëheqjes së vet protestën tonë.

MEHMETI U NIS PËR NË RUMANI

SHUMI

Sot Mehmeti u nis për në Rumani në bazë të kërkesës së bërë nga Dezhi për të diskutuar probleme ekonomike midis dy vendeve tona.

Me Mehmetin u nis për në Rumani në bazë të kërkesës së bërë nga Dezhi për të diskutuar probleme ekonomike midis dy vendeve tona. Mehmeti u nis për në Rumani në bazë të kërkesës së bërë nga Dezhi për të diskutuar probleme ekonomike midis dy vendeve tona.

DEZHI PREMTON, POR UNË NUK KAM SHUMË BESIM

Mora radiogram prej Mehmetit, me anë të të cilit ai më njoftoi se në Rumani e pritën mirë dhe se Dezhi ka mendimin që Shqipëria duhet ndihmuar gjerësisht për zhvillimin e saj ekonomik. Unë s'kam shumë besim në deklaratat e Dezhit se rumunët kanë shumë fjalë, prandaj i shkrova Mehmetit të sigurojë të paktën aprovimin e kërkesave tona që u drejtuam rumunëve në shkurt. «Më mirë një vezë sot, se një pulë mot».

MEHMETI U KTHYE NGA BUKURESHTI

SOVJETIK

Rezultatet e bisedimeve që Mehmeti pati me rumunët janë të kënaqshme. Përveç premtimeve që dhanë për të ardhmen, ka rëndësi fakti që ata na shtynë pagesën e kësteve prej 35 milionë rublash për pas vitit 1975.

LOGJIKË BANDITËSH

Lexova artikullin që do të botohet në gazetën «Zëri i popullit» lidhur me demaskimin e demagogjisë së revizionistëve jugosllavë. Ia dërgova Ramizit që të jepet për botim. I rekomandova që të hiqet emri i Nehruse për të evituar polemikën me Indinë. Problemi të mbetet siç është, por pa përmendur emrin e tij. I rekomandova, gjithashtu, të forcohet pjesa ku flitet për aeroplanin spin amerikan. Konkluzioni të jetë se, ashtu siç pohojnë me cinizëm imperialistët amerikanë se veprimet e spiunazhit kundër vendeve të kampit socialist janë normale dhe do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, ashtu veprojnë dhe pohojnë edhe revizionistët jugosllavë kundër vendit tonë dhe vendeve të tjera të kampit socialist. Kjo është logjikë e njëjtë banditësh. Por banditëve ne ua kemi thyer dhe do t'ua thyejmë kokën, sa herë që do të prekin kufijtë tanë.

Bisedova me shokun Ramiz lidhur me Kongresin e 5-të të Lidhjes socialiste të popujve punonjës të Jugosllavisë dhe diskutuam së bashku se si duhet të shkruhet artikulli për demaskimin e këtij kongresi revizionist.

PIKËPAMJE TË KUNDËRTA ME AMBASADORIN SOVJETIK

Prita sot ambasadorin sovjetik Ivanov. Vura re se ai kishte ardhur të tatonte pulsën dhe të njihej me pikëpamjet tona mbi konferencën e nivelit të lartë që duhet të fillojë sot në Paris.

I thashë se qëndrimet tona janë vendosur në Mbledhjen e Moskës të Komitetit Konsultativ Politik të Traktatit të Varshavës, domethënë asnjë lëshim nuk duhet t'u bëjmë imperialistëve. Unë nuk kam shpresa për arritjen e ndonjë rezultati. Çdo gjë atje do të sabotohet nga imperialistët.

Pikëpamjet tona nuk u puqën, pse ambasadori Ivanov kishte shpresa se diçka mund të dilte nga kjo konferencë. Le ta vërtetojë koha drejtësinë e gjykimit tonë!

Po sot prita ambasadorin çekoslovak, i cili, në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Çekosllovake, më ftoi për të kaluar pushimet në Çekosllovaki. Pasi e falënderova, i thashë që sivjet nuk do të dal për pushime jashtë atdheut.

NJË HAP I MIRË NË KONFERENCËN E PARISIT

Konferenca e nivelit të lartë në Paris «u pordh», si me thënë, pa filluar. Deklarata e Hrushovit në takim paraprak të kryetarëve të katër fuqive të mëdha dhe demaskimi prej tij i imperialistëve amerikanë për dërgimin e avionit spiun U-2 mbi hapësirën ajrore të Bashkimit Sovjetik, ishte e mirë dhe e nevojshme. Ne e mbështetim atë me gjithë zemër. Ky veprim i drejtë i zuri ngushtë amerikanët dhe ata e sabotuan konferencën.

Unë mendoj se konferenca as që do të fillojë, pse imperialistët amerikanë nuk do të kërkojnë ndjesë.

Situata ndërkombëtare do të ashpërsohet, por rëndësi ka që çështjet këtë herë, me ç'shihet, u vunë drejt, sepse Hrushovi, deri tani, për problemet e situatës ndërkombëtare, ka ndjekur rrugën e oportunitetit, të lajkave dhe të lëshimeve ndaj imperializmit amerikan.

TAKIM ME AMBASADORIN SOVJETIK

Ambasadori Ivanov erdhi sot dhe më tha: «Të doli fjala»¹. Ia ktheva se ne jemi dakord me deklaratën e Hrushovit dhe shtova: Kështu duam t'u qëndrojmë ai kurdoherë imperialistëve amerikanë.

¹ Është fjala për dështimin e mbledhjes së konferencës së nivelit të lartë në Paris.

«SIHARIQ» I AMBASADORIT SOVJETIK

Në takimin që pata sot me ambasadorin sovjetik Ivanov, më dha «sihariqin» që revista sovjetike «Komunist» paska shkruar një artikull kundër revizionistëve jugosllavë!

DREJTËSI PËR VËLLEZËRIT TANË TË KOSOVËS

Në mitingun e organizuar në sheshin përpara vatrës së kulturës të kooperativës së bashkuar Brezhdan-Zdojan, «Rruga e Partisë», i përshëndeta të pranishmit. U fola shkurt edhe për gjendjen ndërkombëtare, për pozitën e fortë të Shqipërisë si dhe për veprimtarinë armiqësore të revizionistëve jugosllavë ndaj vendit tonë. Theksova, midis të tjerave, se ne i hedhim poshtë akuzat e tyre se po përzihemi në çështjen e Kosovës pasi kjo qenka vetëm punë e tyre e brendshme. Ne nuk përzihemi në punët e brendshme të Jugosllavisë, përkundrazi ata janë përzier në punët tona. Për sa u përket kosovarëve që janë vëllezërit tanë, ne nuk mund të mos interesohemi. Ne kërkojmë drejtësi për ta¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 18, f. 256.

HRUSHOVI PROPOZON MBLEDHJEN E PARTIVE KOMUNISTE E PUNËTORE TË VENDEVE TË KAMPIT SOCIALIST

Sot ambasadori sovjetik Ivanov më dorëzoi letrën zyrtare të Nikita Hrushovit në lidhje me organizimin e një mbledhjeje të partive komuniste dhe punëtoare të vendeve të kampit socialist dhe të një mbledhjeje të Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës. Në letrë propozohet që këto mbledhje të zhvillohen në Bukuresht nga fundi i këtij muaji.

NJË MANOVËR DINAKE

Në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike vendosëm t'i dërgojmë Liri Belishovës disa sqarime e porosi me letër lidhur me bisedimet që ajo po bën me kinezët në Pekin. Gjithashtu, në këtë mbledhje diskutuam letrën e 2 qershorit që na dërgon Hrushovi, në të cilën bëhet fjalë për një takim të afërt të partive komuniste e punëtoare në lidhje me çështjet që ziejnë. Ai propozon që takimi të bëhet në Bukuresht, ku përfaqësuesit e partive motra do të shkojnë për të asistuar në kongresin e Partisë Punëtoare Rumune.

Hrushovi ka për qëllim që në Bukuresht t'i kalojë si nëpër këmbë mosmarrëveshjet serioze sovjeto-kineze dhe, duke vepruar kështu, të pengojë po munda ose të nënvleftësojë mbledhjen e ardhshme që, me të drejtë, një numër partish kanë kërkuar ta organizojnë. Kjo manovër e Hrushovit është dinake dhe e papranueshme. Duhet të jemi shumë vigjilentë, se diçka e madhe po luhet!

Po sot prita ambasadorin sovjetik Ivanov, i cili pa dyshim donte mendimin tonë për letrën e Hrushovit në të cilën ai propozon mbledhjen e Bukureshtit. I dhashë një përgjigje lakonike.

LETËR E DYTË E HRUSHOVIT — ÇFARË FSHIHET PAS VEPRIMEVE TË TIJ?

Bisedova me shokun Ramiz se si të përgatitemi për mbledhjen e afërt të Bukureshtit.

Prita ambasadorin sovjetik Ivanov, i cili më lajmëroi se mbledhja e Bukureshtit shtyhet dhe më dorëzoi një letër të dytë të Hrushovit, ku shpjegohet pse shtyhet kjo mbledhje. Por në këtë letër të dytë kërkohet që në Bukuresht përfaqësuesit e partive motra të mbli-dhen për të përcaktuar vendin dhe kohën kur do të mba-het mbledhja e ardhshme. Si tepër e përdredhur kjo pu-në: edhe «ta shtyjme» mbledhjen, edhe të bëjmë një tjetër po në Bukuresht. Mos fshihet ndonjë hile pas kësaj?! Sidoqoftë gjëja e parë që mendoj të bisedoj me shokët e Byrosë është kjo: në Bukuresht s'kam pse të vete unë në krye të delegacionit, gjersa mbledhja e partive u shty. Të shkojë një shok tjetër, mundet shoku Hysni, ai të marrë pjesë në kongresin e Partisë Punëtore Rumune dhe le të marrë pjesë edhe në takimin e përfaqësuesve të partive komuniste për përcaktimin e vendit dhe të ko-hës së mbledhjes së ardhshme.

AMBASADORI SOVJETIK KËRKON TAKIM

Ambasadori sovjetik Ivanov kërkoi sot takim dhe më dorëzoi procesverbalet e takimit paraprak, që u zhvi-llua një muaj më parë në Paris midis kryetarëve të ka-tër fuqive të mëdha.

PARTIA JONË KURRË NUK DO TË SHKELE NË DËRRASË TË KALBUR

Diskutuam me Hysniun mbi fjalimin që ai do të mbajë në emër të Komitetit Qendror të Partisë sonë në Kongresin e 3-të të Partisë Punëtore Rumune si dhe për qëndrimet që duhet të mbajë delegacioni ynë në mbledhjen e partive komuniste e punëtore që do të mbahet atje sipas propozimit të sovjetikëve.

Mehmeti, i cili ndodhet në Moskë, më lajmëroi me telegram për bisedën e poshtër antikineze që i kishte bërë Kosigini duke i thënë, midis të tjerave, se «Ne, në asnjë mënyrë nuk mund të bëjmë asnjë kompromis, asnjë lëshim ndaj kinezëve». Kuptohet se qëllimi i bisedës së Kosiginit ishte që Partia jonë, në mosmarrëveshjet sovjeto-kineze, të mbajë anën e sovjetikëve. Mehmeti i kishte dhënë atij përgjigjen e merituar.

Udhëheqësit sovjetikë e kanë të qartë se Partia jonë kurrë nuk shkel në dërrasë të kalbur. Ajo do të mbrojë kurdoherë ata që kanë të drejtë dhe që janë në rrugën marksiste-leniniste. Si po zhvillohen ngjarjet, del se kinezët janë në rrugë të drejtë, kurse udhëheqja sovjetike është në rrugë të gabuar.

SHOKU HYSNI NISËT PËR NË BUKURESHT

Hysniu nisët sot për të përfaqësuar Partinë tonë në punimet e Kongresit të 3-të të Partisë Punëtore Rumune.

TAKIM ME SHOKËT MEHMET E GOGO

Mehmeti u kthye mirë nga Moska. Më raportoi gjatë mbi bisedën që i kishte bërë Kosigini e për të cilën kam shkruar shkurt në shënimin e datës 16 qershor.

Po sot Gogo Nushi erdhi nga Pekini. Më raportoi mbi punimet e sesionit të Këshillit të Përgjithshëm të Federatës Sindikale Botërore dhe për mosmarrëveshjet që ishin dukur midis sovjetikëve dhe kinezëve në çështje parimore të vijës. Më vuri në dijeni gjithashtu për bisedën që Liu Shao Çia kishte pasur me delegacionin tonë të Presidiumit të Kuvendit Popullor, që është duke vizituar Kinën dhe në të cilin bëjnë pjesë Haxhiu dhe Liria, bisedë në të cilën kishte marrë pjesë.

I fola çfarë mendonim ne se po luhet në mes BS e Kinës e prapa shpinës së partive komuniste.

NJË MBLEDHJE QË SHNDËRROHET NË KOMPLOT

Mbledhja e Bukureshtit me përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore, që asistojnë në kongresin e Partisë Punëtore Rumune, në fakt po shndërrohet në një komplot kundër Partisë Komuniste të Kinës. Duhet ta shpartallojmë këtë komplot të rrezikshëm. Për këtë çështje bisedova edhe me Mehmetin, i cili po pushon në Durrës.

PARTINË E PUNËS HRUSHOVI NUK DO TA GËNJEJË DOT KURRË

Mora një sërë radiogramesh nga Hysniu, me anë të të cilave ai më vë në dijeni mbi zhvillimin e ngjarjeve në Bukuresht.

Për ne është më se e qartë se Nikita Hrushovi, për të mbrojtur pikëpamjet e tij oportunisto-revizioniste, po sulmon marksizëm-leninizmin dhe Partinë Komuniste të Kinës. Ai po mashtron gjithë udhëheqësit dhe përfaqësuesit e partive komuniste dhe punëtoare që ndodhen në Bukuresht dhe po i fut në rrjetën e komplotit që është duke kurdisur. Por Partinë tonë Hrushovi s'e gënjen dot kurrë!

Informova Byronë Politike dhe e vura në dijeni për çka më lajmëron Hysniu nga Bukureshti¹. Pasi analizuam me kujdes gjendjen e krijuar, vendosëm qëndrimin që duhet të mbajë Hysniu në mbledhje dhe ia komunikuam urgjentisht².

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 2.

2 Po aty, f. 8.

ASNJË LËSHIM REVIZIONISTËVE

U mblohdëm përsëri në Byronë Politike për ngjarjet që po zhvillohen në Bukuresht. Si kurdoherë, pati unanimitet të plotë mendimi.

E orientuam Hysniun për qëndrimin e patundur që duhet të vazhdojë të mbajë në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit e të Partisë Komuniste të Kinës. Nuk duhet t'u bëjmë asnjë lëshim revizionistëve, qoftë edhe sikur vetëm të mbetemi kundër të gjithëve. Qëndrimi ynë është i drejtë, marksist-leninist. Komploti revizionist që është organizuar atje nga Hrushovi duhet shpartalluar!

Ambasadori sovjetik Ivanov, si ai qeni që kërkon të nuhasë, erdhi sot të tatonte pulsën tonë për Bukureshtin. Iku siç erdhi.

TË QËLLOHET PA MËSHIRË KUNDËR REVIZIONISTËVE

Po ndjek çdo orë me radiondërlidhje si venë punët në Mbledhjen e Bukureshtit.

Hysniu më lajmëron se Hrushovi dhe shokët e tij janë bërë si qen të tërbuar kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë sonë. E këshillova Hysniun të qëllojë mbi ta pa mëshirë, t'i demaskojë deri në fund qëllimet e revizionistëve dhe, në emër të Partisë sonë, të mbrojë Partinë Komuniste të Kinës¹.

Situata është serioze, po ne s'jemi nga ata që frikësohemi, sepse lufta jonë është e drejtë.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 24.

FILLOI LUFTA JONË KUNDËR REVIZIONISTËVE TË RINJ E TË MASKUAR

Ambasadori sovjetik Ivanov, i cili, si kurdoherë, synon të tatojë puls të tonë, vazhdon të vijë tek unë, por ikën ashtu siç vjen.

Hysniu u kthye sot nga Rumania dhe na raportoi gjerë e gjatë mbi Mbledhjen e Bukureshtit. Kjo Mbledhje u bë një njollë e zezë në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Hrushovi dhe shokët e tij zbuluan atje fytyrën e vërtetë të tyre prej renegatësh.

Filloi kështu lufta jonë kundër revizionistëve të rinj e të maskuar. Ajo do të zgjatë dhe do të jetë një luftë e vështirë, por ne jo vetëm që s'i trembemi asaj, por kemi bindjen e patundur se do të fitojmë, pse jemi në rrugë të drejtë, marksiste-leniniste.

SOVJETIKËT PËRPIQEN TË TATOJNË ME ÇDO KUSHT PULSIN TONË

Ambasadori sovjetik Ivanov po mundohet vazhdimisht të tatojë puls të tonë në lidhje me Mbledhjen e Bukureshtit. Sot ai erdhi përsëri tek unë dhe u përpoq të mësojë ç'ngjaj në Bukuresht, se gjoja nuk ka akoma informata nga Moska. Por edhe kësaj here ai mori përgjigjen e duhur.

Çdo gjë do të diskutohet e do të zgjidhet në mbledhjen që u vendos të bëhet në Moskë në nëntor të këtij viti.

PËRSE KËTO SHQETËSIME?

Shoku Haxhi dhe Liria erdhën nga Kina.

Liria më raportoi shkurt mua dhe Hysniut për udhëtimin e delegacionit të Presidiumit të Kuvendit Popullor në Kinë, në Vietnam dhe në Kore. Foli edhe për bisedën që kishin pasur me Liu Shao Çinë, e quajti këtë bisedë jo të drejtë nga ana e kinezëve. Tek ajo ka tendencë që të dënojë metodën e bisedimeve të kinezëve, por nuk shprehet hapur për përmbajtjen e bisedimeve me Liun. Çdo gjë që u bisedoi Liu, Liria shkoi dhe e raportoi në ambasadën e Bashkimit Sovjetik në Pekin, gjë që është një gabim i rëndë dhe i dënueshëm. Lirisë këtë ia thamë edhe në letrën që i dërguam posaçërisht.

Liria na vuri, gjithashtu, në dijeni për drekën që hëngri me Brezhnjevin dhe me Kozlovin. Çdo gjë që thotë, tregon shqetësim tek ajo. Diçka s'është në rregull. Të shohim më vonë.

SOV NË MBLEDHJEN E BYROSË POLITIKE

Në mbledhjen e Byrosë Politike, shoku Hysni raporto-i në lidhje me ngjarjet e zhvilluara në Mbledhjen e Bukureshtit. Tani çdo gjë është më se e qartë. Si kurdoherë Byroja Politike është unanime për qëndrimin e mbajtur atje nga shoku Hysni në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Në këtë mbledhje u aprovua gjithashtu edhe teksti i letrës së Komitetit Qendror të Partisë sonë drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë në lidhje me qëndrimet antimarksiste të mbajtura nga ambasadorët e tyre në mitingun e zhvilluar më 4 korrik në Sremska-Mitrovica të Serbisë, ku Rankoviçi, njëri prej krerëve revizionistë të klikës së Beogradit, sulmoi me egërsi Partinë e Punës të Shqipërisë, popullin shqiptar dhe Republikën tonë Popullore. Aprovuam gjithashtu notën e Qeverisë sonë drejtuar qeverisë polake në lidhje me incidentin e rëndë që shkaktoi më 29 qershor në ambasadën tonë në Varshavë një funksionar i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë.

ASNJERIU, KUSHDO QOFTË, NUK I LEJOJMË TË DISKUTOJË PËR KUFIJTË E VENDIT TONË

Prita ambasadorin sovjetik Ivanov, i cili më informoi rreth bisedës që kishte pasur Hrushovi me Sofokli Venizellosin. Gjatë kësaj bisede, ky i kishte propozuar Hrushovit se, për të përmirësuar marrëdhëniet me Shqipërinë, duhet që minoritetit grek në Shqipëri t'i jepet «autonomi». Hrushovi, në mes të tjerash, i ishte përgjigjur Venizellosit, duke i thënë se dëshirën dhe propozimin e tij do t'ia transmetonte «shokëve shqiptarë», pse me ta do të takohej në Bukuresht etj.

I thashë Ivanovit se e kundërshtoj qëndrimin që ka mbajtur Hrushovi, se nuk jam fare dakord me përgjigjen që ai i ka dhënë Venizellosit dhe e konsideroj si përgjigje jo të një miku të Shqipërisë dhe aspak të përshtatshme për postin e lartë që ka Hrushovi. Ne e hedhim poshtë me vendosmëri e indinjatë propozimin e Venizellosit. Për kufijtë e vendit tonë, ne nuk lejojmë asnjëri të diskutojë, qoftë ky edhe Hrushovi!

KURTHET E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË JANË SHUMË TË RREZIKSHME

Bisedova me Lirinë për ta bërë atë që të kuptojë më thellë problemet ideologjike dhe politike që na dalin përpara lidhur me divergjencat që ekzistojnë midis sovjetikëve, nga njëra anë, dhe ne e kinezëve nga ana tjetër. Gjatë bisedës Liria qante e fshante dhe bënte be e rrufe se i kuptonte mirë këto probleme, por biseda me të më forcon akoma më shumë bindjen se ajo është lëkundur në besimin ndaj vijës së Partisë sonë, ka rrëshqitur nga vija jonë e drejtë marksiste-leniniste. Sovjetikët atë e kanë tërhequr dhe e kanë futur në rrugën e tyre të gabuar dhe është rrezik që ajo të shkojë larg.

Ne do të përpiqemi ta shpëtojmë Lirinë, po çështja e saj varet nga fakti se sa thellë është futur ajo në intrigat e sovjetikëve. Prandaj ajo duhet të reflektojë thellë. Letrat që unë i dërgova në Kinë ajo thotë se i ka djegur. Kjo është e çuditshme!

Do të shohim se ku do t'i dalë tymi kësaj pune.

VËREJTJE KRITIKE MBI NJË MATERIAL INFORMATIV TË KQ TË PK TË BS

Lexova me vëmendje të madhe materialin informativ që na e kanë dërguar nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi problemet që kanë lindur midis sovjetikëve dhe kinezëve në sesionin e Këshillit të Përgjithshëm të Federatës Sindikale Botërore në Pekin, në fillim të qershorit 1960. Këtë material sovjetikët ua shpërndanë me qëllim të keq delegacioneve të partive komuniste e punëtore që morën pjesë në Kongresin e 3-të të Partisë Punëtore Rumune.

Pothuajse në çdo faqe të këtij materiali unë kam bërë shënimet e mia kritike, me karakter të përgjithshëm parimor, rreth interpretimit të gjërave nga ana e sovjetikëve; kam bërë vërejtje e sugjerime që duhen mbajtur parasysh nga ana jonë në qëndrimin që duhet mbajtur ndaj këtij materiali dhe gjithë çështjes në përgjithësi.

**DËNOJMË QËNDRIMIN E DIPLOMATËVE SOVJETIKË
PËRPARA SULMEVE ANTISHQIPTARE
TË TITISTËVE**

Thirra ambasadorin sovjetik Ivanov, të cilit i bëra protestën verbale¹ kundër qëndrimit të ambasadorit të Bashkimit Sovjetik në Beograd, Zamçevski, dhe atasheut ushtarak, kolonelit Taraseviç. Ata kanë qenë të pranishëm në një miting që ishte mbajtur në Sremska-Mitrovica dhe nuk kanë bërë as më të voglën protestë, kur banditi revizionist Rankoviç sulmoi Shqipërinë duke e quajtur «skëterrë ku mbretëron teli me gjemba dhe çizmja e kufitarit» dhe se, sipas Rankoviçit, regjimi neofashist italian qenka më demokratik nga regjimi ynë i demokracisë popullore! Ivanovi mori shënim për protestën që i bëra dhe tha se do t'ia transmetojë atë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

(Një notë proteste e tillë iu bë për të njëjtin qëndrim edhe ambasadorit bullgar në Tiranë. Letrat që do t'i dërgonim Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bullgare u vendos të mos dërgoheshin, meqenëse iu paraqitën notat e protestës këtyre ambasadorëve.)

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 33.

**PLENUMI I KQ APROVON QËNDRIMIN
E DELEGACIONIT TONË NË BUKURESHT**

U hap mbledhja e Plenumit të 17-të të Komitetit Qendror të Partisë. Plenumi dëgjoi raportin e shokut Hysni mbi punimet e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtorë që asistuan në punimet e Kongresit të 3-të të Partisë Punëtoare Rumune.

Rreth këtij raporti foli edhe unë¹.

Përkrahje unanime nga gjithë shokët ndaj qëndrimit të drejtë që mbajti Partia jonë në Bukuresht.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 33.

NË PLENUMIN E 17-TË TË KQ TË PPSH

Në Plenumin e 17-të të Komitetit Qendror të Partisë përfunduan diskutimet. Mbajta fjalën e mbylljes¹.

Ne do të shkojmë të flasim në Moskë siç na mëson marksizëm-leninizmi dhe do të flasim vetëm kështu si na porosit Komiteti Qendror, gjuhë tjetër për ne nuk ka.

TAKIM ME AMBASADORIN GJERMAN

Prita ambasadorin gjerman Kurt Princel, i cili largohet nga Shqipëria. Ishte shok i mirë.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 62.

MORIS TOREZI ERDHI NË VENDIN TONË

Sot në orën 12 të natës shkua në Portin e Durrësit dhe pritëm shokun Moris Torez, sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste Franceze dhe të shoqen, Zhanet Vermesh, anëtare e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Franceze, së bashku me djalin e vogël të tyre, Pier Torezin. Erdhën nga Italia për të pushuar në vendin tonë. Ishin shumë të gëzuar, i shoqëruam në vilën e Durrësit. Ata do të qëndrojnë sonte atje.

NJË VEPRIM JO I MIRË I SOVJETIKËVE NDAJ RP TË KINËS

Në takim të mërkurë me ambasadorin sovjetik Ivanov, ky më dha disa informacione dhe kopjen e një letre që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i ka drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, me të cilën e njofton këtë të fundit për tërheqjen nga Kina të specialistëve sovjetikë.

Kjo vepër është një poshtërsi e madhe dhe punë armiqësore nga ana e Hrushovit në dëm të Republikës Popullore të Kinës dhe të popullit kinez. Ivanovit nuk ia zgjata, por i thashë se një veprim i tillë s'është i mirë. «Duhet vepruar me gjakftohtësi në mes miqve dhe shoqëve, duhet mirëkuptim!», — i thashë.

Sot shkua në Durrës, ku hëngrëm drekën së bashku me Torezin. Biseda që zhvilluam ishte e përgjithshme.

Pasdreke miqtë francezë erdhën në Tiranë. Hëngrëm darkën me ta në Pallatin e Brigadave.

BISEDIME ME SHOKËT FRANCEZË

Sot zhvilluam bisedime partie me shokun Moris Torez dhe Zhanet Vermeshin që ndodhen për pushime në vendin tonë. I vumë dhe na vunë në korent për çështjet që kanë të bëjnë me partitë tona. Biseduam për problemet reciproke që na preokupojnë dhe për çdo gjë ishim dakord. Torezi foli me dashuri dhe me admirim për Partinë tonë.

Pastaj folëm dhe shprehëm, të dyja palët, pikëpamjet tona mbi Mbledhjen e Bukureshtit.

Mbi këtë çështje pikëpamjet tona nuk u puqën. Moris Torezi dhe veçanërisht Zhanet Vermeshi bënë kritika joparimore karshi Partisë Komuniste të Kinës. Ne qëndruam në pikëpamjet tona dhe shprehëm shpresën se në Mbledhjen e Moskës gjërat do të zgjidhen drejt.

MIQTË FRANCEZË VIZITOJNË VENDIN TONË

Miqtë francezë po vizitojnë zona të ndryshme të vendit tonë.

TAKIM ME SHOKUN MANUSH MYFTIU

Erdhi shoku Manush për drekë. U kthye nga Çekoslovakia.

TOREZI NË DURRËS

Moris Torezi u kthye në Durrës.

**ME TOREZIN NË KOMBINATIN E TEKSTILEVE
«STALIN»**

Moris Torezi u kthye në Tiranë. Shkuam me të dhe vizituam kombinatin e tekstileve «Stalin». U bë miting i madh. Folëm edhe unë, edhe Morisi. Entuziazëm i madh. U habit.

Në mbrëmje vamë në koncert në Teatrin e Operës dhe të Baletit. Mbeti jashtëzakonisht i entuziazmuar.

NGA QËNDRIMI I TOREZIT NË VENDIN TONË

Moris Torezi u kthye në Durrës dhe unë shkova në Dajt. Atje erdhën Mehmeti me Hysniun.

SOVJETIKËT FILLUAN TË VEPROJNË SI TROCKISTËT JUGOSLLAVË, VIGJILENCË!

Fill pas mbarimit të punimeve të Mbledhjes së Bukureshtit gjithë njerëzit e ambasadës sovjetike kanë filluar të sulmojnë fshehurazi Partinë tonë dhe qëndrimin e saj të drejtë. Veprimet e tyre dhe çdo gjë që bëjnë ata, u përngjasin si dy pika uji veprimeve trockiste të jugosllavëve. Në rrugë antimarksiste ata orvaten të informohen, të hedhin helm, të shpifin, të mbjellin dyshime. Por asgjë nga veprimet e tyre të dënueshme nuk i shpëton syrit tonë. Çdo qëllim të tyre ne e kuptojmë. Kua-drot tanë, pa përjashtim, qëndrojnë lart, janë në nivelin e situatës dhe mbrojnë Partinë e vijën e saj të drejtë. Përgjigjet tona të matura e të pjekura ndaj provokimeve të tyre kanë për qëllim gjithashtu që t'u tregojnë sovjetikëve se e kanë kot që i janë futur kësaj rruge, se ajo është e rrezikshme dhe antimarksiste, prandaj duhet ta braktisin. Ne kemi durim, për hir të miqësisë.

Por njerëzit e Hrushovit e gjetën një të çarë: oportunistin e përhershëm Koço Tashko. Me çështjen e Koços sovjetikët e mbushën kupën. Tani ne do të godasim bankën me grusht. Ambasadori Ivanov dhe shokët e tij e çorën maskën dhe vepruan si agjenturë. Ata e futën në kllapat e tyre Koçon, i cili u tregoi mbi diskutimet dhe vendimet e Plenumit tonë.

Koço Tashkoja tradhtoi Partinë. Edhe pas një bise-

de me mua ai qëndroi në pozita antiparti, armiqësore. Çështja e tij do të shihet më thellë, sepse ai gënjen dhe fsheh të vërtetën, atij i ka hyrë frika dhe belbëzon. E porosita t'i hapet Partisë, po ai refuzoi. I thashë gjithashtu që të mos largohet nga Durrësi dhe të përgatitet se do të thirret të japë llogari në Komitetin Qendror.

Ambasadori sovjetik Ivanov është një trockist, provokator dhe aspak diplomat e njeri partie, por një agjent i sigurimit sovjetik. Duhet të marrim masa që ai të qërohet sa më parë nga vendi ynë.

TOREZIT DO T'I FLAS HAPUR MBI QËNDRIMIN E SOVJETIKËVE

Vendosa t'i flas hapur Moris Torezit, për çka po bëjnë sovjetikët te ne. Nesër do të takohem me të.

TOREZI INDINJOHET NGA VEPRIMET SKANDALOZE TË DIPLOMATËVE SOVJETIKË NË VENDIN TONË

Sot shkova në Durrës, ku u takova dhe bisedova me Moris Torezin për të gjitha poshtërsitë që po bëjnë kundër Partisë sonë ambasadori sovjetik dhe shokët e tij. Ai u indinjua dhe më tha që të mos i lejojmë. Kur i fola atij për masat që kemi marrë për largimin e tyre, ai i vlerësoi ato të drejta, por dyshonte nëse i dinë vallë udhëheqësit sovjetikë këto veprime që bëjnë diplomatët sovjetikë këtu. I thashë që për këtë të mos ketë asnjë dyshim, se çdo gjë bëhet me urdhër nga Moska. Më tej i fola edhe për të gjitha mosmarrëveshjet ideologjike dhe politike që kemi ne me udhëheqjen sovjetike. Ai më dëgjoi me vëmendje dhe u shpreh se ato duhet të rregullohen.

Bindja ime është se Torezi akoma nuk ka filluar të dyshojë për rrugën e tmerrshme në të cilën po e çon Hrushovi Bashkimin Sovjetik. Më vonë do t'i dhembë koka!

TOREZI NË SHKODËR

Moris Torezi dhe shokët e tjerë francezë shkuan sot në Shkodër.

Moris Torezi për të gjitha pozitë të po bëjnë kur-der Partisë sonë ambasador sovjetik dhe shokët e tij. Ai u ndalua dhe me të mos i lejohet. Kur i foli gjithë masat që kemi marrë për largimin e tyre, ai i shpreh ato të drejtat për dyshonte nëse i dinë vëllë udhëheqës sovjetikë këto veprimet që bëjnë diplomatisht sovjetikë këtu. I thashë që për këtë të mos ketë asnjë dyshim, se odo gjë bëhet me urdhër nga Moskë. Me tej i foli edhe për të gjitha masat marrë për largimin e tyre politikë që kemi në me udhëheqës sovjetikë. Ai më dëgjoi me vëmendje dhe u shpreh se ato duhet të rregu-llon.

Bindja ime është se Torezi akoma nuk ka filluar të dyshojë për rrugën e transformimit në të cilën po e çon Hrushovi Haxhinin Sovjetik. Me vonë do të dëshmohet!

DARKE LAMTUMIRE PËR TOREZIN

U ktheva në Tiranë, ku i dhamë darkën zyrtare të lamtumirës Moris Torezit. Në banket fola unë. Pas meje foli edhe ai shumë mirë për Partinë dhe për popullin tonë.

TOREZI U LARGUA NGA VENDI YNË

Moris Torezi e la sot Shqipërinë. E përcollëm në Portin e Durrësit, nga ku, me vapor, u nis për në Bashkimin Sovjetik.

MANOVRA PA REZULTAT TË IVANOVIT DHE TË PADRONËVE TË TIJ

Erdhën e më takuan Mehmeti me Hysniun, të cilët më thanë se Ivanovi qe lutur të kishte një takim me mua, por, në pamundësi që të më takonte mua, shkoi te Hysniu dhe i tha se më ka ftuar të vete të kaloj pushimet në Bashkimin Sovjetik.

I thashë Hysniut t'i transmetojë Ivanovit «falënderim» nga ana ime dhe t'i thotë se sivjet shoku Enver nuk vjen dot për pushime në Bashkimin Sovjetik, sepse ato po i mbaron në Shqipëri. Jam i sigurt që te lutjet dhe ftesat e Ivanovit fshihen përpjekjet për të mbuluar veprimet e tyre antimarksiste e intrigante me Koço Tashkon. Por ne s'i hamë ato!

AMBASADORI SOVJETIK IVANOV U LARGUA NGA VENDI YNË

Ambasadori sovjetik Ivanov u largua nga Tirana. U qërua një njeri i poshtër. Do t'ia zërë sytë qëndrimi ynë shumë shoqëror, të cilin ne e mbajmë vetëm nga dashuria që kemi për Bashkimin Sovjetik dhe jo për këtë qen bir qeni.

Kjo është një fitore kolosale për njerëzimin. Partia e lavdishme e Leninit dhe e Stalinit ka forca të mahnitshme! Po si do të vejë halli i «qenve» që janë në Moskë?

Sot u njoftua se Bashkimi Sovjetik lëshoi anijen e dytë kozmike në orbitën e sputnikut të Tokës me dy qen brenda. Kjo është një fitore kolosale për njerëzimin. Partia e lavdishme e Leninit dhe e Stalinit ka forca të mahnitshme! Po si do të vejë halli i «qenve» që janë në Moskë?

FITORE KOLOSALE PËR NJERËZIMIN

Sot u njoftua se Bashkimi Sovjetik lëshoi anijen e dytë kozmike në orbitën e sputnikut të Tokës me dy qen brenda. Kjo është një fitore kolosale për njerëzimin. Partia e lavdishme e Leninit dhe e Stalinit ka forca të mahnitshme! Po si do të vejë halli i «qenve» që janë në Moskë?

Kjo është një fitore kolosale për njerëzimin. Partia e lavdishme e Leninit dhe e Stalinit ka forca të mahnitshme! Po si do të vejë halli i «qenve» që janë në Moskë?

KORÇË, E SHTUNË
20 GUSHT 1960

ANIJA KOZMIKE SOVJETIKE U KTHYE NË TOKË

Anija kozmike sputnik zbriti në tokë. Kafshët u kthyen të gjalla dhe shëndoshë e mirë. U hap rruga e Kozmosit për njeriun.

17

KORÇË, E DIEL
21 GUSHT 1960

SHQIPËRIA KA ZOT POPULLIN E SAJ

Sot shkova për vizitë në Leskovik ku vizitova edhe shtabin e garnizonit të kufirit. Komandanti i garnizonit më raportoi mbi situatën në kufi. U fola edhe unë kufitarëve mbi situatën dhe mbi detyrat. Pastaj vizitova repartin ushtarak dhe kooperativën bujqësore të Leskovikut.

Duke u kthyer për në Ersekë, u ndala në Borovë, ku vura një buqetë me lule përpara monumentit të dëshmorëve dhe bëra vizita në disa familje fshatarësh.

Në Ersekë, ku hëngrëm drekën, vizitova edhe shkollën e re, shumë të bukur dhe të mbajtur mirë.

Udhëtimi im në këtë zonë kufitare është një përgjigje për monarko-fashistët grekë dhe Venizellosin, si dhe për miqtë e tij të hapët dhe të maskuar.

NE MBROJMË DREJTËSINË MARKSISTE-LENINISTE

Erdhi këtu shoku Mehmet për të parë variantin përfundimtar të letërpërgjigjes që Komiteti Qendror i Partisë sonë do t'i dërgojë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, lidhur me kërkesën e këtij të fundit për një takim të dy partive tona para Mbledhjes së ardhshme të Moskës.

Udhëheqja sovjetike, me Hrushovin në krye, me anë të njerëzve të vet dhe të të huajve që e ndjekin atë në rrugën oportuniste, po komploton kundër marksizëm-leninizmit, Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Kinës. Hrushovi po përgatit ose, si me thënë, kërkon të mbajë frontin që krijoi në Bukuresht kundër nesh. Për këtë qëllim ai përpiket të na tërheqë edhe ne në rrugën e tij, por qëllimit të tij s'do t'ia arrijë kurrë. Letra që i përgatitëm dhe po i dërgojmë, i vë të gjitha pikat mbi «i» dhe afirmon edhe një herë vendosmërinë e Partisë sonë për të mbrojtur drejtësinë marksiste-leniniste.

MAO NA FALËNDERON PËR MBROJTJEN QË I BËMË PK TË KINËS NË BUKURESHT

Takim me ambasadorin kinez Lo Shi Gao, i cili më transmetoi një mesazh nga Mao Ce Duni. Ai më solli përshëndetjet e Maos dhe më falënderoi nga zemra në emër të tij, të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe të popullit kinez për qëndrimin e vendosur, marksist-leninist dhe heroik të Partisë së Punës të Shqipërisë në mbrojtje të Partisë Komuniste të Kinës në Bukuresht. Mao Ce Duni, në emër të Partisë Komuniste të Kinës dhe të popullit kinez, siguron përkrahjen me çdo mënyrë dhe në çdo kohë për popullin vëlla shqiptar dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë.

E falënderova dhe i fola ambasadorit kinez për çështjet tona të përbashkëta, i shpjegova se si i ka kuptuar e i ka zbatuar dhe si do t'i zbatojë ato Partia jonë edhe në të ardhmen dhe i theksova se ajo do t'i qëndrojë besnike marksizëm-leninizmit.

BISEDË ME SHOKUN RAMIZ ALIA

Bisedova me Ramizin lidhur me përgatitjen tonë për në Mbledhjen e partive komuniste dhe punëtore në Moskë.

Me të diskutuam gjithashtu edhe për botimin e një artikulli kundër pretendimeve të Sofokli Venizellosit.

**MBI KORRESPONDENCËN TONË ME KQ
TË PK TË BS**

Vazhdojnë punimet e Plenumit të 18-të të KQ të Partisë. Në seancën e sotme, përpara se të flisnim për çështjen e Liri Belishovës, e informova Plenumin mbi korrespondencën që është zhvilluar midis Komitetit tonë Qendror dhe Komitetit Qendror të PK të Bashkimit Sovjetik, lidhur me akuzat e rënda që i drejtohen PK të Kinës¹.

¹ 1 Enver Hoxha, Vepra, vëll. 19, f. 168.

PARAQITËM NGUSHËLLIME PËR VDEKJEN E PIKUT

Shkuam në ambasadën e RD Gjermane për të ngushëlluar për vdekjen e Vilhelm Pikut¹, personalitet i vjetër i lëvizjes komuniste punëtorë ndërkombëtare, udhëheqës i shquar i shtetit të parë demokratik popullor gjerman dhe mik i madh i popullit tonë.

1 Në atë kohë president i Republikës Demokratike Gjermane.

DEBAT POLITIK ME AMBASADORIN BULLGAR

Shkova në pritjen e dhënë nga ambasada e RP të Bullgarisë me rastin e festës kombëtare të popullit bullgar, ku edhe përshëndeta. Atje pata një debat politik me ambasadorin bullgar¹, i cili më bëri pyetje mbi Mbledhjen e Bukureshtit dhe njëkohësisht kërkoi të shfaqësohej për qëndrimin që ka mbajtur ambasadori i tyre në Beograd në mitingun në Sremska-Mitrovica, ku banditi Rankoviç sulmoi vendin tonë. Nga unë mori përgjigjen e duhur.

1 Vëllko Shivarov.

HRUSHOVI DHE KOLEGËT E TIJ E SHTOJNË PRESIONIN MBI NE

Hrushovi dhe kolegët e tij po e tregojnë çdo ditë e më shumë armiqtësinë që ushqejnë prej kohësh ndaj nesh. Për arsye të thatësirës katastrofale të sivjetme, me kohë u kemi kërkuar drithë sovjetikëve, bullgarëve, rumunëve. Sovjetikët na janë përgjigjur se do të na japin por një të pestën e sasisë së kërkuar, bile edhe këtë pas nëntorit. Ky qëndrim i tyre do të thotë presion mbi ne. Bullgarët na dhanë një të tretën e kërkesës, kurse rumunët, sido që sivjet eksportojnë drithë në Perëndim, nuk na dhanë asnjë kokërr.

SHOKU MEHMET U NIS PËR NË NJU-JORK

Mehmeti u nis për në Nju-Jork, në krye të delegacionit tonë, që do të marrë pjesë në punimet e Sesionit të 15-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Bashkë me shokët e tjerë, e përçolla edhe unë në aerodrom.

KINA PRANON TË NA JAPË DRITHËRA

Kërkesa jonë për drithë u pranua nga Kina. Ajo na plotësoi gjithë sasinë e bukës që i kërkuam. Kurse Bashkimi Sovjetik e la popullin tonë pa bukë dhe këtë krim e bënë Nikita Hrushovi dhe Mikoiani.

U kthye Gogoja nga Republika Demokratike Gjermane.

TAKIM ME AMBASADOREN GJERMANE

Prita në vizitë protokollare ambasadoren e Republikës Demokratike Gjermane, Ane Kunderman.

SHOKU MEHMET ARRITI NË NJU-JORK

Mehmeti mbërriti në Nju-Jork ku do të marrë pjesë në punimet e Sesionit të 15-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

U kërye Gogoja nga Republika e Greqisë

BISEDË ME AMBASADORIN KINEZ

U takova me ambasadorin kinez Lo Shi Gao, me të cilin biseduam mbi mosmarrëveshjet e mëdha ideologjike midis nesh dhe udhëheqjes sovjetike.

PËRGATITEMI PËR MBLEDHJEN E MOSKËS

Po përgatitemi për Mbledhjen e partive komuniste e punëtore të Moskës.

SHOKËT HYSNI DHE RAMIZ NISËN PËR NË MOSKË

Shokët Hysni dhe Ramiz u nisën për në Moskë, për të marrë pjesë në punimet e Komisionit përgatitor të Mbledhjes së partive komuniste e punëtore të Moskës.

TAKIM ME AMBASADORIN KINEZ

Takim me ambasadorin kinez Lo Shi Gao.

SKENA TRAGJIKOMIKE ME AKTORË HRUSHOVIN DHE TITON

Mehmeti më njofton shpesh për ngjarje me të vërtetë të çuditshme e të ulëta, por edhe zbavitëse që ndodhin në sallat e OKB-së me Hrushovin. Dje ai më shkruante me radiogram se si Hrushovi, në mënyrë demonstrative, ka shkuar te delegacioni jugosllav për të përshëndetur Titon dhe, duke i rënë krahëve me buzë në gaz, i është lutur të dalin në fotografi së bashku.

Gazetat e Nju-Jorkut nuk kanë munguar ta botojnë këtë fotografi menjëherë e brenda ditës. Në to Hrushovi, i qeshur e me dashamirësi, duket i përlulur para Titos, kurse ky, me fytyrë të vrenjtur e të rëndë prej padroni, pa e shikuar fare në sy, zgjat dorën.

Të drejtë ka Mehmeti që këto gjëra i quan skena tragjikomike.

«PARABOMBAT» TONA PËR UDHËHEQJEN SOVJETIKE

Mora pjesë në pritjen e dhënë nga ambasadori kinez me rastin e festës kombëtare të Republikës Popullore të Kinës. Në fjalën e përshëndetjes që mbajta me këtë rast hodha «parabombat» e para kundër pikëpamjeve të udhëheqjes sovjetike dhe mbrojta pikëpamjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, natyrisht pa përmendur kërkënd dhe as Mbledhjen e Bukureshtit. Por, megjithatë, çdo gjë ishte e kuptueshme¹.

Siç njoftojnë agjencitë e lajmeve, Hrushov pehlivani po bën estradë në OKB. Qëndrimet dhe gjestet e tij nuk janë aspak serioze dhe dinjitoze.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 268.

TEZA MBI KATËR PROBLEME THEMELORE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT

Këto ditë po hedh në fletore disa teza ideopolitike mbi katër probleme themelore të marksizëm-leninizmit, rreth të cilave ne kemi kundërshtime të thella parimore me revizionistët e të gjitha ngjyrave dhe për të cilat do të na duhet të diskutojmë e të luftojmë në Mbledhjen e Moskës.

a. — Mbi epokën tonë

1. — Nga ana e Hrushovit është shpifur se gjoja ne shohim një rën të epokës sonë, dhe nuk kuptojmë ndryshimet në botë në favor të forcave të socializmit.

— Ne kurrsesi nuk mund të pranojmë këtë shpifje të sovjetikëve.

— Metoda e veprimit e sovjetikëve është jashtë moralit komunist, është denigruese.

2. — Teza se, me gjithë ndryshimet në botë, «leninizmi nuk është vjetruar» është e drejtë. Këtë e thonë tash edhe kinezët. Atëherë përse Hrushovi na godet?

Prandaj teza e kundërt e revizionistëve duhet luftuar.

3. — Teza e Deklaratës së Moskës se përmbajtja themelore e epokës sonë «është kalimi nga kapitalizmi në socializëm, që filloi me Revolucionin e Tetorit, është epoka e luftës së dy sistemeve shoqërore të kundërta, epoka

e revolucioneve socialiste dhe e revolucioneve nacionalçlirimtare, epoka e shembjes së imperializmit etj.».

— Duhet mbrojtur dhe zhvilluar pa asnjë lëshim teza se vetëm nëpërmjet revolucionit proletar dhe diktaturës së proletariatit mund të realizohen transformimet socialiste etj. (Sovjetikët me pikëpamjet e tyre revizioniste do të përpiqen t'i bëjnë bisht kësaj.)

4. — Lufta kundër revizionizmit modern. Asnjë lëshim.

— Tezat e Hrushovit që e bëjnë atë të largohet nga marksizëm-leninizmi dhe Deklarata e Moskës:

a) «Që në kohën e tanishme krijohet mundësia reale për të përjashtuar përfundimisht dhe përgjithnjë luftën nga jeta e shoqërisë».

b) «Vendosja e paqes», «bota pa ushtri dhe pa armë»... «Dita nuk është e largët kur bota do të bëhet e tillë» etj. Viti 1960 do të hynte në histori si «viti i fillimit të realizimit të ëndrrës shekullore të njerëzimit mbi botën pa armë, pa luftëra».

— **Pikëpamjet tona (shkurt):**

— Bota pa armë, pa ushtri mund të jetë vetëm një botë pa shtete.

— Vetëm kur proletariati të ketë çarmatosur borgjezinë.

— Borgjezia armët nuk i hedh, pse duam ne, por duhet ta detyrojmë atë për këtë. Me çfarë? Me fjalë, apo me mënyra revolucionare? Pikërisht me këto të dytat.

— **Tezat e Hrushovit (vazhdim):**

c) Eksporti i kapitalit nga shtetet imperialiste nuk shërben si mjet grabitjeje dhe shtypjeje për popujt.

d) Kapitali monopolist do të përpiqet të përmirësojë jetën e punonjësve.

— Qarqet drejtuese imperialiste dhe udhëheqësit e

tyre, ashtu sikurse edhe udhëheqësit e vendeve socialiste, do të synojnë drejt paqes dhe kështu të sigurojnë besimin absolut të popujve të tyre.

— Zbukurimi i imperializmit dhe lëvdatat për Ajzenhauerin, Makmilanin e Dë Golin.

e) Individët zgjidhin çdo gjë, njerëzit e mëdhenj qëndrojnë mbi klasat.

— Epoka e re, fryma e Kemp Dejvidit etj.

ë) «Në epokën tonë lufta politike mund të shuhet», dhe në fakt nga Hrushovi e pasuesit e tij flitet shumë pak ose aspak kundër imperializmit.

— Luftë ideologjike dhe garë paqësore.

f) Në kohën e sotme «nga një shkëndijë e vogël mund të shpërthejë lufta botërore». Kjo do të thotë se qeveria sovjetike kundërshton çdo lloj lufte, pra edhe luftërat nacionalçlirimtare.

— Luftërat e drejta dhe luftërat e padrejta.

Konkluzion (sipas Hrushovit):

— Natyra e imperializmit ka ndryshuar. Nuk ekzistojnë kontradikta të pakapërcyeshme në gjirin e imperializmit.

— Mund të hiqet dorë nga revolucioni proletar dhe diktatura e proletariatit.

— Imperializmi mund të integrohet në mënyrë paqësore në socializëm.

— Është vjetruar teoria marksiste-leniniste mbi luftën e klasave, mbi shtetin, mbi revolucionin proletar, mbi diktaturën e proletariatit, mbi revolucionin në kolonitë e gjysmëkolonitë.

— Mund të ndalohej lufta botërore. Kjo bëhet aktuale me shpikjen e armës bërthamore.

Pikëpamja jonë:

— Në të vërtetë, siç na mëson marksizëm-leninizmi dhe në kundërshtim me pretendimet e Hrushovit, përderisa ekziston imperializmi, nuk mund të thuhet se ek-

ziston mundësia reale të krijohet «bota pa armë, pa ushtri e pa luftëra».

— Nuk mund të thuhet se reaksioni do të interesohet për mirëqenien e popujve.

— Nuk është reale të thuhet se vendet socialiste, sipas dëshirës së tyre, mund të drejtojnë të gjitha veprimet e imperializmit.

b. — Mbi çështjen e luftës dhe të paqes

Mbi çështjen e luftës dhe të paqes ne kemi mbrojtur:

— Mundësinë e ndalimit të luftërave botërore.

— Lufta nuk është e pashmangshme. Jemi për demaskimin e imperializmit luftënxitës, për demaskimin e revizionizmit, kundër garës së armatimeve, kundër pakteve agresive. Kemi mbrojtur e do të mbrojmë luftërat e drejta të popujve kolonialë dhe gjysmëkolonialë.

— Kemi bërë thirrje për të ngritur vigjilencën.

— Kemi luftuar për uljen e tensionit në botë.

— Kemi mbrojtur çështjen e bashkekzistencës leniniste.

— Në kushtet e sotme teza sovjetike «Lufta për ndalimin e luftës», mbi ndalimin e të gjitha luftërave, mbi zhdukjen e të gjitha armatimeve, mbi realizimin e «botës pa armë» etj. është një iluzion i rrezikshëm.

— Teza e sovjetikëve rreth «epokës pa luftëra, pa ushtri e pa armë» etj. dhe se «shtetet imperialiste do t'i përdorin fondet e krijuara nga çarmatimi për të mirën e punonjësve», teorikisht është antimarksiste, praktikisht është një zero.

— Këto janë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin, me Deklaratën e Moskës, bien erë oportuniste dhe i sjellin dëm luftës së popujve për çlirim.

— Mundësia e ndalimit të luftës dhe mundësia e shpërthimit të luftës.

— Sovjetikët theksojnë vetëm, ose më shumë, të parën.

— **Ne:** të dyja.

— Sovjetikët thonë: «Të mos i tremnim popujt!»

— **Ne** u tregojmë popujve rrezikun dhe u bëjmë thirrje të jenë vigjilentë.

— **Ne** i përmbahemi Deklaratës së Moskës; sovjetikët largohen nga ajo.

— Pyetje: **A mund të ndryshojë natyra e imperializmit, a është zhdukur rreziku i luftës për shkak «të ndryshimit të raportit të forcave»?**

Përgjigjja për të dyja:

— Jo! — për ne.

— Po! — për sovjetikët.

— **Në cilat forca duhet të mbështetemi për ndalimin e luftës?**

Ne:

— Në mobilizimin e popujve dhe në forcën e tyre. Sovjetikët:

— Në «arsyen», «qëllimet e mira» e në «urtësinë» e krerëve të imperializmit.

— Të mos ngjiste kjo që ngjau në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Bukureshti. Heqja e specialistëve nga Kina. Qëndrimet karshi nesh.

— Duhej t'i jepej ndihmë aktive luftës së popujve për t'u çliruar.

— Iluzionet e Hrushovit mbi suksesin e mbledhjeve të nivelit të lartë.

— Shantazhi atomik, sovjetikët kanë rënë brenda.

— Urrejtje kundër të gjithë armiqtë dhe në raste konkrete të tregojmë vëmendje serioze. **(Teza jonë.)**

Konkluzion:

— Sovjetikët janë larguar nga Deklarata e Moskës. Ata e vlerësojnë gabim raportin e forcave tona dhe atë të armiqtë tanë.

c. — Mbi bashkekzistencën paqësore

Teza sovjetike: në konditat e bashkekzistencës me imperializmin mund të realizohet paqja e përgjithshme dhe bota «pa armë, pa ushtri, pa luftëra». (Tezë kundër Deklaratës së Moskës dhe marksizëm-leninizmit.) Në Deklaratën e Moskës (1957) thuhet:

— «Përderisa ekziston imperializmi do të mbetet edhe baza për luftëra agresive».

— Teza jonë:

— «Përderisa ekziston imperializmi do të mbetet edhe baza për luftëra agresive».

— «Akoma ekziston imperializmi prandaj është e pamundur të realizohet paqja dhe «bota pa armë, pa ushtri dhe pa luftëra»».

Deklarata kategorike e Hrushovit: «ose bashkekzistencë, ose luftë botërore», nuk i përgjigjet realitetit.

— **Politika e aleancave dhe e luftës me borgjezitë nacionale.**

Ne: aleancë me ta për të dobësuar frontin imperialist, për të mbrojtur paqen, por luftë kur ata na sulmojnë dhe kur ngrihen kundër luftës së klasave, luftës së proletariatit dhe luftës që bëjnë partitë komuniste vendase.

— Lajkat, përkrahjet e ndihmat e kësaj borgjezie janë të dëmshme e të rrezikshme.

Ç'do të thotë bashkekzistencë?

Ne qëndrojmë në tezat leniniste:

1) Të mos shpërthejë luftë e karakterit ndërkombëtar.
2) Të vendosen marrëdhënie të mira ndërkombëtare në bazë të pesë parimeve të njohura të bashkekzistencës paqësore.

3) Të zhvillohet luftë politike.

4) Asnjë pajtim ideologjik.

5) Të ruajmë fuqinë mbrojtëse (derisa nuk bëhet çarmatim) dhe të jemi vigjilentë.

Teza e sovjetikëve:

— Lufta ndërmjet dy sistemeve të shkrihet në luftën ndërmjet dy ideologjive dhe në garën paqësore ekonomike midis tyre (Hrushovi).

— Nuk ekziston luftë politike.

— U zhduk natyra agresive e imperializmit.

— Bashkekzistenca paqësore: forma më e lartë e luftës së klasave në mes dy sistemeve.

(Dy avionët amerikanë që u rrëzuan. Çfarë forme lufte klase është kjo, e lartë apo e ulët, në krahasim me bashkekzistencën paqësore?)

— Bashkekzistenca — vijë e luftës së popujve të vendeve kapitaliste (tezë sovjetike).

Rëndësia e bashkekzistencës:

— Popujt janë të interesuar që të mos bëhet luftë botërore, por ata duhet të luftojnë për të dobësuar prapavijat e imperializmit.

— Çlirimi i popujve është rezultat i luftës heroike të popujve të këtyre vendeve kundër imperializmit dhe kolonizatorëve.

— Hrushovi me teorinë e tij revizioniste pengon luftën e popujve, luftën e klasave.

Me kë duhet të bashkekzistojnë kombet e shtypura?!

— Ato kurdoherë duhet të jenë në luftë revolucionare, pse vetëm kështu shpejtojnë çlirimin e tyre, dobësojnë imperializmin, krijojnë mundësinë, si shtete të pavarura, me kë të bashkekzistojnë, forcojnë luftën për bashkekzistencën dhe largojnë shpërthimin e luftës botërore. Tjetër rrugë nuk ka. Rruga e Hrushovit është revizioniste. Bashkekzistencë me çdo kusht, siç do Hrushovi, do të thotë revizionizëm, do të thotë t'i dorëzohesh në çdo gjë imperializmit, pra, të kesh frikë prej tij, pse fundi i fundit je me të.

— **Konkluzion:** sovjetikët janë larguar nga marksizëm-leninizmi, nga Deklarata e Moskës.

d. — Çështja e kalimit paqësor në socializëm

— Në Kongresin e 20-të Hrushovi shpalli marrjen e pushtetit në rrugë paqësore duke u larguar kështu nga marksizëm-leninizmi. Ashtu si e shtron ai çështjen, del se proletariati, pa e vendosur pushtetin politik mund të bëjë shoqërizimin socialist ose shtetëzimin e mjeteve të prodhimit. Utopi?! Që nga lindja e marksizmit çdo pikëpamje «utopike» nga ana e këtyre lloj komunistëve, është në fakt revizionizëm.

— Lihet mënjandë çështja e vendosjes së diktaturës së proletariatit.

— Lihet mënjandë çështja e shkatërrimit të makinës ushtarake e burokratike të shtetit borgjez.

— Borgjezia në asnjë mënyrë nuk heq dorë nga pushteti. Prandaj çështja duhet shtruar: të dy rrugët, por më parë dhe më reale është marrja e pushtetit me anën e forcës, domethënë në rrugë revolucionare.

— Teza e Hrushovit: «Bota pa armë, pa ushtri, pa luftë» (pra vetëm kalim paqësor), edhe në këtë fushë është tezë antimarksiste.

— **Marrja e pushtetit, diktatura e proletariatit. Revolucion.** — Çështja kryesore.

NE DHE REVIZIONISTËT

1) Mbi vlerësimin e epokës aktuale (teza — vazhdim).

a) Raporti i forcave ka ndryshuar në botë, në favor të socializmit.

b) Imperializmi po dobësohet, po kalbëzohet, por ai

mbetet kurdoherë agresiv, dhe është burimi i rrezikut të luftës. Domethënë ruhet baza ekonomike e politike për shpërthimin e luftërave. Pra forcat reaksionare do të përpiqen edhe në të ardhmen të shkojnë në aventura. **(Teza leniniste s'është vjetruar. Atëherë pse akuzohen partitë marksiste-leniniste që thonë se epoka jonë është epoka e luftërave, epoka e revolucioneve socialiste?)**

c) Epoka e sotme është epoka e revolucioneve nacionalçlirimtare, e likuidimit të sistemit kolonial, pra epoka e revolucioneve demokratiko-borgjeze në vendet që vuanin nën sundimin e imperializmit. Në këto vende duhet të zhvillohet më tej revolucioni, deri në vendosjen e diktaturës së proletariatit, domethënë kalimi nga kapitalizmi në socializëm. **Atëherë pse gabokan partitë tona kur thonë se epoka e sotme është epoka e revolucioneve? Kjo po ngjet, dhe do të ngjasë në epokën tonë. Tezat e Leninit nuk ndryshojnë dhe nuk janë vjetruar aspak.**

d) Partia jonë dhe Partia Komuniste e Kinës nuk kanë pretenduar se imperializmi nuk është dobësuar, dhe nuk shkon duke u dërrmuar. Por, partitë tona kanë thënë se socializmi po ngjitet, po forcohet, po dominon dhe do të dominojë. **Atëherë pse akuzohemi se gjoja nuk e shikojmë realisht zhvillimin e epokës sonë? Këto janë shpifje kundër nesh dhe Kinës, që bëhen për të fshehur pikëpamjet revizioniste të akuzuesve, dhe këtë do ta shohim më vonë, në zbatimin në jetë të parimeve të drejta leniniste.**

e) Sovjetikët e shtrojnë problemin: Munden apo nuk munden forcat e imperializmit, në konditat e tanishme, të realizojnë qëllimet agresive, ashtu siç mund të thuhej gjysmë shekulli më parë?

Kështu, siç vihet pyetja, mund t'i përgjigjemi me plot bindje se nuk munden. Kjo është një e vërtetë evidente. **Nga ana jonë, problemi, si teorikisht ashtu edhe praktikisht, shtrohet sipas pikës b, domethënë:**

— Imperializmi edhe pse po kalbëzohet e po shembet, mbetet agresiv dhe mund të shpërthejë luftëra të reja. Për këtë ekzistojnë baza etj., etj. Vlen të theksohet se në «shënime informative» (citata të Hrushovit), ai heziton të thotë se cilat forca në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francë etj., do të influencojnë në çështjen e madhe të luftës apo të paqes: qarqet reaksionare, apo korrentet paqësore.

— Konkluzionet kryesore teorike për sovjetikët ekzistojnë në letër. Tezat e Leninit mbi këtë çështje janë aktuale, ato nuk janë vjetruar, ato udhëzojnë dhe parashikojnë zhvillimin e ardhshëm. Sovjetikët i reklamojnë këto teza, por në praktikë, duke u fshehur prapa tyre, i kanë shtrembëruar, i kanë revizionuar.

Shpifjeve dhe devijimit revizionist të Hrushovit në këtë kapitull të «shënimeve informative» të tij duhet t'u vëmë përballë fakte konkrete nga arsenali i fjalimeve të tij dhe pelegrinazhet e tij të ndryshme.

Problemi i garave në mes dy sistemeve.

Dihet rruga e zhvillimit të sistemit tonë socialist. Ajo është e drejtë, paqësore, progresive.

Po sistemi kapitalist në ç'drejtim zhvillohet dhe pse zhvillohet në këtë drejtim? Ç'kuptim ka gara me të? Sa kemi influencuar që të ndryshojë ky drejtim?

Deri tash propozimet paqësore të Bashkimit Sovjetik janë hedhur e po hidhen poshtë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përkundrazi, ato po armatosen dhe po shkojnë çdo ditë e më shumë drejt militarizimit të ekonomisë.

Përpara një gjendjeje të tillë shtohet apo pakësohet rreziku i luftës?

A kanë hequr dorë imperializmi dhe kapitalizmi nga përpjekjet e tyre me armë për të dominuar botën, për të shkatërruar sistemin tonë socialist, për të vendosur një formë tjetër të re të sundimit kolonial? Në rast se jo,

atëherë, kur dhe me ç'forma, me ç'metoda do ta bëjë këtë? Me forma paqësore, apo agresive? Ç'na tregojnë ngjarjet aktuale, ndërhyrjet e shpeshta të imperialistëve në njërin apo në tjetrin skaj të botës, pavarësisht nëse kanë ose jo sukses?

A mundet dhe a duhet përpara një situatë të tillë ta trajtojmë çështjen në mënyrë kaq të lehtë, siç bëjnë hrushovianët, duke nënçmuar parimet e drejta marksist-leniniste? Pse të mos e trajtojmë problemin e madh aktual në bazë të zhvillimit real të situatës ndërkombëtare?

Përpara rritjes së forcës së kampit tonë socialist, të lëvizjeve nacionalçlirimtare dhe të lëvizjes së paqes, ç'po bën imperializmi? Po hedh armët, po zbythet, po zbutet, po heq dorë nga agresiviteti, apo po egërsohet, po armatoset? etj.

Nuk është çështja për të mbivlerësuar forcën aktuale të imperializmit, por teza e Stalinit, që sa më të fortë të bëhemi ne, aq më i egër dhe më agresiv bëhet imperializmi që jep shpirt, nuk mund të hidhet poshtë.

Të supozojmë se imperializmi edhe blufon, edhe bën shantazhe e frikësime. Ne nga këto jo vetëm që nuk frikësohemi, por duhet t'i qëndrojmë si duhet, me superioritetin tonë t'i demaskojmë veprimet e tij, ta dobësojmë, ta dërrmojmë jo vetëm me formula teorike, por, në radhë të parë, me veprime taktike.

Përcaktimi real i përgjithshëm i epokës sonë, duhet bërë duke u bazuar në studimin krijues të marksizëm-leninizmit. Kjo është kryesorja. Por shumë rëndësi ka çështja e strategjisë dhe e taktikës që duhet të ndjekim në lidhje me triumfin e kauzës sonë, në lidhje me dobësimin dhe me shembjen e mëtejshme të imperializmit.

Sipas pikëpamjes së Hrushovit kjo gjë aktualisht po bëhet. Për këtë, sipas tij, nuk ka dhe nuk lejohet diskutim. Kush thotë pikëpamjen e vet kundër kësaj, atë-

herë ai cilësohet «dogmatik», «sektar», «shovinist», «nationalist» etj.

Në strategjinë dhe në taktikën e Hrushovit ka oportunizëm të theksuar, ka lëkundje të tmerrshme nga e djathta në të majtë, ka aventurizëm, ka mbjellje dyshimesh e përçarje, ka kërcënime bajate, ka afrime, lajka të palejueshme karshi imperialistëve, ka pajtim me revizionistët jugosllavë etj. Të gjitha këto ide duhet të konkretizohen dhe të ilustrohen me fakte nga arsenalu i fjalimeve dhe i korrespondencave të Hrushovit, të cilat janë me volume të tëra.

2) Mbi çështjen e luftës dhe të paqes

Derisa pranojmë se ekziston rreziku i luftës, baza për luftëra, si dhe aventurierë për të bërë aventura, teza e kinezëve është e drejtë.

Por që ne duhet të luftojmë që t'ua zvogëlojmë, derisa t'ua ndalojmë këtë mundësi armiqve, edhe kjo është e drejtë. Ne besojmë dhe dëshirojmë që Partia Komuniste e Kinës të mos thotë e të mos mendojë të kundërtën.

Do t'ia arrijmë këtij qëllimi? Nga ne varet shumë, por ndalimi qind për qind i luftës agresive s'varet vetëm nga ne. Deri tash imperializmi nuk ka bërë dhe nuk po bën asnjë lëshim, përkundrazi po shton armatimet, përgatitet për luftë etj.

Do të ketë apo nuk do të ketë luftë, **këtë duhet ta shohim në varësi me vendosjen e diktaturës së proletariatit** në gjithë botën ose në shumicën e vendeve të botës. Do të vendoset kjo në rrugë parlamentare apo me mjete revolucionare, në mënyrë paqësore, apo me luftë civile, varet nga rezistenca e borgjezisë, por ne duhet të përgatitemi për rrugën më të vështirë.

Përse ne duhet të krijojmë në masat idenë se im-

perializmi absolutisht «nuk do të mund të bëjë luftë»? Luftën agresive e shpërthejnë vetëm imperialistët. Po të bëhet çarmatimi i plotë, atëherë mund të thuhet me plot gojë se luftërat nuk janë fatale e se luftëra të përgjithshme nuk do të ketë, ndërsa luftëra civile, konflikte lokale do të ketë. Por sa dekada ka që po flitet për çarmatimin dhe ç'është arritur?!

Ç'kuptim kanë gjithë këto përgatitje të imperializmit? A nuk është aktualisht Pentagoni ai që do të vendosë të shpërthejë luftën, në rast se imperializmit për interesat e tij do t'i duhet ta hedhë botën në një konflikt të përgjakshëm?

Kështu thotë Partia Komuniste e Kinës dhe që këtej Hrushovi me shokë dalin me konkluzionin se Partia Komuniste e Kinës «mbivlerëson imperializmin dhe nënvleftëson forcën e kampit socialist». Ne te thëniet e PK të Kinës nuk shohim ndonjë gjë të gabuar.

Luftën do ta ndalojë forca morale, politike, ekonomike, ideologjike dhe ushtarake e kampit socialist. Luftën do ta ndalojë lufta për paqen e të gjithë popujve të botës. Dakord, por kjo luftë kundër luftës nuk duhet bërë vetëm me fjalë, por politikisht, moralisht dhe sidomos duke luftuar për të dobësuar imperializmin dhe kapitalizmin, duke e paralizuar atë, duke e demaskuar politikisht, ideologjikisht dhe moralisht deri në zhdukjen e tij.

Një luftë të tillë mund ta udhëheqë me konsekuencë vetëm klasa punëtore dhe partia komuniste, që është pararoja e saj, në të gjitha vendet kapitaliste. Forca e kampit tonë duhet ta aktivizojë dhe ta ndihmojë këtë zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk duhet ta frenojë dhe as të ngjallë fatalizmin. Të veprosh siç po bën Hrushovi do të thotë të bësh punë revizioniste, antimarksiste.

Deklarata e Moskës thotë se komunistët e shikojnë luftën për paqe si detyrën e tyre të dorës së parë.

— Por çfarë taktike duhet të ndjekin komunistët për këtë?

Të flasin fjalë të mira dhe të presin fikun të bjerë nga pema, apo të luftojnë, siç thamë më lart? Shokët sovjetikë këshillojnë rrugën revizioniste. Nuk është e vërtetë se popujt çmobilizohen po t'u thuash ku qëndron forca e tyre, si duhet të luftojnë për paqen dhe kundër imperializmit, ku është rreziku i luftës etj.

— Armiku do prapavija të qeta.

— Armiku përgatit luftën.

— Ne duhet të veprojmë pikërisht për të arritur të kundërtën e këtyre qëllimeve të imperializmit.

3) Mbi bashkekzistencën paqësore dhe luftën e klasave në vendet kapitaliste

— Si forcohet socializmi dhe si zhvillohet e ashpërsohet lufta e klasave në vendet kapitaliste, po të ndjekësh tezën pacifiste të Hrushovit?

— Ç'qëndrim dhe çfarë ndihme do t'i japë kampi ynë kësaj lufte klasash në vendet kapitaliste, në kuadrin e bashkekzistencës paqësore ala hrushoviane?!

— Si do të reagojë borgjezia imperialiste përpara luftës së klasave në vendet e saj dhe ndihmës së kampit socialist? Mos do të na buzëqeshë e do të na thotë «faleminderit»?! Jo, do të tërbohet.

— Çfarë do të katandiset, pra, «bashkekzistenca paqësore» e trumbetuar nga Hrushovi?

— Ç'qëndrim do të mbajë Hrushovi përpara ashpërsimit të luftës së klasave në Indi, në Indonezi? Ç'qëndrim do të mbajë ai kur borgjezia indiane të godasë grevat, partinë, kur të burgosë komunistët?

— Ndihma «bujare» e Hrushovit dhënë Indisë for-

con, apo dobëson borgjezinë indiane, dhe a është e drejtë të tregohemi kaq bujarë?

— Parimi leninist i bashkekzistencës është i drejtë edhe tash, por ashtu si e ka formuluar Lenini dhe si e ka zbatuar ai e jo si e trajton dhe si e zbaton Hrushovi.

— Teza e Hrushovit: «O bashkekzistencë, o luftë», nuk është e drejtë. Ajo është kapitulluese.

— Teza e bashkekzistencës leniniste: luftë ideologjike, luftë politike, garë ekonomike, luftë e klasave, luftë nacionalçlirimtare.

— Luftë për paqen, për çarmatim (por vallë kur do të arrihet?!). Prandaj ne duhet të jemi më të fortë se armiqët, të bëjmë gjithçka për evitimin e luftës ndërimperialiste e agresive dhe po ta shpallin ata luftën, t'i shpartallojmë.

— Teza e Hrushovit do të thotë të zbathim brekët që të mos bëhet luftë. Kjo është revizioniste.

— Nuk është vetëm «revolucion i teknik-ushtarak» ai që na bën të ndjekim politikën e bashkekzistencës.

— Bashkekzistenca e vërtetë, në rrugë marksiste-leniniste, ua lehtëson forcave revolucionare, klasës punëtore, partive komuniste të vendeve kapitaliste luftën kundër kapitalizmit për çlirimin shoqëror. Por, ashtu siç trajtohet e shtrohet ajo nga Hrushovi dhe pasuesit e tij, nuk është e drejtë.

E DIEL

2 TETOR 1960

**PROJEKTDEKLARATË REVIZIONISTE
E PAPANUESHME**

Po lexoj e po studioj projektdeklaratën e Mbledhjes së 81 partive komuniste e punëtore. Ky projekt, që është paraqitur nga sovjetikët, ka shtrembërime, konkluzione e terma të rinj revizionistë hrushovianë, përmban shumë pikëpamje të gabuara për çështje themelore të ideologjisë sonë marksiste-leniniste si mbi karakterin e epokës, mbi çështjen e luftës dhe të paqes, mbi bashkekzistencën paqësore, mbi rrugët e kalimit në socializëm. Në shumë vende përmban sulme të maskuara kundër nesh duke na akuzuar, midis të tjerave, për «komunizëm nacional», për «fraksionizëm», na krahason me Jugosllavinë e të tjera.

Në përgjithësi projekti ka frymë të butë, oportuniste. Për mendimin tim, sikurse kam shkruar në faqen 7 të kopjes së projektit, kjo komunikatë ose deklaratë, si do të quhet, është si një artikull i revistës «Kohë të reja», i çalë, jo i plotë. Faqe për faqe dhe shpesh, paragraf për paragraf, në projektin në fjalë unë kam shkruar vërejtjet e mia ideopolitike e teorike, kritika për përmbajtje e interpretime të gabuara me paramendim, sugjerime për ndreqjen dhe përmirësimin e tekstit etj. Këto shënime të miat duhet të mbahen parasysh nga Hysniu e Ramizi në debatet që do të bëhen në mbledhjen e Komisionit për redaktimin përfundimtar të deklaratës.

Në faqen 37 kam shënuar se për revizionistët jugos-

llavë nga ne duhet të formulohet një paragraf shumë i rreptë, kundër grupit trockist të Titos dhe të luftojmë të vihet medoemos në dokument. Diskutimet për këtë të jenë të rrepta.

PËRGATITEM PËR MBLEDHJEN E MOSKËS

Gjithë këto ditë po punoj për t'u përgatitur për Mbledhjen e Moskës të partive komuniste e punëtore.

NE S'JEMI PËR SERENATA NOKTURNE

Hysniu më dërgoi fjalimin që Ten Hsiao Pini ka mbajtur më 5 tetor në mbledhjen e Komisionit të redaktimit të dokumenteve për mbledhjen e nëntorit. E lexova atë dhe, sipas mendimit tim, edhe pse çështjet në përgjithësi ai i shtron mirë, toni i fjalimit është pajtues. Si fillim ky fjalim mund të konsiderohet si një «prelud», por, po nuk shpërtheu me forcë si sinfonitë e Bethovenit, atëherë do të kthehet në një «serenatë nokturne».

Në fakt nëse sovjetikët kanë interes t'i mbyllin gjërat e t'u vënë kapak qelbësirave të tyre, dhe ata e kanë këtë interes, kanë rastin e mirë të kapen pas këtij fjalimi dhe, në njërën apo në tjetrën formë, t'i bëjnë korrigjimet e kërkuara dhe, nën parullën «jemi dakord të mos polemizojmë», t'i kalojnë çështjet e t'i bëjnë bisht debatit e diskutimeve parimore.

Edhe katër-pesë ditë më parë Hysniu, pas një bisede që kishte pasur me shokët kinezë, më njoftonte, midis të tjerave, se «miku» (aluzion për Tenin) mendon të mos e fillojmë polemikën. Këto nuk më duken shenja të mira, sidoqoftë, le të presim e të shohim.

Mendimet e mia lidhur me fjalimin e Tenit, po ia njoftoj edhe Hysniut në një letër¹ që po i dërgoj për disa çështje të cilat duhet t'i ketë parasysh në punimet e Komisionit.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 302.

**HYSNIU DHE RAMIZI U KTHYEN NGA
BASHKIMI SOVJETIK**

Hysniu dhe Ramizi u kthyen nga Moska.

**BYROJA POLITIKE APROVON FJALËN
QË DO TË MBAHET NË MBLEDHJEN
E MOSKËS**

Në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike diskutuam dhe aprovuam fjalën e Komitetit Qendror të PPSH që do të mbahet në Mbledhjen e partive komuniste e punëtoresh në Moskë në nëntor 1960¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 332.

**PLENUMI I KQ APROVON FJALËN QË DO
TË MBAHET NË MBLEDHJEN E MOSKËS**

Sot Plenumi i 20-të i Komitetit Qendror të Partisë dëgjoi dhe aprovoi fjalën që do të mbaj unë, në emër të KQ të PPSH, në Mbledhjen e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtoresh në Moskë në nëntor 1960.

NISEMI PËR NË BASHKIMIN SOVJETIK

U nisëm me avion për në Bashkimin Sovjetik, ku do të marrim pjesë në festimet e 43-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, si dhe në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtoresh që do të mbahet në Moskë. Gjatë rrugës u ndalëm në Budapest. Në mbrëmje u dha një darkë nga Karoli Kish, në të cilën asistoi edhe ambasadori sovjetik në Hungari, Ustinov.

NË UZHGOROD

Sot në mëngjes, në orën 8³⁰, u nisëm me tren të posaçëm nga Budapesti për në Çop (kufiri hungarezo-sovjetik). Na shoqërojnë ministri i Drejtësisë i RP të Hungarisë dhe shumë shokë të tjerë. Hungarezët po tregohen të dashur dhe të hapur me ne.

Në orën 22⁰⁰, me orën e Moskës, arritëm në Çop. Aty na priti sekretari i komitetit të partisë të Uzhgorodit dhe shokë të tjerë sovjetikë. Bisedë dhe darkë e ftohtë. Pastaj me automobil shkuaam dhe pamë Uzhgorodin. Ishte natë, por na bënë përshtypje dyqanet, të cilat, megjithëse po afrohej festa e 7 Nëntorit, ishin shumë të varfra.

ARRITËM NË MOSKË

Në orën 8³⁰, me orën e Moskës, arritëm në stacionin hekurudhor «Kievskaja» në Moskë. U pritëm nga F. Kozlovi, sekretar i KQ të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe anëtar i Byrosë Politike. Në stacion pritja ishte zyrtare me rojë nderi, me bandë dhe me trupin diplomatik. Në stacion kishin dalë gjithashtu studentët shqiptarë, të cilët na pritën me entuziazëm të madh. Pastaj Kozlovi na shoqëroi deri në vilën e zakonshme në Zareçje.

Pasdite morëm pjesë në mbledhjen solemne në pallatin e sportit «Lluzhniki», me rastin e 43-vjetorit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

FALSITET NË QËNDRIMET E UDHËHEQËSVE AKTUALE SOVJETIKË NDAJ NESH

Sot në mëngjes, nga tribuna e mauzoleut «Lenin-Stalin», asistua në paradën ushtarake dhe në manifestimin popullor të banorëve të Moskës me rastin e 43-vjetorit të Revolucionit të Madh të Tetorit.

Taktika e zbatuar nga ana e udhëheqësve aktualë sovjetikë dhe konkretisht e Kozlovit, që dje kur arritëm në Moskë na shoqëroi deri në Zareçie, nuk tregon asgjë të sinqertë nga ana e tyre, pse çdo herë tjetër që ne kemi ardhur në këtë vend, edhe në kohët e mira, domethënë pa plasur mosmarrëveshjet ideologjike midis nesh, këta vetëm sa na jepnin dorën dhe ndaheshim që në stacion.

Sot Kozlovi erdhi për të ngrënë mëngjesin me ne dhe përsëri na buzëqeshte në mënyrë false. Kur u ulëm për të ngrënë bukë, ai, në mënyrë artificiale dhe të neveritshme, filloi të flasë për lidhjet dhe miqësinë që gjoja ka me ne. U përpoq të bënte disa «spunto» për të tatur terrenin, por dhe ne i bëmë disa «kundërspunto» dhe me kaq mori fund mëngjesi.

Nga shokët kinezë mësuam sot se Nikita Hrushovi, prapa krahëve dhe në prani të Liu Shao Çisë, ka sulmuar udhëheqjen e Partisë sonë. Si e pse do ta sqarojmë më mirë më vonë.

PËR DËRKË TË MORIS TORREZI

NJË VEPRIM I PANDERSHËM DHE ANTIMARKSIST I HRUSHOVIT

Nikita Hrushovi më ftoi në takim, po unë nuk shkoja. Në të vërtetë ne kishim vendosur që unë të shkoja në këtë takim, ashtu siç kërkoi Nikita, edhe pse e di që ai orvatet të realizojë taktikën e përçarjes; sidoqoftë unitetin tonë s'e çan dot ky kryerevizionist. Por sot Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik na dorëzoi një letër të gjatë që më 5 nëntor 1960 ia ka drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe ua ka shpërndarë edhe të gjitha delegacioneve pjesëmarrëse në Mbledhjen e partive komuniste e punëtorë të Moskës. Duke e lexuar këtë letër, pikërisht kur po përgatitesha për të shkuar në takim, pashë se në të vendi ynë nuk figuronte në radhën e vendeve socialiste. Pashë gjithashtu se aty sulmohej Komiteti ynë Qendror, dhe akuzohej për veprim me metoda antidemokratike kundër Liri Belishovës dhe Koço Tashkos, vetëm sepse janë «miq» të Bashkimit Sovjetik, e shpifje të tjera. Atëherë thirra Andropovin dhe i thashë se refuzoja të shkoja në takim me Nikita Hrushovin, pse ai, në mënyrë jo të ndershme, jomarksiste dhe duke shpifur, pa pritur të bisedonte më parë me mua, ka sulmuar Partinë tonë me anë të një dokumenti zyrtar ndërkombëtar, për ta diskre-

MOSKË, E ENJTE
10 NËNTOR 1960

FILLOI Mbledhja E 81 PARTIVE KOMUNISTE E PUNËTORE TË BOTËS

Në sallën «Georgevskij» filloi Mbledhja e Moskës e 81 partive komuniste dhe punëtore të botës. Neve na e kanë caktuar vendin afër tribunës (apostafat), bile ngjitur e në një radhë me koreanët. Në sallë sundonte një atmosferë mbytëse dhe plot «furtunë» të pashpërthyer.

I pari foli Suslovi, i cili mbajti një raport në emër të Komisionit që përgatiti projektin e deklaratës.

Sot në Zareçie erdhën për një takim Mikoiani, Kozlovi, Suslovi, Pospjelovi dhe Andropovi. Nga ana jonë ishin të gjithë. Bisedë e tmerrshme¹.

Të dërguarit e Hrushovit erdhën të na mashtronin e të na «bindnin» që të hiqnim dorë nga pikëpamjet tona dhe të mos i ngrejme ato në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore. Ata jo vetëm që janë në dijeni për mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis dy partive tona, pse vetë janë shkaktarët dhe autorët e tyre, por mbi qëndrimin që ne do të mbajmë në mbledhje ata i ka informuar edhe Moris Torezi. Pikërisht ky qëndrim i drejtë, i prerë, demaskues yni i tmerron ata.

Të gjitha manovrat po i përdorin sovjetikët në kontaktet e takimet që kemi pasur gjer tani me ta. E bëjnë këtë vetëm e vetëm për të na përkulur, por pa dobi: në

fillim na sulmuan, pastaj bënë sikur u zbutën, bënë edhe tërheqje taktike, «njohën» një sërë fajesh, u munduan të na lanin e të na lyenin, bile u përpoqën të bënin edhe diferencime. Por gjithmonë ata hëngrën prej nesh grushte të atilla, sa që s'i kishin parë as në ëndërr.

Këto takime po vërtetojnë mirë se e drejta është në anën tonë dhe se kemi të bëjmë me revizionistë, dretharakë, hipokritë, matrapazë, njerëz pa turp dhe tregtarë të marksizëm-leninizmit. Nga takimi i parë me ne ata ikën me duar bosh dhe plot «plagë» në fytyrë.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 359.

MIKOJANI KËRKON TAKIM TË DYTË

Vazhdon Mbledhja, vazhdojnë edhe prapaskenat e sovjetikëve.

Mikojani kërkoi një takim të dytë me ne. Ia dhamë. Erdhi në Zareçie tok me Kozlovin si delegatë të Presidiumit të Komitetit Qendror dhe kërkoi takim të ri për bisedime. Ne pranuan. Do të vemi të gjithë, si një trup.

Konstatojmë se ambasada jonë është nën përgjimin e sovjetikëve me anë aparaturash speciale qysh prej 3 vjetësh, qëkurse ajo hyri për herë të parë në ndërtesën e re.

ME SHOKËT NË ATDHE MBAJMË LIDHJE
TË VAZHUESHME

Me shokët në Tiranë mbajmë lidhje të vazhdueshme. Ne i njoftojmë për punët tona këtej, ata na mbajnë në dijeni të gjendjes së punëve në atdhe. Dje shokët na njoftuan se gjithçka shkon mirë, përveç shirave të mëdha që kanë rënë ditët e fundit, sidomos në zonën bregdetare, ndërsa në zonat e Veriut po bie dëborë. Për këtë arsye mbjelljet vazhdojnë me ndërprerje.

Ata na njoftuan gjithashtu se edhe festat e 7 dhe 8 Nëntorit i kanë kaluar mirë. Por në mbledhjen solemne, që çdo vit mbahet në vendin tonë me rastin e këtyre festave, Novikovi, i ngarkuari me punë i ambasadës sovjetike, që ka përsëndetur në emër të ambasadës, nuk paska thënë asnjë fjalë për Partinë tonë. Për këtë, të pranishmit në sallë, siç e ka merituar ky agent i Hrushovit, e paskan pritur ftohtë dhe pa asnjë duartrokitje. Kur ka mbaruar fjalimin, aty paskan shpërthyer në ovacione për Partinë tonë të lavdishme. Kështu Novikovi dhe padronët e tij kanë marrë një dush të ftohtë. E meritonin.

MBLEDHJE E STUHISHME ME UDHËHEQËSIT SOVJETIKË

Në Mbledhjen e 81 partive vazhdojnë diskutimet dhe, në prapaskenë të saj, vazhdojnë gjithashtu edhe intrigat e sovjetikëve.

Sovjetikëve u ka ndezur me ne. Dje na kërkuan një takim të ri, në Kremlin, kësaj radhe me të deleguarit e Presidiumit të Komitetit të tyre Qendror. Shkuam në këtë takim. Në mbledhje nga ana e sovjetikëve ishin Hrushovi, Mikoiani, Kozlovi, Andropovi dhe Llaptjevi. Hrushovi që në fillim u orvat të na vinte në bankën e të akuzuarve. Por në këtë bankë e vumë ne atë. Ai tha se nuk tërhiqte asgjë nga ato që kishte thënë kundër nesh, na bëri edhe presione ushtarake duke na kërcënuar se mund ta hiqte bazën detare nga Vlora. Por në këtë çështje ne e sulmuam fort dhe demaskuam qëllimet e tij. I zënë ngushtë, ai më bëri mua një krahasim se gjoja po flisja me të, si kishte folur Makmilani. Atëherë shokët Mehmet e Hysni i kërkuan Hrushovit të tërhiqte ofezën e poshtër që më bëri dhe, kur ai tha «po ku ta fus?», shokë Mehmet i tha: «futeni në xhepin tuaj». Pas kësaj ne të gjithë u ngritëm në këmbë, ndërpreme bisedimet dhe dolëm nga salla. Hrushovin dhe shokët e tij i lamë si të dhjerë dhe të poshtër, ashtu siç janë.

Çdo gjë vërteton se Nikita Hrushovi është një revizionist i rrezikshëm. Prandaj shumë vigjilentë, shumë vigjilentë duhet të jemi karshi tij dhe grupit të tij!

NË ATDHE PUNËT ECIN MIRË

Njoftimet që na dërgojnë shokët nga Tirana na e ndryshojnë atmosferën mbytëse në të cilën ndodhemi përkohësisht. Sot ata na njoftojnë se poshtë në rrethe po bëhen mbledhjet e plenumeve të Partisë dhe të këshillave popullore për të diskutuar rreth planit. Kudo ka pasur diskutime e propozime të mira.

Për sa i përket qëndrimit të sovjetikëve, shokët na thonë se në Pashaliman ata kanë lëshuar brezin që ne t'ua shkëlqim e kështu të lindin incidente. Nga ana jonë janë marrë të gjitha masat për t'u treguar vigjilentë e të kujdesur. Shokët na njoftojnë gjithashtu se specialistët sovjetikë, në degë të ndryshme të ekonomisë sonë, kanë filluar të sillen keq. Të njëjtën gjë po bëjnë edhe ata bullgarë. Sa gjë e shëmtuar! Duan të na bëjnë presione e të na pengojnë të themi fjalën tonë. Por më kot e kanë revizionistët sovjetikë dhe shërbëtorët e tyre.

VAZHDON MBLEDHJA E 81 PARTIVE NË MOSKË

Vazhdojnë diskutimet në Mbledhjen e Moskës dhe, po ashtu, edhe intrigat e sovjetikëve në prapaskenën e saj.

MARRIM MASA PËR T'U KTHYER NË ATDHE

Informuam shokët në Tiranë se mund ta marrim fjalën ditën e martë, më 16 nëntor. Fjalimit i shtuam të dhënat e fundit që mësuam këtu si dhe poshtërsitë që Hrushovi u ka thënë kinezëve kundër nesh.

Lidhur me kthimin tonë në atdhe, i njoftuam shokët se do të nisemi së shpejti dhe se mendojmë të kthehemi me det. Porositëm që një vapor yni të niset për në Kostancë të Rumanisë.

SOVJETIKËT KËRKOJNË PËRSËRI TAKIM

Në seancën e sotme të Mbledhjes foli përfaqësuesi kinez Ten Hsiao Pin.

Sot sovjetikët na dorëzuan një dokument zyrtar të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me të cilin kërkojnë përsëri takime për bisedime.

KRYEM DETYRËN TONË TË SHENJTË NDAJ MARKSIZËM-LLENINIZMIT

Në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore të botës që po mbahet këtu, në Moskë, sot paradite mbajta fjalimin tim. Fjalimi, i cili vazhdoi gati dy orë, u dëgjua në heshtje. Asnjë ndërprerje, asnjë ndërhyrje nga Hrushovi.

Çdo gjë pra shkoi në rregull. Ne bëmë kështu një detyrë të shenjtë ndaj Partisë sonë, për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe për gjithë lëvizjen komuniste e punëtore. Ne jemi në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Çdo thënie tonën do ta vërtetojë koha. Ne kemi marrë parasysh çdo gjë, çdo sulm e poshtërsi që do të na bëhet. Marksizëm-leninizmi duhet mbrojtur me çdo kusht dhe Partia jonë po e mbrohet atë.

Pasdreke ndenja u çlodha.

Shokët më njoftuan se në seancat e pasdites të Mbledhjes, Dolores Ibaruri, «Pasionarja», kishte çelur e para sulmin joparimor kundër nesh. Kishte bërë një sulm të turpshëm. Por ne as na prek e as na tund. «Qentë le të lehin, karvani ecën përpara!».

SOVJETIKËT I KANË SHTUAR PROVOKACIONET

Në njoftimet që na dërguan sot nga Tirana shokët na vënë në dijeni se, në mënyrë të theksuar pasi ne u nisëm për të marrë pjesë në Mbledhjen e Moskës, sovjetikët që ndodhen në Shqipëri po zbatojnë një plan të tyre provokacionesh. Shokët na thonë se në Vlorë kanë ardhur dy anije nga Sebastopoli. Njëra ka prurë ushqime dhe po shkarkon në bazën lundruese dhe tjetra është tanker.

Shokët na njoftojnë se koha vazhdon të jetë me lagështirë dhe se në Lezhë një sasi misri ka filluar të fermentohet. Ushtria është bashkuar me kooperativistët për korrjen sa më shpejt të misrit dhe për ta shpëtuar nga dëmtimi.

Duke parë gjendjen që na kanë krijuar këtu revizionistët sovjetikë dhe rreziqet që paraqet ajo edhe për sigurimin tonë konkret, bashkë me shokët Mehmet, Hysni e të tjerë kemi menduar variantet e kthimit për në atdhe. Mendimet tona rreth variantit që mund të jetë më i zbatueshëm ua kishim njoftuar edhe shokëve në Tiranë. Sot ata na propozojnë të kthehemi me etapa me aeroplan. Në të njëjtën kohë na njoftojnë se një vapor i flotës sonë ndodhet në Kostancë dhe është përgatitur për të na kthyer në atdhe.

Diskutuar me shokët përsëri çështjen e rrugëve të kthimit në atdhe. Vendosëm të mos kthehemi me det,

por me tren deri në Budapest. Andej shohim e bëjmë, por për çdo eventualitet dhe për të çorientuar veprimet dhe planet e revizionistëve sovjetikë të pabesë, kërkuam aeroplanin tonë të na presë në Budapest. Kërkuam të vijë në Budapest edhe një grup shokësh të sigurimit, të cilët, së bashku me shokët që na shoqërojnë dhe shokët e ambasadës sonë atje, të kujdesen për masat e nevojshme të kthimit deri në Tiranë.

Çështjen e kthimit nga Budapesti me aeroplan do ta rishikojmë.

MOSKË, E ENJTE**17 NËNTOR 1960****VAZHDON MBLEDHJA E MOSKËS**

Vazhdon punimet Mbledhja e Moskës. Sot trockisti Vladislav Gomulka ndërmoi edhe ai një sulm banditesk kundër fjalimit tonë në këtë Mbledhje, kundër meje personalisht etj.

Shtoi se në raportin e tij në Moskë, ai ka bërë përpjekje të mëdha për të shprehur mendimet e tij në mënyrë të përcaktuar. U shpreh se ai ka bërë përpjekje të mëdha për të shprehur mendimet e tij në mënyrë të përcaktuar.

Të kësaj llojei të mendimit, ai ka bërë përpjekje të mëdha për të shprehur mendimet e tij në mënyrë të përcaktuar. U shpreh se ai ka bërë përpjekje të mëdha për të shprehur mendimet e tij në mënyrë të përcaktuar.

U shpreh se ai ka bërë përpjekje të mëdha për të shprehur mendimet e tij në mënyrë të përcaktuar.

MOSKË, E ENJTE
17 NËNTOR 1960**MOSKË, E PREMTE****18 NËNTOR 1960****VIZITË DELEGACIONIT KINEZ**

I bëmë një vizitë delegacionit kinez në rezidencën e tij në Leninskie Gori. Asistonin të gjithë anëtarët e delegacioneve tona. U zhvillua një bisedë e ngrohtë, shoqërore.

Kinezët thanë fjalë shumë të mira për Partinë tonë të lavdishme dhe për rrugën e saj të drejtë.

KINEZËT NA KTHEJNË VIZITËN

Kinezët na kthyen vizitën në ambasadën tonë në Moskë. Delegacionin kinez e kryesonte Liu Shao Çia.

NË MBLEDHJEN E MOSKËS LAKENJTË E SOVJETIKËVE NA SULMOJNË

Këto ditë unë dhe Mehmeti nuk kemi shkuar në Mbledhje, por qëndruam në ambasadë, pse Zhivkot e Dezhët me shokë shajnë dhe lehin si qenër.

Do të vijë koha që ata do t'i lëpjnë të gjitha çfarë po thonë kundër nesh. Do të vijë patjetër koha e dhënies së llogarisë prej tyre.

VENDOSËM TA SHTYJMË MBAJTJEN E KONGRESIT TONË TË 4-T

Duke pasur parasysh situatat që po zhvillohen këtu dhe kohën e shkurtër që na ngelet për Kongresin tonë të 4-t si dhe problemet e rëndësishme, me karakter politik e ideologjik, që do të duhet të shtrohen në të në dritën e situatës së krijuar pas Mbledhjes së Moskës dhe kritikave që u bëmë revizionistëve sovjetikë, së bashku me shokët këtu, menduam dhe e gjykuam të drejtë ta shtyjmë Kongresin¹. Ua njoftuam këtë mendim shokëve në Tiranë me rekomandimin që ta diskutojnë më parë në Byronë Politike dhe pastaj të vendosim definitivisht në Komitetin Qendror kur të kthehemi ne atje.

U sugjeruam shokëve gjithashtu që lidhur me këtë atje ku nuk janë bërë të ndërpritet zhvillimi i konferencave të Partisë në rrethe. Menduam kështu sepse konferencat duhet të jenë një parapërgatitje e Partisë për situatën e re që po lind për Partinë dhe për popullin tonë.

1 Kongresi i 4-t ishte vendosur të mbahej në muajin nëntor të vitit 1960. Për arsye të Mbledhjes së Moskës si dhe të ngjarjeve që u zhvilluan para e gjatë muajit nëntor, si në marrëdhëniet midis Partisë sonë dhe PK të BS, ashtu edhe në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, ai u shty dy herë. Plenumi i 19-të i KQ të Partisë e shtyu nga muaji nëntor në muajin dhjetor 1960 dhe Plenumi i 21-të e shtyu nga muaji dhjetor 1960 në muajin shkurt 1961.

Kongresi i 4-t i zhvilloi punimet e tij nga data 13 deri më 20 shkurt 1961.

HRUSHOVI DHE PASUESIT E TIJ I ZGJATIN DISKUTIMET

Sot është seanca e fundit plenare e pjesës së parë të Mbledhjes. Shkuam edhe ne. Megjithëse praktikisht diskutimet mbaruan, ato rifilluan sepse Hrushovi dhe një numër tjetër delegacionesh, mbi 20, sigurisht të shtyrë nga sovjetikët, kërkuan edhe një herë fjalën. Këta janë Zhivkot, Gomulkat, Torezët e të tjerë. Edhe vetë Hrushovi mbajti një fjalim të dytë. Pas tij e mori fjalën edhe Ten Hsiao Pini për t'iu përgjigjur fjalimit të Hrushovit.

Ne vendosëm të mos diskutonim për herë të dytë, por bëmë një deklaratë të shkurtër me shkrim që ia shpërndamë të gjitha delegacioneve. Në të ne hodhëm poshtë të gjitha shpifjet që u bënë kundër delegacionit, Partisë dhe popullit tonë.

NISEMI PËR T'U KTHYER NË ATDHE

Shokët Mehmet dhe Hysni u takuan në Kremlin me Mikojanin dhe me Kozlovin.

Në mbrëmje u larguam nga Moska dhe me tren u nisëm për në Shqipëri. Nga sovjetikët kishin dalë për të na përcjellë po ata që na pritën, me Kozlovin në krye, por këtë radhë pa trupin diplomatik.

Në stacionin e trenit «Kievskaja» me qindra studentë shqiptarë që kishin dalë për të na përcjellë, bënë një manifestim të zjarrtë.

TË EVITOHET ÇDO PROVOKACION ME SOVJETIKËT

Po udhëtojmë me tren për t'u kthyer në atdhe nëpërmjet Hungarisë. Njoftimet që kishim marrë nga Tirana mbi përpjekjet e sovjetikëve për të bërë provokacione e për të shkaktuar incidente, na patën shqetësuar. Prandaj përpara se të niseshim nga Moska e ngarkuam Hysniun që, me t'u nisur ne, në emrin tim dhe të Mehmetit, t'i porositë shokët në Tiranë të marrin të gjitha masat e nevojshme që të mos ndodhë asgjë me ushtarakët sovjetikë në bazën e Vlorës. Të evitohet çdo provokacion, pse ata mundohen me të gjitha mënyrat që të krijojnë situata të turbullta për t'i përdorur pastaj kundër nesh.

RRUGËS PËR T'U KTHYER NË ATDHE, QËNDROJMË NË HUNGARI

Pas dy ditë udhëtimi, arritëm në Budapest, ku shokët hungarezë na pritën shumë mirë. Me ne ndodhej Shandor Ronai. Kadari në Moskë nuk na sulmoi si të tjerët. Duhet shikuar me kujdes qëndrimi i shokëve hungarezë ndaj nesh, pse ai paraqitet shoqëror dhe miqësor.

Këtu vendosëm të kthehemi në atdhe me tren duke kaluar nëpërmjet Austrisë dhe Italisë dhe jo me aeroplanin tonë Budapest—Tiranë. Në Bari do të na presë aeroplani ynë për në Tiranë. Ndërkohë shokët që na shoqërojnë, ata që erdhën nga Tirana e që ndodhen këtu, si dhe shokët e ambasadës sonë, duke punuar me ndjenjë e përgjegjësisë së detyrës, pa u lodhur e me zgjuarsia, kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për pasaportat, vizat, trenat etj. Në orën 12 të natës u nisëm përsëri me tren për në Vjenë.

NJË NDALESË E SHKURTËR NË VJENË

Arritëm në Vjenë, ku qëndruam për 4 orë dhe bëmë një shëtitje të vogël me taksi. Pasi hëngrëm mëngjes në një hotel¹, u nisëm për në Itali.

¹ Hotel «Ambasador», Kërtner Shtrese, Vjena 1.

NË ATDHE NA PRESIN KRAHËHAPUR E ME ENTUZIAZËM TË MADH

Arritëm në Bari dhe, me avionin tonë që na priste atje, u nisëm drejt për në Tiranë. Në aeroportin e Rinastit mbërritëm natën vonë.

Shkuam për të marrë pjesë në pritjen që ishte organizuar në Pallatin e Brigadave me rastin e 16-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Të pranishmit na pritën me entuziazëm të madh, gjë që shpreh aprovimin për qëndrimin e vendosur e parimor të Partisë sonë në Mbledhjen e Moskës.

U NËNSHKRUA DEKLARATA E MOSKËS

U nënshkrua në Moskë Deklarata e Mbledhjes së 81 partive komuniste dhe punëtorë.

ERDHËN HYSNIU DHE RAMIZI

Sot Hysniu me Ramizin u kthyen me avion nga Moska.

SHTYPI YNË BOTON DEKLARATËN E MOSKËS

Shtypi i vendit tonë sot botoi Deklaratën e Mbledhjes së 181 partive komuniste e punëtore që u mbajt në Moskë.

APROVIM I PLOTË I VIJËS SË DREJTË MARKSISTE-LENINISTE TË PARTISË SONË

Bëmë mbledhjen e Byrosë Politike mbi Deklaratën e Mbledhjes së Moskës.

Raportova mbi zhvillimin e punimeve. Unanimitet dhe unitet i çeliktë. Besim i patundur ndaj vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë.

UNITET I ÇELIKTË, ENTUZIAZËM I PAPËRSHKRUAR. ASNJË LËSHIM REVIZIONISTËVE SOVJETIKË

Sot u bë mbledhja e Plenumit të 21-të të Komitetit Qendror. Unë raportova mbi rezultatet e Mbledhjes së Moskës¹.

Punimet e Plenumit i përshkoi një entuziazëm i papërshkruar. Unitet i çeliktë. Komitet Qendror i mrekullueshëm. Si një trup i vetëm me unanimitet të plotë. Komiteti Qendror i Partisë aprovoi vijën e Partisë dhe qëndrimin e mbajtur nga delegacioni ynë në Moskë. Asnjë lëshim revizionistëve sovjetikë!

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 484.

**LUFTA PARIMORE E KONSEKUENTE
KUNDËR IMPERIALIZMIT E REVIZIONIZMIT
ËSHTË RRUGA E PARTISË SONË**

Sot morën fund punimet e Plenumit të 21-të të KQ të PPSH¹. Në mbyllje të punimeve e mora fjalën edhe unë. Vura në dukje se kemi përpara një luftë të madhe dhe të rëndë, por armiqtë tanë nuk do të kenë sukses. Lufta parimore e konsekuente kundër imperializmit e revizionizmit do të mbetet edhe në të ardhmen rruga e Partisë sonë².

1 Plenumi dëgjoji raportin «Mbi Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore, që u bë në Moskë në nëntor 1960».

2 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 574.

**TAKIM ME AMBASADORËT TANË QË NDODHEN
NË ATDHE**

Sot takova dhe bisedova me ambasadorët tanë që kanë ardhur në atdhe. U fola mbi zhvillimin e punimeve të Mbledhjes së Moskës të 81 partive komuniste e punëtore.

TREGUESI TEMATIK I LËNDËS

A

Ambasadat e huaja në RPSH

— e BRSS

20, 34, 97, 148, 161, 224,
353, 362, 395, 521

— e Bullgarisë
147, 165, 475

— e Çekoslovakisë
42, 241, 414

— e Hungarisë
30, 153, 232, 401

— e Kinës
157, 394

— e Koresë
145, 271

— e Rumanisë
11

— e RD Gjermane
474

— e Indisë
55

Anglia, imperializmi anglez
105, 229, 388

*Armatimi, çarmatimi, vendo-
sja e bazave ushtarake*
276, 365, 372, 388, 397,
398, 496, 499-500

B

*Bashkekzistenca paqësore dhe
shtrembërimet revizioniste lidhur me të*
492-494, 500-501

*Bashkimi i Republikave So-
cialiste Sovjetike (BRSS), re-
vizionizmi sovjetik*

— qëndrimet oportuniste, an-
timarksiste të udhëheqjes
sovjetike
12, 212, 361, 374, 387, 388,
396, 397, 405, 416, 420,
422, 428, 449, 464, 465,
470, 486, 495, 500-501, 505

— rehabilitimi i klikës së
Titos, bashkëpunimi dhe
kontradiktat sovjeto-ju-
gosllave

31, 45, 62, 79, 374, 402,
425, 464, 485

— marrëdhëniet sovjeto-
-amerikane
397, 398, 489

— marrëdhëniet, kontradik-
tat sovjeto-kineze
79, 430, 436, 443, 449, 470

— marrëdhëniet, qëndrimet
provokuese e armiqësore
të udhëheqjes sovjetike
ndaj PPSH e RPSH

12, 25, 87, 155, 164, 167,
208, 215-216, 248, 249, 251,
257, 261, 262, 268-269, 372,
373, 399, 436, 438, 442,
456-457, 465, 470, 476,
478, 513, 514, 515-516,
518-519, 522, 523, 526,
528-529

*Bullgaria, Partia Komuniste
Bullgare, vizita nëpër Bullgari
dhe marrëdhëniet me RP të
Shqipërisë*

65, 66, 67, 68, 69, 70, 71,
72, 73, 74, 75, 76, 305,
306, 307, 308, 309, 310,
311, 312, 313, 314, 315,
316, 317, 318, 319, 320,
321, 322, 323, 324, 325,
326, 327, 328, 339, 340,
371

C

Çekosllovakia, vizita nëpër

*Çekosllovakia, marrëdhëniet me
RPSH*

99, 100, 101, 102, 103, 104,
106, 107, 108, 109, 110,
111, 112, 113, 114, 115,
116, 117, 119, 120, 121,
122, 125, 126, 127, 128,
129, 130, 131, 132, 133,
134, 135, 136, 137, 139,
140, 193, 194, 195, 196,
197, 198, 199, 200, 201,
202, 203, 204, 205, 206,
281, 282, 283, 284, 285,
286, 287, 288, 289, 290,
291, 292, 293, 294, 295,
296, 297, 298, 299, 300,
301, 302, 303, 304

D

*Delegacioni i Bashkimeve Pro-
fesionale të Shqipërisë në Ses-
sionin e Këshillit të Përgjith-
shëm të Federatës Sindikale
Botërore*

432

E

*Ekonomia e RPSH, zhvillimi
dhe forcimi i saj*

82-86

*Epoka jonë, shtrembërimet re-
vizioniste lidhur me të*

485-490, 494-498

G

Greqia, marrëdhëniet me Shqi-

*përinë, qëndrimi armiqësor i
reaksionit grek ndaj RPSH*

275, 416, 441, 469

H

*Hungaria, kundërrevolucionit
në Hungari, marrëdhëniet me
RPSH*

52, 153, 163, 181, 182, 398

I

*Imperializmi, qëndrimi armi-
qësor ndaj Shqipërisë*

364, 496-497, 499-500

India

396, 420, 500-501

J

*Jugosllavia, revizionizmi jugo-
sllav*

— revizionistët jugosllavë —
tradhtarë të marksizëm-
leninizmit, agjenturë e
imperializmit
27-29, 33, 35-37, 47-52,
231, 234, 235-236, 237-238,
358, 398, 406, 420

— qëndrimi armiqësor i re-
vizionistëve jugosllavë
ndaj PPSH dhe RPSH
17, 50-51, 122-123, 230,
331, 351, 358, 366, 373,
440, 444, 475

K

*Kampi socialist, antiimperia-
list*

49-50, 82, 372, 374, 420

*Kina, politika e jashtme, ma-
rrëdhëniet me RPSH*

146, 430, 471, 532

*Kolonializmi, problemi koloni-
al*

490, 493

*Kominterni (Internacionalja e
Tretë Komuniste)*

234-235, 236-237

*Konferenca e nivelit të lartë
e Parisit (maj 1960) — dështi-
mi i saj*

421, 422, 429

*Koreja, marrëdhëniet e saj
me RPSH*

9, 264, 271

KNER-i

32, 56, 58, 59, 60, 61, 80,
243, 244, 245, 247

*Kreditë, probleme lidhur me
kreditë për Shqipërinë*

191, 199, 412, 419, 476

L

*Lëvizja komuniste e punëto-
re ndërkombëtare*

— uniteti në gjirin e lëvizjes komuniste dhe përpjekjet e revizionistëve për minimin e saj
48, 237, 374, 376, 436, 518-519, 527, 530, 541

— Byroja Informative e Partive Komuniste e Punëtore
51, 236, 237

— mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës, mbi zhvillimin e bujqësisë (janar 1960)
383, 384, 385, 386, 387

— Mbledhja e Bukureshtit (qershor 1960)
428, 429, 433, 434, 435, 436, 445, 450

— Mbledhja e Moskës e 81 partive komuniste e punëtore (10 nëntor — 1 dhjetor 1960)
472, 502-503, 503, 509, 510, 515-516, 518-519, 520, 522, 524, 527, 530, 533, 541, 547

Lufta e klasave, qëndrimi antimarksist i revizionistëve ndaj saj

500-501

Lufta, shkaqet e saj, shtre-

mbërimet revizioniste lidhur me luftën
490-491, 492, 494, 498-499

M

Maroku, takim me komunistë marokenë
156

Martinika, takim me komunistë martiniken
18

N

NATO
8, 12, 56

O

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)
477, 480, 486

P

Paqja, probleme të paqes dhe qëndrimi antimarksist i revizionistëve ndaj saj
490-491, 494, 496, 498-499

Partia e Punës e Shqipërisë, probleme të jetës së brendshme të saj
80, 122-123, 268, 382, 393, 427, 434, 440, 445, 446, 473, 510, 534, 544, 545

Partia e Punës e Shqipërisë — politika e jashtme e saj

— qëndrimet parimore kundër revizionizmit
27-29, 52-53, 81, 251, 374, 380, 436, 437, 445, 449, 471, 502, 527, 534, 546

— lufta e saj kundër revizionizmit jugosllav
17, 27-29, 33, 35-37, 45, 47-54, 80, 81, 122, 234-238, 351, 358, 420, 425, 464, 502-503

— qëndrimet parimore kundër revizionizmit sovjetik
374, 486, 500-501

— marrëdhëniet me partitë komuniste e punëtore
18, 64, 65, 68, 70, 72, 78, 80, 125, 126, 157, 160, 251, 281, 370, 375, 376, 377, 381, 383, 384, 385, 386, 387, 388, 389, 390, 391, 392, 393, 430, 435, 437, 445, 448, 450, 509, 515-516, 527

Partia Komuniste e Indonezisë, komunistë indonezianë
159, 160, 370, 376, 377, 379

Partia Komuniste Italiane, takim me komunistë italianë, tradhtia revizioniste në të
125, 142, 296, 302, 360, 378, 380

Politika e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë

— parimet themelore m-l të politikës së jashtme të RPSH, rritja e prestigjit dhe e autoritetit ndërkomëtar
82, 275, 276, 365, 416, 423

— marrëdhëniet me BRSS
8, 19, 20, 23, 34, 43, 56, 83-84, 97, 148, 149, 166, 206, 229, 247, 249, 255, 327, 329, 352, 355, 371, 404, 430, 444, 449, 470, 473, 537

— marrëdhëniet me Çekoslovakinë
22, 82-84, 93, 103, 113, 128, 193-194, 195, 196-197, 198, 199, 279, 332, 338, 421

— marrëdhëniet me RD Gjermane
38, 180, 181, 183-184, 185, 186, 187, 188, 189, 190, 191, 192, 223, 226, 447

— marrëdhëniet me Bullgarinë
65, 74, 75, 144, 440, 444

— marrëdhëniet me Hungarinë
152, 163, 511, 512, 537

— marrëdhëniet me Rumalinë
11, 174, 294, 414, 417, 418

— marrëdhëniet me Kinën
146, 255, 332, 334, 335,
430, 471, 531

— marrëdhëniet me Korenë
9, 173, 176, 264, 267, 270,
272, 365, 415

— marrëdhëniet me Viet-
namin
209, 354

— marrëdhëniet me Jugo-
sllavinë
33, 45, 49, 51-54, 122, 331,
444

— marrëdhëniet me Algjeri-
në
227

— marrëdhëniet me Egjiptin
16

R

Revizionizmi modern, lufta kundër tij
27-28, 47-48, 95, 373, 535

Rumania, marrëdhëniet e saj me RPSH
408, 418, 443, 476

S

Spiunët, agjentët, lufta kundër tyre
422, 456-457, 521

SH

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), imperializmi amerikan

105, 388, 397, 420, 496

T

Takime me:

— delegacionin e Federatës Demokratike Ndërkombëtare të Grave dhe të Grave të Vendeve Arabe
162

— komunistë francezë
211, 360

— studentë shqiptarë në Moskë
169

— gazetarë të huaj
259, 324

— shokë irlandezë
159

Traktati i Varshavës, Komiteti Politik Konsultativ dhe qëndrimi shovinist i hrushovianëve në të

12, 56, 62, 372, 379, 384, 388, 413, 421, 426

U

Ushtria Sovjetike, spastrimi

dhe problemi i çmobilizimit të saj

19, 20, 97, 372, 413

V

Vendet Arabe, marrëdhëniet e

tyre me RPSH
39, 40, 41, 158

Vietnami, marrëdhëniet me RPSH

96, 209, 354

Vigjilenca revolucionare

398, 456

TREGUESI I EMRAVE

A

Aidit, Dipo Nasuntara
370, 376, 377, 378, 379

Ajzenhauer, Duajt
21, 397, 398, 489

Alia, Ramiz
297, 299, 381, 405, 406,
407, 420, 428, 472, 483,
502, 508, 542

Allkata, Mario
142

Andropov, Juri
221, 518, 522

Antonov, Aleksej
150, 286

Aristov, A.B.
208

Armand, Nikolas
18

B

Bacilek, Karol
129, 196, 197, 274, 279

Bajramov, Abdulla
164

Balmizher, Pol
360

Belishova, Liri
427, 432, 439, 442, 473,
515

Beriuзов, Sergej
326

Bernshtajn, Eduard
47-48

Botev, Kristo
66

Brezhnjev, Leonid
439

Buhali, Larbi
292

Bulganin, Nikolai
26

C

Cankov, G.
317

Ç

Çand, Kub
46

Çan Kai Shi
146

Çarçani, Adil
332, 399

Çarçani, Siri
301

Çerçill, Uinston
236

Çoi Yon Gën
264, 267, 270, 271

Çuvahin, Dmitri
221

D

Damianov, Georgi
165

Danilov, A. D.
208

Dapçeviç, Vllado
402

David, Vaclav
274, 279

Dezh, Georgiu
408, 417, 418

Dë Gol, Sharl
489

Dimitrov, Gjergj
66, 187-188, 312, 325

Dimov, Dimitër
144

Dolanski, Jaromir
98, 132, 199

Dvorzhak, Antonin
194

Dyklo, Zhak
211

F

Firjubin, Nikolai
104, 208

Firlinger, Zdenek
106, 107, 116

Frederiku II
185

Furceva, Ekaterina
104, 107

G

Gandi, Indira
396

Gardia, Umberto
360

Ganev, Dimitri
65

Gébels, Jozef
187

Gëring, Herman
184, 187

Gëte, Johan
109

Ghosh, Axhoi
211

Glebov, V.S.
97

Gomulka, Vladislav
530

Gorkiç, Milan
234-236

Gotvald, Klement
98, 193

Greçko, Andrej
413

Grotevol, Oto
180, 256, 260, 261, 262
265, 266

Groza, Petru
11

GJ

Gjata, Xhavit
289

H

Haçaturian, Aram
186

Heindrih, Jiri
106, 305

Hoxha, Nexhmiçe
107, 132, 140, 181, 202,
205, 211, 213, 217, 219,
220, 225, 281, 285, 325

Hrushov, Nikita
21, 26, 62, 68, 70, 73, 167,
210, 221, 242, 249, 251,
252, 253, 257, 258, 260,
261, 262, 263, 268, 372,
373, 387, 388, 396, 397,
398, 412, 422, 426, 427,
435, 436, 437, 441, 464,
465, 470, 476, 485, 487,
488, 489, 492-493, 497-501,
515-516, 522, 535

I

Ibarur, Dolorez
211, 527

Ivanov, V.I.
8, 12, 13, 14, 25, 26, 31,
32; 33, 45, 143, 147, 179,
228, 248, 250, 273, 353,
369, 371, 373, 379, 380, 397,
399, 402, 412, 413, 416, 420,

421, 426, 427, 435, 437,
444, 456-457, 463, 466

J

Jugov, Anton
65, 70, 74, 76, 305, 306,
309, 325

K

Kadar, Janosh
163, 171, 181, 182, 328, 538

Kahuda, Frantishek
338

Kan Shen
79

Kapo, Hysni
23, 120, 122, 221, 225, 320,
407, 428, 430, 431, 434,
435, 436, 437, 438, 440, 445,
455, 463, 483, 502, 505, 508,
522, 528, 536, 537, 542

Kapo, Vito
220

Kardel, Eduard
28, 29, 35, 36

Kautsk, Karl
47-48

Keko, Endri
355

Kim Du Bon
9

Kim Ir Sen
415

Kim Re Zun
176

Kish, Karoli
152, 153, 328, 511

Kolarov, Vasili
325

Koleka, Spiro
56, 59, 399, 403, 409

Koniev, Ivan
62, 293, 296, 413

Konstantinov, Fjodor
208

Kopalin, Ilia
273, 355, 356

Kopecki, Vacllav
106, 135, 196

Kosigin, Aleksei
243, 246, 247, 283, 285,
409, 430, 432

Koucki, Vladimir
281, 282

Kozlov, Froll
216, 286, 439, 513, 514,
518, 520, 522, 536

Kristozos, K.
321

Kunderman, Ane
479

L

Lamperc, Maksimiljan
19

Lenin, V. Iliç
27-28, 47, 52-53, 407, 467,
495, 501

Lepeshinskaja, A.A.
286

Lesakov, V.I.
208, 214, 218, 221, 391

Libkneht, Karl
184

Lim Çun Çu
173

Liu Shao Çi
432, 439, 514, 532

Lo Shi Gao
32, 41, 157, 471, 481, 484

Luksenburg, Roza
184

LL

Ljaptiev, Ivan
206, 221, 522

Lleshi, Haxhi
270, 432, 439

M

Mackieviç, V.V.
333

Makmilan, Harold
229, 489, 522

Malik, Frantishek
41, 151, 278

Malinovski, Rodion
261, 262

Mao Ce Dun
471

Marks, Karl
10, 29

Maurer, Georgi
294, 295, 296

Medvediev, I.N.
221, 391

Meternik, Klemens
114

Mikojan, Anastas
383, 384, 478, 518, 520,
522, 536

Mileran, Aleksandër
28

Mojsov, Lazar
374

Muhitdinov, N.A.
383, 392

Mynih, Ferenc
181, 182

Myftiu, Manush
181, 189, 297, 299, 410,
452

Myftiu, Nefo
297

N

Nagi, Imre
52

Neuman, S.K.
199

Neumanova, S.K.
199

Nehru, Xhavaharlal
396

Novikov, K.J.
21, 229, 521

Novotni, Anton
106, 193-194, 195, 199, 282

Nushi, Gogo
279, 432, 478

O

Orilov, S.D.
329

P

Pajeta, Xhankarlo
124

Pervencev, Arkadi
175

Pervuhin, Mihail
192

Petrov, Ivan
391

Petrovna, Nina
106, 107

Pik, Vilhelm
474

Pin De Hua
255, 256, 261

Poljanski, Dmitri
215-216, 217

Polit, Harri
211

Popov, Grigori
216

Pospjelov, Pjotër
208, 518

Preobrazhenski, Aleksandër
143, 389

Princel, Kurt
447

Prifti, Koço
117, 151, 289

R

Rankoviç, Aleksandër
440, 444, 475

Rau, Hajnrik
38

Roasio, Antonio
360

Rodimcev, Aleksandër
97

Ronai, Shandër
538

Roshe, Valdek
105

Ruttkay, Josef
259

S

Samavi al Khadhim
369

Sekia, Petro
142

Selasie I, Haile
277, 285

Sergackov, V.F.
97

Sergejev, F.L.
416

Sizov, N.T.
148, 149

Skoçimaro, Mauro
125, 296, 302

Sokolov, K.M.
97, 116

Spano, Velio
142

Spata, Hasan
121, 122

Spiridonov, Ivan
357, 361, 363

Stalin, J. Visarionoviç
47, 185, 221, 467

Suslov, Mihail
518

SH

Shauki, Hysein
158

Shehu, Figret
181, 220

Shehu, Mehmet
39, 40, 56, 62, 122, 167,
170, 189, 196, 200, 201,
202, 215-216, 221, 255, 265,
346, 383, 384, 388, 395,
414, 417, 418, 432, 433, 455,
463, 470, 477, 485, 506,
507, 522, 528, 533, 536, 537

Shiroki, Villam
82, 88, 89, 90, 91, 92, 93,
113, 126, 139, 193, 200,
304

Shivarov, Vëllko
330, 337

Shtylla, Behar
181, 365, 400

Shvernik, Nikolai
57

T

Tashko, Koço
456-457, 515

Taraseviç, V.K.
444

Tebuh, Jan
22

Telman, Ernest
184

Tempo, Vukmanoviç
373, 398

Ten Hsiao Pin
505, 526, 535

Timoshenko, Semjon
104

Tito, J. Broz
27-29, 35-37, 48, 49, 52, 62,

80, 196, 231, 234-238, 249,
406, 485, 503

Todorov, Stanko
308

Ton Dyk Thong
96

Torez, Moris
448, 449, 450, 452, 453,
454, 458, 459, 460, 461,
462, 517

Torez, Pier
448

Toska, Haki
332

Trajkov, Georgi
308

Tupolev, Andrei
73, 262

U

Ulbricht, Valter
183, 185, 189, 191

Ustinov, Dimitri
326, 511

V

Veleshnja, Zylyftar
297

Venizellos, Sofokli

441, 469, 472

Vermersh, Zhanet

448, 450

Velçesku, Georgi

174

Vinj, Ferdinand

360

Vllahoviç, Velko

398

Volter, Fransua

185

Z

Zamçevski, I.K.

444

Zasiadko, A.F.

208

Zogu, Ahmet

108

ZH

Zhatkullak, Nandor

30, 153, 232, 401

Zhivkov, Todor

65, 67, 76, 305, 316, 318,
322, 323, 325, 339, 340,
341, 345, 346, 347, 348,
371

TREGUESI GJEOGRAFIK

A

Austerlic (Çekosllovakia)

127

Austri

538, 539

Athinë

416

Azerbajxhian

164

B

Banka Bistrica (Çekosllovakia)

131

Bansko (Bullgari)

318

Bari (Itali)

538, 540

Batak (Bullgari)

74

Beograd

27, 230, 373, 398, 475

Berlin

182, 183-184, 185-186, 190,
191, 192

Bicaj (Kukës)

331

Biterfeld (Gjermani)

189

Bllagojevgrad (Bullgari)

318

Boronec (Bullgari)

73, 314, 315

Borovë (Kolonjë)

137, 469

Bosfor (Turqi)

262

Bratislavë (Çekosllovakia)

128, 129, 196, 197

Bremë (Gjermani)

189

Brezhdan (Dibër)

425

Brno (Çekosllovakia)
127, 128, 197, 198

Budapest
171, 181, 182, 263, 328, 383,
511, 529, 538

Budjejević (Çekosllovakia)
195

Bukuresht
52, 63, 426, 427, 428, 434,
438, 441, 465, 470

Bulgarec (Korçë)
254

Butrint (Sarandë)
261, 262, 268, 344

Ç

Çop (BRSS)
206, 512

Çukë (Kanal, Sarandë)
276, 344

D

Dajt (mali ~)
455

Danub (lumi ~)
130, 181, 196

Desau (Gjermani)
191

Dimitrovgrad (Bullgari)
309

Dropull i Poshtëm (Gjirokastrë)
275

Durrës
25, 279, 378, 459

Dvoran (Korçë)
254

DH

Dhërmi (Vlorë)
343

E

Egjipt
180

Elbasan
366

Ersekë
469

F

Frantishkov - Lazne (Çekosllovakia)
112

G

Gotvaldov (Çekosllovakia)
136

GJ

Gjibraltar
262

Gjirokastrë
345

H

Heb (Çekosllovakia)
112

Herolt (Francë)
360

J

Jakovliev (Çekosllovakia)
110

Jordani
105

K

Kajro
16

Kaliari (Itali)
360

Karlovi-Vari (Çekosllovakia)
101, 102, 103, 283, 285, 290

Kazanlık (Bullgari)
75

Këmishtaj (Lushnjë)
341

Kinzhar (Çekosllovakia)
114

Kislovodsk (BRSS)
211

Komarno (Çekosllovakia)
196

Kostancë (Rumani)
525

Korçë
89, 154

Kosovë
425

Krime (BRSS)
215

Kozhicë (Çekosllovakia)
202

Kritçin (Bullgari)
74, 308

L

Lajpcig (Gjermani)
187, 188

Leningrad (BRSS)
216

Leskovik
469

Lezhë
528

Liban
105, 162, 253

Lidiçe (Çekosllovak)
137

Lindja e Afërme
180

Lumë (Kukës)
331

Lushnjë
195, 341

M

Maliq (Korçë)
254

Marianski-Lazne (Çekosllovak)
106, 299, 300

Martinikë
18

Mat (lumi ~)
10

Mesdhe
262, 268

Mihaillovgrad (Bullgari)
322

Moskë
13, 14, 23, 24, 34, 56, 57,
64, 80, 167, 169, 171, 200,
208, 215, 220, 222, 225, 228,
229, 380, 383, 390, 430, 432,
438, 465, 470, 508, 511, 513,
514, 537, 538

NJ

Nju-Jork
477, 480, 485, 506, 507

O

Orikum (Pashaliman, Vlorë)
342, 523

Ostravë (Çekosllovak)
110, 134, 135, 287

P

Pançevo (Bullgari)
311

Paris
279, 421, 422, 429

Pazarxhik (Bullgari)
74

Pekin
427, 443

Peshtar (Bullgari)
74

Petriç (Bullgari)
319

Filzen (Çekosllovak)
119, 288

Piqerras (Sarandë)
343

Plovdiv (Bullgari)
74, 309

Potolcan (Çekosllovak)
130

Potsdam (Gjermani)
185

Pragë
94, 98, 99, 100, 132, 136,
138, 141, 192, 193, 198, 200,
281, 303

Pula (Jugosllavi)
48, 52

Q

Qyteti Stalin (Kuçovë)
341

R

Rila (Bullgari)
73

Rinas (Krujë)
94, 181, 262, 277, 370, 540

Romë
381

S

Sarandë
260, 343, 344

Sebastopol (BRSS)
528

Serbi
440

Siri
162

Sillovak (Çekosllovak)
129, 196, 204

Sofje
65, 66, 76, 305, 310, 315,
319, 322, 327, 328

Sofratikë (Gjirokastër)
275

Sokolovo (Çekosllovak)
109, 115

Spilberk (Çekosllovaki)	128	Tepelenë	345
Sremska - Mitrovica (Jugosllavi)	440, 444, 475	Tërbuf (Myzeqe)	258
Stara - Zagora (Bullgari)	75	Tërnovo (Bullgari)	75, 76
Stjar (Sarandë)	261, 345	Tiranë	43, 63, 111, 116, 141, 157, 171, 222, 243, 257, 262, 329, 384, 390, 521, 525, 529, 538, 540
SH		Topolniki (Çekosllovaki)	196
Shihac (Çekosllovaki)	131	Treptov (Gjermani)	184
Shipkë (Bullgari)	75	Tunizi	162
Shkodër	253, 346	TH	
Shtoi (Shkodër)	253	Thumanë (Krujë)	253
T		U	
Tajvan	146	Ukrainë	207
Tatra (Çekosllovaki)	131, 132, 200, 206	Ulzë (Mat)	10
Tatra-Llomnica	200, 201, 202, 204	Uzbekistan	168

Uzhgorod (BRSS)	512	Vraça (Bullgari)	322
V		Vranje (Bullgari)	312
Varshavë	440	Z	
Vitosha (Bullgari)	305, 306, 307	Zasimove - Usti (Çekosllovaki)	195
Vjenë	538, 539	Zdojan (Dibër)	425
Vlorë	91, 258, 260, 268, 341, 342, 345, 528, 537	ZH	
Vltava (lumë, Çekosllovaki)	99	Zhilina (Çekosllovaki)	134

LEŊDA

1958

1. —	1 janar 1958. Intervistë e gazetës «Sovjet-skaja Rosija»	7
2. —	3 janar 1958. Takim me ambasadorin sovjetik	8
3. —	4 janar 1958. Bisedë me ambasadorin korean	9
4. —	7 janar 1958. Hidrocentralit të Ulzës t'i jepet emri «Karl Marks»	10
5. —	8 janar 1958. Ngushëllime për vdekjen e P. Grozës	11
6. —	9 janar 1958. Sovjetikët na dërgojnë projektpropozimet e tyre për uljen e tensio-nit ndërkombëtar	12
7. —	22 janar 1958. Takim me ambasadorin sovjetik	13
8. —	11 shkurt 1958. Ambasadori sovjetik nuk thotë asgjë më shumë nga ç'thotë shtypi	14
9. —	18 shkurt 1958. U hap ekspozita sovjetike mbi energjinë atomike	15

Faqe

	Faqe
10. — 19 shkurt 1958. Bisedë me Kryetarin e Komitetit Ekzekutiv të KP të Tiranës pas kthimit nga Kajroja	16
11. — 20 shkurt 1958. Qëndrimet armiqësore të udhëheqjes jugosllave ndaj vendit tonë janë të vjetra	17
12. — 20 shkurt 1958. Takim me një udhëheqës të PK të Martinikës	18
13. — 22 shkurt 1958. Mbledhje solemne për 40-vjetorin e Ushtrisë e të Flotës Ushtarake Sovjetike	19
14. — 23 shkurt 1958. Pritje në ambasadën sovjetike	20
15. — 28 shkurt 1958. Shenja flirti Hrushov-Ajzenhauer	21
16. — 6 mars 1958. Takim me ambasadorin çekoslovak	22
17. — 11 mars 1958. Shoku Hysni niset për në Moskë	23
18. — 12 mars 1958. Informim formal i ambasadorit sovjetik	24
19. — 15 mars 1958. Morëm në dorëzim gjuajtësit e flotës detare ushtarake	25
20. — 27 mars 1958. Sovjetikët njoftojnë për ndryshimet në qeverinë e tyre	26
21. — [mars] 1958. Një dokument i ri trockist-revizionist i titistëve	27

	Faqe
22. — 4 prill 1958. Pritje në ambasadën hungareze	30
23. — 9 prill 1958. Lëkundje të rrezikshme të sovjetikëve	31
24. — 12 prill 1958. Takim me ambasadorin sovjetik dhe atë kinez	32
25. — 14 prill 1958. Nuk do të marrim pjesë në kongresin e LK të Jugosllavisë	33
26. — 17 prill 1958. Pritje në ambasadën sovjetike	34
27. — 30 prill 1958. Kongres i trockistëve jugosllavë	35
28. — 2 maj 1958. Darkë për Hajnrik Raun	38
29. — 3 maj 1958. Takim me miq arabë	39
30. — 5 maj 1958. Në darkën e dhënë për miqtë arabë	40
31. — 6 maj 1958. Aktivitete politike	41
32. — 9 maj 1958. Pritje nga çekoslovakët me rastin e festës së tyre	42
33. — 10 maj 1958. Darkë për diplomatë sovjetikë	43
34. — 11 maj 1958. Mbrëmje e miqësisë shqiptaro-sovjetike	44
35. — 12 maj 1958. Një kritikë me pambuk ndaj revizionistëve jugosllavë	45
36. — 13 maj 1958. Takim me ministrin fuqiplo-të të Indisë	46

	Faqe
37. — 13 maj 1958. Revizionizmi jugosllav duhet demaskuar pa mëshirë dhe pa lejuar asnjë kompromis	47
38. — 16 maj 1958. Në darkën e dhënë nga ministri fuqiplotë i Indisë	55
39. — 18 maj 1958. Nisemi për në Bashkimin Sovjetik	56
40. — 19 maj 1958. Në darkën e dhënë për 70-vjetorin e Shvernikut	57
41. — 20 maj 1958. Filloi punimet konsulta e KNER-it	58
42. — 21 maj 1958. Në konsultën e KNER-it	59
43. — 22 maj 1958. Vazhdojnë punimet e konsultës së KNER-it	60
44. — 23 maj 1958. Përfundoi konsulta e KNER-it	61
45. — 24 maj 1958. Mbledhje e Këshillit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës	62
46. — 25 maj 1958. U kthyem në Shqipëri	63
47. — 28 maj 1958. Mbledhje e Byrosë Politike të KQ të PPSH	64
48. — 31 maj 1958. Nisemi për në Bullgari	65
49. — 1 qershor 1958. Në Mauzoleun «Gjergj Dimitrov»	66
50. — 2 qershor 1958. Në Kongresin e 7-të të PK të Bullgarisë	67
51. — 3 qershor 1958. Në Kongresin e PK të Bullgarisë	68

	Faqe
52. — 4 qershor 1958. Në Kongresin e PK të Bullgarisë	69
53. — 5 qershor 1958. Në Kongresin e PK të Bullgarisë	70
54. — 6 qershor 1958. Në Kongresin e PK të Bullgarisë	71
55. — 7 qershor 1958. Kongresi i 7-të i PK të Bullgarisë mbaroi	72
56. — 8 qershor 1958. Vizitojmë vende të ndryshme të Bullgarisë	73
57. — 9 qershor 1958. Vizitë nëpër Bullgari	74
58. — 10 qershor 1958. Vizitë nëpër Bullgari	75
59. — 11 qershor 1958. Takim me Zhivkovin	76
60. — 12 qershor 1958. U ktheva në atdhe	77
61. — 13 qershor 1958. Mbledhje e Byrosë Politike	78
62. — 17 qershor 1958. Një artikull i mirë i kinëzëve	79
63. — 20 qershor 1958. Në mbledhjen e Plenumit të 10-të të KQ të Partisë	80
64. — 22 qershor 1958. Revizionizmi modern duhet luftuar pa mëshirë deri në shkatërrimin e tij të plotë teorik e politik	81
65. — 22 qershor 1958. Shënime për takimin me delegacionin qeveritar çekoslllovak të kryesuar nga shoku Viliam Shiroki	82

	Faqe
66. — 23 qershor 1958. Takim me ambasadorin sovjetik	87
67. — 24 qershor 1958. Arriti delegacioni qeveritar çekoslovak i kryesuar nga V. Shiroki	88
68. — 25 qershor 1958. Shiroki viziton vendin tonë	89
69. — 26 qershor 1958. Darkë me Shirokin	90
70. — 27 qershor 1958. Shiroki nisët për në Vlorë	91
71. — 28 qershor 1958. Në ambasadën çekoslovakë	92
72. — 29 qershor 1958. Bisedimet me delegacionin çekoslovak mbaruan	93
73. — 30 qershor 1958. Delegacioni çekoslovak u largua	94
74. — 4 korrik 1958. Doli libri i Leninit për luftën kundër revizionizmit	95
75. — 8 korrik 1958. Takim me delegacionin parlamentar të Vietnamit	96
76. — 9 korrik 1958. Takim me ushtarakë sovjetikë	97
77. — 12 korrik 1958. Nisemi për në Çekoslovakë	98
78. — 13 korrik 1958. Vizitë nëpër Pragë	99
79. — 14 korrik 1958. Në kështjellën e Pragës	100
80. — 15 korrik 1958. Nisemi për në Karlovi-Vari	101
81. — 16 korrik 1958. Nga qëndrimi në Karlovi-Vari	102

	Faqe
82. — 17 korrik 1958. Njihemi me kuriozitetet e Karlovi-Varit	103
83. — 18 korrik 1958. Nga qëndrimi në Çekoslovakë	104
84. — 19 korrik 1958. Të mbështetëm popujt e Libanit e të Jordanisë	105
85. — 20 korrik 1958. Nëpër Çekoslovakë	106
86. — 21 korrik 1958. Nga vizita në Çekoslovakë	107
87. — 22 korrik 1958. Nga vizita nëpër Çekoslovakë	108
88. — 23 korrik 1958. Në shtëpinë e Gëtes	109
89. — 24 korrik 1958. Vazhdojmë vizitat nëpër Çekoslovakë	110
90. — 25 korrik 1958. Në një fabrikë qeramike	111
91. — 26 korrik 1958. Nëpër Çekoslovakë	112
92. — 28 korrik 1958. Do të qëndrojmë për vizitë zyrtare në Çekoslovakë	113
93. — 29 korrik 1958. Në kështjellën e Meternikut	114
94. — 31 korrik 1958. Për gjah në rrethin e Sokolovës	115
95. — 1 gusht 1958. Gjatë qëndrimit në Çekoslovakë	116
96. — 3 gusht 1958. Për gjah	117
97. — 4 gusht 1958. Lajme nga Shqipëria	118

	Faqe
98. — 5 gusht 1958. Në uzinat «Skoda» dhe në fabrikën «Pilzen»	119
99. — 7 gusht 1958. Caktuar itinerarin e shëtijtes në Çekosllovakia	120
100. — 10 gusht 1958. Një krim i titistëve	121
101. — 11 gusht 1958. Të demaskojmë titistët për krimet e tyre të shëmtuara ndaj qytetarëve shqiptarë	122
102. — 11 gusht 1958. Takim me Pajetën	124
103. — 12 gusht 1958. Takim me Skoçimaron	125
104. — 13 gusht 1958. Vizitë kortezie Shirokit	126
105. — 14 gusht 1958. Në fushën e betejës së Austerlicit	127
106. — 15 gusht 1958. Në uzinën e traktorëve «Zetor»	128
107. — 16 gusht 1958. Vizitë në Sllovakia	129
108. — 17 gusht 1958. Për gjah	130
109. — 18 gusht 1958. Vizitë nëpër Çekosllovakia	131
110. — 19 gusht 1958. Në malet e Tatras	132
111. — 20 gusht 1958. Takim me shokë të huaj	133
112. — 21 gusht 1958. Në Ostravë	134
113. — 22 gusht 1958. Vizitë në një uzinë metalurgjike	135
114. — 23 gusht 1958. Në Gotvaldov	136
115. — 25 gusht 1958. Në Lidicen martire	137

	Faqe
116. — 26 gusht 1958. Vizitë në muzeun «Klement Gotvald»	138
117. — 27 gusht 1958. Sot në Pragë	139
118. — 28 gusht 1958. Nesër nisemi për Shqipëri	140
119. — 29 gusht 1958. U kthjem në atdhe	141
120. — 31 gusht 1958. Darkë për një grup shokësh italianë	142
121. — 2 shtator 1958. Drekë me sovjetikë	143
122. — 5 shtator 1958. Takim me delegacionin parlamentar bullgar	144
123. — 8 shtator 1958. Mbrëmje të koreanët	145
124. — 9 shtator 1958. Përkrahim çështjen e drejtë të popullit kinez	146
125. — 9 shtator 1958. Në ambasadën e RP të Bullgarisë	147
126. — 11 shtator 1958. Mbrëmje në ambasadën sovjetike	148
127. — 12 shtator 1958. Takim me delegacionin e miqësisë Bashkimi Sovjetik-Shqipëri	149
128. — 13 shtator 1958. Aktivitete politike	150
129. — 18 shtator 1958. Drekë për ambasadorin çekosllovak	151
130. — 19 shtator 1958. Takim me delegacionin parlamentar hungarez	152
131. — 20 shtator 1958. Në ambasadën hungareze	153

	Faqe
132. — 21 shtator 1958. Darkë tek Ivanovi	154
133. — 24 shtator 1958. «Izvestia» shkruan për vendin tonë	155
134. — 29 shtator 1958. Takim me një shok maroken	156
135. — 1 tetor 1958. Në aktivitetet për përvjetorin e shpalljes së RP të Kinës	157
136. — 22 tetor 1958. Takim me ambasadorin egjiptian	158
137. — 27 tetor 1958. Takim me shokë finlandezë	159
138. — 30 tetor 1958. Takim me shokë indonezianë	160
139. — 7 nëntor 1958. Në pritjen e dhënë nga ambasadori sovjetik për 41-vjetorin e Revolucionit të Tetorit	161
140. — 12 nëntor 1958. Takim me shoqe të huaja	162
141. — 13 nëntor 1958. Hungarezët nuk na japin kredinë që u kërkua	163
142. — 28 nëntor 1958. Takim me kryetarin e delegacionit azerbajxhanas	164
143. — 1 dhjetor 1958. Ngushëllime për vdekjen e Damianovit	165
144. — 2 dhjetor 1958. Takim me delegacionin azerbajxhanas	166
145. — 9 dhjetor 1958. Nisemi për në Bashkimin Sovjetik	167
146. — 10 dhjetor 1958. Në teatrin «Balshoi»	168

	Faqe
147. — 14 dhjetor 1958. Takim me bashkatdhetarët	169
148. — 15 dhjetor 1958. Marrim pjesë në Plenumin e PK të BS	170
149. — 16 dhjetor 1958. Ndalesë e rastit në Budapest	171
150. — 17 dhjetor 1958. U kthyem në Shqipëri	172
151. — 19 dhjetor 1958. Takim me ambasadorin korean	173
152. — 20 dhjetor 1958. Takim me ambasadorin rumun	174
153. — 25 dhjetor 1958. Takim me delegacionin e Komsomolit dhe shkrimtarin Pervencev	175
154. — 30 dhjetor 1958. Takim me ambasadorin korean	176

1959

1. — 1 janar 1959. Ambasadori sovjetik më uron Vitin e Ri	179
2. — 4 janar 1959. Përgatitemi për t'u nisur për në RD Gjermane	180
3. — 5 janar 1959. Nisemi për në RD Gjermane. Një ndalesë e shkurtër në Budapest	181
4. — 6 janar 1959. Kadari na bën vizitë kortezie	182
5. — 7 janar 1959. Arritëm në Berlin. Filluam bisedimet	183

	Faqe
6. — 8 janar 1959. Në shtëpinë ku u mbajt Konferenca e Potsdamit	185
7. — 9 janar 1959. Në Lajpcig vizitojmë muzeun «Dimitrov»	187
8. — 10 janar 1959. Vazhdon vizita nëpër RD Gjermane. Festojmë 46-vjetorin e shokut Mehmet	189
9. — 11 janar 1959. Mbaruan bisedimet me gjermanët. Nisemi për në Çekosllovakë	191
10. — 12 janar 1959. Arritëm në Çekosllovakë. Filluam bisedimet	193
11. — 13 janar 1959. Çekët i shikojnë çështjet vetëm nga ana e interesit të tyre	195
12. — 14 janar 1959. Vizitojmë Sllovakinë	196
13. — 15 janar 1959. Në Brno	198
14. — 16 janar 1959. Përfunduan bisedimet me çekosllovakët	199
15. — 17 janar 1959. Mbaroi vizita jonë zyrtare në Çekosllovakë	200
16. — 18 janar 1959. Gjah i mbarë	201
17. — 19 janar 1959. Në Tatra po e kalojmë mirë	202
18. — 20 janar 1959. Përsëri për gjah	204
19. — 21 janar 1959. Një shëtitje e këndshme me slitë nëpër borë	205
20. — 22 janar 1959. Në Bashkimin Sovjetik	206

	Faqe
21. — 23 janar 1959. Udhëtojmë nëpër Ukrainë	207
22. — 24 janar 1959. Arritëm në Moskë	208
23. — 25 janar 1959. Në ekspozitën e arteve figurative të vendeve socialiste	209
24. — 27 janar 1959. Filloi punimet Kongresi i 21-të i PK të BS	210
25. — 28 janar 1959. Në Kongresin e 21-të të PK të BS	211
26. — 29 janar 1959. Përhëndeta Kongresin e 21-të të PK të BS	212
27. — 30 janar 1959. Në Kongresin e 21-të të PK të BS	213
28. — 31 janar 1959. Vazhdojnë punimet e Kongresit të 21-të të PK të BS	214
29. — 1 shkurt 1959. Poljanski na fton për drekë	215
30. — 3 shkurt 1959. Me sa duket kongresin nuk do ta ndjek më	217
31. — 4 shkurt 1959. Punimet e kongresit po i ndjek me anë të shtypit	218
32. — 5 shkurt 1959. Mbeta brenda nga gripi	219
33. — 7 shkurt 1959. Së shpejti do të nisem për Shqipëri	220
34. — 9 shkurt 1959. Pritje te Hrushovi. Takim me Çuvahinin	221
35. — 10 shkurt 1959. U kthyem në Shqipëri	222

	Faqe
36. — 18 shkurt 1959. Plenumi i KQ aprovon veprimtarinë e delegacionit tonë në RD Gjermane, në Çekosllovaki dhe në Bashkimin Sovjetik	223
37. — 23 shkurt 1959. Darkë në ambasadën sovjetike	224
38. — 24 shkurt 1959. U kthye Hysniu nga Moska	225
39. — 25 shkurt 1959. Do të marrim pjesë në mbledhjen e ministrave të tregtisë së jashtme të vendeve të kampit socialist	226
40. — 28 shkurt 1959. Algjerianët kërkojnë t'i ndihmojmë për shërimin e të plagosurve	227
41. — 2 mars 1959. Ivanovi ikën për pushime	228
42. — 11 mars 1959. Bisedë formale e përfaqësuesit sovjetik	229
43. — 15 mars 1959. Të demaskojmë synimet armiqësore të grupit revizionist të Beogradit	230
44. — 17 mars 1959. Në rrugën e provokimeve dhe të aventurave	231
45. — 4 prill 1959. Pritje në ambasadën hungareze	232
46. — 14 prill 1959. Bisedë me delegacionin e Ministrisë së Gjeologjisë të Bashkimit Sovjetik	233
47. — 17 prill 1959. Trockisti Tito — komunist specifik (shënime — teza)	234

	Faqe
48. — 30 prill 1959. Në ekspozitën industriale çekosllovake	239
49. — 7 maj 1959. Takim me djalin e ministrit gjerman të Komunikacioneve	240
50. — 9 maj 1959. Në pritjen e dhënë nga ambasada çekosllovake me rastin e festës	241
51. — 11 maj 1959. Hrushovi do të vijë në Shqipëri	242
52. — 12 maj 1959. Filloi mbledhja e KNER-it	243
53. — 14 maj 1959. Koncert për pjesëmarrësit në mbledhjen e KNER-it	244
54. — 15 maj 1959. Grotevoli vjen në vendin tonë për pushime	245
55. — 16 maj 1959. Bisedë me Kosiginin	246
56. — 17 maj 1959. Darkë për delegacionin sovjetik	247
57. — 19 maj 1959. Hrushovi vendos kushte për ardhjen në Shqipëri	248
58. — 21 maj 1959. Pranojmë kushtin e Hrushovit por vetëm për aq ditë sa do të qëndrojë në vendin tonë	249
59. — 22 maj 1959. Aktivitete politike	250
60. — 25 maj 1959. Erdhi Hrushovi. Filluam bisedimet	251
61. — 26 maj 1959. Nga vizitat e Hrushovit në Tiranë	252

	Faqe
62. — 27 maj 1959. Filloi vizita nëpër vendin tonë	253
63. — 28 maj 1959. Nga vizitat në rrethin e Korçës	254
64. — 28 maj 1959. Pin De Huaaja vjen në vendin tonë	255
65. — 29 maj 1959. Vazhdojnë bisedimet me sovjetikët	256
66. — 30 maj 1959. U nënshkrua deklarata e përbashkët shqiptaro-sovjetike	257
67. — 31 maj 1959. Nga vizita në rrethin e Vlorës	258
68. — [maj 1959] Takim me një gazetar çekoslovak	259
69. — 1 qershor 1959. Nga vizita në rrethet e Jugut	260
70. — 2 qershor 1959. Hrushovi vazhdon vizitën në Jug. Pin De Huaaja u largua	261
71. — 3 qershor 1959. Nga qëndrimi i Hrushovit në Shqipëri	262
72. — 4 qershor 1959. Hrushovi u largua	263
73. — 5 qershor 1959. Kryetari i Presidiumit të Asamblesë së Lartë Popullore të RDP të Koresë vjen në Shqipëri	264
74. — 5 qershor 1959. Darkë për Grotevolin	265
75. — 6 qershor 1959. Grotevoli u largua	266
76. — 6 qershor 1959. Takim me Çoi Yon Gënin	267
77. — 6 qershor 1959. Disa gjëra që ngjallin dyshim nga bisedat me Hrushovin	268

	Faqe
78. — 8 qershor 1959. Pritje për Çoi Yon Gënin	270
79. — 9 qershor 1959. Pritje në ambasadën koreane	271
80. — 10 qershor 1959. Çoi Yon Gëni u largua nga vendi ynë	272
81. — 12 qershor 1959. Drekë për Kopalinin	273
82. — 16 qershor 1959. Miq çekoslovakë vijnë për pushime	274
83. — 20 qershor 1959. Ne dëshirojmë të jetojmë në miqësi me të gjithë popujt, veçanërisht me popujt fqinjë	275
84. — 21 qershor 1959. Paralajmërim përkrahësve të politikës së raketave	276
85. — 29 qershor 1959. Haile Selasie I ndalon në Rinas	277
86. — 30 qershor 1959. Takim me ambasadorin çekoslovak	278
87. — 2 korrik 1959. Drekë për shokët çekoslovakë	279
88. — 6 korrik 1959. Takim me ambasadorin bullgar	280
89. — 9 korrik 1959. Në Çekoslovakë për vizitë	281
90. — 10 korrik 1959. Bisedë me Novotnin	282
91. — 11 korrik 1959. Në Karlovi-Vari	283
92. — 12 korrik 1959. Takim me oficerë shqiptarë	284

	Faqe
93. — 14 korrik 1959. Nga qëndrimi në Karlovi-Vari	285
94. — 15 korrik 1959. Nga qëndrimi në Karlovi-Vari	286
95. — 18 korrik 1959. Vizitë në Ostrava	287
96. — 19 korrik 1959. Në Pilzen	288
97. — 20 korrik 1959. Shokët na sjellin lajme nga Shqipëria	289
98. — 22 korrik 1959. Në Karlovi-Vari	290
99. — 24 korrik 1959. Për gjah	291
100. — 25 korrik 1959. Darkë me Kosiginët	292
101. — 26 korrik 1959. Takim me mareshalin Konjev	293
102. — 27 korrik 1959. Takim me Maurerin	294
103. — 29 korrik 1959. Në kinema me Maurerët	295
104. — 30 korrik 1959. Shëtitje me Konjevin	296
105. — 31 korrik 1959. Vijnë shokë nga Tirana	297
106. — 1 gusht 1959. Pamë një film anglez	298
107. — 2 gusht 1959. Vizitë në Marianskij-Lazne	299
108. — 3 gusht 1959. Në Marianskij-Lazne	300
109. — 4 gusht 1959. Në Karlovi-Vari	301
110. — 5 gusht 1959. Bisedë me Skoçimaron	302
111. — 6 gusht 1959. Përsëri në Pragë	303

	Faqe
112. — 7 gusht 1959. Shiroki na fton për darkë	304
113. — 8 gusht 1959. Nisemi për në Bullgari	305
114. — 9 gusht 1959. Në Vitosha me Jugovin	306
115. — 10 gusht 1959. Në Vitosha	307
116. — 11 gusht 1959. Takim me shokë bullgarë	308
117. — 12 gusht 1959. Në Dimitrovgrad dhe në Plovdiv	309
118. — 13 gusht 1959. Përsëri në Sofje	310
119. — 16 gusht 1959. Në Pançevo	311
120. — 18 gusht 1959. Në pallatin e Vranjës	312
121. — 20 gusht 1959. Nga vizita nëpër Bullgari	313
122. — 22 gusht 1959. Në Borovec	314
123. — 23 gusht 1959. Nisemi për në Sofje	315
124. — 25 gusht 1959. Drekë me Zhivkovin	316
125. — 26 gusht 1959. Vizitë në uzinën «Vasil Kolarov»	317
126. — 30 gusht 1959. Vizitë nëpër Bullgari	318
127. — 31 gusht 1959. Kthehemi në Sofje	319
128. — 1 shtator 1959. Lajm i hidhur nga atdheu	320
129. — 2 shtator 1959. Vizitë në ambasadën tonë	321
130. — 3 shtator 1959. Në Vraça dhe Mihailovgrad	322
131. — 4 shtator 1959. Darkë në ambasadën sovjetike	323

	Faqe
132. — 5 shtator 1959. Takim me gazetarë bullgarë	324
133. — 7 shtator 1959. Kurorë në Mauzoleun e Dimitrovit	325
134. — 8 shtator 1959. Në mbrëmjen solemne për 15-vjetorin e çlirimit të Bullgarisë	326
135. — 9 shtator 1959. Paradë e manifestim në Sofje	327
136. — 10 shtator 1959. Në Budapest, takim me Kadarin dhe Kishin	328
137. — 11 shtator 1959. U kthyem në atdhe	329
138. — 15 shtator 1959. Takim me ambasadorin bullgar	330
139. — 20 shtator 1959. Udhëheqja revizioniste jugosllave përpiket që të na pengojë e të na dëmtojë	331
140. — 23 shtator 1959. Delegacioni ynë nis për në RP të Kinës	332
141. — 24 shtator 1959. Takim me Mackieviçin	333
142. — 30 shtator 1959. Mbledhje solemne për festën e kinezëve	334
143. — 1 tetor 1959. Në pritjen e dhënë nga ambasada kineze	335
144. — 4 tetor 1959. Sukses i ri i shkencës sovjetike	336
145. — 5 tetor 1959. Takim me ambasadorin bullgar	337

	Faqe
146. — 6 tetor 1959. Aktivitete politike	338
147. — 7 tetor 1959. Zhivkovi erdhi për vizitë miqësore te ne	339
148. — 8 tetor 1959. Nga vizita e Zhivkovit në Tiranë	340
149. — 9 tetor 1959. Në Vlorë për vizitë	341
150. — 10 tetor 1959. Vizitë në Pashaliman	342
151. — 11 tetor 1959. Vizitë në rrethin e Sarandës	343
152. — 12 tetor 1959. Në Butrint	344
153. — 13 tetor 1959. Vizitë në rrethin e Gjirokastrës	345
154. — 14 tetor 1959. Koncert për Zhivkovin	346
155. — 16 tetor 1959. Darkë për Zhivkovin	347
156. — 17 tetor 1959. Zhivkovi u largua nga Shqipëria	348
157. — 31 tetor 1959. Revizionistët jugosllavë tremben nga e vërteta	349
158. — [tetor 1959]. Mbi parimin socialist të barazisë së popujve	350
159. — 3 nëntor 1959. Çështjen e revizionistëve jugosllavë Partia jonë e ka parë, e sheh dhe do ta shohë kurdoherë drejt	351
160. — 6 nëntor 1959. Mbledhje solemne me rastin e 42-vjetorit të Revolucionit të Tetorit	352
161. — 7 nëntor 1959. Darkë në ambasadën sovjetike	353

	Faqe
162. — 11 nëntor 1959. Prita ansamblin e këngëve e të valleve të Vietnamit	354
163. — 20 nëntor 1959. Pamë filmin «Lulëzo Shqipëri»	355
164. — 24 nëntor 1959. Takim me Kopalinin	356
165. — 27 nëntor 1959. Erdhi delegacioni sovjetik	357
166. — 28 nëntor 1959. Do të mbrojmë deri në fund pastërtinë e marksizëm-leninizmit	358
167. — 29 nëntor 1959. Pravda boton një artikullin tim	359
168. — 1 dhjetor 1959. Aktivitete politike	360
169. — 3 dhjetor 1959. Darkë për delegacionin sovjetik	361
170. — 4 dhjetor 1959. Darkë në ambasadën sovjetike	362
171. — 8 dhjetor 1959. Delegacioni sovjetik u largua	363
172. — 16 dhjetor 1959. Sigurimi dhe mirëqenia e popullit tonë vlejné më shumë se buzëqeshjet e ujkut	364
173. — 25 dhjetor 1959. Kuvendi Popullor aprovoi politikën e jashtme të Qeverisë sonë	365
174. — 28 dhjetor 1959. Manovrat e revizionistëve jugosllavë kundër Partisë dhe vendit tonë nuk do të pinë kurrë ujë	366

	1960	Faqe
1. — 6 janar 1960. Bisedë me drejtorin e Radiodifuzionit të Irakut		369
2. — 12 janar 1960. Erdhi shoku Aidit		370
3. — 12 janar 1960. Duke vepruar kështu, udhëheqësit bullgarë shkelin traktatin e miqësisë që kanë me ne		371
4. — 14 janar 1960. Gjendje e errët, e parregullt dhe shqetësuese për mbrojtjen e kampit socialist		372
5. — 16 janar 1960. Intriga dhe dallavere nëpër kulisa të revizionistëve modernë		373
6. — 18 janar 1960. Hrushovi përpiqet të futë ujë titistë në vathë		374
7. — 19 janar 1960. Takim me ambasadorin sovjetik		375
8. — 20 janar 1960. Bisedë me shokun Aidit dhe shokë të tjerë indonezianë		376
9. — 21 janar 1960. Nënshkruam deklaratën e përbashkët me PK të Indonezisë		377
10. — 22 janar 1960. Aiditi u largua		378
11. — 23 janar 1960. Sovjetikët përpiqen të mësojnë si shkuan bisedimet tona me Aiditin		379
12. — 26 janar 1960. Ivanovi e mori përgjigjen e asaj që kërkonte të mësonte		380
13. — 27 janar 1960. Do të marrim pjesë në Kongresin e 9-të të PK të Italisë		381

	Faqe
14. — 28 janar 1960. Do të marrim pjesë në mbledhjen për zhvillimin e bujqësisë në vendet e Evropës Lindore	382
15. — 30 janar 1960. Nisemi për në Moskë	383
16. — 31 janar 1960. Sovjetikët përpiqen të na përpunojnë kundër Kinës	384
17. — 1 shkurt 1960. Nga qëndrimi në Moskë	385
18. — 2 shkurt 1960. Një mbledhje e shpëlarë	386
19. — 3 shkurt 1960. Hrushovi kërcënon!	387
20. — 4 shkurt 1960. Në mbledhjen e Komitetit Konsultativ Politik të Traktatit të Varshavës	388
21. — 5 shkurt 1960. Vizitë protokollare Hrushovit	389
22. — 6 shkurt 1960. Në ambasadën tonë në Moskë	390
23. — 7 shkurt 1960. Nga qëndrimi në Moskë	391
24. — 9 shkurt 1960. Përsëri në gjirin e atdheut të dashur, të ngrohtë e plot diell	392
25. — 11 shkurt 1960. Mbledhje e Byrosë Politike	393
26. — 14 shkurt 1960. Në pritjen e dhënë nga ambasada kineze	394
27. — 15 shkurt 1960. Pritje e dhënë nga ambasada sovjetike	395
28. — 10 mars 1960. Qëndrim i çuditshëm ndaj udhëheqësve të borgjezisë indiane	396

	Faqe
29. — 25 mars 1960. Politikë zbutëse, kompromisesh dhe lëshimesh ndaj imperializmit amerikan	397
30. — 26 mars 1960. Vigjilencë!	398
31. — 30 mars 1960. Vërtetohen dyshimet mbi punën e parregullt të gjeologëve sovjetikë	399
32. — 31 mars 1960. Takim me shokun Behar Shtylla	400
33. — 4 prill 1960. Pritje nga ambasada hungareze	401
34. — 11 prill 1960. Çfarë fshihet prapa kësaj kthese?!	402
35. — 13 prill 1960. Bisedë me shokun Spiro Koleka	403
36. — 19 prill 1960. Mbrëmje tradicionale shqiptaro-sovjetike	404
37. — 20 prill 1960. Revista «Probleme të paqes e të socializmit» është në dorë të sovjetikëve	405
38. — 21 prill 1960. Orientime kundërrevolucionare të renegatit Tito	406
39. — 22 prill 1960. Mbledhje solemne për ditëlindjen e Leninit	407
40. — 23 prill 1960. Letër nga Dezhi	408
41. — 25 prill 1960. Takim me shokun Spiro Koleka	409
42. — 26 prill 1960. Takim me shokun Manush Myftiu	410

43. — 27 prill 1960. Pravda boton një artikullin tim	411
44. — 28 prill 1960. Shenjë «behari» nga Moska!	412
45. — 8 maj 1960. Veprime që na imponojnë rritjen e vigjencës për mbrojtjen e atdheut tonë	413
46. — 9 maj 1960. Shoku Mehmet do të shkojë në Rumani	414
47. — 10 maj 1960. Takim me ambasadorin korean	415
48. — 11 maj 1960. Deklarata të dëmshme ndaj vendit tonë të ambasadorit sovjetik në Athinë	416
49. — 11 maj 1960. Mehmeti u nis për në Rumani	417
50. — 12 maj 1960. Dezhi premtan, por unë nuk kam shumë besim	418
51. — 13 maj 1960. Mehmeti u kthye nga Bukureshti	419
52. — 14 maj 1960. Logjikë banditësh	420
53. — 16 maj 1960. Pikëpamje të kundërta me ambasadorin sovjetik	421
54. — 17 maj 1960. Një hap i mirë	422
55. — 18 maj 1960. Takim me ambasadorin sovjetik	423
56. — 22 maj 1960. «Sihariq» i ambasadorit sovjetik	424
57. — 31 maj 1960. Drejtësi për vëllezërit tanë të Kosovës	425

58. — 4 qershor 1960. Hrushovi propozon mbledhjen e partive komuniste e punëtore të vendeve të kampit socialist	426
59. — 6 qershor 1960. Një manovër dinake	427
60. — 8 qershor 1960. Letër e dytë e Hrushovit — çfarë fshihet pas veprimeve të tij?	428
61. — 15 qershor 1960. Ambasadori sovjetik kërkon takim	429
62. — 16 qershor 1960. Partia jonë kurrë nuk do të shkelë në dërrasë të kalbur	430
63. — 18 qershor 1960. Shoku Hysni niset për në Bukuresht	431
64. — 20 qershor 1960. Takim me shokët Mehmet e Gogo	432
65. — 21 qershor 1960. Një mbledhje që shndërron në komplot	433
66. — 22 qershor 1960. Partinë e Punës Hrushovi nuk do ta gënjejë dot kurrë	434
67. — 23 qershor 1960. Asnjë lëshim revizionistëve	435
68. — 24 qershor 1960. Të qëllohet pa mëshirë kundër revizionistëve	436
69. — 27 qershor 1960. Filloi lufta jonë kundër revizionistëve të rinj e të maskuar	437
70. — 1 korrik 1960. Sovjetikët përpiqen të tastojnë me çdo kusht pulsën tonë	438
71. — 5 korrik 1960. Përse këto shqetësime?	439

	Faqe
72. — 7 korrik 1960. Në mbledhjen e Byrosë Politike	440
73. — 8 korrik 1960. Asnjëri, kushdo qoftë, nuk i lejojmë të diskutojë për kufijtë e vendit tonë	441
74. — 9 korrik 1960. Kërthet e revizionistëve sovjetikë janë shumë të rrezikshme	442
75. — 10 korrik 1960. Vërejtje kritike mbi një material informativ të KQ të PK të BS	443
76. — 11 korrik 1960. Dënojmë qëndrimin e diplomatëve sovjetikë përpara sulmeve anti-shqiptare të titistëve	444
77. — 11 korrik 1960. Plenumi i KQ aprovon qëndrimin e delegacionit tonë në Bukuresht	445
78. — 12 korrik 1960. Në Plenumin e 17-të të KQ të PPSH	446
79. — 13 korrik 1960. Takim me ambasadorin gjerman	447
80. — 21 korrik 1960. Moris Torezi erdhi në vendin tonë	448
81. — 22 korrik 1960. Një veprim jo i mirë i sovjetikëve ndaj RP të Kinës	449
82. — 23 korrik 1960. Bisedime me shokët francezë	450
83. — 26 korrik 1960. Miqtë francezë vizitojnë vendin tonë	451

	Faqe
84. — 28 korrik 1960. Takim me shokun Manush Myftiu	452
85. — 30 korrik 1960. Torezi në Durrës	453
86. — 1 gusht 1960. Me Torezin në kombinatin e tekstileve «Stalin»	454
87. — 2 gusht 1960. Nga qëndrimi i Torezit në vendin tonë	455
88. — 3 gusht 1960. Sovjetikët filluan të veprojnë si trockistët jugosllavë, vigjilencë!	456
89. — 5 gusht 1960. Torezit do t'i flas hapur mbi qëndrimin e sovjetikëve	458
90. — 6 gusht 1960. Torezi indinjohet nga veprimet skandaloze të diplomatëve sovjetikë në vendin tonë	459
91. — 7 gusht 1960. Torezi në Shkodër	460
92. — 8 gusht 1960. Darkë lamtumire për Torezin	461
93. — 9 gusht 1960. Torezi u largua nga vendi ynë	462
94. — 11 gusht 1960. Manovra pa rezultat të Ivanovit dhe të padronëve të tij	463
95. — 12 gusht 1960. Ku po shkon udhëheqja sovjetike?	464
96. — 16 gusht 1960. Na thërresin në Moskë për të na imponuar kapitullimin	465
97. — 16 gusht 1960. Ambasadori sovjetik Ivanov u largua nga vendi ynë	466

	Faqe
98. — 19 gusht 1960. Fitore kolosale për njerëzimin	467
99. — 20 gusht 1960. Anija kozmike sovjetike u kthye në tokë	468
100. — 21 gusht 1960. Shqipëria ka zot popullin e saj	469
101. — 25 gusht 1960. Ne mbrojmë drejtësinë marksiste-leniniste	470
102. — 1 shtator 1960. Mao na falënderon për mbrojtjen që i bëmë PK të Kinës në Bukuresht	471
103. — 2 shtator 1960. Bisedë me shokun Ramiz Alia	472
104. — 6 shtator 1960. Mbi korrespondencën tonë me KQ të PK të BS	473
105. — 8 shtator 1960. Paraqitëm ngushëllime për vdekjen e Pikut	474
106. — 9 shtator 1960. Debat politik me ambasadorin bullgar	475
107. — 10 shtator 1960. Hrushovi dhe kolegët e tij e shtojnë presionin mbi ne	476
108. — 12 shtator 1960. Shoku Mehmet u nis për në Nju-Jork	477
109. — 14 shtator 1960. Kina pranon të na japë drithëra	478
110. — 15 shtator 1960. Takim me ambasadoren gjermane	479

	Faqe
111. — 20 shtator 1960. Shoku Mehmet arriti në Nju-Jork	480
112. — 21 shtator 1960. Bisedë me ambasadorin kinez	481
113. — 23 shtator 1960. Përgatitemi për Mbledhjen e Moskës	482
114. — 27 shtator 1960. Shokët Hysni dhe Ramiz nisen për në Moskë	483
115. — 28 shtator 1960. Takim me ambasadorin kinez	484
116. — 28 shtator 1960. Skena tragjike me aktorë Hrushovin dhe Titon	485
117. — 30 shtator 1960. «Parabombat» tona për udhëheqjen sovjetike	486
118. — [Shtator 1960]. Teza mbi katër probleme themelore të marksizëm-leninizmit	487
119. — 2 tetor 1960. Projektdeklaratë revizioniste e papranueshme	502
120. — 2 tetor 1960. Përgatitem për Mbledhjen e Moskës	504
121. — 7 tetor 1960. Ne s'jemi për serenata nokturne	505
122. — 11 tetor 1960. Mehmeti u largua nga Nju-Jorku	506
123. — 22 tetor 1960. Mehmeti u kthye në atdhe	507
124. — 24 tetor 1960. Hysniu dhe Ramizi u kthyen nga Bashkimi Sovjetik	508

	Faqe
125. — 31 tetor 1960. Byroja Politike aprovon fjalën që do të mbahet në Mbledhjen e Moskës	509
126. — 1 nëntor 1960. Plenumi i KQ aprovon fjalën që do të mbahet në Mbledhjen e Moskës	510
127. — 3 nëntor 1960. Nisemi për në Bashkimin Sovjetik	511
128. — 4 nëntor 1960. Në Uzhgorod	512
129. — 6 nëntor 1960. Arritëm në Moskë	513
130. — 7 nëntor 1960. Falsitet në qëndrimet e udhëheqësve aktualë sovjetikë ndaj nesh	514
131. — 8 nëntor 1960. Një veprim i pandershëm dhe antimarksist i Hrushovit	515
132. — 9 nëntor 1960. Për darkë te Moris Torezi	517
133. — 10 nëntor 1960. Filloi Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore të botës	518
134. — 11 nëntor 1960. Mikoiani kërkon takim të dytë	520
135. — 11 nëntor 1960. Me shokët në atdhe mbajmë lidhje të vazhdueshme	521
136. — 12 nëntor 1960. Mbledhje e stuhishme me udhëheqësit sovjetikë	522
137. — 12 nëntor 1960. Në atdhe punët ecin mirë	523
138. — 13 nëntor 1960. Vazhdon Mbledhja e 81 partive në Moskë	524

	Faqe
139. — 13 nëntor 1960. Marrim masa për t'u kthyer në atdhe	525
140. — 14 nëntor 1960. Sovjetikët kërkojnë përsëri takim	526
141. — 16 nëntor 1960. Kryem detyrën tonë të shenjtë ndaj marksizëm-leninizmit	527
142. — 16 nëntor 1960. Sovjetikët i kanë shtuar provokacionet	528
143. — 17 nëntor 1960. Vazhdon Mbledhja e Moskës	530
144. — 18 nëntor 1960. Vizitë delegacionit kinez	531
145. — 19 nëntor 1960. Kinezët na kthejnë vizitën	532
146. — 20 nëntor 1960. Në Mbledhjen e Moskës lakenjtë e sovjetikëve na sulmojnë	533
147. — 20 nëntor 1960. Vendosëm ta shtyjmë mbajtjen e Kongresit tonë të 4-t	534
148. — 24 nëntor 1960. Hrushovi dhe pasuesit e tij i zgjatin diskutimet	535
149. — 25 nëntor 1960. Nisemi për t'u kthyer në atdhe	536
150. — 26 nëntor 1960. Të evitohet çdo provokacion me sovjetikët	537
151. — 27 nëntor 1960. Rrugës për t'u kthyer në atdhe, qëndrojmë në Hungari	538
152. — 28 nëntor 1960. Një ndalesë e shkurtër në Vjenë	539

	Faqe
153. — 29 nëntor 1960. Në atdhe na presin krahëhapur e me entuziazëm të madh	540
154. — 1 dhjetor 1960. U nënshkrua Deklarata e Moskës	541
155. — 2 dhjetor 1960. Erdhën Hysniu dhe Ramizi	542
156. — 6 dhjetor 1960. Shtypi ynë boton Deklaratën e Moskës	543
157. — 15 dhjetor 1960. Aprovim i plotë i vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë	544
158. — 19 dhjetor 1960. Unitet i çeliktë, entuziazëm i papërshkruar. Asnjë lëshim revizionistëve sovjetikë	545
159. — 20 dhjetor 1960. Lufta parimore e konsekuente kundër imperializmit e revizionizmit është rruga e Partisë sonë	546
160. — 29 dhjetor 1960. Takim me ambasadorët tanë që ndodhen në atdhe	547
Treguesi tematik i lëndës	549
Treguesi i emrave	556
Treguesi gjeografik	565